RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI
"AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË"

BASHKIA GRAMSH

TIRANË, tetor 2025

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 3
1. 1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit. 3
a. Përshkrim i shkurtër 3
b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij. 3
c. Qëllimi i auditimit: 3
d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave. 4
e. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore; 4
f. Gjetjet kryesore: 4
g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore. 5
1.2. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit. 5
II. HYRJE 8
1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit 8
2. Identifikimi i çështjes: 8
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar: 9
4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH: 9
5. Kriteret e vlerësimit: 9
6. Standardet e auditimit 11
7. Metodat e auditimit 11
8. Dokumentimi i rezultateve të auditimit: 12
III. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT 12
1. Informacion i përgjithshëm 12
2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT. 12
2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik 12
2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin, dhe monitorimin e planit të buxhetit 32
2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në së pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin e rregullator në fuqi 65
2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve 85
2.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës publike (Aseteve dhe Pyjeve Kullotave) të transferuara sipas VKM 130
2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit 153
2.7 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtës së Territorit të Njësive Vendore (IMTV) 160
2.8 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm 170
III. GJETJE DHE REKOMANDIME 192
A. MASA ORGANIZATIVE 192
B. MASA SHPËRBLIM DËMI 209
C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE. 209
D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH 211
E. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE 214
F. MASA DISIPLINORE 214
G. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTARTËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL 217

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. 1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

a. Përshkrim i shkurtër

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me objektiv vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Gramsh, për aktivitetin ekonomik dhe financiar, prokurimet publike, investimet publike, planifikimi dhe zhvillimi i territorit, etj. Auditimi mbuloi periudhën nga data 01.01.2024 deri në datën 31.12.2024 për auditimin financiar dhe nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2024 për auditimin e përputhshmërisë. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive kryesore nga Bashkia Gramsh si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore, realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore, mbajtjen e evidencës kontabël, zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e procedurave të prokurimit publik, planifikimi dhe zhvillimi i territorit etj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore" nenit 50 "Auditi i jashtëm" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "*1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose audituesë të tjerë ligjorë".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Gramsh administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit, për të siguruar qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024, duke vlerësuar nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Për auditimin e përputhshmërisë për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar nëpërmjet dhënies së opinionit të përputhshmërisë.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik;
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin, dhe monitorimin e planit të buxhetit;
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në së pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin e rregullator në fuqi;
- Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve;

- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës publike (Aseteve dhe Pyjeve Kullotave) të transferuara sipas VKM;
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtës së Territorit të Njësive Vendore (IMTV);
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike të kampionuara ose në tërësi sipas rastit, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

Intervistimi - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimet e auditimit;

Verifikimi në sistemin elektronik - me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

e. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore;

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se Bashkia Gramsh për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka konstatuar 37 masa organizative dhe janë lënë 39 rekomandime, 5 masa shpërblim dëmi dhe janë lënë 6 rekomandime, 1 masa 3E dhe është lënë 1 rekomandim, 6 masa të ardhura të mungura dhe janë lënë 7 rekomandime si dhe 1 masë detyrim për arkëtim dhe është lënë 1 rekomandim. Në vijim paraqiten ato më kryesoret:

f. Gjetjet kryesore:

Nga auditimi i Bashkisë Gramsh u konstatua mangësi në dokumentacionin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore përkatësisht në:

- Në 7 raste rezulton se nuk janë argumentuar kriteret e veçanta të vendosura, si dhe KVO mjaftohet me vetëdeklaratën e operatorëve mbi përmbushjen e kritereve e cila ngarkohet në sistem dhe nuk merren masa për verifikimin e përmbushjes së kritereve nga operatori fitues në momentin e dorëzimit të dokumentacionit fizik origjinal, nga ku ka rezultuar se ka mos përputhje me kriteret e kërkuara;
- Ka rezultuar dëm ekonomik në vlerën 8,815,693 lekë si pasojë punimeve të pakryera të Bashkisë dhe janë situacionuar më tepër mbetje urbane të depozituara në impjantin e trajtimit të mbetjeve;
- Gjithashtu përdorimi pa efektivitet të fondeve në dispozicion në vlerën financiare 11,370,680 lekë;
- Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 48,280,050 lekë;
- Detyrim për arkëtim për buxhetin e Bashkisë në vlerën 2,946,790 lekë.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Njësia e prokurimit të marrë masa që të verifikojë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga specialisti i fushës për mënyrën e përzgjedhjes së kritereve të kualifikimit, si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, duke garantuar që përcaktimi i kritereve të jetë sa më i argumentuar dhe i mbështetur në përllogaritje sipas nevojave;
- Në funksion të garantimit të përmbushjes së kapaciteteve teknike, KVO të marrin masa të mos mjaftohen vetëm me vetëdeklaratat e ofertuesit të kualifikuar, por përpara lidhjes së kontratës të sigurohen për vërtetësinë e deklaratës, nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit fizik të dorëzuar;
- Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 8,815,693 lekë, dëm si pasojë punimeve të pakryera të Bashkisë dhe janë situacionuar më tepër mbetje urbane të depozituara në impjantin e trajtimit të mbetjeve;
- Titullari i AK dhe KVO, të marrin masa për garantimin e përdorimit me efektivitet të fondeve në dispozicion duke vlerësuar me kujdes dhe paanshmëri mangësitë që çojnë në skualifikimin e operatorëve ekonomik sidomos në rastet kur kjo vendimarrje shoqërohet me pasoja financiare 11,370,680 lekë;
- Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 48,280,050 lekë;
- Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 2,946,790 lekë, nga debitorët.

1.2. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

1. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2024:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Gramsh për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, nga auditimi në pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Gramsh janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të "modifikuar, me rezervë", e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Bazat për opinionin e modifikuar/kualifikuar me rezervë:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare", pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n. Ne i

kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.
Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej **24,238 mijë** lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2024, si dhe anomalitë e mëposhtme:

- Nga auditimi i procedurës të inventarizimit u konstatua se, nuk u paraqitën dokumente për kryerjen e inventarëve fizikë për aktivet e institucionit, për rrjedhojë llogaritë e aktiveve në bilancin e vitit 2024, janë mbyllur për gjendjen kontabël. Në këto kushte, llogaritë e pasqyrave financiare, nuk janë të rakorduar me gjendjen fizike gjë e cila nuk krijon besueshmëri mbi vërtetësinë e tyre. Në këtë rast, nxjerrja e pasqyrave financiare pa kryer inventarizimin fizik të të gjithë aseteve;
- Në gjendjen e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" janë përfshirë projektet "Rikonstruksion i Lagjes "Holta" dhe "Rikonstruksion i Lagjes Sporti nr. 2", në vlerën totale 2,810,976 lekë (kosto historike) të cilat nuk duhej të kontabilizoheshin në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë;
- Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" e pasqyruar në bilanc për vlerën 50,742,734 lekë dhe 211 "Pyje, kullota, plantacione" në vlerën 13,203,906 lekë, janë të pa analizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari;
- Në gjendjen e llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" në vlerën 916,488,386 lekë kosto historike është përfshirë vlera 376,538,010 lekë dhe 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" në vlerën 2,509,282,471 lekë kosto historike është përfshirë vlera 343,864,618 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Këto vlera janë të trashëguara nga bilanci i ish-komunave Gramsh (në formë tabelore në programin Excel) e pa analizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit;
- Për llogarinë 218 "Inventar ekonomik" është përllogaritur normë amortizimi i akumuluar deri më datë 31.12.2024, në vlerën 125,927,730 lekë (kosto historike) ose në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 "Pajisje kompjuterike" nga aktivet e llogarisë bazë 218 "Inventar ekonomik" e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%;
- Gjendja e llogarisë 231 "Për aktive afatgjata materiale" më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve u konstatua se, për vitin 2024 janë aktive tre kontrata të cilat ende nuk kanë përfunduar si punimet si dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer likuidimet sipas situacioneve pjesore në vlerën 93,093,690 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 231 "Për aktive afatgjata materiale" është nënvlerësuar në vlerën 93,093,690 lekë;
- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 "Investime për aktive afatgjata jo materiale" paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" në vlerën 0 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 0 lekë e cila nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 "Nga fondet e veta të investimeve" e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 "Teprica e grandeve kapitale të brendshme" në vlerën 693,000 lekë.

Opinion për auditimin e përputhshmërisë i kualifikuar/modifikuar[1]:

Mbështetur në, ISSAI 4000 "*Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë*", Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Gramsh, me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat dhe rregulloret që lidhen me procedurat e prokurimit, zbatimin e kontratave, veprimeve me bankën, etj., mbi të cilat është rënë dakord, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.

"Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Gramsh, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar/modifikuar të përputhshmërisë".

Baza për opinionin e përputhshmërisë.

Në kemi audituar veprimtarinë e Bashkisë Gramsh në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet INTOSAI-PI, "Deklarata e Limës"; INTOSAI P-10, "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20 dhe INTOSA P-50, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 217, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga Bashkia Gramsh dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e ***opinionit të kualifikuar/modifikuar,*** si më poshtë:

Në 7 raste rezulton se nuk janë argumentuar kriteret e veçanta të vendosura, si dhe KVO mjaftohet me vetëdeklaratën e operatorëve mbi përmbushjen e kritereve e cila ngarkohet në sistem dhe nuk merren masa për verifikimin e përmbushjes së kritereve nga operatori fitues në momentin e dorëzimit të dokumentacionit fizik origjinal, nga ku ka rezultuar se ka mos përputhje me kriteret e kërkuara. Po kështu, ka rezultuar një dëm ekonomik në vlerën 8,815,693 lekë si pasojë punimeve të pakryera të Bashkisë dhe janë situacionuar më tepër mbetje urbane të depozituara në impjantin e trajtimit të mbetjeve. Gjithashtu përdorimi pa efektivitet të fondeve në dispozicion me pasoja financiare prej 11,370,680 lekë. Së fundmi, në realizimin e të ardhurave ku për periudhën objekt auditimi, rezulton 48,280,050 lekë, të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë dhe detyrim për arkëtim në vlerën 2,946,790 lekë.

[1] **Opinion i modifikuar/ kualifikuar:** Referuar Manualit të Përputhshmërisë të KLSH-së (vendim nr. 24, datë 29.12.2022 q.104) *Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, **janë materiale por jo të përhapura***".

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 405/1 prot., datë 08.04.2025, i ndryshuar nga data 10.04.2025 deri më datë 04.07.2025, në Bashkinë Gramsh, mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë për periudhën nga data 01.01.2024 deri në datën 31.12.2024 për auditimin financiar dhe nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2024 për auditimin e përputhshmërisë, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. K., Përgjegjës grupi;
2. B. B., Anëtar;
3. M. H., Anëtar;
4. E. S., Anëtar;
5. H. A., Anëtar;
6. L. Gj., Anëtar;
7. A. B., Anëtar.

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.
Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.
Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Gramsh.

2. Identifikimi i çështjes:

Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të titullarëve dhe stafeve mbështetëse për realizimin e përgjegjësive publike.
Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, çështjet e vlerësuara i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së këtij institucioni publik, transparencës, përgjegjësisë dhellogaridhënies.
Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në disa kapituj ku identifikohet hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimin e auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit; përfshirë dhe gjetjet e rekomandimet së bashku me anekset. Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Gramsh.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:
Titullari i Bashkisë, dhe Nëpunësi Zbatues sipas rastit, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH", i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", etj.
Gjithashtu, stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe gjithë veprimtarisë.

4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH:
Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.
Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Gramsh është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit:
Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:
Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"
Ligji nr. 84/2023 "Për buxhetin e vitit 2023" dhe aktet normative që ndryshojnë këtë ligj.
Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", i ndryshuar;
VKM 783 datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël";
UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit", etj.;
Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar;

Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme";
Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.
Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 "Për përgatitjen e buxhetit vendor";
Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore",
Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:
Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar me Ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006";
VKM nr. 248, date 10.4.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre" i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël";
Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj.;
Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:
Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar";
Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 "Për Sistemin e Taksave Lokale", i ndryshuar;
Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar
VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", me ndryshime;
VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, "Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave";
Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
Në fushën e prokurimeve publike:
Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar;
VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe akte të tjera nënligjore për prokurimin publik;
Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar;
UMF nr. 57, datë 12,06.2014, "Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë".
Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:
Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative";
Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë";
Ligji nr. 107-2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit";
Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve të ndërtimit";
VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuar";
VKM nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore";
Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

6. Standardet e auditimit

ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; INTOSAI GOV 9100 "Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik" si dhe INTOSAI GOV 9110 "Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm"; ISSAI 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë", i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; si dhe ISSAI 4200 "Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë"; INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë" etj.; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodat e auditimit

1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël. 4. Kontrolli i vlerësimit Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre. 5. Konfirmim nga të tretët Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

4. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Gramsh me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

5. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion i kërkuar dhe i vënë në dispozicion lidhur me çështjet nën auditim.

8. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave dhe dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me stafin, kanë mbledhur dhe shqyrtuar dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, intervistave etj., të finalizuara me Akt-Konstatimet dhe Akt-Verifikimet të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Auditimi. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e mbledhura gjatë auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur vlerësimet/përfundimet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tij.

III. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Bashkia Gramsh kufizohet në veri me bashkinë Elbasan, në lindje me bashkinë Pogradec, në jug-lindje me bashkinë Maliq, në jug me bashkinë Skrapar dhe në perëndim bashkitë Berat, Kuçovë dhe Cërrik. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Gramshit.

Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia e re numëron 24,231 banorë me densitet 32.78 banorë për km², ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 36.305 banorësh dhe densitet 49.11 banorë për km². Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 739.22 km².

Bashkia e Gramshit shtrihet në një territor shumë malor në Shqipërinë qendrore, ku toka bujqësore është e paktë (rreth 14 për qind e sipërfaqes) ndërsa pjesa tjetër e territorit është zonë pyjore ose kullotë. Qendra e bashkisë së re, Gramshi, u shpall qytet në vitin 1960 si një qendër e agroindustrisë dhe e industrisë ushtarake, e cila ka lënë një trashëgimi ndotjeje dhe papunësie.

2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.

2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

Në zbatim të pikës **1** të programit të auditimit "Nr. 405/1 prot., datë 08.04.2025", i ndryshuar referuar kuadrit ligjor të veprimtarisë së Bashkisë Gramsh si më poshtë:

-Ligji nr.10296/2010 "*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar;
-Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
-Ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar;
-Ligji nr.7961 /1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar;
-Ligji nr.68/2017 "*Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*";
-Ligji "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH*";
-VKM nr.243/2015 "*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*" i ndryshuar me VKM nr.746/2018;
-VKM nr. 833 datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit";
-Udhëzimi nr. 15 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit

financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike";
-Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016.

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Gramsh, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.
Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti "Mjedisi i kontrollit"

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Gramsh në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se bashkia vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar me Vendimin nr. 129 datë 30.08.2021 "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Gramsh". Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit.
Bashkia ka miratuar Kodin e Etikës nr. 689/3 datë 18.02.2020, "Kodi standard i sjelljes në Bashkinë Gramsh", në mbështetje të Ligjit nr. 9131 datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar si dhe ligje apo rregulloret specifike që janë krijuar në bazë të një ligji specifik. Rregullorja e Brendshme dhe Kodi i Etikës janë të afishuara në faqen zyrtare të Bashkisë.
Një problematikë e evidentuar lidhur me këtë parim është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës.
Bashkia nuk ka procedura të shkruara për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave si rrjedhojë e kësaj.
-Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se për vitin 2024, *bashkia nuk ka përcaktuar procedura për mbrojtjen ndaj sinjalizuesve dhe nuk ka mekanizma të cilat i dedikohen ankesave për korrupsion.* Gjithashtu u konstatua se nuk ka evidenca që të tregojnë aftësinë e njësisë publike

për të kryer një hetim të brendshëm të drejtë dhe të ndershëm.

Gjatë vitit 2024 nuk ka patur masa disiplinore:

Bashkia vlerëson performacën e personelit nëpërmjet vlerësimeve të punës të cilët përmbajnë edhe elementë të vlerësimit dhe monitorimit për zbatimin e rregullave të etikës.

Parimi 2 -Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua mungesa e raportimeve periodike mbi monitorimin e planit të veprimit për KB. Nga Drejtoritë dhe Sektorët nuk janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në nenin 20 të Rregullores së Brendshme është përcaktuar përgjegjësia menaxheriale e drejtuesve të të gjitha strukturave të bashkisë të cilët janë përgjegjës dhe raportojnë e i japin llogari, sipas shkallës hierarkike, eprorit direkt deri tek Kryetari ose tek nëpunësit të cilëve kryetari u ka deleguar përgjegjësinë, për: Hartimin dhe monitorimin e planeve vjetore dhe periodike në përputhje me objektivat strategjike, afatmesme si dhe urdhrat dhe udhëzimet e Kryetarit, menaxhimin/administrimin e risqeve/problemeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë (nëpërmjet identifikimit, vlerësimit dhe kontrollit periodik të zbatimit të masave për zvogëlimin e risqeve), informacionin në kohë dhe në formën e kërkuar për rezultatet e arritura gjatë përmbushjes së përgjegjësive të tyre, për risqet dhe defektet serioze në veprimtarinë e strukturave që drejtojnë, si dhe për masat e marra e të zbatuara për riparimin e këtyre defekteve. Ky rregull jo gjithmonë është ndjekur dhe mungon dokumentimi i takimeve të menaxherëve me stafin e lartë menaxherial.

Bashkia Gramsh rezulton të ketë 3(tre) njësi vartësie që janë: Drejtoria e Pyjeve, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe MZSH. Njësitë e vartësisë nuk raportojnë tek titullari i bashkisë mbi performancën (përmbushjen e detyrave) gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Nëpërmjet shkresës nr. 918/1 prot., datë 28.02.2025 është dërguar pranë MFE-së "Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm", "Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm" dhe "Raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon", për vitin e mëparshëm.

Bashkia nuk ka Plan Menaxhimi të risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë për veprime korrigjuese/përmirësuese kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.

Bashkia Gramsh është aksionere me kuota 4.13% e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan e krijuar më datë 22.09.2022 dhe aksionere me kuota 8% e Shoqërisë E.. e krijuar më datë 06.12.2021. Nga auditimi i kryer, u konstatua mungesa e raportimeve zyrtare të marra përgjatë vitit 2024 mbi performancën e kompanive dhe vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Parimi 3 - Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organi gramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësive funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit te delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

Institucioni vepron mbi bazën e rregullore të brendshme të miratuar me Vendimin nr. 129 datë 30.08.2021 "Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të administratës së Bashkisë Gramsh" e cila përmban përshkrimin e vendeve të punës sipas funksioneve duke filluar nga specialistët deri tek Drejtorët e Drejtorive, të publikuara në faqen zyrtare të bashkisë.

Nga auditimi u konstatua se nuk është rishikuar rregullorja e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore e për rrjedhojë nuk ka çdo drejtori, sektor apo njësi, përgjegjësi dhe detyra të mire përcaktuara.

Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, por është bërë pjesë e dokumentit e PBA-ve, por këto nuk janë përfshirë as në rregulloren e brendshme. Bashkia Gramsh ka të hartuar dhe miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor nr.15 datë 25.02.2020.

Me Vendimin nr.08 datë 30.01.2024 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gramsh dhe njësive vartëse të saj, për vitin 2024" është miratuar struktura e përbërë nga **375** punonjës, ndër të cilat **48** nëpunës civilë.

- **Struktura organizative e bashkisë**

Administrata e Bashkisë përbëhet nga funksionarët politikë (jo nëpunës civil), nëpunësit civilë dhe punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Struktura është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga:

Funksionet politike: Kryetari; Zëvendëskryetarët; Administratoret; Kabineti. Emërimi dhe lirimi i funksionarëve politikë dhe funksionarëve të kabinetit të bashkisë bëhet me Urdhër të Kryetarit.

Nëpunësit civilë: Shërbimi Civil në bashki organizohet dhe funksionon sipas Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke përcaktuar skemën e administrimit të këtij shërbimi. Pozicionet e shërbimit civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit. Pozicionet e shërbimit civil ndahen në këto kategori:

a. Nëpunës të nivelit te lartë drejtues: - Sekretari i Përgjithshëm.
b. Nëpunës të nivelit te mesëm drejtues: - Drejtorë Drejtorie
c. Nëpunës të nivelit të ulët drejtues: - Përgjegjës Sektori
d. Nëpunës të nivelit ekzekutiv: - Specialistët.

Punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Përfshihen të gjithë punonjësit e tjerë.

Struktura e Bashkisë Gramsh për vitin 2024

		Nëpunës Civilë	**48**
Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	**375**	Nëpunës me kontratë	**327**
Numri i të punësuarve me kontratë provizore		-	-
Vende vakante		-	

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore Gramsh, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Përgjatë vitit 2024, janë rekrutuar **90** punonjës të rinj dhe janë larguar **65** punonjës. Në dosjet e personelit ka mungesë dokumentacioni, nuk janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion,

dhe as objektivat për secilin punonjës.
Bashkia Gramsh ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet e cila përditëson dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.
Një element tjetër i rëndësishëm, i cili thekson nevojën për rritje të përgjegjshmërisë menaxheriale, është procesi i delegimit, ku u konstatua se bashkia nuk përdor procedurat për delegimin e detyrave.

Parimi 4 -Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave
Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.
-Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila ka mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.
Në lidhje me rekrutimin (punësimin) e punonjësve pranë Bashkisë Gramsh
Përgjatë vitit 2024, janë rekrutuar **90** punonjës (nëpunës civil dhe punonjës me kontratë), pranë Bashkisë Gramsh. Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, por nuk ka një plan vjetor rekrutimi.
Për sa më sipër, grupi i auditimit ka verifikuar respektimin e kuadrit ligjor nga ana e bashkisë për rekrutimin (punësimin) e punonjësve gjatë kësaj periudhe kohore, konkretisht:
1-Për punësimin e **z. E. S.** , i punësuar me shkresën nr. 13/2 datë 11.01.2024, "Kontrate Individuale pune me afat" në pozicionin "Drejtor i Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerëzore" aktualisht emëruar në pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm me urdhër nr 380 datë 28.10.2024 nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se: nga ana e Bashkisë Gramsh rezulton se dosja e nëpunësit është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
2-Për punësimin e **znj. A. G.**, i punësuar me shkresën nr. 531 datë 02.02.2024, "Urdhër për punësim" të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin "Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor , Mjedisit dhe Mbrojtjes së konsumatorit", nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se: nga ana e Bashkisë Gramsh nuk rezulton, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune.
Grupi i auditimit vlerëson se, punësimi i **znj. A. G.,** pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.
3-Për punësimin e **z. E. K.** , i punësuar me shkresën nr. 1966, datë 13.05.2024, "Vendim nr 19. Datë 13.05.2024" të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin "Punonjës në shërbimin e MZSH-se Gramsh" nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se: nga ana e Bashkisë Gramsh rezulton se dosja e nëpunësit është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
Si konkluzion, punësimi pranë Bashkisë Gramsh i nëpunësve për të cilët nuk është zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi e hapur, përveçse bie ndesh me interesin publik, parimin e konkurrencës së lirë dhe barazisë përpara ligjit, ndër të tjera, përbën një risk të shtuar duke ndikuar negativisht në mbarëvajtjen e punës në Bashkinë Gramsh.
Për sa më sipër, Bashkia Gramsh ka vepruar në kundërshtim me Kushtetutën e R. Sh., Ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, nenet 5, 20, 22, 23, 24, 25, 26 , VKM nr. 243, datë 18.03.2015 *"Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive"*, i ndryshuar, VKM nr. 242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe **titullari i institucionit.**

Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.
Nga drejtoria juridike dhe e burimeve njerëzore nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxheret e programeve për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.
Nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.
Për vitin 2024 janë kryer nga ASPA, **17** trajnime ku kanë marrë pjesë **17** nëpunës të institucionit.
Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12, 13 të Ligjit 114/2015 "Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit".
Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale
Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.
Nga auditimi i kryer rezulton se bashkia ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme. Njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë dhe nuk ka autorizime për delegimin e detyrave.
Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.
Për vitin 2024, me shkresën nr. 1751 prot., datë 18.05.20243 Titullari i Bashkisë ka nxjerrë Urdhrin nr. 94 datë 18.05.2023 *"Për krijimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP)"*. Në këtë urdhër, komisioni ka në përbërje **5** anëtarë dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë.
Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se takimet e GMS, nuk dokumentohen me procesverbale. Vlen të theksojmë se GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20;
-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.1 "Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK" a, b, c, d, pika 2.3.1;
-VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", Kreu II. "Dosja e Personelit";
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.1, Kapitulli IV "Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit", Kapitulli V, Anekset.

II. Komponenti "Menaxhimi i Riskut"
Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të

mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Nga auditimi i kryer u konstatua se, bashkia ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), në të cilin evidentohen objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin. Dokumenti përfundimtar i PBA-së 2023-2025 është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) nr. 88 datë 27.12.2023 "Për miratimin e Programit Buxhetor për vitin 2024". *Ky dokument nuk është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë.*

Bashkia nuk ka hartuar plan-veprime operacionale të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), objektivave vjetore që të përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar. Rezulton se objektivat e miratuara nuk i komunikohen stafit të bashkisë nëpërmjet emailit apo shkresave zyrtare.

Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.

Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se njësia publike nuk ka krijuar mekanizma të organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut.

Nuk janë identifikuar dhe vlerësuar risqet përmes një procesi të strukturuar dhe sistematik që përfshin vlerësimin e rëndësisë potenciale dhe priotizimin e risqeve të përputhshmërisë. *Bashkia Gramsh ka miratuar urdhërin për Menaxhimin e Riskut nr.142 datë 25.04.2024 për përcaktimin e grupit koordinues teknik për procesin e menaxhimit dhe raportimet mbi risqet, nuk janë hartuar strategjia dhe regjistri i riskut, për vitin 2024, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Gramsh.*

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

Nga auditimi i kryer u konstatua se bashkia nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. *Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.*

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal

për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.
Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel mesatar. Bashkia Gramsh ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni por këto ndryshime strukturore apo menaxheriale duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 21, pika 2;
-Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 3 "Përgjegjësitë dhe detyrat e KR", pika 3.2.1 "Titullari i njësisë publike" pika 4 "Hapat për ngritjen e sistemit të MR"
-"Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.2, Kapitulli V, Anekset.

III. Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit"

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.
Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.
Në vijim të auditimit të kryer, u konstatua mungesa e hartave apo manualeve të proceseve të punës që sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive. Vlen të theksojmë se përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.
Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
Listë prezencat plotësohen nga përgjegjësi i sektorit përkatës dhe listë pagesa përpilohet nga specialisti i pagave, të dhënat hidhen çdo muaj në librin e pagave.
Në zbatim të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", bashkia ka hartuar procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj.. Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive sipas natyrës së objektit të prokurimit (punë,

mall, shërbim etj.)
Në zbatim të Udhëzimit nr. 01 datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP.... dhe krijimi i tyre në sistemin e PP" është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve. Ky regjistër është publikuar në faqen e APP dhe përditësohet sa herë ka ndryshime. Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AMFIS i përdorur për pagesat i cili ruan në sistem praktikat e pagesave të kryera me Degën e Thesarit dhe në Bankën e Shqipërisë.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë
Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.
Bashkia nuk ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra përveç sistemeve qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS etj.) dhe nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it.
Ndarja e detyrave në funksionimin e sistemeve të IT- së bëhet duke hapur llogari personale për të gjithë punonjësit sipas funksionit që kanë në çdo proces. *Bashkia ka plan masash për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.*

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.
Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.
Bashkia nuk ka procedura të shkruara dhe politika të brendshme për ndarjen e përgjegjësive për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar. *Nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.*

- **Gjurma e auditimit**

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.
Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të për proceset kryesore të punës.** Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;
-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 5.2.7 "Monitorimi dhe

Raportimi";
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

IV. Komponenti: "Informimi dhe komunikimi"

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.
Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.
Në vijim të auditimit, u konstatua se bashkia nuk i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit.
Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit por *ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.*
Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit. Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.
Nuk ka sistem për kontabilizimin e të dhënave në bashki.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.
Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se nuk janë hartuar procedura të shkruara për të siguruar që menaxherët dhe personeli i bashkisë të informohen mbi që të gjitha vendimet, projektet, procesverbalet e mbledhjeve dhe nismat e tjera të bashkisë.
B*ashkia ka përgatitur raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e njësisë në lidhje me shërbimet publike.* Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë. Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave apo në rrugë elektronike sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.
Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresore dhe **evidentohet që punonjësit përdorin adresat zyrtare të e-mailit.** Bashkia nuk siguron qasje publike nëpërmjet publikimit faqes së internetit të

njësisë të informacionit lidhur me: Dokumentin e Buxhetit vjetor të propozuar; Buxhetin e miratuar të bashkisë; Raporte periodike të zbatimit të buxhetit; Pasqyrat vjetore financiare të dhe të buxhetit; Planet vjetore të prokurimit, proceset e hapura të prokurimit, kontratat e lidhura, statistika mbi prokurimet; Raporti i auditimit të jashtëm për njësinë mbi pasqyrat financiare dhe aktivitetin e vitit paraardhës.
Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Çdo sugjerim nga aktorët kryesor diskutohet për të reflektuar ndryshimet e duhura në buxhet.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 23, "Informacioni dhe Komunikimi" pika 2;
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

V. Komponenti: "Monitorimi"

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.
Nga auditimi i kryer, u konstatua se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.
Progresi lidhur me arritjen e objektivave dhe analizimi i shkaqeve për dështimet e mundshme nuk monitorohet nëpërmjet raportimeve periodike. Institucioni ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit të miratuar për monitorimin e MFK-së.
Bashkia Gramsh monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar me shkresën nr. 918/1 prot., datë 28.02.2025 në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE-së.
Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet edhe nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm, performuar nga Njësia e Auditit të Brendshëm .
-Bashkia Gramsh nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.
Titullari i njësisë informohet në vazhdimësi në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.
NJAB ka hartuar planin strategjik të auditit të brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2024.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë

mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi. Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 24, "Monitorimi" pika 1;

-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.5, Kapitulli V, Anekset.

 Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Përsa i përket sistemit të MFK: Bashkia ka ngritur një sistem jo efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se për periudhën objekt auditimi nuk janë hartuar planet vjetore të punës. Nga auditimi rezulton se nuk ka raportime periodike nga njësitë e varësisë si dhe menaxherët e strukturave brenda institucionit.. Dosjet personale të punonjësve kanë disa mangësi në kushtet e mosplotësimit të kritereve të kërkuara dhe pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të. Takimet e GMS nuk dokumentohen me minuta takimi apo procesverbale. Bashkia nuk ka hartuar strategjinë dhe regjistrin e riskut dhe nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime.

Bashkia nuk i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar. Bashkia nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm.

<u>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:</u>

1. z. **B. A.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Gramsh.
2. z. **E. H.,** në cilësinë e nëpunësit zbatues në Bashkinë Gramsh.
3. z. **E. S.,** në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore.

1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

1.3 Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm, të auditimit Nr. 405/1 Prot., datë 08.04.2025, i ndryshuar "Mbi auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2023– 31.12.2024", u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njësisë AB të Bashkisë Gramsh;
2. Planet Strategjik dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Planifikimi vjetor për vitit 2024 dhe pasqyrat shoqëruese;
4. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2024;
5. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
6. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
7. Dosjet koherente të subjekteve të audituara;
8. Projekt raportet dhe raportet përfundimtare të auditimit të brendshëm të njësive publike;

9. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre;

Organizimi dhe funksionimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm

Auditimi i Brendshëm është një veprimtari e pavarur që i jep siguri objektive dhe i ofron këshillim për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes.

Në zbatim të Ligjit Nr.114 datë 20.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar, neni 10, pika 1, ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se:

"*Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në germat a-c të kësaj pike"* është ngritur dhe funksionon Njësia e Auditit të Brendshëm (NJAB) në varësi funksionale nga Titullari i Bashkisë Gramsh, duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm.

Ky sektor përgjatë periudhës 2024, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Vendimit nr. 8, datë 30.01.2024 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gramsh dhe njësive vartëse të saj", duke pasur në strukturën e saj 1 (një) Përgjegjës Sektori zj. L. P. dhe 2 (dy) specialiste auditi, zj. M. Dr. dhe zj.A. B. , rezulton se 2 (dy) audituese janë të pa certifikuar për vitin 2024 pasi kanë filluar punë në këtë sektor në shtator të vitit 2024 deri tani ka vetëm 7 (shtatë) muaj në sektorin e auditit të brendshëm. Nga Ministria e Financave Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit për auditimin e brendshëm për vitin 2024-2025 deri tani nuk janë çelur procedurat për regjistrimin për certifikim për audituesë të brendshëm.

Bashkia Gramsh, në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së saj dhe përmbushjes së objektivave të vendosura, me Vendimin nr. 129, datë 30.08.2021, ka miratuar Rregulloren e Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e administratës në Bashkinë Gramsh".

Struktura e njësisë AB për vitin 2024

Nr.	Periudha	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime te vijueshme	Aktualisht në punë apo larguar, data
	Për vitin 2024						
1	L.P.	Përgjegjëse	Financë	11	2017	1	Në punë
2	M.D.	Audituese	Juriste	4 muaj	Pa certifikuar	-	Në punë
3	A. B.	Audituese	Ekonomiste	7 muaj	Pa certifikuar	-	Larguar

Burimi: NJAB Gramsh, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Trajnimet e NjAB dhe certifikimet

Referuar Ligjit Nr.114 datë 20.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar, i është kushtuar rëndësi trajnimeve të audituesve për të zgjeruar njohuritë, të rrisin aftësitë dhe zotësitë e tyre nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Përgjegjësia për trajnimin nuk është vetëm e njësisë së auditimit të brendshëm ose struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit, por çdo audituesë duhet të përditësojë individualisht njohuritë dhe aftësitë e veta mbi zhvillimet e fundit, përmirësimet, standardet e auditimit dhe këshillat praktike mbi teknikat dhe praktikat e reja të auditimit. Përgjegjësi i Sektorit NJAB ka realizuar 40 orët e trajnimit në kuadër te programit TVP për vitin 2024, të miratuar me urdhër Nr.304. datë 29.12.2023 të Ministrisë së Financave.

Komiteti i Auditit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësive të saj, nuk është krijuar nga Bashkia Gramsh.

Referuar të Ligjit Nr.114 datë 20.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar, neni 12/b, përcakton se: **Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për:**

b) **krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike** përkatëse sipas kritereve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës "b" të nenit 23 të këtij ligji.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me Ligjin Nr.114 datë 20.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar, neni 12/b, 13 "Komitetit të Auditimit të Brendshëm"

Konstatim: Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12/b, 13 të Ligjit Nr.114 datë 20.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar.

Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik

Karta e Auditimit është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, e cila përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm.

NJAB në mbështetje të Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" ka hartuar "Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" në Bashkinë Gramsh e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr. 48 prot., datë 05.01.2024 dhe rezulton se është në përputhje me formatin e paraqitur në Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016".

Planifikimi/ndryshimet dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve.

Plani strategjik është një dokument që përgatitet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm mbi bazën e vlerësimit të riskut të njësisë publik edhe përfaqëson veprimtarinë audituese për një periudhë 3 vjeçare. Plani vjetor i auditimit hartohet vetëm pasi të jetë përfunduar plani strategjik i Auditimit të Brendshëm.

Në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 3.3, kapitulli, III miratuar me Urdhrin e Ministrit të MFE Nr.100, datë 25.10.2016, përcaktohet se:

"Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, para se të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë publike, duhet të dërgohet për mendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri me datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri me datën **10 Tetor të çdo viti**. Planet pas dhënies së mendimit të KAB-së, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data **20 Tetor e çdo viti**, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm"

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar dhe miratuar plani strategjik 2024-2026. Plani strategjik për vitet 2024-2026 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2024 janë përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 3682/3 prot., datë 12.10.2023, në përputhje me të Ligjin Nr.114 datë 20.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar.

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2024

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se:

Për vitin 2024 janë planifikuar për t'u kryer **6** auditime (1 auditimi financiar dhe 5 auditime të kombinuara) të cilat janë realizuar të gjitha pasqyruar si më poshtë:

Nr.	Planifikuar	Nr. Auditime	Subjekte të audituara nga NJAB	Nr. Auditime	Realizimi i angazhimeve të auditimit					Të përfunduar	Në proces
					Përputhsh	Perform	Financ	IT	Kombin		
1	Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi	1	Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi	1					1		
2	Sektori i Menaxhimit te Aseteve	1	Sektori i Menaxhimit te Aseteve	1					1		
3	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit (detyrimet e prapambetura)	1	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit (detyrimet e prapambetura)	1			1				
4	Njësia Administrative Pishaj	1	Njësia Administrative Pishaj	1					1		
5	Drejtoria Tatim Taksave dhe Inspektorati Tatimor	1	Drejtoria Tatim Taksave dhe Inspektorati Tatimor	1					1		
6	Drejtoria e planifikim Territorit	1	Drejtoria e planifikim Territorit	1	1						
		6	**Totali**	**6**	**1**		**1**		**4**	**6**	**-**

Burimi: NJAB Gramsh, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Raporti i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm, është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 603 prot., datë 12.02.2025. Nga auditimi i kryer, rezulton se për vitin 2024, janë dhënë **24** rekomandime gjithsej, të cilat janë pranuar nga subjektet objekt auditimi. Nga rekomandimet e pranuara janë në proces zbatimi **15** prej tyre. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Pranuar	Zbatuar	Ne proces	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	2024	24	24	9	15	0			
TOTALI		**24**	**24**	**9**	**15**	**0**			

Burimi: NJAB Gramsh, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Konstatim: Nga auditimi i kryer, u konstatua se NJAB, nuk ka audituar aktivitete që kryen Bashkia Gramsh, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë si: Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore në mospërputhje me përcaktimet e bëra në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të *"Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit"*

Auditimi i dosjeve të auditimit kryer nga DAB

Grupi auditimit duke patur në fokus gjetjet e konstatuara në subjektet e audituara në vitin 2024, auditoi 6 (gjashtë) dosjet e auditimit, që janë:

-dosja e auditimit të kryer në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, Sektori i Financës;

-dosja e auditimit të kryer në Sektori i Menaxhimit të Aseteve ;

-dosja e auditimit të kryer në Njësinë Administrative Pishaj;

-dosja e auditimit të kryer në Drejtorinë e Planifikimit te Territorit;
-dosja e auditimit të kryer në Drejtorinë e Tatim Taksave;
-dosja e auditimit të kryer për Zbatimin e Rekomandimeve të lëna;

1. Dosja e auditimit financiar për subjektin **Drejtoria e Financës dhe Buxhetit**, me objekt "Detyrimet e Prapambetura"
Nga Raporti i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është:
☞Të japë siguri objektive për Kryetarin e Bashkisë mbi detyrimet e prapambetura sipas metodës FIFO, mos krijimin e detyrimeve të reja si dhe planifikimin për shlyerjen e tyre. Të ndihmojë Sektorin e Financës në realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirësuar sistemet e kontrollit në parandalimin e krijimit të detyrimeve financiare të prapambetura për njësinë e vetëqeverisjes vendore.
Rekomandimet e lëna paraqiten në tabelën si më poshtë vijon:

Nr.	Rekomandime	Niveli i Riskut
1	Sektori i Financës të zbatojë metodën FIFO (hyrja e parë-dalja e parë), në likuidimin e faturave të prapambetura	I mesëm
2	Të bëhet planifiki i sakte ne buxhet dhe llogaritja ne masën e duhur te fondeve për detyrimin e likuidimeve për detyrimet e prapambetura.	I lartë
3	Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të merren masa për faturat me mungesë dokumentacioni në plotësimin e tyre.	I mesëm

Burimi: NJAB Gramsh, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

2. Dosja e auditimit të përputhshmërisë për subjektin **Sektori i Menaxhimit te aseteve ,** me objekt "Vlerësimi i funksionimit të veprimtarisë në përputhje me ligjet, vendimet, rregulloret, udhëzimet, veprimtarinë financiare të saj":
Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është:
☞Të japë siguri objektive për Kryetarin e Bashkisë, se funksionimi i Sektori i Menaxhimit të aseteve vendore është i saktë dhe i besueshëm dhe vepron konform ligjeve.

Rekomandimet e lëna paraqiten në tabelën si më poshtë vijon:

Nr.	Rekomandime	Niveli i Riskut
1	Nga Sektori i Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me ***Sektori i Menaxhimit të aseteve vendore*** të bëjë ndarjen e detyrave me shkrim, si dhe të proceseve të punës	I mesëm
2	Nga përgjegjësi i ***Sektori i Menaxhimit të aseteve vendore***, të hartohet regjistri i riskut, të identifikohen risqet e strukturës e për pasojë të ndërmerren veprimtari për vlerësimin e kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave të drejtorisë, e si rrjedhojë edhe të Bashkisë, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", pika 2, neni 11, "Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë".	I mesëm
3	Nga përgjegjësi i ***Sektori i Menaxhimit të aseteve vendore***, të hartohen, të përcaktohen dhe miratohen objektivat vjetorë, afatmesëm, strategjikë, të diskutohen dhe t'i bëhen të njohura stafit të drejtorisë së planifikim territorit në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ..	I mesëm
4	Nga ***Sektori i Menaxhimit të aseteve vendore***, të merren masat për ndjekjen me përpikmëri të vjeljes së debitorëve. Lidhjen e kontratave ,dhe ndjekjen e të gjitha procedurave për qiramarrësit	I mesëm
5	Nga ***Sektori i Menaxhimit të aseteve vendore***, të merren masat për fillimin e	I mesëm

Nr.	Rekomandime	Niveli i Riskut
	procedurave për certifikimin e pronave te bashkisë.	

Burimi: NJAB Gramsh, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

3. Dosja e auditimit të kombinuar për subjektin **Planifikim dhe Zhvillimi i Territorit,** me objekt zbatimin ne përputhshmëri me ligjet, vendimet, rregulloret, udhëzimet, veprimtarinë financiare të saj":

Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është:

☞Të japë siguri objektive për Kryetarin e Bashkisë, se **Planifikim dhe Zhvillimi i Territorit** është i saktë dhe i besueshëm dhe vepron konform ligjeve.

Rekomandimet e lëna paraqiten në tabelën si më poshtë vijon:

Nr.	Rekomandime	Niveli i Riskut
1	Të hartohet nga Administratori i njësisë në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore ndarja e proceseve të punës në bazë të detyrave të secilit punonjës.	I mesëm
2	Të merren masat e menjëhershme nga inspektori i Tatim – Taksave për regjistrimin e të gjitha bizneseve pranë QKB –së si edhe të ndiqen procedurat për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.	I larte
3	Të vendosen saksione për mbledhjen e taksave vjetore dhe të prapambetura sa më parë , si edhe të bëhet ndarja e tyre në detyrime të prapambetura dhe të vitit .	I mesëm
4	Nga punonjësi i njësisë administrative dhe i drejtorisë së Tatim – Taksave dhe Inspektoratit Tatimor mbahet proces verbal në fund të çdo muaji të mbylljes së arkës dhe proces verbalet e anuluara të jenë me dy firma.	I larte
5	Nga punonjësi i ndihmës ekonomike të plotësohet dokumentacioni përkatës në të gjitha dosjet e ndihmës ekonomike.	I lartë

Burimi: NJAB Gramsh, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

4. Dosja e auditimit të kombinuar për subjektin **Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore.,** me objekt "Vlerësimi i funksionimit dhe veprimtarisë në përputhje me ligjet, vendimet, rregulloret, udhëzimet, veprimtarinë financiare të saj":

Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është:

☞Të japë siguri objektive për Kryetarin e Bashkisë, se funksionimi i Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore është i saktë dhe i besueshëm dhe vepron konform ligjeve.

Rekomandimet e lëna paraqiten në tabelën si më poshtë vijon:

Nr.	Rekomandime	Niveli i Riskut
1	Të hartohet nga Administratori i njësisë në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore ndarja e proceseve të punës në bazë të detyrave të secilit punonjës	I mesëm
2	Nga Drejtori i Drejtorisë së Tatimeve dhe Tarifave Vendore të përcaktohen objektiva vjetorë, afatmesëm, strategjikë, të hartojë regjistrin e rriskut të cilat duhet *të diskutohen dhe t'i bëhen të njohura* stafit të saj, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", pika 2, neni 11, "Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë".	I mesëm
3	Nga Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore të marrë masa për ndarjen e detyrimeve të prapambetura nga ato të vitit ushtrimor, për një planifikim sa më të saktë të paketës fiskale..	I larte
4	Nga Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore	I larte

Nr.	Rekomandime	Niveli i Riskut
	në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndiqen të gjitha procedurat në rrugë gjyqësore për subjektet private që nuk kanë likuiduar.	
5	Nga punonjësi i drejtorisë tatimeve e tarifave vendore të ndiqen të gjitha procedurat për mbledhjen e detyrimeve tatimore, sipas saksioneve e ligjeve në fuqi.	I mesëm
6	Nga punonjësi i drejtorisë tatimeve e tarifave vendore të bëhen rakordimet mujore dhe shlyerja sipas aktrakordimit mujor.	I mesëm

Burimi: NJAB Gramsh, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

5. Dosja e auditimit të kombinuar për subjektin **Njësia Administrative Pishaj** në përputhje me ligjet, vendimet, rregulloret, udhëzimet, veprimtarinë financiare të saj":
Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është:
☛Të japë siguri objektive për Kryetarin e Bashkisë, se funksionimi i Njësisë Administrative Pishaj është i saktë dhe i besueshëm dhe vepron konform ligjeve.
Rekomandimet e lëna paraqiten në tabelën si më poshtë vijon:

Nr.	Rekomandime	Niveli i Riskut
1	Të hartohet nga Administratori i njësisë në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore ndarja e proceseve të punës në bazë të detyrave të secilit punonjës.	I mesëm
2	Të merren masat e menjëhershme nga inspektori i Tatim – Taksave për regjistrimin e të gjitha bizneseve pranë QKB –së si edhe të ndiqen procedurat për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.	I mesëm
3	Të vendosen sanksione për mbledhjen e taksave vjetore dhe të prapambetura sa më parë , si edhe të bëhet ndarja e tyre në detyrime të prapambetura dhe të vitit .	I lartë
4	Nga punonjësi i njësisë administrative dhe i drejtorisë së Tatim – Taksave dhe Inspektoratit Tatimor bëhet kthimi dhe rakordimi i mandateve të arkëtimit dhe mandatë pagesave nga specialisti i Financës i cili jep mandatet dhe specialistit të njësisë administrative i cili i merr në dorëzim ato .	I mesëm
5	Nga punonjësi i njësisë administrative dhe i drejtorisë së Tatim – Taksave dhe Inspektoratit Tatimor mbahet proces verbal në fund të çdo muaji të mbylljes së arkës dhe proces verbalet e anuluara të jenë me dy firma.	I lartë
6	Nga punonjësi i ndihmës ekonomike të plotësohet dokumentacioni përkatës në të gjitha dosjet e ndihmës ekonomike.	I mesëm

Burimi: NJAB Gramsh, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Konkluzion: Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar; Opinioni i përgjithshëm është lëne vetëm në raportin vjetor.
-NJAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;
Dosja e auditimit mbi "<u>Zbatimin e rekomandimeve për vitin 2024</u>"
Gjatë verifikimit të rekomandimeve të dhëna gjatë 2024 janë verifikuar dhe vlerësuar gjithashtu statusi i rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme.
Në mbështetje të planit vjetor të miratuar për vitin 2024 me nr. 3682/3 prot., datë 12.10.2023, ka

qenë planifikuar edhe 1 angazhim auditimi, me objekt:“ Zbatimi i rekomandimeve të lëna në subjektet e audituara gjatë vitit 2024”.
Në auditimet e kryera gjatë vitit 2024 janë dhënë gjithsej 24 rekomandime të cilat janë pranuar nga subjektet objekt auditimi. Nga rekomandimet e pranuara janë në proces zbatimi 15 rekomandime prej tyre dhe 9 rekomandime të zbatuara. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:
Referuar Raportit të Auditimit rezulton se:
Niveli i zbatimit të rekomandimeve, për periudhën 2022 paraqitet si më poshtë:

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	2024	24	9	15	0	0			
TOTALI		**24**	**9**	**15**	**0**	**0**			

Burimi: NJAB Gramsh, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se Njësia e Auditimit të Brendshëm ka marrë në shqyrtim dhe ka mbikëqyrur procesin e monitorimit e ndjekjes së rekomandimeve të dhëna nga struktura e auditimit të brendshëm. Me shkresën nr. 603 datë 12.02.2025 është përcjellë pranë Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Raporti vjetor i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm.
Konstatim: Grupi i auditimit nuk ka analizuar arsyet e mosrealizimit të rekomandimeve të mëparshme. Referuar Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.13.3 përcaktohet se: *Një njësi e mirë menaxhuar vendos procedura për t’u siguruar se çdo rekomandim i bërë nga njësia e AB, zbatohet ashtu siç duhet.*
-NJAB nuk ka kryer auditim tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH-ja.

Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm
Për të analizuar mjedisin e kontrollit, në manual jepet formati standard 1 “Pyetësor vlerësimi për mjedisin e kontrollit të brendshëm” në fund të kapitullit III i cili duhet të plotësohet një herë në vit dhe të bëhet si pjesë e procesit të planifikimit fillestar. Pyetësori i vlerësimit të Mjedisit të Kontrollit ka për qëllim të ndihmojë njësinë e auditimit të brendshëm të kuptojë se sa mirë menaxhohet njësia dhe se cilat janë fushat/sistemet më me risk.
Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm është bërë vlerësimi i kontrollit të brendshëm si një nga detyrat themelore të auditimit të brendshëm. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm është bërë nga përgjegjësi dhe dy audituesit e NJAB duke qenë se nuk ka një komitet auditimi për të pasur një vlerësim më të saktë e profesional.
Nga kontrolli i dokumentacionit NjAB në Bashkinë Gramsh ka kryer trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm
Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm , si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet. Programi i sigurimit të cilësisë, vlerëson efikasitetin, efektivitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe identifikon mundësitë për përmirësim.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Gramsh ka hartuar *"Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm"* me nr. 1970 prot datë 13.05.2024.

Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të zhvillojë dhe të mirëmbajë programin e siguri dhënies dhe përmirësimit të cilësisë, i cili mbulon të gjitha aspektet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Programi për vlerësimin e cilësisë përbëhet nga vlerësimet e brendshme dhe të jashtme, që përfshijnë:

- vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga vetë njësia e auditimit të brendshëm bazuar në politikat dhe praktikat e saj;
- vlerësimin e jashtëm të cilësisë që kryhet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik, për zbatimin e metodologjisë dhe performancës së njësisë të auditimit të brendshëm; dhe
- vlerësimin e pavarur të jashtëm të cilësisë që kryhet nga një person i jashtëm, auditues në një njësi të pavarur të sistemit të përgjithshëm të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Nga kontrolli i dokumentacionit Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Gramsh ka hartuar *"Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm"* në përputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VII.

Dosja e përhershme

Audituesit e Brendshëm duhet të njohin mirë njësinë publike, veprimtaritë operacionale dhe sistemin financiar me qëllim që të sigurojnë se puna e tyre do të jetë e përshtatshme për organizatën vlerësimin e sistemeve, proceseve të cilat janë pjesë e aktiviteteve të përditshme të njësisë që auditohet.

Nga kontrolli i dokumentacionit, u konstatua se audituesit e brendshëm kanë krijuar dosjet e përhershme të auditimit në përputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm ku përcaktohet se: "Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet".

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12/b, 13 të Ligjit nr.114 datë 20.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar;

-NJAB, për vitin 2024 nuk ka audituar aktivitete që kryen Bashkia Gramsh, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë si:, Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore në mospërputhje me përcaktimet e bëra në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit;

-Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë një opinion të përgjithshëm, por opinionin i përgjithshëm është dhënë vetëm tek raporti vjetor mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;

-NJAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;

-NJAB nuk ka kryer auditim tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH-ja.

Baza Ligjore

-Ligji Nr.114 datë 20.10.2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* i ndryshuar;
-Ligji Nr.9154, datë 6.11.2003 *"Për Arkivat";*
-VKM nr. 83, datë 03.02.2016 *"Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik"*;
-VKM nr.160, datë 02.03.2016 *"Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike"* i ndryshuar;
-Manuali i "Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016;
-Udhëzimi Nr.42, date 27.10.2020 *"Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik"*;
-Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë *"Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016";*
-Normat Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Për sa më sipër mban përgjegjësi, Përgjegjësi i Njësisë së Auditit të Brendshëm si dhe titullari i Bashkisë Gramsh.

2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin, dhe monitorimin e planit të buxhetit

Në zbatim të Programit të Auditimit u auditua planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit, bazuar në Ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",* ligjet vjetore për buxhetin e shtetit të vitit 2024, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.
Dokumentacioni që u shqyrtua për auditimin e kësaj pike të programit të auditimit është si vijon:
- PBA 2024-2026;
- Projekt-buxheti i miratuar për vitin 2024;
- Vendimet e KB "*Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Gramsh"* për vitin 2024;
- Vendime të tjera të KB, në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Situacioni i shpenzimeve për vitin 2024 i rakorduar me Degën e Thesarit;
- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Raportimet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë lidhur me detyrimet e prapambetura të Bashkisë Gramsh;
- Informacion shkresor-elektronik i përgatitur nga subjekti bazuar në kërkesat e hartuara nga grupi i auditimit.

Baza Ligjore:
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*;
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH",* i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 97/2023, *"Për buxhetin e vitit 2024";*
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore";*
- Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*
- Udhëzim nr.13., datë 18.12.2024 *"Për Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2024"*

- Udhëzimi nr.9., datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i* ndryshuar.
- Udhëzimi nr.23.,datë 29.12.2023 *"Për procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njësite e vetëqeverisjes vendore"*
- Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore".*
- Udhëzim plotësues nr.1., datë 24.01.2024 *"Për zbatimin e buxhetit për vitin 2024"*
- Udhëzimi i MFE nr. 6, datë 28.02.2023 "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026".*
- VKB nr. 88, datë 27.12.2023, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan me shkresën nr. 84/1.prot., datë 16.01.2023.

2.2.1. Programimi i PBA-së dhe programimi i buxhetit vjetor.

Nga auditimi i procedurave për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (në vijim PBA) për vitet 2024-2026 u konstatua se, për realizimin e fazave të përgatitjes, Kryetari i Bashkisë Gramsh z. B. A. ka nxjerrë Urdhrin nr. 94, datë 18.05.2023, për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP).

Grupi përbehet nga z. K. T. (Kryetari GMS), z. A. S. (Koordinator i GMS) z. A. S. (Sekretar i GMS): PBA është hartuar për 15 programe buxhetore

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA-së për vitet 2024-2026, janë realizuar fazat e përgatitjes si më poshtë:

-Bashkia Gramsh ka hartuar tavanet përgatitore të programit Buxhetor Afatmesëm Vendore për vitet 2024-2026 me relacionin nr. 1315.prot., datë 31.03.2023, relacion i cili është miratuar nga Këshilli Bashkiak me Vendim nr. 30, datë 28.04.2023,me nr.1315/2.prot ., datë 09.05.2023 i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresë nr. 548/1.prot., datë 11.05.2023.

-Nga drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve nuk janë paraqitur kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit të Koordinatori i GMS, brenda muajit Prill 2023. Pjesë e kërkesave buxhetore duhet të jenë edhe objektiva për arritjen e barazisë gjinore, si dhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë në komunitetin e tyre pakica rome dhe egjiptiane objektiva për integrimin e tyre në komunitet të cilat nuk janë parashikuar në PBA 2024-2026.

-Nga Sektorët e Bashkisë Gramsh nuk janë hartuar kërkesat buxhetore të cilat duhen të dorëzohen tek koordinatori i GMS, vlerësohen dhe miratohen nga Grupi për Menaxhim Strategjik.

-Me Urdhrin e nr. 98, datë 11.04.2023, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe paralelisht është hartuar Udhëzimi i Brendshëm për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm nr. 1, datë 18.05.2023, me nr. 1752.prot. Projekt dokumenti i PBA-së për vitet 2024-2026 të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar është dërguar elektronikisht më datë 01.06.2023, me nr.2014.prot., datë 05.06.2023 dhe zyrtarisht me shkresë nr.2014/1.prot., datë 05.06.2023 në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.

-Nga Bashkia Gramsh janë organizuar takime konsultative me përfaqësues të komunitetit lokal gjatë fazës së përgatitjes së projekt dokumentit të PBA-së sipas procesverbaleve përkatëse.

Me shkresën nr.11099.prot., datë 19.06.2023 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dhënë rekomandimet e sajë për përmirësimin e PBA 2024-2026 në fazën përfundimtare pasi rezulton me 15 programe buxhetore nga 20 që duhen si dhe ka produkte qe nuk janë pjesë e planifikimit të PBA 2024 2026 anekset shtojcës 4 *"Lista orientuese e Produkteve Standarde sipas 20 programeve buxhetore të NJVQV-ve"*

Me shkresën nr.2227 prot., datë 21.06.2023 është hartuar projekti i parë i PBA 2024-2026 i cili është paraqitur në këshillin bashkiak për miratim dhe është miratuar nga Këshilli Bashkiak me

Vendimin nr.47., datë 30.06.2023 protokolluar me nr.2227/2 datë 04.07.2023 hartuar nga z. A. S. Drejtor i Financës dhe Buxhetit. Nga auditimi u konstatua që projekti i parë i PBA 2024-2026 nuk është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Gramsh.
Me shkresën nr.3588.prot., datë 15.09.2023 është rishikuar PBA 2024-2026 në fazën e dytë dërguar Këshillit Bashkiak për miratim me shkresën nr.3588/2 datë 15.09.2023 ku nga 20 programe buxhetore 7 programe janë planifikuar me zero.
Me vendim të këshillit Bashkiak nr.65 prot., datë 29.09.2023 është miratuar PBA-2024-2026 e rishikuar me nr.3588/3.prot., datë 05,10.2023, konfirmuar nga prefekti i qarkut me shkresën 1128/1 prot., datë 17.10.2023. Për vitin 2024, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 88, datë 27.12.2023, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan me shkresën nr. 84/1 prot., datë 16.01.2024.Të dhënat në lidhje me vlerat e planifikimeve sipas programeve buxhetore të PBA 2024-2026 (Faza e pare, faza e dytë dhe buxheti i vitit 2024 me ndryshime) paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela nr.2.2/1: Të dhënat sipas programeve dhe fazave të PBA 2024-2026 000/lekë

Nr.	Programi	Shpenzimet sipas programeve	Faza e pare e PBA 2024-2024	Faza e dytë e PBA 2024-2026	Planifikimi me ndryshime gjatë 2024
			000/lekë	000/lekë	000/lekë
1	01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	328,769	328,769	270,438
2	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	6,154	6,154	7,270
3	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	19,288	19,288	23,962
4	04130	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik			
5	04220	Shërbimet Bujqësore, inspektimi, ushqimi	1,620	1,620	
6	04240	Menaxhimi I Infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit	12,016	12,016	12,501
7	04260	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	22,048	22,048	27,269
8	04520	Rrjeti rrugor rural	46,915	46,915	88,147
9	04570	Transporti Publik			
10	05100	Menaxhimi i Mbetjeve	34,100	34,100	36,486
11	06140	Planifikimi Urban dhe Vendor			
12	06260	Shërbimet publike vendore	48,339	48,339	38,228
13	06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime			
14	07220	Shërbimet e Kujdesit Parësor			
15	08130	Sport dhe argëtim	14,254	14,254	25,530
16	08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	9,959	9,959	21,478
17	09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	114,386	114,386	124,727
18	09230	Arsimi Mesëm i Përgjithshëm	13,405	13,405	37,678
19	10430	Përkujdes social			538
20	10661	Strehimi Social			5,298
	04980	Fondi rezerve			65
	06440	Ndriçim rrugësh (energji oshe)			5,400
		Fondi Kontigjences	12,143	12,143	
		TOTALI	**683,396**	**683,396**	**722,016**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bashkia Gramsh përpunoi grupi i auditimit

Sipas të dhënave të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Gramsh për dokumentacionin bashkëlidhur buxhetit të vitit 2024, buxheti fillestar të ardhurat e parashikuara për vitit 2024 kanë qenë në vlerë 110,470 mijë lekë, transferta e pakushtëzuar ka vlerën 286,762 mijë lekë, transferta e kushtëzuar ka vlerën 179,994 mijë lekë dhe transfertë fond për rritjen e pagave 18,031 mijë lekë. Në total **të ardhurat kanë vlerën 595,257 mijë lekë** po ashtu edhe **shpenzimet kanë vlerën 595,257 mijë lekë.** Shkresa e VKB nr. 88, datë 27.12.2023, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan me shkresën nr. 84/1, prot., datë

16.01.2024 nuk përmban vlerën e miratuar të buxhetit për vitin 2024.Në shkresë citohet që:
1-*"Të miratojë planin e buxhetit të vitit 2024 sipas tabelave 1-10 bashkëlidhur"*
2-*"Të miratoje tavanet buxhetore për çdo program për vitet 2024-2026 sipas pasqyrave elektronike të FPT bashkëlidhur."*
Programi Buxhetor i vitit 2024 është konceptuar nga Z. E. H. Drejtor i Financës dhe Buxhetit dhe miratuar nga z. B. A. Kryetari i Bashkisë Gramsh.
Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat mbi planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2024:

Tabela nr.2.2/2.Buxheti i miratuar VKB nr.88., datë 27 Dhjetor 2024 000/lek

Nr.	Emërtimi	Plan vjetor
Të ardhura gjithsej		
1	Të ardhura të trashëguara	0
2	Të ardhura të vitit 2024	110,470
3	Transferta e pa kushtëzuar	286,762
4	Transferte fond për rritjen e pagave	18,031
5	Transferta kushtëzuar (specifike)	179,994
6	Transferta e kushtëzuar për investim	0
Totali		**595,257**
Shpenzimet		
1	**Shpenzime personeli**	**139,557**
	Paga	120,315
	Sigurime shoqërore	19,242
2	**Shpenzime të tjera operative**	**142,666**
3	**Fond për emergjencat civile**	**16,415**
4	**Fondi rezerve**	**2,000**
5	**1% e Qarkut**	**1,300**
6	**Investime**	**113,325**
Totali		**415,263**
6	Shpenzime Specifike të trashëguara	**0**
7	Shpenzime specifike sipas tabelave	**179,994**
Totali i buxhetit		**595,257**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Gramsh

Buxheti vjetor është miratuar është miratuar me VKB nr. 88, datë 27.12.2023, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan me shkresën nr. 84/1.prot., datë 16.01.2024 jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"*, neni 41, *"Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor",* pika 3, Vendimi i miratuar nga Këshilli Bashkiak është bazuar në projektvendimin dhe relacionin e hartuar nga Drejtori i Drejtorisë së të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar z. A. S. dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë z.B. A. sipas shkresës nr.3588/2.prot., datë 15.09.2023. Ky dokumentacion është dërguar pranë Këshillit Bashkiak jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"*, neni 41.Buxheti fillestar i Bashkisë Gramsh i miratuar për vlerën e te

ardhurave dhe shpenzimeve prej 595,257 lekë pas kalimit të të ardhurave të trashëguara nga viti 2023 në vlerën 95,130 mijë lekë arrin vlerën e planifikimit në shumën prej 690,397 mijë lekë. Vlera prej 95,130 mijë lekë e trashëguar nga viti 2023 përbehet nga të ardhurat e veta të trashëguara në vlerën prej 15,525 mijë lekë, të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar 62,401 lekë dhe të ardhura të trashëguara nga transferta specifike 17,204 mijë lekë. Me VKB-në nr.17, datë 29.02.2024, "*Për miratimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2023"*, janë miratuar mjetet monetare nga Granti i trashëguar shtesë me aktin normativ nr.06, datë 14.12.2023 në vlerën 95,130,217 lekë. Situata në lidhje me planifikimin e te ardhurave dhe shpenzimeve pas reflektimit të të ardhurave të trashëguara nga viti 2023 paraqitet si me poshtë vijon:

Tabela nr.2.2/3:Buxheti fillestar Bashkia Gramsh VKB 17 datë 27.02.2024 000/ lekë

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2024		**Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2024**	
Burimi i të ardhurave	**Buxheti fillestar, miratuar me VKB**	**Emërtimi i zërave**	**Buxheti fillestar, miratuar me VKB**
Të ardhura të planifikuara për vitin 2024	110470	Art. 600 Paga	256,637
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe te planifikuara për shpenzim për vitin 2024	15525	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	42,961
Total të ardhurat e veta	**125,995**	Art.602 Shpenzime operative	190,547
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	62,401	Art.604 Transferime korrente të brendshme	18,110
Të ardhura të trashëguara nga transferta specifike	17,204	Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	476
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2024	304,793	Art. 230-231 Investime	179,656
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2024	179,994	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	2,000
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit te shtetit	**564,392**		
TOTALI TE ARDHURAVE	**690,387**	**TOTALI SHPENZIMEVE**	**690,387**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Gramsh

Përgjatë vitit 2024, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (të miratuar në muajin dhjetor të vitit 2023 me VKB nr. 88, datë 27.12.2023). Këto ndryshime paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 2.2/4:Buxheti i ndryshuar Bashkia Gramsh viti 2024 000/lekë

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2024				**Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2024**			
Burimi i të ardhurave	**Buxheti fillestar, miratuar me VKB**	**Buxheti shtesë, miratuar me VKB**	**Vlera në 000/lekë**	**Emërtimi i zërave**	**Buxheti fillestar, miratuar me VKB**	**Buxheti shtesë miratuar me VKB**	**Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)**
	1	**2**	**1+2**		**3**	**4**	**3+4**
Të ardhura të planifikuara për vitin 2024	110470	11,145	121,615	Art. 600 Paga	256,637	16,870	273,507
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe te planifikuara për shpenzim për vitin 2024	15,525		15,525	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	42,961	3,147	46,108

Total të ardhurat e veta	**125,995**	**11,145**	**137,140**	Art.602 Shpenzime operative	190,547	2,160	192,707
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	62,401		62,401	Art.604 Transferime korrente të brendshme	18,110	(12,495)	5,615
Të ardhura të trashëguara nga transferta specifike	17,204		17,204	Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	476	1,457	1,933
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2024	304,793	20,484	325,277	Art. 230-231 Investime	179,656	20,490	200,146
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2024	179,994		179,994	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	2,000	-	2,000
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit te shtetit	**564,392**	**20,484**	584,876				
TOTALI TE ARDHURAVE	**690,387**	**31,629**	**722,016**	**TOTALI SHPENZIMEVE**	**690,387**	**31,629**	**722,016**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Gramsh

Nga auditimi u konstatua që në programin buxhetor 1110 planifikim menaxhim administrim janë përshirë produkte buxhetore investimesh për rruge rurale dhe investime te tjera të cilat nuk duhej të kategorizoheshin në programin buxhetor 1110 por në programin buxhetor 04520 rrjeti rrugor rural.

Konkluzion: PBA fillestare është hartuar për 15 programe buxhetore në mospërputhje me Udhëzimin nr.6, datë 28.02.2023 "*Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026"* kreu VII, pika 42 germa d, shtojca 4 *"Lista orientuese e produkteve standarde sipas 20 programeve buxhetore të NJVQV-ve"*

Bashkia Gramsh ka hartuar tavanet përgatitore të programit Buxhetor Afatmesëm Vendore për vitet 2024-2026 me relacionin nr. 1315.prot., datë 31.03.2023, relacion i cili është miratuar nga Këshilli Bashkiak me Vendim nr. 30, datë 28.04.2023,me nr.1315/2 prot., datë 09.05.2023 i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresë nr. 548/1 prot., datë 11.05.2023, jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimi nr.6, datë 28.02.2023 *"Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026"* kreu I pika 1.

Nga drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve nuk janë paraqitur kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit të Koordinatori i GMS, brenda muajit Prill 2023. Pjesë e kërkesave buxhetore duhet të jenë edhe objektiva për arritjen e barazisë gjinore, si dhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë në komunitetin e tyre pakica rome dhe egjiptiane objektiva për integrimin e tyre në komunitet të cilat nuk janë parashikuar në PBA 2024-2026 në kundërshtim me Udhëzimin nr.6., datë 28.02.2023 "*Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026"* pika 7.

Projekt dokumenti i PBA-së për vitet 2024-2026 është përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar është dërguar elektronikisht më datë 01.06.2023, me nr.2014.prot., datë 05.06.2023 dhe zyrtarisht me shkresë nr.2014/1.prot., datë 05.06.2023 në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr.6, datë 28.02.2023 *"Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026"* pika 9.

PBA 2024-2026 në fazën përfundimtare rezulton me 13 programe buxhetore nga 20 që duhen si dhe ka produkte brenda programeve qe nuk janë pjesë e planifikimit të PBA 2024-2026 anekset, shtojca 4 *"Lista orientuese e Produkteve Standarde sipas 20 programeve buxhetore të NJVQV-ve"*

-Nga Sektorët e Bashkisë Gramsh nuk janë hartuar kërkesat buxhetore të cilat duhen të dorëzohen tek koordinatori i GMS vlerësohen dhe miratohen nga Grupi për Menaxhim Strategjik.

Nga auditimi u konstatua që projekti i parë i PBA 2024-2026 nuk është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Gramsh në kundërshtim me Udhëzimin nr.6, datë 28.02.2023 *"Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026"* pika 14 ,*"Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 korrik 2023, merr masat e nevojshme për publikimin e dokumentit te parë të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026."*

Buxheti vjetor është miratuar është miratuar me VKB nr. 88, datë 27.12.2023, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan me shkresën nr. 84/1.prot., datë 16.01.2024 jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"*, neni 41, *"Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor"*, pika 3 *"Bazuar në vlerësimin e të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor, këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se data 25 dhjetor, miraton projektbuxhetin sipas përcaktimeve në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji".*

Dokumentacion për buxhetin 2024 është dërguar pranë Këshillit Bashkiak jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore",* neni 41, *"Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor",* pika 1: "*Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për miratimin në këshill projekt buxhetin vjetor, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji, jo më vonë se data 30 nëntor e vitit buxhetor".*

Referuar ndryshimeve buxhetore u konstatua që përgjatë vitit 2024, buxheti fillestar në vlerën prej 595,257 mijë lekë, miratuar VKB nr. 88, datë 27.12.2023, nuk përputhet me buxhetin fillestar i cili është 690,387 lekë për vlerën prej 95,130 mijë lekë e cila përbehet nga të ardhurat e veta të cilat janë trashëguar nga viti 2023 për vitin 2024 dhe ka ndodhur rregullimi buxhetor i vitit 2024 pas trashëgimit të të ardhurave të veta me VKB-në nr.17, datë 29.02.2024, "*Për miratimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2023"* .Gjithashtu u konstatua që ka pasur ndryshime buxhetore për vitin 2024 në vlerën prej 31,629 mijë lekë duke arritur planifikimin buxhetor në vlerën prej 722,016 lekësh që nuk përfshin fondet e deleguara të Bashkisë Gramsh. Ndryshimet buxhetore kanë ndodhur brenda muajit Mars 2024 në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar neni 47 "*Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor", "Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse për ndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin e vitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor".*

Nga auditimi u konstatua që në programin buxhetor 1110 *"Planifikim menaxhim administrim"* janë përshirë produkte buxhetore investimesh për rruge rurale dhe investime te tjera të cilat nuk duhej të kategorizoheshin në programin buxhetor 1110 por në programin buxhetor 04520 *"Rrjeti rrugor rural"*.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar neni 19.20,22,32,33,47, 67, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* neni 9, pika 1.3, germa "c" dhe "ç", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore"* nenet 40,41,45,46.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"*; *"Përgjegjësia e Kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore"* pikat 12-17', *"Përgjegjësitë e Nëpunësit Autorizues të njësisë së vetëqeverisjes vendore"* pikat 21-27, *"Përgjegjësitë e Grupit të Menaxhimit Strategjik"* pikat 28-33,

Veprime në kundërshtim me Udhëzim nr. 22, datë 30.7.2018 *"Për procedurat standarde të*

monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" kreu II pika 9 *"Përgjegjësia e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore", "Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes është kryetar i Grupit për Menaxhimin Strategjik dhe si rregull është nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Ai mund ta delegojë këtë kompetencë, me shkrim, te zëvendëskryetari ose te një nga zëvendëskryetarët e njësisë së vetëqeverisjes vendore."* pikat 10,11,12.
Përgjegjësitë e nëpunësit autorizues të njësisë së vetëqeverisjes vendore pika 17. *"Nëpunës autorizues" është nëpunësi i nivelit më të lartë i njësive të vetëqeverisjes vendore, përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat dhe programet buxhetore, duke përfshirë planifikimin, zbatimin, monitorimin e kontrolleve të risqeve të lidhura me zbatimin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin financiar të njësive të vetëqeverisjes vendore" pikat 18-26.*
Përgjegjësitë e nëpunësit zbatues, pika 27. *"Nëpunësi zbatues është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë, si dhe drejtuesve të programeve, informacionin e nevojshëm financiar për përgatitjen e raporteve përkatëse të monitorimit"* dhe pikat 28-30.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:
Z. B. A. Kryetari i Bashkisë Gramsh
Z. K. T. Kryetar i grupit të menaxhimit strategjik GMS
Z. A. S. Koordinator i GMS
Z. A. S. ish Drejtor i Financës dhe Buxhetit dhe sekretar i GMS
Z. E. H. Drejtor i Financës dhe Buxhetit

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.
Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.
Me vendim të Këshillit Bashkiak nr.18., datë 29.02.2024 *"Për miratimin e ndryshimit të planit të buxhetit të Bashkisë Gramsh për vitin 2024"* është pakësuar fondi rezerve programi 01110 *"Planifikim menaxhim administrim"* me vlerë 2,000,000 lekë dhe të shtohet *"fondi rezerve"* në programin 04980 me vlerë 2,000,000 lekë.
Vendim i cili është konfirmuar nga prefekti i qarkut me shkresën 366/1 prot., datë 18.03.2024.
Për sa më sipër rezulton që ka pasur planifikim të pasaktë duke përfshirë fondin rezerve brenda programit 1110 që është *"planifikim menaxhim dhe administrim"*. Ndryshimi ka ndodhur brenda muajit Mars 2024. Programi buxhetor 04980 *"fondi rezerve"* sipas raportit të monitorimit është 65,000 lekë në planifikim dhe zero lekë në realizim ndërkohe që fondi rezerve në vetvete është planifikim 2,000,000 lekë dhe realizim 1,950,000 lekë.
Nga të dhënat e thesarit rezulton që programi 04980 për vitin 2024 është realizuar në vlerën 0 lekë. Për sa më sipër rezulton që programi 04980 nuk është pakësuar gjatë vitit 2024.
Nga auditimi u konstatua që programi buxhetor 04980 ka qenë i planifikuar me ndryshime në vlerën 2,000,000 lekë dhe në raportin e monitorimit të buxhetit rezulton planifikim 65,000 lekë, rrjedhimisht vlera prej 1,935,000 lekë rezulton e ndryshuar si program buxhetor nga prekja e fondit rezerve. Nga auditimi u konstatua që ka vendime te Këshillit Bashkiak të vitit 2024 për prekjen e fondit rezerve për shpenzime për kurim në të cilën nuk përcaktohet pakësimi i programit 04980 *"fondi rezerve"* dhe praktika e ndjekur për ndryshimin e programit nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit është pas vendimit të Këshillit bashkiak për prekjen e fondit rezerve. Drejtoria e Financës

dhe Buxhetit i është drejtuar Degës se thesarit Gramsh për pakësimin e programit buxhetor 04980*"fondi rezerve"* dhe shtimin e programit 01110 *"planifikim menaxhim administrim"* në mënyrë qe të kryente veprimet e pagesës për kurim të vendosur nga Këshilli Bashkiak .
Me VKB-në nr.17, datë 29.02.2024, *"Për miratimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2023"*, janë miratuar mjetet monetare nga granti i trashëguar shtesë me aktin normativ nr.06., datë 14.12.2023 në vlerën 95,130,217 lekë i cili përbehet nga fondi i trashëguar i ndarë në tre nën ndarje 47,821,893 lekë ,30,103,647 lekë dhe 17,204,677 lekë. Në total fond i trashëguar 95,130,217 lekë. Nga vlera 47,821,893 lekë angazhime te marra janë 44,173,729 lekë dhe mjete të lira 3,648,164 lekë.
I. Këshilli bashkiak ka vendosur me vendimin e tij që të përdoren mjetet e lira për Bashkinë në vlerën 3,648,164 lekë e ndarë si më poshtë:

- Nga granti i trashëguar 476,240 lekë të përdoren për bonus qiraje financuar nga bashkia në vlerën 476,240 lekë

Nga të ardhurat e trashëguara 3,171,924 lekë:

- Të përdoren për bonus qiraje financuar nga bashkia në vlerën 371,924 lekë
- Të përdoren për rikonstruksionin e bllokut të banimit të Lagjes Xhile Kici në shumën 2,350,000 lekë
- Blerje kompjuter printer kondicioner 450,000 lekë;

II. Të përdoren mjetet monetare e lira nga granti i trashëguar sipas aktit normativ nr.06., datë 14.12.2023 në shumën prej 30,103,647 lekë për *"Shpërndarjen e fondit të pa kushtëzuar shtesë"* për shlyerjen e detyrimeve kontraktuale të mbartura si më poshtë:
a)Rikonstruksioni i Gjimnazit Shefqet Guzi në vlerën 17,994,168 lekë;
b)Rikonstruksion asfaltim i lagjes *"Ish depo e grumbullimit"* në vlerën 7,000,000 lekë;
c)Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme Fshati Cerunje në vlerën 5,109,479 lekë.
III. Të shtohen të ardhurat e trashëguara për funksionet specifike 17,204,677 lekë nga të cilat angazhime të marra janë 12,641,283 lekë dhe mjete të lira janë 4,563,394 lekë.
Të përdoren fondet e lira për funksionet specifike nga grandi shuma 4,563,394 lekë si më poshtë:
1-Grande specifike dhe ai i Bashkisë për arsimin parashkollor janë 1,698,120 lekë të përdoret:
a)Paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore 1,200,000 lekë
b)Shpenzime operative 138,120 lekë
c)Blerje topa dhe materiale sportive 138,120 lekë
2.Të përdoret fondi prej 1,061,923 lekë shpenzime operative për ujitjen dhe kullimit për mirëmbajtjen sistemime dhe pastrimin e kanaleve vaditëse dhe rezervuare.
3.Të përdoret për shpenzime operative te Drejtorisë së Pyjeve shuma 76,615 lekë
4.Të përdoret për shpenzime operative të sektorit të MZSH-së shuma 1,726,736 lekë.
VKB nr.17, datë 29.02.2024, *"Për miratimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2023"* është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën 365/1 datë 18.03.2024.
Ndryshimi buxhetor me VKB nr.57. datë 31.07.2024 është protokolluar me shkresën nr.3230/2.prot datë 07.08.2024 në të cilin është vendosur pakësim i programit 04520 *"Rikonstruksioni i rrugës Pishaj"* në vlerë 2,952,000 lekë dhe shtimi i programit 01110 mbikëqyrje kolaudimit për projektet e investimit në vlerën 2,952,000 lekë.
Janë rritur të ardhurat e parashikuara në vlerën 2,668,000 lekë me përdorim për shpenzimet e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të projekteve në programin 1110 në vlerën 2,668,000 lekë
Shkresa nr.1040., datë 04.03.2024 e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit përcakton që programi 1110 llogaria 231 pakësohet 730,000 lekë dhe shtohet programi 1110 llogaria 602 në vlerën 730,000 lekë për financimin 10% të një autoambulance te re nga fondacioni.

Me shkresën 1412.prot., datë 03.04.2024 DFB ka kryer ndryshime brenda të njëjtit program programi 4240 në të cilin pakësohet llogaria 602 në vlerën 5,777,790 lekë dhe shtohet llogaria 231 në vlerën 5,777,790 lekë për objektin *"Merematimi i kanalit vaditës Mashan"*.
Me shkresën 1522.prot., datë 11.04.2024 të DFB janë bërë ndryshime brenda të njëjtit program, programi 3280, pakësohet llogaria 602 në vlerën 98,000 lekë dhe shtohet llogaria 231 në vlerën 98,000 lekë për blerje motosharrë për zjarrfikësen.
Me shkresën nr.2309.prot., datë 03.06.2024 DFB ka kryer ndryshim plani shpenzimesh brenda të njëjtit program, programi 8220 pakësohet llogaria 602 në vlerën 60,000 lekë pakësohet llogaria 231 në vlerën 2,523,000 lekë dhe shtohet llogaria 602 në vlerën 2,583,000 lekë për zhvillimin e aktiviteteve kulturore.
Marrëveshja e bashkëpunimit të Qarku nr.2595,prot., datë 20.06.2024 përcakton shtimin e programit 8220 në llogarinë 231 në vlerën 8,477,065 lekë për objektin *"Rikonstruksionin e Qendrës Kulturore të Fëmijëve"* fond i cili nuk është përdorur gjatë vitit 2024.
Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.57., datë 07.08.2024 përcakton që pakësohet programi 4520 llogaria 231 në vlerën 2,952,000 lekë duke përdorur te ardhurat e veta 2,668,000 lekë dhe shtohet programi 1110 llogaria 231 në vlerën 5,620.000 lekë me objekt *"Mbikëqyrje dhe kolaudime për objektet e investimit".*
Shkresa nr.3637.prot., datë 26.08.2024 e DFB për *"Bashkëfinancime banesat"* bazuar ne Vendim të Këshillit Bashkiak nr.16., datë 29.02.2024 përcakton që pakësohet programi 1110 llogaria 231 në vlerën 2,236,991 lekë dhe shtohet programi 6190 llogaria 231 në vlerën 2,236,991 lekë, me objekt *"përmirësimin e banesave te komuniteteve te varfër dhe të pa favorizuara"*.
Shkresa nr.4313., datë 04.10.2024 përcakton ndryshime brenda të njëjtit program, programi 3280 dhe 8130 pakësohet llogaria 602 në vlerën 200,000 lekë dhe shtohet llogaria 231 në vlerën 200,000 lekë blerje fryrje ajri për zjarrfikëset dhe bojlerë për dushet.
Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.61 datë 18.09.2024 përcakton ndryshime dhe shtesë fondi për programet 4260,9120,4520,1110 në vlerën totale 9,520,000 lekë dhe shtohen programet 9120,3280,9230,1110,3140,4240,4520,6260,8130,82220 për vlerën 30,004,056 lekë shtuar fondi 20,484,056 lekë. Vlera prej 20,484,056 lekë përben fondin për rritjen e nivelit të pagave sipas shkresave të Ministrisë së Financave me nr.11788.prot datë 04.09.2024 në të cilën dërgohet fondi për rritjen e pagave në vlerën 9,422,942 lekë dhe me shkresën nr.8098/2 datë 25.07.2024 dërgohet fond me vlere 11,061,114 lekë.
Vendim i Këshillit Bashkiak nr.61 datë 18.09.2024, për ndryshimet buxhetore dhe fondin e pagave është miratuar nga Prefektura e Qarkut Elbasan me nr.1014/1.prot., datë 25.09.2024.
Shkresa nr.5293.prot datë 15.11.2024 e DFB përcakton ndryshime brenda programeve të njëjta 4260 dhe 9230 përkatësisht llogaritë 601 dhe 602 pakësohen 600,000 lekë dhe shtohen llogaritë 600 dhe 601 në vlerën 600,000 lekë.
Fondi i emergjencave civile *"Fondi rezerve dhe i kontigjencës"* është ndryshuar me shkresën nr.5665.prot., datë 16.12.2024, programi 1110 llogaria 604 pakësohet 12,122,860 lekë dhe shtohet programi 1110 llogaria 231 në vlerën 12,122,860 lekë.
Me shkresën nr.1815/3 datë 11.03.2024 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit është dërguar fond për shpenzime kapitale llogaria 231 me vlere 94,407,839 lekë e financuar nga ministria, nga e cila për vitin 2024 është planifikuar 23,000,000 lekë dhe për vitin 2025 në vlerën 71,407,839 lekë. Vlera e financimit nga Bashkia Gramsh është 16,660,207 lekë. Financimi i objektit *"Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare rilindja"* për vitin 2024, realizuar vlera e projektit 23,000,000 lekë nga fondi i Ministrisë.
Me shkresën nr.836/1,prot datë 19.02.2024 dërgohet detajimi i buxhetit për shpenzimet kapitale me vlere 3,484,200 lekë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Me shkresën nr.816/2.prot., datë

23.02.2024 dërgohet transferim fondi për shpenzime me vlere 3,484,200 lekë e financuar nga ministria nga e cila për vitin 2024 është planifikuar 3,484,200 lekë për *"Blerje Mobilieri Shkolla 35 Vjetori"*

Projekti i shkollës Shefqet Guzi me vlere 80,000,078 lekë .Ky projekt ka filluar në vitin 2023 i planifikuar për financim nga Ministria e Arsimit dhe Sportit nga të cilat ngelur për financim për vitin 2024 vlera 64,054,814 lekë. Ky projekt është miratuar me VKB nr.59 prot., datë 07.08.2023 dhe ka qenë në vazhdim gjatë vitit 2024.

Me shkresën Sportit nr.836/1,prot datë 19.02.2024 nga Ministria e Arsimit përcaktohet transferimi i fondit dhe dërgimi i detajuar i buxhetit për shpenzimet kapitale me vlere 46,002,955 lekë. Shkresa nr.816/2 datë 23.02.2024 transferim fondi për shpenzime me vlere 46,002,955 lekë përcakton financimin nga ministria nga e cila për vitin 2024 është realizuar 46,002,955 lekë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe nga Bashkia vlera 18,051,860 lekë.

Transferim fondi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për shpenzimet kapitale *"Blerje mobilierie për shkollën Shefqet Guzi"* me shkresën nr.1669/36 prot., datë 27.03.2024. Pajisje mobilieri arsim i mesëm i përgjithshëm me vlere 6,230,756 lekë e cila është realizuar në vlerën 4,258,000 lekë gjatë vitit 2024.

Shkresa e Ministrisë së Kulturës dhe Inovacionit me nr.7006.prot 29.05.2024 *"Për miratimin e transferimit të fondit për fazën e dytë të financimit për projektet e shpallura fituese gjatë vitit 2023"* përcakton financimin me vlere 4,754,934 lekë për përmirësimin e kushteve te banimit të komuniteteve te varfër.

Shkresa e Ministrisë së Kulturës dhe Inovacionit nr.8086/3 prot 20.06.2024 *"Për njoftimin e fituesit të projektit të përmirësimit te banesave ekzistuese të shtresave në nevojë"* përcakton fondin me vlerë 8,947,963 lekë nga të cilat 6,889,932 lekë për vitin 2024 dhe 2,058,031 lekë për vitin 2025.Fond i transferuar me shkrese 8086/24 datë 24.07.2024 në vlerën 8,947,963 lekë.

VKM nr.307., datë 22.05.2024, dërgim fondi për menaxhimin e fatkeqësive natyrore projekti *" Ndërtimi i pritave për bregun e lumit Devoll në kuadër te mbrojtjes se tokës bujqësore"* me vlere 98,442,888 lekë prej të cilave planifikuar 34,455,011 lekë për vitin 2024 dhe 63,987,877 lekë për vitin 2025.

Shkresa nr.4474/5 prot., datë 23.04.2024 e Ministrisë së Kulturës dhe Inovacionit për miratim fondi për shpenzimet korrent për bonusin e subvencionimit të qerasë programi 6190 me vlerë 3,091,890 lekë transferuar fondi me shkresë 4474/7 prot., datë 29.05.2024 nga Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit.

Shkrese e Agjencisë Kombëtare e Mbrojtjes Civile nr.446/2 prot., datë 20.02.2024 *"Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"* me vlerë 5,136,902 lekë me objekt shtetas te ndihmuar banesat e te cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme.

Fondi i miratuar nga Ministria e Arsimi dhe Sportit me nr.806/1, datë 06.02.2024 me vlere 1,910,520 lekë për bursat ë konviktoreve.

Në mënyrë analitike paraqitet përmbledhësja mbi planifikimin e buxhetit për vitin 2024 sipas VKB-ve përkatëse si më poshtë:

Tabela nr.2.2/5: Planifikimin e buxhetit për vitin 2024 sipas VKB-ve përkatëse 000/Lekë

Planifikimi i të ardhurave 2024		**Planifikimi i shpenzimeve 2024**	
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/ lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2024	121,615	Art. 600 Paga	273,507
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2023	15,525	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	46,108
Total të ardhurat e veta		Art.602 Shpenzime operative	

	137,140		192,707
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.	62,401	Art.604 Transferime korrent të brendshme	5,310
Të ardhura të trashëguara nga granti i kushtëzuar (transferua specifike 600, 601, 602 etj.).	17,204	606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	4,173
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2024	325,277	Art.230-231 Investime	200,146
Transfertë specifike e çelur për llogari të vitit 2024	179,994	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	65
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit	584,876		
TOTALI TË ARDHURAVE GRAND + TR	**722,016**	**TOTALI SHPENZIMEVE GRAMD + TR**	**722,016**
Të ardhura për funksionet e deleguara bursa konvikti	1,910	Art. 600 Paga	6,789
Të ardhura per funksionet e deleguara bonus strehimi	3,327	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,136
Të ardhura për funksionet e deleguara ndihma ekonomike dhe pagese paaftësie	459,218	Art.602 Shpenzime operative	1,910
Të ardhura për funksionet e deleguara paga dhe sigurime për projektin qendra "Lulet e Diellit"	3,210	Art.604 Transferime korrent të brendshme	6,912
Të ardhura për funksionet e deleguara paga dhe sigurime Gjendja Civile	7,925	606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	465,755
Të ardhura per funksionet e deleguara kompesim për demet nga tërmeti	6,912	Art.230-231 Investime	122,846
Të ardhura për Investime specifike	122,846		
TOTALI TË ARDHURAVE TE DELEGUARA	**605,348**	**TOTALI SHPENZIMEVE TE DELEGUARA**	**605,348**
TOTALI TË ARDHURAVE	**1,327,364**	**TOTALI SHPENZIMEVE**	**1,327,364**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Gramsh

Planifikimi i buxhetit me ndryshime për vitin 2024 rezulton 722,016 mijë lekë vlere e cila është sipas të dhënave të thesarit dhe qe i përket objektit të planifikimit që nuk përfshin fondet e deleguara të Bashkisë Gramsh.

Fondet e deleguara për vitin 2024 janë në vlerën 605,348 mijë lekë dhe në total planifikimi për vitin 2024 është në vlerën 1,327,364 mijë lekë.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli në përgjithësi është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Plani përfundimtar i buxhetit sipas shkresave përkatëse është krahasuar me situacionin progresiv të thesarit për të përcaktuar nivelin e planit përfundimtar dhe realizimin e tij.

Auditimi është drejtuar në përcaktimin e saktësisë së klasifikimit të zërave buxhetorë sipas realizimit dhe kryerja e testeve u orientua në krahasimin e situacionit faktik të realizimit të buxhetit të konfirmuar nga struktura përgjegjëse për thesarin nga të cilat nuk rezultuan devijime materiale. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2024 së bashku me njësitë e varësisë, referuar akt- rakordimit me thesarin paraqitet në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 2.2/6; Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2024 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2024								
		Plani përfundimtar	Fakti sipas akt r akordimit	% e realizimit te buxhetit	Të ardhura veta	% e realizimit nga te ardhurat e veta	Transferte e pa kushtëzuar	Transferte. e kushtëzuar	Transferta. Kushtëzuar	Transferte. Kushtëzuar

								Specifike	Funksione Deleguara.	Për Investime.
1	Paga (600)	280,296	270,143	96%	0		136,242	127,137	6,764	0
2	Sigurime (601)	47,244	45,264	96%	0		20,390	23,745	1,129	0
3	Shpenzime (602)	194,617	158,548	81%	47,283	30%	77,021	32,334	1,910	0
4	Shpenzime (604)	12,222	7,714	63%	802	10%	0	0	6,912	0
5	Transferta 606 F. Rezervë	469,928	467,993	99%	2,307	57%	1,703	63	463,920	0
6	Investime (230 +231)	322,992	266,333	82%	37,268	14%	87,042	19,177	0	122,846
7	Artikulli 609 (fond rezervë + kontigjencës	65	0	0%	0	0%	0	0		0
8	Granaci pulle(466)		243							
9	Çlirim garancie (466)		10,839							
	Totali	**1,327,364**	**1,227,077**	**92%**	**87,660**	7%	**322,398**	**202,456**	**480,635**	**122,846**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Gramsh

Sipas akt rakordimit me Degën e thesarit Gramsh shpenzime buxhetore te realizuara për vitin 2024 janë 1,227,076,957 lekë. Realizimi i shpenzimeve buxhetore për sa trajtuar në tabelën më sipër është 1,227,076,957 lekë. Në realizimin e buxhetit janë dhe vlerat nga llogaria 466 taksë pulle në vlerën 243,200 lekë dhe çlirim garancie 10,838,719 lekë.

Për vitin 2024 realizimi përfshirë funksionet dhe transfertat e deleguara është vlerën prej 1,227,077 mijë lekë. Buxheti është realizuar nga të ardhurat e veta në shumën prej 87,660 mijë lekë ose 7% të tije. Është realizuar nga transferta e pa kushtëzuar në vlerën prej 322,398 mijë lekë ose 26,3% të realizimit në total. Nga transferta e kushtëzuar specifike është realizuar 202,456 mijë lekë ose 16,5% të totalit. Nga transferta e kushtëzuar për funksionet të deleguara 480,635 mijë lekë ose 39,1% të totalit dhe nga transferta e kushtëzuar për investime 122,846 mijë lekë ose 10% e totalit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2024.

-Artikulli 600 "Paga, Shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli" është planifikuar në vlerën 280,296 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 270,143 mijë lekë ose në masën 96% e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 0 lekë + nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 136,242 mijë lekë + nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 202,456 mijë lekë + nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 6,764 mijë lekë. Mos realizimi i këtij artikulli ka ardhur si pasojë e vendeve vakant në strukturë si dhe mos përdorimit të fondit të veçantë.

-Artikulli 601 "Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore" është planifikuar në vlerën 47,244 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 45,264 mijë lekë ose në masën 96% e përbërë nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 20,390 mijë lekë + nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 23,745 mijë lekë + nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 6,764 mijë lekë.

-Artikulli 602 "Mallra dhe shërbime të tjera" është planifikuar në vlerën 194,617 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 158,548 mijë lekë ose në masën 81% e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 47.283 mijë lekë + nga transferta e kushtëzuar në vlerën 77,021 mijë lekë + nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 32,334 mijë lekë + nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 1,910 mijë lekë.

-Artikulli 604 "Transferime korrente të brendshme është planifikuar në vlerën 12,222 mijë lekë

dhe realizuar në vlerën 7,714 mijë lekë ose në masën 63% e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 802 mijë lekë + transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 6,912 mijë lekë.
-Artikulli 606 *"Transferime për buxhete familjare dhe individë"* "+ fondi rezerve është planifikuar në vlerën 469,928 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 467,993 mijë lekë ose në masën 99% e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 2,307 mijë lekë + nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 1,703 mijë lekë + nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 63 mijë lekë + nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 463,920 mijë lekë.
-Artikulli 230-231 "Investime" është planifikuar në vlerën 322,992 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 266,333 mijë lekë ose në masën 82% e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 37,268 mijë lekë + nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 87,042 mijë lekë + nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 19,177 mijë lekë + nga transferta e kushtëzuar për investimet në vlerën 122,846 mijë lekë.
-Artikulli 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* është realizuar në vlerën 11,082 mijë lekë.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të Këshillit Bashkiak.
-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Gramsh dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar.
-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nen artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla. Në mënyrë analitike paraqiten të dhënat si më poshtë:

Tabela nr. 2.2/7: Ndryshimet buxhetore gjatë vitit 2024 lekë

I	**Buxheti VKB nr. 88, datë 27.12.2023**						**595,257,000**
Nr.	**Përshkrimi i ndryshimit**	**Pakësohet**			**Shtohet**		
		Programi	Klasa	Vlera	**Programi**	Klasa	Vlera
	VKB-në nr.17, datë 29.02.2024 te ardhura trashëguara				**1110**	602	11,343,271
						604	394,922
						606	476,240
						231	44,592,872
					3280	602	2,795,925
					4240	602	1,061,923
					4260	602	232,890
					4520	602	2,231,944
					9120	600	1,200,000
						602	5,725,012
						231	619,530

					9230	602	3,337,453
						231	18,057,091
					6190	231	3,061,145
II	**Totali i shtesave nga te ardhurat**						**95,130,218**
	Përshkrimi i ndryshimit	**Pakësohet**			**Shtohet**		
1	Shkresa 1040 datë 04.03.2024	**1110**	231	730,000	**1110**	602	730,000
2	Shkresa 1412.prot., datë 03.04.2024	**4240**	602	5,777,790	**4240**	231	5,777,790
3	Shkresa 1522.prot., datë 11.04.2024	**3280**	602	98,000	**3280**	231	98,000
4	Shkresa 2309.prot., datë 03.06.2024	**8220**	231	2,523,000	**8220**	602	2,583,000
		8220	602	60,000			
5	Marrëveshje me qarkun nr. 259 datë 20.06.2024				**8220**	231	8,477,065
6	VKB nr.57., datë 07.08.2024	**4520**	231	2,952,000	**1110**	231	5,620,000
7	VKBnr.16. datë 29.02.2024	**1110**	231	2,236,991	**6190**	231	2,236,991
8	Shkresa 4313.prot., datë 04.10.2024	**3280**	602	100,000	**3280**	231	100,000
		8130	602	100,000	**8130**	231	100,000
9	VKB nr.61., datë 18.09.2024 ndryshime dhe shtese fondi për pagat				**9,120**	600	8,270,000
					9,120	601	1,381,475
					3,280	600	1,208,000
					3,280	601	201,639
					9,230	600	128,942
					9,230	601	21,000
					1,110	600	6,855,000
					1,110	601	1,145,000
					3,140	600	129,000
					3,140	601	21,000
					4,240	600	240,000
					4,240	601	40,000
					4,520	600	843,000
		4260	600	1,200,000	**4,520**	600	828,000
		4260	231	187,000	**4,520**	601	279,000
		9120	602	1,200,000	**6,260**	600	668,000
					6260	601	112,000
					8130	600	171,000
					8130	601	29,000
					8220	600	428,000
					8220	601	72,000
		4520	231	2,950,000	**1110**	602	1,296,000
		1110	231	320,000	**1110**	231	4,117,000

		4260	231	3,663,000	**8130**	602	1,520,000
10	Shkrese nr.5293.prot datë 15.11.2024 sistemim pagash	**4260**	601	170,000	**4260**	600	500,000
		4260	602	330,000	**9230**	600	85,000
		9230	602	100,000	**9230**	601	15,000
11	Shkrese nr.5665.,datë 16.12.2024 përdorimi i fondit rezerve	**1110**	604	12,122,860	**1110**	231	12,122,860
III	**Totali i ndryshimeve**			**36,820,641**	**IV**		**68,449,762**
VI	**Totali i buxhetit viti 2024 me ndryshime VI= I+II+IV-III**						**722,016,339**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Gramsh /përpunoi grupi i auditimit

Nga krahasimi i shpenzimeve të realizuara përgjatë vitit 2024 konstatohen diferenca me planifikimin fillestar sipas parashikimit të bërë në fillim të vitit nga institucioni konkretisht të realizuara në llogaritë shpenzime operative, transferime korrente të brendshme, transferime për buxhete familjare dhe individë dhe investime. Të gjitha diferencat e paraqitura në llogaritë e mësipërme janë në tejkalim të parashikimit fillestar që rezulton në një parashikim jo të saktë të nevojave gjatë vitit buxhetor.
Planifikimi dhe realizimi i investimeve për vitin 2024.Për vitin 2024 me ndryshimet buxhetore të kryera gjatë vitit janë planifikuar të realizohen investime në vlerën 200,146,353 lekë dhe janë realizuar 143,487,001 lekë ose në masën 71,6%.Të detajuara investimet e kryera nga Bashkia Gramsh për vitin 2024 paraqiten në aneksin nr. 1 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër investimet e kryera nga bashkia janë në vlerën 143,487,001 lekë dhe investimet nga ministritë e linjës janë në vlerën 122,845,827 lekë në total japin vlerën 266,332,828 lekë e cila përputhet me llogarinë 231 sipas thesarit që është në vlerën 266,332,828 lekë.

Konkluzion: Me vendim të Këshillit Bashkiak nr.18, datë 29.02.2024 *"Për miratimin e ndryshimit të planit të buxhetit të Bashkisë Gramsh për vitin 2024"* pakësohet fondi rezerve programi 01110 me vlerë 2,000,000 lekë dhe të shtohet fondi rezerve në programin 04980 me vlerë 2,000,000 lekë.
Vendim i cili është konfirmuar nga prefekti i qarkut me shkresën 366/1 prot., datë 18.03.2024.
Për sa më sipër rezulton që ka pasur planifikim të pasaktë duke përfshirë fondin rezerve brenda programit 1110 që është *"Planifikim menaxhim dhe administrim"*. Ndryshimi ka ndodhur brenda muajit Mars 2024. Programi buxhetor 04980 *"fondi rezerve"* sipas raportit të monitorimit është 65,000 lekë në planifikim dhe zero lekë në realizim, ndërkohe që fondi rezerve në vetvete është planifikim 2,000,000 lekë dhe realizim 1,950,000 lekë.
Nga të dhënat e thesarit rezulton që programi 04980 për vitin 2024 është realizuar në vlerën 0 lekë. Për sa më sipër rezulton që programi 04980 nuk është pakësuar gjatë vitit 2024.
Nga auditimi u konstatua që programi buxhetor 04980 i cili është ka qenë i planifikuar me ndryshime në vlerën 2,000,000 lekë dhe në raportin e monitorimit të buxhetit rezulton planifikim 65,000 lekë rrjedhimisht vlera prej 1,935,000 lekë rezulton e ndryshuar si program buxhetor nga prekja e fondit rezerve. Nga auditimi u konstatua që ka vendime te këshillit bashkiak të vitit 2024 për prekjen e fondit rezerve për shpenzime për kurim në të cilën nuk përcaktohet pakësimi i programit 04980 *"fondi rezerve"* dhe praktika e ndjekur për ndryshimin e programit nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit është pas vendimit të këshillit bashkiak për prekjen e fondit rezerve. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit i është drejtuar Degës se thesarit Gramsh për pakësimin e programit buxhetor 04980*"fondi rezerve"* dhe shtimin e programit 01110 *"planifikim menaxhim*

administrim" në mënyrë qe të kryente veprimet e pagesës për kurim të vendosur nga Këshilli Bashkiak.
Nga auditimi u konstatua që ka ndryshime të shumta buxhetore gjatë vitit 2024 gjë që tregon një planifikim të pasaktë të shpenzimeve dhe te ardhurave buxhetore për vitin 2024.
Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar neni 19.20,47, 67, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9, pika 1.3, germa "c" dhe "ç", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" nenet 40,45,46, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, Kreu II.3. "*Buxheti i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore Rregulla dhe kritere për përdorimin e buxhetit vendor"* pikat 92 deri 108 UMFE nr. 22, date 30.07.2018, *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore"*, kreu II *"Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e monitorimit të buxhetit".*
Udhëzimin plotësues nr.1., datë 24.01.2024 Për zbatimin e buxhetit për vitin 2024 Kreu II. *"Kritere dhe procedura specifike shtesë për zbatimin e buxhetit vendor"*, pika 100 deri 130

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:
Z. B. A. Kryetari i Bashkisë Gramsh
Z. A. S. ish Drejtor i Financës dhe Buxhetit
Z. E. H. Drejtor i Financës dhe Buxhetit

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.
Për vlerësimin e procesit të programimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor për vitin 2024 të Bashkisë Gramsh janë analizuar fillimisht planifikimet buxhetore afatmesme për përballimin e nevojave për vitet në vijim në bazë të eksperiencës së viteve të kaluara dhe nevojave reale si pasojë e ndryshimeve në vitin e pritshëm buxhetor.
Me shkresën nr.917.prot datë 28.02.2025 është dërguar në Ministrinë e Financave dhe ekonomisë nga ana e Bashkisë Gramsh, raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2024 i cili nuk përmban përdorimin e fondit rezerve programi 04980, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar neni 63 "*Miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit*" germa ç) *"raportin për përdorimin e fondit rezervë dhe të kontingjencës"* Sipas shkresës së Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë nr.5706.prot., datë 02.04.2025 *"Dërgohen mendimet mbi raportin vjetor të monitorimit të buxhetit 2024"* planifikimi i programeve buxhetore dhe realizimi është si më poshtë vijon:

Tabela nr. 2.2/8: Planifikimi dhe realizimi i programeve buxhetore për vitin 2024 000/lekë

Nr.	Programi	Shpenzimet sipas programeve	Planifikimi me ndryshime 2024	Realizimi sipas raportit të monitorimit	Realizimi në %
			000/lekë	000/lekë	000/lekë
1	01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	270,438	223,097	82,5%
2	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	7,270	7,270	100%
3	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	23,962	20,813	86,9%
4	04130	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik			
5	04220	Shërbimet Bujqësore, inspektimi, ushqimi			
6	04240	Menaxhimi I Infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit	12,501	10,160	81,3%
7	04260	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	27,269	24,292	89,1%

8	04520	Rrjeti rrugor rural	88,147	76,027	86,3%
9	04570	Transporti Publik			
10	05100	Menaxhimi i Mbetjeve	36,486	31,895	87,4%
11	06140	Planifikimi Urban dhe Vendor			
12	06260	Shërbimet publike vendore	38,228	34,223	89,5%
13	06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime			
14	07220	Shërbimet e Kujdesit Parësor			
15	08130	Sport dhe argëtim	25,530	19,959	88,6%
16	08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	21,478	11,637	54,2%
17	09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	124,727	111,367	89,3%
18	09230	Arsimi Mesëm i Përgjithshëm	37,678	31,460	83,5%
19	10430	Përkujdes social	538	21,8	4,1%
20	10661	Strehimi Social	5,298	4,889	92,3%
	04980	Fondi rezerve	65		
	06440	Ndriçim rrugësh	5,400	5,400	100%
	06190				
		Fondi Kontigjences			
		TOTALI	**722,016**	**612,514**	**84,8%**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit/raporti i monitorimit të buxhetit

Planifikimi dhe realizimi i treguesve sipas raporteve të monitorimit nuk përfshijnë funksionet e deleguara për të ardhurat dhe shpenzimet por paraqesin planifikimin dhe realizimin buxhetor te bashkisë vetëm për shpenzimeve që u përkasin njësive të vetëqeverisjes vendore. Për vitin 2024 planifikimi i buxhetit me ndryshime pa funksionet e deleguara është 722,016 mijë lekë dhe realizuar 612,514 mijë lekë.

Nga shqyrtimi i raportit të monitorimit të buxhetit dërguar në Ministrinë e Financave dhe ekonomisë nga ana e Bashkisë Gramsh rezulton që për vitin 2024 janë realizuar treguesit buxhetor në programin 10430 *"për përkujdesjen sociale"* në vlerën prej 21,8 mijë lekë, programi buxhetor 10661 *"strehimi social"* në vlerën 4,889 mijë lekë dhe programi buxhetor 06440 *"ndriçim rrugësh"* në vlerën 5,400 lekë.

Tabela nr.2.2/9: Programeve buxhetore të pa planifikuara në buxhetin fillestar për vitin 2024 000/lekë

Nr.	**Programi**	**Shpenzimet sipas programeve**	**Faza e pare e PBA 2024-2024**	**Faza e dytë e PBA 2024-2026**	**Planifikimi me ndryshime 2024**
			000/lekë	**000/lekë**	**000/lekë**
	10430	Përkujdes social	0	0	538
	10661	Strehimi Social	0	0	5,298
	04980	Fondi rezerve	0	0	65
	06440	Ndriçim rrugësh (energji oshe)	0	0	5,400

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit/raporti i monitorimit të buxhetit

Për sa më sipër u konstatua që programi 10430 *"përkujdes social"* dhe programi 10661 *"strehimi social"* nuk janë planifikuar në buxhetin fillestar të Bashkisë Gramsh në kundërshtim me përcaktimet ligjore të Udhëzimin nr.6., datë 28.02.2023 *"Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026"* kreu VII pika 42 germa d , Shtoja 4 *"Lista orientuese e produkteve standarde sipas 20 programeve buxhetore të NJVQV-ve"*

Programi buxhetor 06440 që i përket pagesave te energjisë për ndriçimit të rrugëve nuk është program buxhetor që përfshihet në 20 programet buxhetore të njësisë së vetëqeverisjes vendore në PBA 2024-2026.

Nga auditimi u konstatua së ky program buxhetor 06440 është planifikuar dhe realizuar në vlerën 5,400 mijë lekë. Në (PBA Përfundimtare) nuk ka qenë i planifikuar si program buxhetor Programi buxhetor 06440 ndriçim rrugësh i përket PBA 2023-2025.Në buxhetin fillestar me vlere 595,000

mijë lekë datë 27.12.2024 rezulton që ky program buxhetor është planifikuar në vlerën 5,400 mijë lekë. Për sa më sipër në buxhetin vjetor të vitit 2024 programi 06440 nuk duhej të përcaktohej në numrin e programit 06440 por në programin 06260 *"shërbimet publike vendore"* sipas Udhëzimit nr.6., datë 28.02.2023 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026" kreu VII pika 42 germa d Shtojca 4 "*Lista orientuese e produkteve standarde sipas 20 programeve buxhetore të NJVQV-ve".*

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë: Vlerat e llogaritura për këtë qëllim: Fondi rezervë dhe i kontigjencës paraqitet në shumën 19,715 mijë lekë miratuar me VKB nr.88., datë 27 Dhjetor 2024.

Fondi Rezervë dhe kontigjencës: Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* dhe nenit 6 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, Buxheti vendor përfshin një fond rezervë dhe një fond kontingjence, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

Fondi rezerve në fillim të vitit 2024 ka qenë i përfshirë në programin buxhetor 1110 *"planifikim menaxhim administrim"* dhe është ndryshuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr.18., datë 29.02.2024 *"Për miratimin e ndryshimit të planit të buxhetit të Bashkisë Gramsh për vitin 2024"* .Me ketë vendim pakësohet fondi rezerve programi 01110 me vlerë 2,000,000 lekë dhe të shtohet fondi rezerve në programin 04980 me vlerë 2,000,000 lekë. Ndryshimi ka ndodhur brenda muajit Mars 2024 dhe nuk duhej të ndodhte sipas përcaktimeve ligjore për afatin kohor te ndryshimit të buxhetit.

Fondet e Emergjencës dhe për Mbrojtjen Civile: Në zbatim të nenit 65 të Ligjit nr. 45/2019, *"Për mbrojtjen civile",* fondi i emergjencave civile planifikohet në shumë totale minimalisht 4% të totalit të buxhetit të Bashkisë, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Bazuar në Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* neni 6 "*Fondi i kontingjencës përdoret sipas përcaktimit në vendimin për buxhetin vjetor të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese."*
Në buxhetin e Bashkisë Gramsh është parashikuar fond për emergjencat civile në vlerën 16,415 mijë lekë me VKB nr. 88, datë 27.12.2023.Ky fond është i parashikuar brenda programit buxhetor *"planifikim menaxhim administrim",* programi 1110. Me shkresën e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit drejtuar Thesarit Gramsh me nr.5665 prot., datë 16.12.2024, fondi i emergjencave civile *"fondi rezerve dhe i kontigjencës"* ka ndryshuar destinacion të përdorimit të tije pasi ndodhej në programin 1110 llogaria 604 e cila pakësohet 12,122,860 lekë dhe shtohet programi 1110 llogaria 231 në vlerën 12,122,860 lekë për ndërtimin e pritave lumore për shmangien e aksidenteve. U konstatua që fondi i emergjencave civile nuk duhet të përshihet në programin buxhetor 1110 por në programin buxhetor 03280 *"mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile".*
Ndryshimi i destinacionit të përdorimit të fondit rezerve është dërguar në thesar brenda programit 1110 ndërkohe që duhej të ndryshohej programi buxhetor në programin 03280 i cili kërkon miratimin e Këshillit Bashkiak pavarësisht që nuk është përdorur gjatë vitit 2024.

Subvencione: Bashkia Gramsh për vitin nuk ka pasur subvencione për vitin 2024.

Kredi të marra: Bashkia Gramsh nuk ka marrë kredi për vitin 2024.

Konkluzion: Programi buxhetor 10430 *"Përkujdes social"* dhe programi 10661 "*Strehimi social"* nuk janë planifikuar në buxhetin fillestar të Bashkisë Gramsh në kundërshtim me përcaktimet ligjore të Udhëzimin nr.6., datë 28.02.2023 *"Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026"* kreu VII pika 42 germa d, Shtojca 4 *"Lista orientuese e produkteve standarde sipas 20 programeve buxhetore të NJVQV-ve"*.
Programi buxhetor 06440 që i përket pagesave te energjisë për ndriçimit të rrugëve nuk është program buxhetor që përfshihet në 20 programet buxhetore të njësisë së vetëqeverisjes vendore në PBA 2024-2026.
Nga auditimi u konstatua së ky program buxhetor 06440 është planifikuar dhe realizuar në vlerën 5,400 mijë lekë. Në PBA Përfundimtare nuk ka qenë i planifikuar si program buxhetor. Programi buxhetor 06440 *"ndriçim rrugësh"* i përket PBA 2023-2025.Në buxhetin fillestar me vlere 595,000 mijë lekë datë 27.12.2024, rezulton që ky program buxhetor është planifikuar në vlerën 5,400 mijë lekë. Për sa më sipër në buxhetin vjetor të vitit 2024 programi 06440 nuk duhej të përcaktohej në numrin e programit 06440 por në programin 06260 *"shërbimet publike* vendore" sipas Udhëzimit nr.6., datë 28.02.2023 *"Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026"* kreu VII pika 42 germa d shtojca 4 *"Lista orientuese e produkteve standarde sipas 20 programeve buxhetore të NJVQV-ve"*.
Në buxhetin e Bashkisë Gramsh është parashikuar fond për emergjencat civile në vlerën 16,415 mijë lekë me VKB nr. 88, datë 27.12.2023.Ky fond është i parashikuar brenda programit buxhetor *"planifikim menaxhim administrim"* programi 1110. Me shkresën e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit drejtuar Thesarit Gramsh me nr.5665.prot., datë 16.12.2024, fondi i emergjencave civile , fondi rezerve dhe i kontigjencës ka ndryshuar destinacion të përdorimit të tije pasi ndodhej në programin 1110 llogaria 604 e cila është pakësuar 12,122,860 lekë dhe është shtuar programi 1110 llogaria 231 në vlerën 12,122,860 lekë, për ndërtimin e pritave lumore për shmangien e aksidenteve. U konstatua që fondi i emergjencave civile nuk duhet të përshihet në programin buxhetor 1110 por në programin buxhetor 03280 *"mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile"*.
Ndryshimi i destinacionit të përdorimit të fondit rezerve është dërguar në thesar brenda programit 1110 ndërkohe që duhej të ndryshohej programi buxhetor në programin 03280 i cili kërkon miratimin e Këshillit Bashkiak pavarësisht që nuk është përdorur gjatë vitit 2024.
Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar neni 44 *"Rishpërndarja e fondeve buxhetore", "Për njësitë e qeverisjes vendore, kur buxheti miratohet në nivel programi germa a) rishpërndarjet ndërmjet programeve miratohen nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore"*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:
z. B. A. Kryetari i Bashkisë Gramsh
Z. A. S. ish Drejtor i Financës dhe Buxhetit
Z. E. H. Drejtor i Financës dhe Buxhetit

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministritë e linjës etj.)

Bashkia Gramsh ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Raportin e monitorimit dhe të zbatimit të buxhetit për vitin 2024.Sipas shkresës së Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë nr.5706.prot., datë 02.04.2025 *"Dërgohen mendimet mbi raportin vjetor të monitorimit të buxhetit 2024"* Bashkia Gramsh nuk ka paraqitur dhe trajtuar informacion lidhur me detyrimet e prapambetura për vitin 2024. Bashkia Gramsh ka dërguar pranë Ministrisë së Financave Raportin e Vetëvlerësimit Financiar për periudhën për vitin 2024,me shkresë nr.916.prot., datë 28.02.2025 i cili përmban:

"Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiare normale dhe rastet e vështirësive financiare" me vlerë detyrimi 15,853,909 lekë në raport me shpenzimet vjetore të NJVQV-së në vlerë 612,514,127 lekë.

Tabela nr. 2.2/10:Detyrimet e prapambetura Bashkia Gramsh 31.12.2024 lekë

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	**Borxhe (a+b)**	**0**		
a	**Hua afatgjatë**	**0**		
a,1	Marrëveshje financimi			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	**Hua afatshkurtër**	**0**		
b,1	Marrëveshje financimi			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	**Detyrimet e prapambetura**	**15,853,909**		**2.59%**
Llogaria	**Emërtimi**			
4864100	Vendime Gjyqësore	3,989,392		
4864200	Det. Prap. Shërbime	6,663,979		
4864201	D.P. Eneri Elektrikë			
4864300	Det. Prap.Mirembajtje			
4864400	Det. Prap. Investime	4,347,667		
4864500	Det .Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra	852,871		
4864900	Det .Prap.Te Tjera			
4864601	Det. Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det .Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det. Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det. Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	**Totali (I+II)**	**15,853,909**	**612,514,127**	**2.59%**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Gramsh

Të detajuara dhe ndryshimet shtesat dhe pikësimet e detyrimeve të prapambetura paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela nr. 2.2/11:Detyrimet e prapambetura Bashkia Gramsh 31.12.2024 lekë

Kodi i detyrimit te prapambetura	Emërimi i detyrimit te prapambetura	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2023	Vlera e paguar gjatë vitit 2024 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2024 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2023)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2024 (situata më 31.12.2024)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur më 31.12.2024
1	2	3	4	5=3-4	6	7=5+6
I. Detyrime që kanë si burim financimi të ardhurat e veta						
1	Detyrime për vendime gjyqësore	3,989,392	0	3,989,392	0	3,989,392
2	Detyrime për investime	5,992,632	5,590,832	401,800	828,937	1,230,737
3	Detyrime për Shërbime	1,681,357	0	1,681,357	4,982,622	6,663,979
4	Detyrime për Mallra	852,871	0	852,871	0	852,871
Totali i d**etyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta**		**12,516,252**	**5,590,832**	**6,925,420**	**5,811,559**	**12,736,979**
Detyrime te prapambetura nga FZHR		**2,641,476**	**-**	**2,641,476**	**-**	**2,641,476**
Detyrime te prapambetura nga Ministritë e linjës		**475,454**	**-**	**475,454**	**-**	**475,454**
Detyrime ne total nga të ardhurat e veta + granti		**15,633,182**	**5,590,832**	**10,042,350**	**5,811,559**	**15,853,909**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Gramsh

Detyrimet e prapambetura më datë 31.12.2024 janë në vlerën 15,853,89 lekë e përbërë nga detyrime të prapambetura që kanë si burim financimi të ardhurat e veta në vlerën 12,736,879 lekë + detyrime të prapambetura nga FZHR në vlerën 2,641,476 lekë + detyrime të prapambetura nga Ministria e linjës në vlerën 475,454 lekë.

Detyrimet e prapambetura viti 2024:

Bashkia Gramsh më datën 01.01.2023, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive në total në vlerën 15,633,182 lekë e përbërë nga detyrime të prapambetura me burim financimi nga të ardhurat e veta në vlerën 12,516,252 lekë + detyrime të prapambetura nga FZHR në vlerën 2,641,476 lekë + detyrime të prapambetura nga Ministria e Linjës në vlerën 475,454 lekë.

Gjatë vitit 2024 janë likuiduar detyrime të prapambetura në vlerën 5,590,832 lekë me burim financimi nga të ardhurat e veta që i përkasin detyrimeve progresive të datës 31.12.2023. Vlera e detyrimeve të trashëguara të papaguara më datë 31.12.2024, pa përfshirë detyrimet e krijuara gjatë vitit 2022, është në vlerën 10,042,350 lekë e përbërë nga detyrime të trashëguara me burim financimi nga të ardhurat e veta në vlerën 6,925,420 lekë + detyrime të trashëguara nga FZHR në vlerën 2,641,476 lekë + detyrime të trashëguara nga Ministria e Linjës në vlerën 475,454 lekë.

Detyrimet e prapambetura të krijuara vetëm përgjatë vitit 2024 janë vlerën 5,811,559 lekë. Vlera totale e detyrimeve të prapambetura progresive më datë 31.12.2024, është në vlerën 15,853,909 lekë e përbërë nga detyrime të prapambetura me burim financimi nga të ardhurat e veta në vlerën 12,736,979 lekë + detyrime të prapambetura nga FZHR në vlerën 2,641,476 lekë + detyrime të prapambetura nga Ministria e Linjës në vlerën 475,454 lekë.

Raportimi i detyrimeve të prapambetura sipas raporteve të monitorimit:

Nga auditimi u konstatua se, nga Bashkia Gramsh nuk ka dërguar raporte 4 mujore të monitorimit dhe të zbatimit të buxhetit për vitin 2024 Bashkia Gramsh ka dërguar pranë Ministrisë së Financave

Raport të Vetëvlerësimit Financiar për periudhën Janar -Prill 2024,me shkresë nr.2263 prot., datë 30.05.2024 i cili përmban:
a) *"Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiare normale dhe rastet e vështirësive financiare"* me vlere detyrimi 11,517,483 lekë në raport me shpenzimet vjetore të NJVQV-së në vlerë 566,413,532 lekë.
b) *"Treguesit fiskale të konsoliduar të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore"* për te ardhurat planifikuar 110,470,000 lekë vjetor dhe realizuar 35,577,737 lekë dhe shpenzimet e realizuara 171,232,634 lekë krahasuar me planifikimin fillestar 595,257,000 lekë.
Nuk ka raport të mirëfillte të monitorimit të buxhetit për 4 mujorin e parë sipas realizimit të programeve buxhetore.
Bashkia Gramsh ka dërguar pranë Ministrisë së Financave Raportit të Vetëvlerësimit Financiar për periudhën Janar - Gusht 2024,me shkresë nr.4265.prot., datë 01.10.2024 i cili përmban:
a) *"Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiare normale dhe rastet e vështirësive financiare"* me vlere detyrimi 15,633,132 lekë në raport me shpenzimet vjetore të NJVQV-së në vlerë 566,413,532 lekë.
b) *"Treguesit fiskale të konsoliduar të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore"* për të ardhurat planifikuar 121,615,065 lekë vjetor dhe realizuar 76,649,715 lekë dhe shpenzimet e realizuara 376,150,613 lekë krahasuar me planifikimin e rishikuar 701,532,284 lekë.
Nuk ka raport të mirëfillte të monitorimit të buxhetit për 8 mujorin sipas realizimit të programeve buxhetore.
Bashkia Gramsh ka dërguar pranë Ministrisë së Financave Raportit të Vetëvlerësimit Financiar për periudhën për vitin 2024,me shkresë nr.916.prot., datë 28.02.2025 i cili përmban:
a) *"Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiare normale dhe rastet e vështirësive financiare"* me vlere detyrimi 15,853,909 lekë në raport me shpenzimet vjetore të NJVQV-së në vlerë 612,514,127 lekë.
b) *"Treguesit fiskale të konsoliduar të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore"* për te ardhurat planifikuar 113,138,000 lekë vjetor dhe realizuar 126,318,836 lekë dhe shpenzimet e realizuara 612,514,127 lekë krahasuar me planifikimin e rishikuar 722,016,339 lekë.
c)Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për vitet 2025,2026,2027 që janë 5,000,000 viti 2024 dhe viti 2025 në vlerën 5,000,000 lekë dhe për vitin 2027 në vlerën 5,853,909 lekë.
Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka dërguar pranë Ministrisë së Financave Raportin e monitorimit dhe të zbatimit të buxhetit për vitin 2024. Ministria e Financave ka dërguar mendimet në lidhje me raportin e monitorimit të buxhetit me shkresën nr.5706.prot., datë 02.04.2025.
Raporti i monitorimit nuk përmban argumente shpjegues në lidhje me përqindjen e realizimit të të ardhurave të ardhurave faktike të mbledhura, kundrejt planit të periudhës dhe planit vjetor të të ardhurave nga dy kategoritë kryesore të taksapaguesve, personave fizikë e juridikë (familjarë dhe subjekteve juridike të ardhurave faktike të mbledhura; Nuk përmban raport të shpenzimeve të përgjithshme ndaj të ardhurave të përgjithshme; Shpenzimeve për investime kapitale ndaj shpenzimeve të përgjithshme; Detyrimeve financiare të papaguara në kohë ndaj të tretëve ndaj të ardhurave të përgjithshme detyrimeve tatimore të pa arkëtuara në kohë ndaj të ardhurave tatimore; Shpenzimeve për politikat e kujdesit shoqëror ndaj shpenzimeve të përgjithshme; Shpenzimeve për politikat që mbështesin barazinë gjinore ndaj shpenzimeve të përgjithshme.
Bashkia Gramsh, totalin e shpenzimeve të realizuara nga të ardhurat e veta për vitin 2024 e ka në vlerën 612,514,127 lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura më 31.12.2024, (pa përfshirë detyrimet e FZHR), ka vlerën 15,853,909 lekë. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 2.59 %. Për sa më sipër raporti i detyrimeve të prapambetura në vlerën 2,59% është poshtë nivelit 15% që tregon që

bashkia Gramsh nuk është në vështirësi financiare. Përcaktimet për vështirësitë financiare janë në Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.35, datë 29.12.2023 "Procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njësite e vetëqeverisjes vendore" kreu IV, pika 4.1 "Problemet Financiare", pika 59 ku citohet *"Njësia e vetë qeverisjes vendore konsiderohet me probleme financiare kur në një muaj të caktuar të vitit buxhetor konstatohen vonesa prej më shumë se 30 ditësh në likuidimin e detyrimeve ndaj palëve te treta dhe kur detyrimet e konstatuara dhe te pa paguara përbëjnë 15% të shpenzimeve vjetore faktike".*

Konkluzion: Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Gramsh nuk ka dërguar raporte 4 mujore të monitorimit dhe të zbatimit të buxhetit për vitin 2024. Raporti i monitorimit të buxhetit për vitin 2024 nuk është hartuar në përputhje të plote të përcaktimeve te nenit 54 të Ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar germa a, ç, h, i, f.
Raporti i monitorimit të buxhetit nuk është publikuar në faqen zyrtare të bashkisë Gramsh ne zbatim të nenit 48 pika 3 të Ligjit 68/2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar ku citohet "Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit publikohen nga nëpunësi autorizues në faqen zyrtare të njësisë përkatëse, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit, dhe një kopje e tyre i dërgohet Ministrisë së Financave".*
Nuk disponohet një korrespodencë shkresore me Këshillin Bashkiak dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me raportimin mujor mbi monitorimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit.
Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* neni 48, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 65, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* neni 44, Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2, datë 06.02.2012, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018, *"Për procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore"*.
Veprime këto në kundërshtim me Ligj nr.9936, datë 26.6.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* neni 3. Pika 44, Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", "Përgjegjësitë e nëpunësit autorizues të njësisë së vetëqeverisjes vendore"* pika 22 dhe *"Përgjegjësitë e nëpunësit zbatues të njësisë së vetëqeverisjes vendore"* pika 27, 28, 29.

Për sa u konstatua në situatën e mësipërme për raportimin e raportit të monitorimit të buxhetit mban përgjegjësi z.B. A. nëpunës autorizues dhe Z.E. H. si nëpunës zbatues i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.,

U konstatua që për vitin 2024 janë kryer likuidime të detyrimeve të vitit 2024 ndërkohe që nuk janë likuiduar faturat e prapambetura që rezultojnë në fillim të vitit 2024 në vlerën 2,534,228 lekë për mallrat dhe shërbimet, 5,992,632 lekë për investimet dhe 3,116,930 lekë për investimet nga ministritë e linjës. Te dhënat të detajuara në lidhje me detyrimet e prapambetura paraqiten në aneksin nr. 2 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit:

Konkluzion: Drejtoria e Financës së Bashkisë Gramsh nuk ka respektuar radhën e kryerjes së pagesave Veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar neni 52, me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, pikat 153-12, Rubrika "Marrja e angazhimit dhe

kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve". Në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 5, datë 27.12.2014, "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 27-30 ku citohet *"Pagesat e detyrimeve të prapambetura do të bëhen duke respektuar radhën sipas klasifikimit të detyrimeve të prapambetura në paragrafin 8 të këtij udhëzimi"* qe janë sipas radhës *"1-Detyrime për projekte investimesh 2-Detyrime për mallra dhe shërbime 3-Rimbursim i TVSH-së, 4-Rimbursim i tepricës kreditore të tatimit mbi fitimin 5-Detyrime për vendime gjyqësore ndërkombëtare 6-Te tjera (vendime gjyqësore, shpronësime publike, përfitimet për persona me aftësi të kufizuar, etj.)"*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:
z. B. A. Kryetar i Bashkisë Gramsh në cilësinë e nëpunësit autorizues,
z. E. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues.
z. A. S. Ish- Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Vendimet gjyqësore:
Detyrimet e prapambetura mbi vendimet gjyqësore më datë 31.12.2024, janë në vlerën 3,989,392 lekë e përbërë nga shpenzime me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna në vlerën 2,187,656 lekë dhe çështje të tjera të ndryshme gjyqësore në vlerën 3,989,392 lekë.
Bashkia Gramsh për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2024 ka shpenzuar vlerën 961,430 lekë, nga e cila i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 2 raste. Lista e likuidimeve të vendimeve gjyqësore dhe pagesat e kryera për zbatimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna për periudhën 2024 paraqitet në aneksin nr. 3 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.
Vlera totale 961,430 lekë e shpenzuar për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, nga Bashkia Gramsh për zbatimin e vendimeve gjyqësore konsiderohet efekt negativ financiar.

Konkluzion: Vlera prej 961,430 lekë e shpenzuar për vitin 2024 nga Bashkia Gramsh për zbatimin e vendimeve gjyqësore konsiderohet efekt negativ financiar. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* i ndryshuar, pika 60. *"Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa miratimin e titullarit"*.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:
Z. B. A. Kryetari i Bashkisë Gramsh
Z. A. S. ish Drejtor i Financës dhe Buxhetit
Z. E. H. Drejtor i Financës dhe Buxhetit

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHSH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për vitin 2024 janë realizuar 7 projekte investimi të financuara nga ministritë e linjës me vlere te kontraktuar 315,636,715 lekë nga të cilat për vitin 2023 janë financuar 23,190,032 lekë. Për vitin 2024 janë financuar nga ministritë e linjës vlera prej 122,845,827 lekë dhe nga Bashkia Gramsh vlera prej 22,941,267 lekë. Për vitin 2024 janë financuar me fonde të buxhetit të shtetit objektet e investimeve si më poshtë vijon:

Tabela nr.2.2 /12.Objekte investimi nga ministritë e linjës Lekë

Nr.	Objekti i prokurimit	Kontrata numër dhe datë	Vlera e plotë e kontratës me TVSh	Vlera e likuiduar 2023	Vlera e realizuar viti 2024 nga Ministria e linjës	Vlera e realizuar viti 2024 nga Bashkia
1	Rikonstruksioni i shkollës Rilindja	4482/ 14.10.2024	105,507,976		23,000,000	
2	Blerje Mobilieri shkolla 35 Vjetori	5048/ 21.12.2023	3,484,200		3,484,200	
3	Rikonstruksion i shkollës Shefqet Guzi	4533/ 14.11.2023	80,000,078	15,940,032	46,002,954	18,051,860
4	Blerje Mobilieri shkolla Shefqet Guzi	2999/ 10.07.2024	4,258,800		4,258,800	
5	Përmirësimin e banesave ekzistuese te komuniteteve te varfra 2023-2024	4956/ 15.12.2023	15,127,102	7,250,000	4,815,957	3,061,145
6	Përmirësimin e banesave ekzistuese te komuniteteve te varfra 2024-2025	4201/ 27.09.2024	10,715,199		6,828,906	1,828,262
7	Ndërtimi i pritave lumore	4631/ 23.10.2024	96,543,360		34,455,010	
Totali			**315,636,715**	**23,190,032**	**122,845,827**	**22,941,267**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Gramsh.

Të detajuara projektet e investimit nga ministritë e linjës janë si më poshtë vijon:

1. *"Rikonstruksioni i shkollës Rilindja"*: Kontrata e lidhur me nr.4482 prot., datë 14.10.2024 me vlerë 105,507,976 lekë. Financimi i projektit kryhet nga Ministria e arsimit dhe Sportit dhe bashkia Gramsh. Me shkresën nga Ministria e Arsimit dhe Sportit nr.1815/3, datë 11.03.2024 dhe njoftim për shpallje fituesi nr.1815/5, datë 27.03.2024 është transferuar fondi për shpenzime kapitale llogaria 231 me vlere 94,407,839 Lekë. Për vitin 2024 është financuar nga ministria vlera prej 23,000,000 për shkollën 9 vjeçare rilindja. Planifikimi për shpenzimet në vitin në vazhdim vitin 2025 është 71,407,839 lekë nga ministria dhe 11,100,137 lekë nga Bashkia Gramsh.

2. *"Blerje Mobilieri shkolla 35 Vjetori":* Kontrata e lidhur me nr.5048.prot., datë 21.12.2023, në vlerën 3,484,200 lekë. Financimi i kryer sipas shkresës për transferim fondi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit nr.836/1,prot datë 19.02.2024 "*dërgohet detajimi i buxhetit për shpenzimet kapitale"* me vlere 3,484,200 lekë. Shkresa nr.816/2 datë 23.02.2024 transferim fondi për shpenzime me vlere 3,484,200 lekë e financuar nga ministria nga e cila për vitin 2024 është planifikuar 3,484,200 lekë dhe realizuar me fondet e ministrisë për *"Blerje Mobilieri Shkolla 35 Vjetori"*

3. *"Rikonstruksioni i gjimnazit "Shefqet Guzi"*: Kontrata e lidhur me nr. 4533.prot., datë 14.11.2023, në vlerën 80,000,078 lekë. Në vitin 2023 fondet e çelura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit janë në vlerën 80,000,078 lekë e planifikuar në dy vite 2023-2024, shpërndarja e financimit.

Vlera progresive e likuiduar nga fondet e buxhetit të shtetit deri në datën 31.12.2023, për këtë objekt është 15,940,032 lekë. Vlera e likuiduar për vitin 2024 është realizuar 46,002,954 lekë nga Ministria dhe 18,051,860 lekë nga Bashkia Gramsh.

4. *"Blerje Mobilieri shkolla Shefqet Guzi"*: Kontrata e lidhur me nr.2999.prot., datë 10.07.2024, në vlerën 4,258,800 lekë. Me shkresen nr. 1669/36.prot., datë 27.03.2024 është transferuar fondi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për shpenzimet kapitale *"Pajisje mobilieri arsim I mesëm i përgjithshëm"* me vlere 6,230,756 lekë e cila është realizuar në vlerën 4,258,000 lekë gjatë vitit 2024 sipas kontratës.

5. *"Përmirësimin e banesave ekzistuese te komuniteteve te varfra 2023-2024"*: Kontrata e lidhur me nr. 4956.prot., datë 15.12.2023, në vlerën 15,127,102 lekë. Për vitin 2023 është realizuar vlera prej 7,250,000 lekë. Vlera progresive e likuiduar nga fondet e buxhetit të shtetit deri në datën 31.12.2024 nga Ministria e linjës për këtë objekt është 4,815,957 lekë ndërsa nga Bashkia Gramsh vlera prej 3,061,145 lekë.

6. *"Përmirësimin e banesave ekzistuese te komuniteteve te varfra 2024-2025":* Kontrata e lidhur me nr.4201.prot., datë 27.09.2024, në vlerën 10,715,199 lekë. Shkresa e Ministrisë së Kulturës dhe Inovacionit nr.8086/3.prot 20.06.2024 *"Për njoftimin e fituesit të projektit të përmirësimit te banesave ekzistuese të shtresave në nevojë"*. Për vitin 2024 është realizuar nga Ministria e linjës vlera prej 6,828,906 lekë dhe 1,828,262 lekë nga Bashkia Gramsh. Planifikuar për tu realizuar nga ministria e linjës për vitin 2025 vlera prej 2,058,031 lekë.

7. *"Ndërtimi i pritave lumore"*: Kontrata e lidhur me nr. 4631.prot., datë 23.10.2024, në vlerën 96,543,360 lekë. VKM nr.307 datë 22.05.2024 dërgim fondi për menaxhimin e fatkeqësive natyrore projekti *" Ndërtimi i pritave për bregun e lumit Devoll në kuadër te mbrojtjes se tokës bujqësore"* me vlere 98,442,888 lekë prej të cilave planifikuar 34,455,011 lekë për vitin 2024 dhe 63,987,877 lekë për vitin 2025. Për vitin 2024 është realizuar nga Ministria e linjës vlera prej 34,455,010 lekë. Planifikuar për tu realizuar nga ministria e linjës për vitin 2025 vlera prej 62,088,350 lekë.

2.2.6 Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit

Mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Gramsh në bazë të programit të auditimit nr. 405/1 Prot, datë, 08.04.2025, i ndryshuar, "Mbi Auditimin Financiar për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, në Bashkinë Gramsh.
Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër pika 2, nënpika 2.6, u auditua *burimi i krijimit të të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së tyre bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.*

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Gramsh bëhet mbështetur në kuadrin ligjor si më poshtë:
- Ligji nr. 139/2015, datë, 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 9920, datë, 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

- Ligji nr. 9632, datë, 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar;
- VKB-në nr. 96, datë, 31.12.2019, i ndryshuar "Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gramsh me shkresë nr. 799/4 prot., datë, 07.11.2022.

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore është si vijon:
- Vendimet e Këshillit Bashkiak Gramsh për miratimin e paketave fiskale të vitit 2024;
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet dhe familjarët, lidhur me taksat dhe tarifat vendore;
- Dokumentacioni i Sektori i Tatim Taksave, në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave dhe dokumentacionit të tatim-paguesve;
- Kontrata, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Regjistrat dhe mbajtja e debitorëve për bizneset, për taksat dhe tarifat vendore;
- Realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Sektori i Tatim Taksave.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2024 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Gramsh është miratuar me VKB-në nr. 96, datë, 30.12.2019,i ndryshuar "Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve.

Tabela nr.1: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, Bashkia Gramsh 2024, 000 në lekë

Nr.	Lloji i Taksës	Viti 2024		
		Plan	Fakt	%
I	**Të ardhura nga Tatimet**			
1	Tatimi mbi te ardhurat personale	*6,500*	*6,540*	*100.6*
II	**Të ardhura nga Taksat**			
2	Taksa mbi B. Vogël	-	*88*	
3	Taksa e Pasurisë, ndërtesë	*7,015*	15,062	214.7
4	Taksa mbi token	*3,565*	3,632	*101.8*
5	Taksa mbi truallin	809	*1,884*	*232.8*
6	Takse Blektorie	837	*600*	*71.6*
7	Taksë mbi rregj. e Automjete	8,000	*10,768*	*134.6*
8	Kalim Pronësie	300	*46*	*15.3*
9	Taksa e ndikimin të nd. mbi infrastrukturën	4,450	*3,771*	*84.7*
10	Taksë Tabele	89	*92*	*103*
11	Taksë hoteli	100	*5*	*5*
12	Takse Tregu	500	*398*	*79.6*
13	Taksë Parkimi	1,220	*1,136*	*93.11*
14	Taksë për hapësira publike	951	*524*	*55*
15	Taksë reklame	81	*81*	*100*
16	Takse e ndikimit ne Mjedis	*1,907*	*1,991*	*104*
III	**Të ardhura nga Tarifat**			
17	Tarifë Pastrimi	15,010	*9,743*	*65*
18	Tarife Gjelberimi	3,067	*2,030*	*66*
19	Tarife Ndriçimi	4,254	*2,691*	*64*
20	Tarife Ujra të përdorura	1,392	*1,029*	*74*
21	Vërtetime	124	*390*	*314*

Nr.	Lloji i Taksës	Viti 2024		
		Plan	Fakt	%
22	Shërbimi	-	*20*	
23	Tarifë licence	800	*894*	*112*
24	Certifikatë + Autorizime	171	*733*	*428*
25	Tarife Linje Ajrore	174	*144*	*83*
26	Leje zhvillimi	-	*14*	
27	Tarifë urbanistike	-	*699*	
28	Kamatëvonesa	-	*3,099*	
29	Dru Zjarri	3,281	*2,863*	*87*
30	Tarife për vaditje	550	*471*	*86*
31	Qira toke bujqësore	910	*520*	*57*
32	Tarife vendore për hidrocentrale	-	*5,398*	
33	Leje ndërtimi	-	*2,131*	
34	Tarifë vendore për varrezat	*190*	*219*	*115*
IV	**Të ardhura të tjera**			
35	Qira trualli	13,000	*6,179*	*48*
36	Kopshte, çerdhe, konvikt	*4,090*	*7,044*	*172*
37	Të ardhura nga pyjet, kullotat	*6,750*	*11,627*	*172*
38	Të ardhura te tjera	*4,023*		
	Të ardhura nga AMTP, kontrolli i territorit etj.	*550*		
39	Gjoba inspektorati ndërtimor	-	*100*	
40	Gjoba Policia Bashkiake	-	*41*	
41	Taksë pulle	-	*13*	
42	Qira objekti	*3,389*	*3,699*	*109*
43	Te ardhura miratim projekti MNZ	*50*	*1,257*	*2514*
44	Dhurata, sponsorizim & Garanci.	-	*1,250*	
	Të ardhura nga pjesëmarrja në aktivitete sportive	*2000*		*0*
45	Shtypshkrime	-	*66*	
46	Privatizim banese	*10,058*	*998*	*9.2*
47	Shqyrtim dosje	-	*40*	
48	Derdhje në buxhet	-	*137*	
49	Të ardhura nga sekuestrimet	-	*1,184*	
50	Transferta	-	*500*	
	GJITHSEJ (I+II+II+ IV)	***110,470***	***113,841***	*103*

Burimi: Bashkia Gramsh

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Gramsh për vitin 2024 është në masën **103%** nga **110,470** mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën **113,841** mijë lekë.

Agjentët tatimorë dhe rakordimet:

Duke u bazuar në Rregulloren e Brendshme të institucionit të aplikuar për vitin 2024 nga Bashkia Gramsh miratuar me Vendimin nr. 129, datë, 30.08.2021, të Kryetarit të Bashkisë nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrën e ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt-rakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (Ujësjellës Kanalizime Gramsh ShA sot pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan, ASHK Gramsh në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë, Drejtoria Rajonale e Tatime Elbasan në lidhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat personale dhe DSHTRR Elbasan në lidhje me taksat vendore të qarkullimit për mjetet e përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Gramsh dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Gramsh, duke kuadruar edhe me akt-rakordime vjetore.

a) Për detyrimet e familjarëve u konstatua se Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Gramsh është caktuar si agjent tatimor për vjeljen e taksës së ndërtesës e të truallit dhe tarifën e pastrimit dhe të shërbimit dhe referuar akt marrëveshjes me nr. 4311 Repertori dhe nr. 2332 Koleksioni datë, 12.10.2022, është nënshkruar kontrata e bashkëpunimit me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me agjentin tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse. Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, nga DTTV nuk janë mbajtur akt-rakordimet me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan në lidhje me arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore nga abonentët familjarë.
Të ardhurat e vjela nga Agjentët Tatimorë për vitin 2024 paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.2: Të ardhurat e vjela nga Agjentët Tatimorë

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	Plan 2024	Fakt 2024	Detyrimi
Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan	Tatimi i Thjeshtë i Fitimit DRT			
	Tatimi mbi të ardhurat personale	6,500,000	6,540,118	40,118
	Taksa e regjistrimit te automjeteve SHTR	8,000,000	10,768,357	-
Ujësjellës Kanalizime Elbasan	Taksat e tarifat	6,772,382	5,000,000	1,772,382

Burimi i të dhënave: Bashkia Gramsh

Janë kryer likuidimet për taksat dhe tarifat vendore ndaj Bashkisë Gramsh për periudhën **01.01.2024 deri më 31.03.2024**, por mbeten ende për t'u likuiduar detyrimet nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan në vlerën **1,812,500 lekë të ardhura të munguara (të pakontabilizuara)**.

<u>Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:</u>
Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, u konstatua se nga ASHK Gramsh janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi. Nga auditimi u konstatua se janë dhënë 9 leje legalizimi për sipërfaqen totale 1,647.2 m^2 në **vlerën 266,265 lekë, vlerë e cila është arkëtuar nga Bashkia Gramsh.** Në përputhje me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", neni 27, pika "d", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 5.

Tabela nr.3: Taksa e ndikimit në infrastrukturë 31.12.2024, në lekë

Periudha	Nr. i lejeve të legalizimit	Sip. totale e ndërtimit (m^2)	Vlera e investimit (lekë/m^2)	Vlera e taksës likuiduar (lekë) (0.5% e Vl. Inv.)
Deri 31.12.2024	9	1,647.2 m2	32,331	266,265
Shuma	**9**	**1,647.2**	**32,331**	**266,265**

Burimi: Bashkia Gramsh

Menaxhimi i borxhit
Në realizimin në nivel të ulët të të ardhurave kanë ndikuar **niveli i lartë e debitorëve**. Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Gramsh rezultoi se, ka nivel të lartë **debitorësh** në numër dhe në vlerë, duke përfshirë biznesin, institucionet dhe pronarët

(për taksën e ndërtesës, tabelës, trualli, zënie hapësire publike, etj.), i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të **vitit 2023** vlera borxhit është **30,055,196 lekë** dhe në fund të **vitit 2024** vlera e borxhit është **41,390,044 lekë**. Informacion më i detajuar lidhur me debitorët progresivë paraqitet në tabelën mëposhtë.

Tabela nr.4: Borxhi tatimor progresiv në Bashkinë Gramsh, në lekë

Emërtimi njësive	Gjendja fund 31.12.2023	Paketime 2024	Shtesa gjate vitit 2024	Gjendja në fund vitit 2024
BIZNESE	**11,242,610**	**721,569**	**2,332,669**	**12,853,710**
Taksë ndërtese	494,910	344,109	470,002	620,803
Taksë Tabele	24,200	23,960	23720	23960
Taksë Pastrimi	734,000	298,000	1,076,583	1,512,583
Taksë Ndriçimi (Gjelberimi)	139,500	55,500	319,834	403,834
Takse Reklame	0	0	13,500	13,500
Tarife ujra të përdorura	0	0	134,833	134,833
Tarifë Parkimi	0	0	216,400	216,400
Hapsire Publike	0	0	20,880	20,880
Taksa e ndikimit në mjedis	9,850,000	0	56,917	9,906,917
Toke Bujqësore	0	0	0	0
Tatimi i Biznesit të Vogël	0	0	0	0
Detyrime të mbartura	0	0	0	0
FAMILJARE	**18,812,586**	**3,400,067**	**13,123,815**	**28,536,334**
Taksa e tokës bujqësore	5,219,245	1,341,806	1,582,957	5,460,396
Taksa pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi	5,679,374	271,830	8,501,386	13,908,930
Taksë ndërtese (objekt banimi)	3,092,567	765,410	1,956,785	4,283,942
Taksa vaditje	139,000	0	79,350	218,350
Takse trualli	182,480	78,888	130,947	234,539
Tarife ujra të përdorura	276,200	91,933	454,850	639,117
Tarife dru zjarri	4,223,720	850200	417540	3,791,060
Biznese + familje	**30,055,196**	**4,121,636**	**15,456,484**	**41,390,044**
Pa konbtabilizuar Familjarë + Taksa e ndërtimit në Mjedis				**38,443,251**
Kontabilizuar biznese				**2,946,793**

Burimi: Bashkia Gramsh

Gjendja e debitorëve në mënyrë progresive **në fund të vitit 2023** është në vlerën **30,055,196 në fund të vitit 2024** është në vlerën **41,390,044 lekë,** nga të cilat të ardhura të munguara në vlerën 38,443,251 lekë dhe detyrim për arkëtim në vlerën 2,946,793 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", neni 15, pika, ku citohet "*Njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë gjatë periudhës raportuese, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumenteve kontabël përkatëse në përputhje me rregulloren e inventarizimit të hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit*" dhe pika 2, ku citohet "*Organi i drejtimit të njësisë ekonomike mban përgjegjësi për procedurat e ndjekura për inventarizimin e aktiveve dhe detyrimeve, me qëllim paraqitjen me vërtetësi dhe besueshmëri të elementeve të aktivit dhe detyrimeve në pasqyrat financiare*".

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve

Në territorin e Bashkisë Gramsh për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë për vitin 2024, ushtrojnë këtë aktivitet 5 subjekte.

Tabela nr. 5: Pagesat e licencave për tregtimin e hidrokarbureve gjendje 31.12.2024

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	K. ShPK	...	18.11.2022	17.11.2027	1,000,000	600,000	400,000
2	K. ShPK	...	01.08.2022	31.07.2027	1,000,000	600,000	400,000
3	S. ShPK	...	02.12.2022	01.12.2027	1,000,000	600,000	400,000
4	S. ShPK	...	11.12.2020	10.12.2025	1,000,000	1,000,000	0
5	G.ShPK	...	11.05.2023	10.05.2028	1,000,000	200,000	800,000
SHUMA					**5,000,000**	**3,000,000**	**2,000,000**

Burimi: Bashkia Gramsh

Nga auditimi u konstatua se, nga informacioni dhe dokumentacioni që Bashkia disponon, rezultojnë 27 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, nga këto subjekte 4 prej tyre rezultojnë me detyrime në vlerë 2,000,000 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë, 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me Ligjin nr. 71.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8450, datë, 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, neni 4 "*Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme*". Neni 20-Autorizimet pika 2. "*Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11*[2]*, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje*". Detyrimet e krijuara nga subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë janë **me vlerë totale 2,000,000 lekë që përbën të ardhur të munguar në buxhetin e Bashkisë Gramsh (vlerë e pakontabilizuar),** duke qenë se e gjithë vlera e mësipërme është njohur dhe kontabilizuar, sipas tabelës mëposhtë.

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e energjitikës

Në territorin e Bashkisë Gramsh ushtrojnë aktivitet në fushën e energjitikës (Prodhim energjie, HEC), janë 27 subjekte, nga të cilat 7 nuk janë pajisur me leje ndërtimi. Nga auditimi rezulton se subjekti Shoqëria "R" ShPK është debitor për **vlerën 622,860 lekë që përbën të ardhur të munguar në buxhetin e Bashkisë Gramsh (vlerë e pakontabilizuar)**, si në aneksin nr. 21.

Tabela nr. 6: Të dhëna mbi numrin e subjekteve, në numër

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime reja	Mbyllur Aktivit	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	2023	447	6	23	430
		2024	402	25	28	399
2	Biznesi Madh	2023	70	0	0	70
		2024	69	2	1	71

[2]Ligji nr. 8450, datë, 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, neni 11 Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes se karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë".

(1+2)	Gjithsej	2023	517	6	23	500
		2024	471	27	29	469

Burimi: Bashkia Gramsh

Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë, 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: "Pranë çdo Bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë, 22.12.1999, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar".

Situata e lëvizjes se subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Gramsh bazuar në ndryshimin e xhiros si dhe të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 7: Të dhëna për subjektet me mbyllje ose me status pasiv

Nr.	Subjekti	Nipti	Lloji Aktivitetit	Data e mbylljes	Det. pashlyer	Akt-verifikimi Nr./ datë	Grupi i kontrollit
1	O. Z.	...	ushqimore	20.01.2024	0	1/05.03.2024	J.T., F. B.
2	B. B.	...	Ne fushën e ndërtimit	19.02.2024	0	2/05.03.2024	J.T., F. B.
3	P. T.	...	Tregti mishi	20.02.2024	0	3/05.03.2024	J.T., F. B.
4	E. Zh.	...	Bar/Kafe	27.02.2024	0	4/05.03.2024	J.T., F. B.
5	F. B.	...	Bar-kafe	05.03.2024	0	5/16.04.2024	J.T., F. B.
6	D. M.	...	Tregti mishi	06.03.2024	0	6/16.04.2024	J.T., F. B.
7	P. V.	...	Kancelari	25.03.2025	0	7/16.04.2024	J.T., F. B.
8	A. B.	...	Bar-kafe	04.04.2024	0	8/ 16.04.2024	J.T., F. B.
9	R. Zh.	...	Artikuj industrial	17.04.2024	0	9/ 19.06.2024	J.T., F. B.
10	E. Ç.	...	Artikuj industrial	18.04.2024	0	10/ 19.06.2024	J.T., F. B.
11	Sh. P.	...	Topograf	19.04.2025	0	11/ 19.06.2024	J.T., F. B.
12	D.K.	...	Bar-kafe	23.04.2024	0	13/19.06.2024	J.T., F. B.
13	A.B.	...	Bar-kafe	27.04.2024	0	14/16.07.2024	J.T., F. B.
14	M. V.	...	Mekanik	30.04.2024	0	15/16.07.2024	J.T., F. B.
15	Ad. A.	...	Artikuj industrial	01.05.2024	0	16/16.07.2024	J.T., F. B.
16	L. D.	...	Artikuj industrial	30.05.2024	0	17/16.07.2024	J.T., F. B.
17	G. D.	...	Sherbime fotografike	12.06.2024	0	18/12.11.2024	J.T., F. B.
18	M. D.	...	Stomatolog	25.06.2024	0	19/12.11.2024	J.T., F. B.
19	P.Ç.	...	Artikuj industrial	14.07.2024	0	20/12.11.2024	J.T., F. B.
20	S. Xh.	...	Bar-kafe	03.09.2024	0	21/12.11.2024	J.T., F. B.
21	K. B.	...	Fushen e nderitimit	30.09.2024	0	22/12.11.2024	J.T., F. B.
22	D. S.	...	Tabakino	06.09.2024	0	23/12.11.2024	J.T., F. B.
23	R. K.	...	Ushqimore	02.10.2024	0	24/15.11.2024	J.T., F. B.
24	F. K.	...	Artikuj industrial	24.10.2024	0	25/ 15.11.2024	J.T., F. B.
25	Z. T.	...	Bar-kafe	29.10.2024	0	26/15.11.2024	J.T., F. B.
26	A. E.	...	Bar-kafe	15.10.2024	0	27/15.11.2024	J.T., F. B.

Burimi: Bashkia Gramsh

Për sa trajtuar më sipër nga DTTV nuk janë mbajtur akt-konstatime mbi verifikimin në qoftë se këto subjekte ushtrojnë aktivitet, për këtë arsye grupi i auditimit nuk mund të shprehet lidhur me

situatën e subjekteve të pezulluara/mbyllura. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9723, datë, 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, neni 22 dhe nenet 48-49.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. A. J., Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore;
2. Z. E. H., Drejtor i Financës.

2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në së pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin e rregullator në fuqi

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpëmjet bankës dhe arkës.

2.3.4. Auditiın mbi procedutat e inventatizimit.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël"; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin 2024 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- ☐ Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- ☐ Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- ☐ Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- ☐ Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- ☐ Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- ☐ Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- ☐ Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- ☐ Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- ☐ Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të Bashkisë Gramsh për vitin ushtrimor 2024 janë të nënshkruara nga z. B. A. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. E. H. Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në cilësinë e Nëpunësit Zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Gramsh më datë 22.03.2025, dhe konfirmuar nga DTH Gramsh më datë 28.03.2025, brenda afatit ligjor.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e Klasës 6 dhe Klasës 2 me akt-rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i

nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor u konstatua se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhen me veprim ekstra-kontabël.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.,. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese,

kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.,. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.,.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Gramsh për aktivitetin ekonomiko-financiar **për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024.** Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 u konstatua se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuandrojnë me ato analitike.

Llogaritja e nivelit të materialitetit për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2024:

Bashkia Gramsh 2024, Materialiteti për shpenzimet			
Emërtimi i Shpenzimeve	**Vlera e Popullatës**	**Faktori i Riskut (0.7-2-3)**	**Çështje për t'u shqyrtuar**
Paga (600)	270,143	0.70	10
Sigurime Shoqërore (601)	45,264	0.70	2
Mallra e Shërbime (602)	158,548	0.70	6
Investime të brendshme (230-231)	266,333	2.00	27
Të tjera transferime korrente (606)	471,634	0.70	17
Total	**1,211,922**		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	**24,238**		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	**24,238**		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	2,424		
Nëntotali	**21,815**		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
Vlera e precizionit	**19,633**		
Bashkia Gramsh 2024, Materialiteti për të ardhurat			
Emërtimi i të ardhurave	**Vlera e Popullatës**	**Faktori i Riskut (0.7-2-3)**	**Çështje për t'u shqyrtuar**
Të ardhurat nga buxheti	0	0.70	0
Të ardhurat e veta	**113,841**	0.70	43
Total	**113,841**		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti	**2,277**		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	**2,277**		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	228		
Nëntotali	**2,049**		
Precizioni i planifikuar (80 -90%)	90%		
Vlera e precizionit	**1,844**		

Procesi i inventarizimit:

Nga auditimi i procedurave të inventarizimit u konstatua se, nuk u paraqitën dokumente për kryerjen e inventarëve fizikë për aktivet e institucionit, për rrjedhojë llogaritë e aktiveve në bilancin e vitit 2024, janë mbyllur për gjendjen kontabël. Në këto kushte, llogaritë e pasqyrave financiare, nuk janë të rakorduar me gjendjen fizike gjë e cila nuk krijon besueshmëri mbi vërtetësinë e tyre. Në këtë rast, nxjerrja e pasqyrave financiare pa kryer inventarizimin fizik e të gjithë aseteve, është shkelje e kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave

financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, pika 30.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2024, të pozicionit financiar të Bashkisë Gramsh, formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme. Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2024, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

Lekë

Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto	**2,765,313,865**
Aktivet	2,906,911,412
Pasivet	141,597,547
Aktivet Neto	2,765,313,865

Lekë

Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.2024	**395,205,563**
Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre"	160,263,235
Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues"	117,471,164
Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra"	117,471,164

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e klasës 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	**Emërtimi i llogarive**	**31.12.2024**	**31.12.2023**	**Diferenca/Ndryshimi 2024-2023**
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	160,263,235	118,583,839	41,679,396
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
Totali		**160,263,235**	**118,583,839**	**41,679,396**

- **Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar"** paraqitet më datë 01.01.2024, në vlerën 118,583,839 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 160,263,235 lekë. Kjo llogari kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" në vlerën 136,136,852 lekë dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në vlerën 24,126,383 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pikat 49-50.

2. Llogaritë e klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	**Emërtimi i llogarive**	**31.12.2024**	**31.12.2023**	**Diferenca/Ndryshimi 2024-2023**
31	Materiale	26,454,117	14,404,648	12,049,469
32	Inventar i imët	30,555,103	29,935,037	620,066
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	17,170	17,170	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
Totali		**57,026,390**	**44,356,855**	**12,669,535**

- Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2024, paraqitet në vlerën 57,026,390 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 26,454,117 lekë, 32 "Inventar i imët" 30,555,103 lekë dhe 35 "Mallra" në vlerën 17,170 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 12,669,535 lekë e cila kuadron me

llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së invetarit” e cila paraqitet në vlerën 12,669,535 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 4.1.

- **Llogaria 31 “Materiale”**, ka vlerën 26,454,117 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2024	14,404,648
Shtesa (K)	72,246,940
Pakësime (D)	63,197,471
Gjendja në 31.12.2024	**26,454,117**

- **Llogaria 32 “Inventarë i imët”**, ka vlerën 30,555,103 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2024	29,935,037
Shtesa (K)	620,066
Pakësime (D)	0
Gjendja në 31.12.2024	**30,555,103**

- **Llogaria 35 “Mallra”**, ka vlerën 17,170 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2024	17,170
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	0
Gjendja në 31.12.2024	**17,170**

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	0
431	Tatime e taksa	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0
468	Debitorë te ndryshëm	52,629,361	48,980,497	3,648,864
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	64,841,803	54,453,567	10,388,236
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Totali		**117,471,164**	**103,434,064**	**14,037,100**
	Të tjera aktive afatshkurtra	0	0	0
409	Parapagime	0	0	0
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0
481	Shpenzime për t’u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0	0
Totali		**0**	**0**	**0**

- Gjendja e **llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”** më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 48,980,497 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 52,629,361 lekë me

një rritje në vlerën 3,648,864 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet **(në Aneksin nr. 4.)** në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"	
Çelje e vitit 2024	48,980,497
Shtesa (K)	4,821,159
Pakësime (D)	1,172,295
Gjendja debitore në 31.12.2024	**52,629,361**

Në gjendjen e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" nuk janë të përfshirë debitorët për kategorinë "Abonentë Familjarë" në vlerën 28,536,334 lekë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në shkresën me nr. 1072 prot., datë 11.03.2025, që Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizimit është drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit mbi borxhin tatimor progresiv më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 52,629,361 lekë pa përfshirë debitorët "Abonentë Familjarë", konkretisht:

Lekë

Emërtimi njësive	**Gjendja 31.12.2023**	**Pakësime 2024**	**Shtesa 2024**	**Gjendja 31.12.2024**
Familjarë				
Taksa e tokës bujqësore	5,219,245	1,341,806	1,582,957	5,460,396
Taksa pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi	5,679,374	271,830	8,501,386	13,908,930
Taksë ndërtese (objekt banimi)	3,092,567	765,410	1,956,785	4,283,942
Taksa vaditje	139,000	0	79,350	218,350
Takse trualli	182,480	78,888	130,947	234,539
Tarife ujra të përdorura	276,200	91,933	454,850	639,117
Tarifë dru zjarri	4,223,720	850200	417540	3,791,060
Totali	**18,812,586**	**3,400,067**	**13,123,815**	**28,536,334**

Burimi i të dhënave: Bashkia Gramsh.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. **Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: z. A. J.** Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizimit.

- Gjendja e **llogarisë 4342 "Operacion me shtetin (të drejta)"** më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 54,453,567 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 64,841,803 lekë me një rritje në vlerën 10,388,236 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 4342 "Operacion me shtetin (të drejta)"	
Çelje e vitit 2024	54,453,567
Shtesa (K)	152,174,890
Pakësime (D)	141,786,654
Gjendja debitore në 31.12.2024	**64,841,803**

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, përmbledhsja e llogarive 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" paraqitet në vlerën 35,617,323 lekë, 42 "Detyrime ndaj personelit" në vlerën 20,338,605 lekë, 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" në vlerën 1,668,126 lekë, 435 "Sigurime shoqërore" në vlerën 6,344,988 lekë dhe 436 "Sigurime shëndetësore" në vlerën 872,761 lekë ku totali shkon në vlerën 64,841,803 lekë e cila kuadron me llogarinë 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)" 64,841,803 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Aneksi 1.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në

kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e Klasës 20 "Aktive afatgjata jo materiale", 21 "Aktive afatgjata materiale", 25-26 "Aktive afatgjata financiare" dhe 23 "Investime në proces" përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
	II. Aktive Afatgjata	**2,572,150,623**	**2,456,804,376**	**115,346,247**
20	**1. Aktive Afatgjata jo materiale**	**12,377,478**	**14,561,739**	**(2,184,261)**
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	12,377,478	14,561,739	(2,184,261)
203	Koncesione, Patenta, Licensa e të ngjashme	0	0	0
21	**2. Aktive Afatgjata materiale**	**2,559,080,145**	**2,411,549,637**	**147,530,508**
210	Toka, Troje, Terene	50,742,734	50,742,734	0
211	Pyje, Plantacione	13,203,906	11,217,186	1,986,720
212	Ndërtesa e konstruksione	669,324,623	595,410,483	73,914,140
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,741,573,140	1,709,640,822	31,932,318
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	6,388,202	7,767,302	(1,379,100)
215	Mjete transporti	39,231,894	28,038,723	11,193,171
216	Rezerva shtetërore	0	0	0
217	Kafshë pune e prodhimi	0	0	0
218	Inventar ekonomik	38,615,645	38,732,386	(116,741)
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0	0	0
28	Caktime të aktiveve afatgjata	0	0	0
25-26	**3. Aktive Afatgjata Financiare**	**693,000**	**693,000**	**0**
25	Huadhënie e nënhuadhënie	0	0	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	693,000	693,000	0
	4. Investime	**0**	**0**	**0**
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	0	0	0
231	Për Aktive Afatgjata materiale	0	0	0

1. Aktivet Afatgjata Jomateriale

- **Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"** më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 14,561,739 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është përllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 13,254,199 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 12,377,478 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet **(në Aneksin nr. 5)** në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	25,631,677
	2	Amortizim i akumuluar	11,069,938
	3	**Gjendja në 01.01.2024**	**14,561,739**
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	2,184,264
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	25,631,677
	5	Amortizim i akumuluar	13,254,199
	6	**Gjendja më datë 31.12.2024**	**12,377,478**

Nga auditimi u konstatua se në gjendjen e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" janë përfshirë projektet "Rikonstruksion i Lagjes "Holta" dhe "Rikonstruksion i Lagjes Sporti nr. 2", në vlerën totale 2,810,976 lekë (kosto historike) të cilat nuk duhej të kontabilizoheshin në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale" i përmirësuar, pikat 66-69, VKM nr. 783, datë 22.11.2006, "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", Seksioni II

"Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar" pika 1/b "Klasifikimi kontabël" e cila ndër të tjera përcakton se: "Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - Llogaria 202" "Studime dhe Kërkime", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" pika 2, klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël).

2. Aktivet Afatgjata Materiale

- **Llogaria 210 "Toka, troje, terrene"** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 50,742,734 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 50,742,734 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	50,742,734
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	**Gjendja në 01.01.2024**	**50,742,734**
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	50,742,734
	5	Amortizim i akumuluar	0
	6	**Gjendja më datë 31.12.2024**	**50,742,734**

- **Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione"** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 11,217,186 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,986,720, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 13,203,906 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet **(në Aneksin nr. 6)** në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	11,217,186
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	**Gjendja në 01.01.2024**	**11,217,186**
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	1,986,720
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	13,203,906
	5	Amortizim i akumuluar	0
	6	**Gjendja më datë 31.12.2024**	**13,203,906**

Për sa trajtuar më sipër llogaria 210 "Toka, troje, terrene" e pasqyruar në bilanc për vlerën 50,742,734 lekë dhe llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione" në vlerën 13,203,906 lekë, janë të paanalizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, "Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale", Kapitulli "Trajtimi Kontabël për Aktivet Afatgjata të Investuara", pikat 47-54, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26-30.

- **Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione"** më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 595,410,483 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 110,822,844 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 357,986,607 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie

paraqitet në vlerën 669,324,623 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet **(në Aneksin nr. 7)** në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	916,488,386
	2	Amortizim i akumuluar	321,077,903
	3	**Gjendja në 01.01.2024**	**595,410,483**
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	110,822,844
	5	Amortizim i shtesës	36,908,704
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	1,027,311,230
	5	Amortizim i akumuluar	357,986,607
	6	**Gjendja më datë 31.12.2024**	**669,324,623**

- **Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore"** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 1,709,640,822 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 123,561,036 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 891,270,367 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,741,573,140 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet **(në Aneksin nr. 8)** në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	2,509,282,471
	2	Amortizim i akumuluar	799,641,649
	3	**Gjendja në 01.01.2024**	**1,709,640,822**
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	123,561,036
	5	Amortizim i shtesës	91,628,718
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	2,632,843,507
	5	Amortizim i akumuluar	891,270,367
	6	**Gjendja më datë 31.12.2024**	**1,741,573,140**

Nga auditimi i analitikëve u konstatua se, në gjendjen e llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" në vlerën 916,488,386 lekë kosto historike është përfshirë vlera 376,538,010 lekë dhe 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" në vlerën 2,509,282,471 lekë kosto historike është përfshirë vlera 343,864,618 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Gramsh (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30.

- **Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune"** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 7,767,302 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 218,000 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 16,569,119 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 6,388,202 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" Objekte inventari	
	1	Kosto historike	22,739,321
	2	Amortizim i akumuluar	14,972,019

Ditari i veprimeve	**3**	**Gjendja në 01.01.2024**	**7,767,302**
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	218,000
	5	Amortizim i shtesës	1,597,100
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	22,957,321
	5	Amortizim i akumuluar	16,569,119
	6	**Gjendja më datë 31.12.2024**	**6,388,202**

- **Llogaria 215 "Mjete transporti"** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 28,038,723 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 21,020,017 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 72,685,020 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 39,231,894 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet **(në Aneksin nr. 9)** në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	**Nr.**	**Llogaria 215 "Mjete transporti" Objekte inventari**	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	90,896,897
	2	Amortizim i akumuluar	62,858,174
	3	**Gjendja në 01.01.2024**	**28,038,723**
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	21,020,017
	5	Amortizim i shtesës	9,826,846
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	111,916,914
	5	Amortizim i akumuluar	72,685,020
	6	**Gjendja më datë 31.12.2024**	**39,231,894**

- **Llogaria 218 "Inventar ekonomik"** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 38,732,386 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 9,537,170 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 125,927,730 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 38,615,645 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	**Nr.**	**Llogaria 218 "Inventar ekonomik" Objekte inventari**	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	155,006,205
	2	Amortizim i akumuluar	116,273,819
	3	**Gjendja në 01.01.2024**	**38,732,386**
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	9,537,170
	5	Amortizim i shtesës	9,653,911
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	164,543,375
	5	Amortizim i akumuluar	125,927,730
	6	**Gjendja më datë 31.12.2024**	**38,615,645**

Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)" për llogarinë 218 "Inventar ekonomik" është përllogaritur normë amortizimi i akumuluar deri më datë 31.12.2024, në vlerën 125,927,730 lekë (kosto historike) ose në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 "Pajisje kompjuterike" nga aktivet e llogarisë bazë 218 "Inventar ekonomik" e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 36.

- Në gjendjen e **llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta"** janë përfshirë pjesëmarrje me 4.13% të kapitalet të Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Elbasan me kapital të përgjithshëm 10,000,000 lekë ku pjesa e kapitalit të Bashkisë Gramsh është në vlerën 413,000 lekë (4.13*10,000,000 lekë/100 = 413,000 lekë) dhe pjesëmarrjen me 8% të kapitalet të "E." Sh.a me

Nipt .... me kapital të përgjithshëm 3,500,000 lekë ku pjesa e kapitalet të Bashkisë Gramsh është në vlerën 280,000 lekë (8*3,500,000 lekë/100 = 280,000 lekë), në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale" i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje", pikat 27-30, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar.

4. Invenstimet

- Gjendja e llogarisë 231 "Për aktive afatgjata materiale" në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve u konstatua se, për vitin 2024 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punimet si dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, që i përkasin llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" konkretisht objektet: "Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore" me vlerë kontrate 80,452,800 lekë pa TVSh me OE "M" ShPK me afat përfundimi punimesh më datë 24.03.2025, për të cilën janë likuduar situacionet pjesore në vlerën 34,455,010; "Rikonstruksion asfaltim rruga e fshatit Mashan" me vlerë kontrate 79,164,260 lekë pa TVSh me OE "T" ShPK me afat përfundimi punimesh më datë 15.05.2025, për të cilën janë likuduar situacionet pjesore në vlerën 35,638,680, dhe "Rikonstruksioni Shkollës 9-vjeçare "Rilindja" Bashkia Gramsh" me vlerë kontrate 87,923,313 lekë pa TVSh me OE "I" ShPK me afat përfundimi punimesh më datë 13.06.2025, për të cilën janë likuduar situacionet pjesore në vlerën 23,000,000. Në këto kushte gjendja e kësaj llogari nuk duhej të paraqitej në pasqyrat financiare në vlerën 0 lekë, kur ka kontrata investimesh në proces, pra në këtë llogari duhej të pasyqrohej vlera e situcioneve pjesore të likuduara. Sipas informacionit kontabël llogaria 231 "Për aktive afatgjata materiale" është nënvlerësuar në vlerën 93,093,690 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Aneksi 1.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 "Investime për aktive afatgjata jo materiale" paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" në vlerën 0 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 0 lekë e cila nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 "Nga fondet e veta të investimeve" e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 "Teprica e grandeve kapitale të brendshme" në vlerën 693,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Aneksi 1, gërma "c".

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e Klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Gramsh më datën 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.,. Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca/Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	35,617,323	29,972,801	5,644,522
42	Detyrime ndaj personelit	20,338,605	17,516,675	2,821,930

16,17,18	Hua afat shkurtra	0	0	0
460	Huadhënës	0	0	0
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	1,668,126	1,053,365	614,761
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal	0	0	0
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	0	0	0
435	Sigurime shoqërore	6,344,988	5,196,317	1,148,671
436	Sigurime shëndetësore	872,761	714,409	158,352
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike	0	0	0
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	0	0	0
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	24,126,383	23,453,620	672,763
467	Kreditorë të ndryshëm	0	0	0
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	0	0	0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Gjendje në fund të periudhës		**88,968,186**	**77,907,187**	**11,060,999**

- **Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"** më datë 01.01.2024, është në vlerën 29,972,801 lekë e cila paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Gramsh. Gjatë vitit 2024 ka pasur shtesa në vlerën 122,950,410 lekë dhe pakësime në vlerën 117,305,888 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 35,617,323 lekë. Lëvizja e llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", paraqitet **(në Aneksin nr. 10)** në tabelën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"	
Çelje e vitit 2024	29,972,801
Shtesa (K)	122,950,410
Pakësime (D)	117,305,888
Gjendja debitore në 31.12.2024	**35,617,323**

Në gjendjen e llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" është përfshirë vlera prej 15,853,909 lekë e përbërë nga vendime gjyqësore në vlerën 3,989,392lekë + mallra në vlerën 852,871 lekë + shërbime në vlerën 6,663,979 lekë + investime në vlerën 4,347,667 lekë të cilat duhet të kontabilizohen në llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm". Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 3.2.

- **Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"** referuar pasqyrave financiare vlera 20,338,605 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2024 e cila mbetet për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Lekë

Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Çelje e vitit 2024	17,516,675
Shtesa (K)	245,936,905
Pakësime (D)	243,114,975
Gjendja debitore në 31.12.2024	**20,338,605**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, u konstatua se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		
Nr.	**Datë**	**Vlera**
4	21.01.2025	10,390,459
5	21.01.2025	5,702,022
6	21.01.2025	4,246,124
Totali		**20,338,605**

Burimi i të dhënave: Bashkia Gramsh.

- **Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa",** paraqitet në vlerën 1,668,126 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor.

Lekë

Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2024	1,053,365
Shtesa (K)	17,602,362
Pakësime (D)	16,987,601
Gjendja debitore në 31.12.2024	**1,668,126**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, u konstatua se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	**Datë**	
7	20.01.2025	601,763
8	20.01.2025	41,986
9	20.01.2025	64,992
10	20.01.2025	92,924
11	20.01.2025	152,848
12	20.01.2025	25,117
13	20.01.2025	529,119
14	20.01.2025	19,856
15	20.01.2025	38,751
16	20.01.2025	41,859
17	20.01.2025	13,801
18	20.01.2025	45,110
Totali		**1,668,126**

Burimi i të dhënave: Bashkia Gramsh.

- **Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2024 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 6,344,988 lekë.

Lekë

Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2024	5,196,317
Shtesa (K)	75,342,117
Pakësime (D)	74,193,446
Gjendja debitore në 31.12.2024	**6,344,988**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, u konstatua se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	**Datë**	
7	20.01.2025	1,943,905
8	20.01.2025	477,080
9	20.01.2025	166,585
10	20.01.2025	355,402
11	20.01.2025	462,413
12	20.01.2025	77,889
13	20.01.2025	1,834,597
14	20.01.2025	174,948
15	20.01.2025	424,300
16	20.01.2025	160,889
17	20.01.2025	97,128
18	20.01.2025	169,852
Totali		**6,344,988**

Burimi i të dhënave: Bashkia Gramsh.

- **Llogaria 436 "Sigurime shoqërore"** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2024 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 872,761 lekë.

Lekë

Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2024	714,409
Shtesa (K)	10,383,994
Pakësime (D)	10,225,642
Gjendja debitore në 31.12.2024	**872,761**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, u konstatua se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
7	20.01.2025	269,277
8	20.01.2025	66,922
9	20.01.2025	23,118
10	20.01.2025	41,248
11	20.01.2025	64,182
12	20.01.2025	10,819
13	20.01.2025	254,607
14	20.01.2025	24,289
15	20.01.2025	58,892
16	20.01.2025	22,338
17	20.01.2025	13,489
18	20.01.2025	23,580
Totali		**872,761**

Burimi i të dhënave: Bashkia Gramsh.

- Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Gramsh në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 24,126,383 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Gramsh. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet **(në Aneksin nr. 11)** në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Çelje e vitit 2024	23,453,620
Shtesa (K)	11,511,482
Pakësime (D)	10,838,719
Gjendja debitore në 31.12.2024	**24,126,383**

- Për 22 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Gramsh janë ngurtësuar fonde në vlerën 3,264,686 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Gramsh, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 3,264,686 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2011, *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

Lekë

C	**AKTIVET NETO/FONDET (A-B)**	**2,765,313,865**	**2,596,291,450**
D	**FONDI I KONSOLIDUAR**	**2,765,313,865**	**2,596,291,450**
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	2,628,484,013	2,500,468,231
12	Rezultatet e mbartura	0	0
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	136,136,852	95,130,219
111	Rezerva	0	0
115	Nga fondet e veta të investimeve	0	0
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime	0	0
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	0	0
106	Teprica e granteve kapitale të huaja	693,000	693,000
107	Vlera e mjeteve të caktuara për përdorim	0	0
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata	0	0
	Të tjera	0	0
E	**TOTALI I PASIVEVE (B+C)**	**2,906,911,412**	**2,723,179,134**

Lekë

Fondi i konoliduar	**Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"**			
	Mbyllje më datë 31.12.2024		**Çelje më datë 01.01.2024**	
2,765,313,865	**Debi**		**Kredi**	
			2,500,468,231	Çelja gjendja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" i datës 31.12.2023
	0	Pakësimet me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	267,145,787	Shtesat sipas pasqyrës nr. 7/b.
	151,799,540	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	12,669,535	Llogaria 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"
Totali	**151,799,540**		**2,780,283,553**	

2,780,283,553 - 151,799,540 = 2,628,484,013
2,628,484,013 – 2,628,484,013 = 0

Çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 2,500,468,231 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 267,145,787 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 12,669,535 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" debitohet për pakësimit e vitit në vlerën 0 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2024 në vlerën 151,799,540 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)". Sipas informacionit kontabël llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" është kontabilizuar saktë në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 17.

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

- **Llogaria 70 "Të ardhurat nga taksat e tatimet",** në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 45,271,816 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 64,273,115 lekë ose me një rritje në vlerën 19,001,299 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
70	**I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME**	**64,273,115**	**45,271,816**
700	**1. Tatimi mbi të ardhurat**	**88,364**	**127,671**
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	0	0
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	88,364	127,671
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
702	**2. Tatimi mbi pasurinë**	**18,739,825**	**9,540,571**
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	18,694,151	8,680,132
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	45,674	860,439
703	**3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit**	**45,432,126**	**35,577,823**
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	10,768,357	9,073,228
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	34,663,769	26,504,595
704	**4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare**	**0**	**0**
7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë	0	0
7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0
705	**5. Taksë e rrugës**	**12,800**	**25,750**
708	**6. Të tjera tatime e taksa kombëtare**	**0**	**0**
709	**7. Gjoba e kamatë vonesa**	**0**	**0**

2. Të ardhurat jo tatimore:

- **Llogaria 71 "Të ardhura jo tatimore",** në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 53,105,123 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 41,277,196 lekë ose me një pakësim në vlerën 11,827,927 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
71	**III. TË ARDHURA JO TATIMORE**	**41,277,196**	**53,105,123**
710	**1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia**	**22,019,016**	**36,773,336**
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0

7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	22,019,016	36,773,336
711	**2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare**	**19,120,741**	**16,282,203**
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	1,337,639	1,247,194
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	8,180,295	3,891,572
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	4,186,460	10,679,138
7114	Të ardhura nga biletat	0	0
7115	Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	5,416,347	464,299
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
719	**3. Të tjera të ardhura jo tatimore**	**137,439**	**49,584**

3. Grante korente:

- **Llogaria 72 "Grante korente",** në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 839,093,640 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 959,663,485 lekë ose me një rritje në vlerën 120,569,845 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
72	**V. GRANTE KORENTE**	**959,663,485**	**839,093,640**
720	**1. Grant korent i brendshëm**	**959,663,485**	**839,093,640**
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	0	200,000
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	874,053,159	773,826,004
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)	0	0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	10,541,458	9,442,619
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	8,477,065	0
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	64,841,803	54,453,567
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	1,750,000	1,171,450
7209	Të tjera grante korente të brendshme	0	0
721	**2. Grant korent i huaj**	**0**	**0**
	Nga Qeveri të Huaja	0	0
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	0

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

- **Llogaria 600 "Pagat dhe përfitimet e punonjësve"** në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 241,875,274 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 274,125,324 lekë ose me një rritje në vlerën 32,250,050 lekë.
- **Llogaria 601 "Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore",** në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 40,178,257 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 46,035,664 lekë ose me një rritje në vlerën 5,857,407 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Gramsh me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
6001	Paga, personel i përhershëm	274,125,324	241,875,274
6002	Paga personel i përkohshëm	0	0
6003	Shpërblime	0	0
6009	Shpenzime të tjera të personelit	0	0
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	41,337,854	35,964,645
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	4,697,810	4,213,612
Totali		**320,160,988**	**282,053,531**

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

- **Llogaria 602 "Blerje mallra dhe shërbime",** në datë 31.12.2023, ka qenë në vlerën 131,722,964 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 158,548,185 lekë ose

me një rritje në vlerën 26,825,221 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Gramsh me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
602	**III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME**	**158,548,185**	**131,722,964**
602	Mallra dhe shërbime të tjera		
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	5,836,495	3,084,039
6021	Materiale dhe shërbime speciale	7,871,688	6,514,907
6022	Shërbime nga të tretë	41,412,762	27,359,060
6023	Shpenzime transporti	25,260,369	22,559,859
6024	Shpenzime udhëtimi	882,550	699,600
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	42,266,164	36,343,530
6026	Shpenzime për qiramarrje	191,250	333,000
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	2,407,666	2,187,656
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	32,419,241	32,641,313

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Gramsh nuk ka pasur subvencione për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024.

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 "Transferime të brendshme"** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 7,714,045 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 "Transferime për Buxhetet familjare e Individë"** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 467,992,795 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
	V. TRANSFERIME KORENTE	**475,706,840**	**435,740,362**
604	**1. Transferime korente të brendshme**	**7,714,045**	**14,992,626**
6040	**Transferime korente tek nivele të tjera të Qeverisë**	**7,714,045**	**14,992,626**
6041	**Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme**	**0**	**0**
6042	**Transferime korente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore**	**0**	**0**
6044	**Transferime korente tek organizata jo fitimprurëse**	**0**	**0**
606	**3. Transferime për buxhetet familjare e individë**	**467,992,795**	**420,747,736**
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH	0	0
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendore	467,992,795	420,747,736

Për vitin 2024 totali i të ardhurave në vlerë është 1,077,883,330 lekë dhe totali shpenzimeve është 941,746,478 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 136,136,852 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 "Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor" në vlerën 136,136,852 lekë.

- **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore u konstatua se

totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- **Veprimet nëpërmjet magazinës:**

- Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje u konstatua se veprimet ishin kontabilizuar saktë.
- Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga titullari i institucionit.
- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 30.
- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

- **Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore në kryerjen e pagesave për pagat e punonjësve, shtesat mbi to , shpërblimeve:**

Nga Bashkia Gramsh është mbajtur dhe përditësuar libri dhe ditari i pagave. Ato hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruar me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe titullari. Për të gjithë periudhën e kontrolluar, janë përllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat. Janë respektuar strukturat organike të miratuara përsa i përket numrit të punonjësve si dhe janë respektuar dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e punës.

Numri i punonjësve dhe fondi i pagave:

Pasqyra nr. 8, jep informacion mbi numrin e punonjësve, ndryshimet gjatë vitit ushtrimor të mbyllur si dhe gjendjen në fund të periudhës, fondin e pagave gjithsej, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe informacion mbi tatimin mbi të ardhurat. Bashkëlidhur janë edhe llogaritë debitore dhe kreditorë në mënyrë analitike, si dhe evidencën përmbledhëse të përdorimit të fondeve.

Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë u konstatua se:

a. Kontrata për realizimin e shërbimit të pranimit, depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve të Bashkisë Gramsh në impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane:

- **Viti 2023**

Për realizimin e shërbimit të pranimit, depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve të Bashkisë Gramsh në impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan është lidhur kontrata e shërbimit publik ndërmjet Bashkisë Gramsh, administruar me praktikën nr. 719 prot., datë 16.02.2023,

përfaqësuar nga z. K. T. Kryetar i Bashkisë dhe Shoqërisë "E" Sh.a, me nr. 109 prot., datë 16.02.2023, përfaqësuar nga z. L. K. Administrator i Shoqërisë. Në nenin 4 "Objekti i kontratës", përcaktohet se:
Pika 4.1. Objekti i kontratës është pranimi, deozitimi (grumbullimi) dhe trajtimi i mbetjeve urbane të AK në impiantin e incenerimit të mbetjeve, i ndërtuar dhe i liçensuar për këtë qëllim, në administrimin të Shoqërisë "E" Sh.a, kundrejt pagimit të çmimit të kontratës.
Pika 4.2. i. Pranimi i mbetjeve që do të depozitohet nga vetë Bashkia apo nga operatori ekonomik, i cili është kontraktuara nga Bashkia për pastrimin dhe grumbullimin e mbetjeve të Bashkisë Gramsh, i përbërë nga territori administrative i Bashkisë (qytetit) Gramsh, si dhe pranimi i mbetjeve të njësive administrative të Bashkisë Gramsh (Pishaj, Kodovjat, Sult, Skënderbegas, Tunjë, Kushovë dhe Lenie).
ii. Grimbullimi (depozitimi) i mbetjeve sipas pikës (i) në vend depozitimin e mbetjeve të "Impiantit të incenerimit".
iii. Trajtimi që përfshin përpunimin (seleksionimin) e mbetjeve që do të depozitohen sipas pikave të mësipërme.
iv. Incenerimi (djegia) nëpërmjet "Impiantit të incenerimit" të mbetjeve që do të depozitohen sipas pikave të mësipërme.
Në nenin 5 "Afati i kontratës" përcaktohet se:
Pika 5.1. Afati i kësaj kontrate fillon me lidhjen e saj dhe përfundon në datë 31.12.2023.
Pika 5.2. Pavarësisht afatit të parashikuar në pikë (1), efektet e kësaj kontrate do të ndërpriten para afatit të mësipërm, në momentin që do të ketë ndryshime në statusin apo në raportet që Shoqëria "A" Shpk ka me institucionet e shtetit Shqiptar, ndryshime këto që sjellin efekt në administrimin e Impiantit të Incenerimit dhe zbatimin e kësaj kontrate.
Pika 5.3. Efektet e kësaj kontrate nuk do të ndërpriten para afatit të mësipërm, nëse gjatë kësaj periudhe (deri më 31.12.2023) "Impianti i incenerimit" i transferimit në pronësi Shoqërisë "E" Sh.a, në zbatim të Kontratës Koncesionare të formës "BOT", me nr. 11026/7, datë 16.12.2024, e lidhur midis Ministrisë së Mjedisit dhe Shoqërisë "A" Shpk me objekt "Ndërtimin, operimin (administrimin) dhe transferimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan".
Në nenin 7, "Çmimi i kontratës" përcaktohet se:
Pika 7.8. Çmimi aktual në këtë kontratë, i përcaktuar si më sipër është 2,500 lekë/ton mbetje (pa Tvsh).
Në nenin 8 "Mënyra e bërjes së pagesës" përcaktohet se:
Pika 8.1. Shoqëria kontraktuesi i paraqet AK një Raport/Situacion mbi sasitë e mbetjeve të pranuara, grumbulluara dhe përpunuara gjatë javës paraardhëse, si dhe një faturë për shërbimet, bazuar në nenin 7.
- Për realizimin e shërbimit të pastrimit të mbetjeve urbane në zonat urbane dhe rurale nga Bashkia Gramsh janë përdorur dy mjete të cilat janë të parashikuara në kontratën e shërbimit të pastrimit si më poshtë:
- Mjeti i markës Mercedes Benz "ATECO" në pronësi të OE "K" Shpk me leje qarkullimi nr. ..., me targë **...**, me kapacitet mbajtës 3.83 ton (13,500 kg - 9,670 kg = 3,830 kg);
- Mjeti i markës MAN "Portok" në pronësi të OE "K" Shpk me leje qarkullimi nr.... me targë **...**, , me kapacitet mbajtës 11.7 ton (25,600 kg - 13,900 kg = 11,700 kg);
- Bashkëlidhur urdhër shpenzimit (praktika likuiduese) ndodhet raporti mujor, situacioni i ngarkesës së mbetjeve të depozituara në landfilld, fatura e lëshuar nga kompania koncesionare mbi depozitimin e mbetjeve dhe fatura tatimore.
- Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, në total është situacionuar në total **2,222.106 ton mbetje urbane** të depozituara pranë impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të

Qarkut Elbasan (Shoqërisë "E" Sh.a) e ndarë në situacione mujore konkretisht 1,788.886 ton mbetje urbane për zonat urbane dhe 433.22 ton mbetje urbane për zonat rurale. Për sasinë 2.222.106 ton mbetje urbane është faturuar vlera totale 5,555,265 lekë pa Tvsh sipas faturave ditore që i përket dokumentimit të peshimit të mjetit në gjendjen fillestare me ngarkesë dhe pa ngarkesë. Ky dokumentacion në zbatim të kushteve të kontratës së shërbimit të sipërcituar shoqërohet Raportin mujor me objekt "Raporti i Sektorit të Sipërmarrjes të shërbimeve publike, Pastrim Gjelbërmit, Varrezave Publike (të reja dhe të vjetra) si dhe Dekori i qytetit". Raporti hartohet nga z. V. T. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve me Sipërmarrje dhe Mjedis.
- Nga auditimi u konstatua se për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, janë situacionuar më tepër **117 ton mbetje urbane të depozituara në impjantin e trajtimit të mbetjeve në vlerën 292,500 lekë pa Tvsh** (117 ton * 2,500 lekë/ton = 292,500 lekë), duke marrë në konsideratë faktin që mjeti me targë ... ka kapacitet mbajtës 3.83 ton ndërkohë që përgjatë kësaj periudhe është situacionuar depozitim ditor i mbejtjeve më tepër nga kapaciteti mbajtës i mjetit. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike **në Aneksin nr. 12.**

- **Viti 2024**

Për realizimin e shërbimit të pranimit, depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve të Bashkisë Gramsh në impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan është lidhur kontrata e shërbimit publik ndërmjet Bashkisë Gramsh, administruar me praktikën nr. 649 prot., datë 09.02.2024, përfaqësuar nga z. B. A. Kryetar i Bashkisë dhe Shoqërisë "E" Sh.a, me nr. 94 prot., datë 12.02.2024, përfaqësuar nga z. L. K. Administrator i Shoqërisë (kushtet e kontraës janë të njëjta me atë të vitit 2023).
- Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, në total është situacionuar në total **2,269.16 ton mbetje urbane** të depozituara pranë impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan (Shoqërisë "E" Sh.a) e ndarë në situacione mujore konkretisht 1,911.08 ton mbetje urbane për zonat urbane dhe 358.08 ton mbetje urbane për zonat rurale. Për sasinë 2,269.16 ton mbetje urbane është faturuar vlera totale 5,672,900 lekë pa Tvsh sipas faturave ditore që i përket dokumentimit të peshimit të mjetit në gjendjen fillestare me ngarkesë dhe pa ngarkesë. Ky dokumentacion në zbatim të kushteve të kontratës së shërbimit të sipërcituar shoqërohet Raportin mujor me objekt "Raporti i Sektorit të Sipërmarrjes të shërbimeve publike, Pastrim Gjelbërmit, Varrezave Publike (të reja dhe të vjetra) si dhe Dekori i qytetit". Raporti hartohet nga z. V. T. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve me Sipërmarrje dhe Mjedis.
- Nga auditimi u konstatua se për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, janë situacionuar më tepër **85.44 ton mbetje urbane të depozituara në impjantin e trajtimit të mbetjeve në vlerën 213,600 lekë pa Tvsh** (85.44 ton * 2,500 lekë/ton = 213,600 lekë), duke marrë në konsideratë faktin që mjeti me targë ... ka kapacitet mbajtës 3.83 ton ndërkohë që përgjatë kësaj periudhe është situacionuar depozitim ditor i mbejtjeve më tepër nga kapaciteti mbajtës i mjetit. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike **në Aneksin nr. 13.**

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. B. A. Kryetar i Bashkisë Gramsh në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, **z. E. H.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare dhe **z. A. J.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizimit.

2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve

Në zbatim të pikës 4 të Programit të Auditimit në Bashkinë Gramsh, nga audituesit e KLSh-së u auditua procedura e prokurimit në Bashkinë Gramsh për vitin 2023-2024. Për auditimin e kësaj procedure u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Regjistri i prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2023-31.12.2024;
2. Dokumentacioni i OE, shpallur fitues, paraqitur në sistemin elektronik të APP;
3. Dosja e procedurës së prokurimit sipërcituar;
4. Dokumentacioni i prokurimit në sistemin elektronik të APP-së;
5. Përllogaritja e fondit limit.

Për vitin 2023:

Nga Bashkia Gramsh janë parashikuar 87 procedura prokurimi dhe janë zhvilluar 41 procedura prokurimi ose 47% nga parashikimi, me vlerë të fondit limit **233,121,847** lekë pa TVSh, vlerë të kontratës **196,933,595** lekë pa TVSh, diferenca midis tyre prej 36,188,252 lekë pa TVSh, ose në masën 84% të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

- **Blerje me vlerë të vogël,** 25 procedura, me fond limit në total prej 17,407,608 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 14,706,080 lekë, duke kursyer shumën prej 2,701,528 lekë;
- **E hapur,** 5 procedura, me fondin limit në total prej 156,068,425 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 134,829,477 lekë, duke kursyer shumën prej 21,238,948 lekë;
- **E hapur e thjeshtuar,** 11 procedura, me fondin limit në total prej 59,645,814 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 47,398,038 lekë, duke kursyer shumën prej 12,247,776 lekë.

Janë audituar 4 procedurat të hapura dhe 3 procedurë blerje të vogla ose 60% e fondit limit dhe 60 % e vlerës së kontratës ku ka rezultuar si mëposhtë vijon.

1. Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i Gjimnazit "Shefqet Guzi"", viti 2023

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: "**Rikonstruksion i Gjimnazit "Shefqet Guzi"" **viti 2023**		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 207 datë 14.08.2023 **4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur**"	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. E. K. 2. O. Ç. 3. E. S.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 232, datë 01.09.2023:** 1. A. S. (Kryetar) 2. X. B. (Anëtar) 3. E. H. (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa TVSh) 67,162,656 lekë	**6. Oferta fituese** OE "I" ShPK, me vlerë 66,666,732 lekë pa TVSh	**7. Diferenca me fondin limit** 495,924 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 08.09.2023	**9. Burimi Financimit:** Nga buxheti i Shtetit (Bashkia Gramsh dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit)	**10. Operatorët Ekonomik** a) BOE "A" ShPK & "z" ShPK b) BOE "E" ShPK & "L" ShPK c) OE "I" ShPK d) OE "P" ShPK
11. Ankimime AK, Ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK, Ka**	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka**
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës nr. 4533 prot., datë 14.11.2023	**15. Vlera e kontratës (me TVSh)**	**80,000,078 lekë**

Me shkresë nr. 3124 prot., datë 15.05.2023, Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) me lëndë "Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për objekte shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin", është shpallur fitues për projektin Bashkia Gramsh. Titullari i Bashkisë Gramsh ka hartuar Urdhrin nr. 208, datë 14.08.2023, "Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit", me përbërje z. X. B, zj. E.I. dhe z. E. H., i ndryshuar me Urdhërin nr. 232, datë 01.09.2023, me përbërje z. A. S., zj. X. B.dhe z. E.H.

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është "E Hapur", me vlerë 67,162,656 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit (bashkëfinancim nga buxheti i Bashkisë Gramsh dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporti), e ndarë si vijon:

- Vlera e financimit nga Bashkia Gramsh për vitin 2023 në shumën 1,666,666 lekë pa TVSh dhe 2,000,000 lekë me TVSh;
- Vlera e financimit nga Bashkia Gramsh për vitin 2024 në shumën 15,491,065 lekë pa TVSh dhe 18,589,278 lekë me TVSh;
- Vlera e financimit nga MAS-i për vitin 2023 dhe 2024 është për secilin vit në shumën 25,002,462 lekë pa TVSh dhe 30,002,955 lekë me TVSh.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:
Projekti i instalimit të sistemit të mbrojtjes nga zjarri dhe projekti i instalimit të sistemit të ngrohjes, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga ING A.Ç. dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh, z. B. A. Bashkëlidhur relacioni teknik dhe Specifikimet teknike hartuar nga ING A. Ç.

Hartimi i fondit limit
Projekt preventivi për investimin me objekt "***Rikonstruksion i Gjimnazit "Shefqet Guzi""*** është hartuar nga Ing. A.Ç. dhe përbëhet nga 18 zëra punimesh me vlerë totale 67,162,656 lekë pa TVSh dhe 80,595,188 lekë me TVSh.

Nga auditimi i hartimit të fondit limit sipas zërave të punimeve rezultoi se çmimet e zërave të punimeve janë në përputhje me përcaktimet e manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre", por jo sipas manualit të ri në sistemin online E-Albania.

Nga auditimi u konstatua se, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gramsh, nuk ka kryer oponencën teknike për projektin e zbatimit me objekt: "Rikonstruksioni Gjimnazit "Shefqet Guzi". Ky veprim është në kundërshtim me nenin 6 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. K. T.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe DT
Janë hartuar kriteret e veçanta për kualifikimin për procedurën e prokurimit me objekt *"Rikonstruksion i Gjimnazit "Shefqet Guzi"",* me Procesverbalin pa numër me datë 23.08.2023,

nga Nj.P përkatësisht anëtarët O. Ç. dhe E. Sh. për kriteret e veçanta për kualifikimin për procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i Gjimnazit "Shefqet Guzi""*. Gjatë hartimit të kritereve për kapacitetin teknik është dhënë edhe argumentimi teknik lidhur me kategoritë e punimeve të përcaktuara sipas zërave të preventivit.
Për zhvillimin e procedurës Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 207, datë 14.08.2023 ku ka ngarkuar NJP me përbërje z. E. K., z, O. Ç. dhe z. E. S., për të vijuar me procedurën e prokurimit me objekt *"Rikonstruksion i Gjimnazit "Shefqet Guzi""* me vlerë të fondit limit 67,162,656 lekë pa TVSh. Më datë 23.08.2023 NJP ka mbajtur proces verbale pa numër protokolli ku ka përcaktuar që lloji i procedurës së prokurimit të jetë *"e hapur"* dhe si kriter vlerësues të ofertave "*çmimin më të ulët*".
Pas kërkesës për sqarim nga OE "K" me datë 26.08.2023, nga Autoriteti Kontraktor, Njësia e Prokurimit, është kthyer përgjigje me shkresën në datë 28.08.2023, si dhe përgjigja nga APP në datë 28.08.2023. U modifikua me datë 08.09.2023 DST për shkak të rekomandimeve të APP-së.

Nga auditimi u konstatua se: kriteret e vendosura për kualifikim, u konstatuan kritere të paargumentuara duke iu referuar përshkrimit të punimeve të bëra në preventiv si vijon:

1. Nuk është argumentuar numri i punonjësve të përcaktuar në pikën 2.3.4 të DT "*Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 75 (shtatëdhjetë e pesë) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën maj 2023-korrik 2023, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8":*

   •Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.

   •Listë pagesat e punonjësve, të konfirmuara nga institucionet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.
2. Nuk është argumentuar kërkesa për makineritë të përcaktuar në pikën 2.3.8 të DT, "*Operatori ekonomik për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri duhet të ketë të punësuar një mjek të përgjithshëm ose të ketë të kontraktuar nga jashtë këtë shërbim. Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licencë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë. Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, licenca përkatëse ,si dhe faturën e këtij shërbimi, bazuar në VKM Nr. 108, datë: 09.02.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në pune" (ndryshuar me VKM nr. 632, datë 15.7.2015). Në rast se mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën maj 2023-korrik 2023"*;
3. Nuk është argumentuar kërkesa për makineritë të përcaktuar në pikën 2.3.11 të DT, për:
   a) Ekskavator me zinxhirë 1 copë;
   b) Rul vibrues 2 copë;
   c) Pajisje niveluese për nivelim shtresash 1 copë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit i përbërë nga z. E. K., z. O. Ç. dhe z. E. S..

Vlerësimi i ofertave
Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me Urdhrin nr. 208, datë 14.08.2023, "Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit", me përbërje z. X. B., zj. E. I. dhe z. E. H., i ndryshuar

me Urdhërin nr. 232, datë 01.09.2023, me përbërje z. A. S., zj. X. B. dhe z. E.H.
KVO ka mbajtur proces verbalin nr. 1, datë 08.09.2023 për hapjen e procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksioni Gjimnazit "Shefqet Guzi"".
U konstatua se për këtë procedurë kanë aplikuar 4 operatorë ekonomik, si më poshtë:

1. BOE "A" ShPK & "2" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 50,399,015 lekë pa TVSh;
2. BOE "E" ShPK & "L" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 58,457,336.5 lekë pa TVSh;
3. OE "I" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 66,666,732 lekë pa TVSh;
4. OE "P" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 54,033,062 lekë pa TVSh.

KVO ka hartuar proces verbalin "Për zhvillim të procedurës së prokurimit" dhe vlerësimin nr. 2, datë 26.09.2023 për procedurën e prokurimit "e hapur" me objekt "Rikonstruksioni Gjimnazit "Shefqet Guzi"".

Nga auditimi në SPE dhe në dosjen e prokurimit janë skualifikuar, 3 Operatorët Ekonomik

1. BOE "A" ShPK & "2" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 50,399,015 lekë pa TVSh;
2. BOE "E" ShPK & "L" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 58,457,336.5 lekë pa TVSh;
3. OE "P" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 54,033,062 lekë pa TVSh, skualifikuar me të drejtë nga KVO.

Raporti përmbledhës me nr. 3972 Prot., është hartuar nga KVO më datë 13.10.2023. Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave KVO-ja ka vendosur që OE që plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit është **"I" ShPK me ofertën e paraqitur në vlerën 66,666,732 lekë pa TVSh.**
Formulari i njoftimit të fituesit paraprak nr. 3837 Prot., është hartuar më datë 04.10.2023 dhe është publikuar në buletinin e APP-së nr. 84 datë 09.10.2023, si dhe Formulari i njoftimit të fituesit në përfundim të afateve të ankimit nr. 3978/1 Prot., është hartuar më datë 13.10.2023 dhe është publikuar në buletinin e APP-së nr. 87 datë 23.10.2023
Nuk ka patur ankesa nga OE pjesëmarrës.
Titullari i Autoritetit Kontraktor ka lidhur kontrata me nr. 4533 Prot., datë 14.11.2023 me vlerë 66,666,732 lekë pa TVSh dhe 80,000,078.4 lekë me TVSh me afat 180 ditë. Formulari i njoftimit të kontratës është publikuar në buletin e APP-së nr. 95, datë 20.11.2023.

Nga auditimi u konstatua se, në SPE, OE "I." ShPK i shpallur fitues, nuk plotëson kriteret:

1. Kriteri 2.2.3, ku kërkohet dokument lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore që vërteton se subjekti i ka plotësuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022 dhe për këstet e maturuara të vitit 2023, por OE sipas Ekstraktit Historik të Regjistrit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, rezulton se ka detyrime tatimore të papaguara ndaj Bashkisë Vlorë, Drejtorisë së të Ardhurave Vendore;
2. Kriteri 2.3.5 ku kërkohet personeli kryesor, OE nuk ka paraqitur dokumentacion për:
   - 1 Inxhinier Ndërtimi,
   - 1 Inxhinier Elektrik.

4. Kriteri 2.3.11, për mjetet dhe pajisjet mungon dokumentacioni si mëposhtë:
   - Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton – 2 copë;
   - Kamion me kapacitet mbajtës 3-5 ton – 1 copë tek certifikata për transport ndërkombëtarë mallrash për llogari të vet, mjeti fadromë me goma me targë..., është për përdorim vetjak, në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportin rrugor" i ndryshuar, si dhe pika 3 e nenit 6 të Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimit e veprimtarisë

në transportin rrugor";
- Kamioçinë me kapacitet mbajtës 1-3 ton – 2 copë;
- Kamion me vinç – 2 copë ;
- Fadromë me goma – 1 copë, tek certifikata për transport ndërkombëtarë mallrash për llogari të vet, mjeti fadromë me goma me targë ..., është për përdorim vetjak, në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportin rrugor" i ndryshuar, si dhe pika 3 e nenit 6 të Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimit e veprimtarisë në transportin rrugor";
- Minifadromë – 1 copë;
- Autobot uji – 1 copë tek certifikata për transport ndërkombëtarë mallrash për llogari të vet, mjeti fadromë me goma me targë ..., është për përdorim vetjak, në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportin rrugor" i ndryshuar, si dhe pika 3 e nenit 6 të Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimit e veprimtarisë në transportin rrugor";
- Pompë uji – 1 copë;
- Pajisje niveluese për nivelim shtresash – 1 copë;
- Elektrosaldatriçe – 1 copë;
- Për mjetet "Kokore dhe Uniforma/Jelek nga 40 copë secila", mungojnë foto.

Sa më sipër, nuk janë marrë masat e nevojshme nga KVO për të verifikuar përputhshmërinë e mjeteve të dorëzuara me vetë deklarimet e bëra në kundërshtim me nenin 26, pika 6 dhe 7 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për "Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".
Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t´i kërkoj operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertës i përbërë nga z. A. S. (Kryetar), z. Xh. B. (Anëtar) dhe z. E. H. (Anëtar).

2. Procedura e prokurimit me objekt "Sistemim asfalti i rrugëve të brendshme të fshatit Cerujë".

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: "**Sistemim-asfaltim i rrugëve të fshatit Cerujë **viti 2023**		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 49 datë 24.02.2023 **4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur**"	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. L. Z. 2. A. B. 3. L. H.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 60, datë 15.03.2023:** 1. A. Sh. (Kryetar) 2. A. C. (Anëtar) 3. E. H. (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa TVSh) 39,166,666 lekë	**6. Oferta fituese** BOE "G." ShPK & "V." ShPK, me vlerë 38,811,880 lekë pa TVSh	**7. Diferenca me fondin limit** 354,786 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 03.04.2023	**9. Burimi Financimit:** Nga buxheti i bashkisë 2023	**10. Operatorët Ekonomik** a) OE "L" ShPK b) OE "B" ShPK c) OE "B."ShPK ç) OE "L." ShPK d) OE "I." ShPK dh) BOE "G" ShPK & "V" ShPK

11. Ankimime AK, **Nuk ka**	**12. Përgjigje ankesës nga AK,** **Nuk ka**	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,** **Nuk ka**
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës **22.06.2023**	**15. Vlera e kontratës (me TVSh)**	**46,574,256 lekë**

Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të Territorit (DPZhT) në Bashkinë Gramsh me shkresën nr. 866/1 Prot., datë 24.05.2023, ka paraqitur kërkesë Njësisë së Prokurimit për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "Sistemim-asfaltim i rrugëve të fshatit "Cerujë, Bashkia Gramsh". Bashkëlidhur kërkesës DPZhT ka dorëzuar edhe dokumentacionin si vijon:
- Projekti i zbatimit;
- Specifikimet teknike;
- Raporti teknik;
- Preventivi i punimeve;
- Preventiv me çmime;
- Grafiku i punimeve.

Hartimi i fondit limit
Projekt preventivi për investimin me objekt "***Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme të fshatit Cerujë, Nj.A. Pishaj"*** është hartuar nga "E." ShPK dhe përbëhet nga 5 zëra punimesh me vlerë totale 39,166,666 lekë pa TVSh.

Nga auditimi i hartimit të fondit limit sipas zërave të punimeve rezultoi se çmimet e zërave të punimeve janë në përputhje me përcaktimet e manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre", por jo sipas manualit të ri në sistemin online E-Albania.

Nga auditimi u konstatua se, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gramsh, nuk ka kryer oponencën teknike për projektin e zbatimit me objekt: "Sistemim-asfaltim i rrugëve të fshatit "Cerujë, Bashkia Gramsh". Ky veprim është në kundërshtim me nenin 6 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. K. T.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe DT
Janë hartuar kriteret e veçanta për kualifikimin për procedurën e prokurimit me objekt *"Sistemim-asfaltim i rrugëve të fshatit "Cerujë, Bashkia Gramsh",* me Procesverbalin pa numër me datë 13.03.2023, nga Nj.P përkatësisht anëtarët L. Z., A. B. dhe L. H. për kriteret e veçanta për kualifikimin për procedurën e prokurimit me objekt "Sistemim-asfaltim i rrugëve të fshatit "Cerujë, Bashkia Gramsh*"*. Gjatë hartimit të kritereve për kapacitetin teknik është dhënë edhe argumentimi teknik lidhur me kategoritë e punimeve të përcaktuara sipas zërave të preventivit.
Për zhvillimin e procedurës Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 49, datë 24.02.2023 ku ka ngarkuar NJP me përbërje zj. L. Z., z. A. B. dhe z. L. H., për të vijuar me procedurën e prokurimit me objekt "Sistemim-asfaltim i rrugëve të fshatit "Cerujë, Bashkia Gramsh" me vlerë të fondit limit 39,166,666 lekë pa TVSh.
AK ka lidhur kontrata nr. 1158 prot., datë 16.03.2023 "Për mbikëqyrjen e punimeve për objektin "Sistemim-asfaltim i rrugëve të fshatit "Cerujë, Bashkia Gramsh", me "E" ShPK. Me shkresën nr.

1165 prot., datë 27.03.2023 është bërë njoftim për ndryshimin e Dokumenteve të Tenderit dhe bashkëlidhur është shtojca me modifikimin e DST-ve.

Nga auditimi u konstatua se: kriteret e vendosura për kualifikim, u konstatuan kritere të paargumentuara duke iu referuar përshkrimit të punimeve të bëra në preventiv, nuk është argumentuar numri i punonjësve të përcaktuar në pikën 2.3.6 të DT, *"Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 25 persona, të cilët duhet të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:*

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, për periudhën e fundit të deklaruar;
- *Listëpagesat e punonjësve te konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit qe kërkohet nga legjislacioni ne fuqi për periudhën e fundit të deklaruar".*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit i përbërë nga zj. L. Z., z. A. B. dhe z. L. H.

Vlerësimi i ofertave

Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 60, datë 15.03.2023, i ndryshuar ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. A. Sh. (Kryetar), z. A. C. (Anëtar) dhe z. E. H. (Anëtar).

KVO ka mbajtur proces verbalin nr. 1, datë 11.04.2023 për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Sistemim asfaltim i rrugëve të fshatit Cerujë", me fond limit 39,166,666 lekë. U konstatua se për këtë procedurë kanë aplikuar 6 operatorë ekonomik, si më poshtë:

1. OE "L" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 28,718,950 lekë pa TVSh;
2. OE "B" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 34,859,430 lekë pa TVSh;
3. OE "B" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 31,631,754 lekë pa TVSh;
4. OE "L" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 31,800,340 lekë pa TVSh;
5. OE "I" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 31,838,190 lekë pa TVSh;
6. BOE "G" ShPK & "V" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 38,811,880 lekë pa TVSh.

KVO ka hartuar Vendimin nr. 1, datë 11.05.2023 "Për kualifikimin dhe renditjen përfundimtare të operatorëve ekonomi në tenderin" me objekt "Sistemim asfaltim i rrugëve të fshatit Cerujë".

<u>*Nga auditimi në SPE dhe në dosjen e prokurimit janë skualifikuar,*</u> 4 Operatorë Ekonomik:

1. OE "L" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 28,718,950 lekë pa TVSh;
2. OE "B" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 34,859,430 lekë pa TVSh;
3. OE "L" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 31,800,340 lekë pa TVSh;
4. OE "I" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 31,838,190 lekë pa TVSh.

Skualifikuar me të drejtë nga KVO.

Raporti përmbledhës me nr. 2185 Prot., është hartuar nga KVO më datë 19.06.2023. Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave KVO-ja ka vendosur që OE që plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit është BOE **"G" ShPK & "V" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 38,811,880 lekë pa TVSh.** Në raportin përmbledhës KVO sqaron se OE "B." ShPK nuk dorëzoi fizikisht dokumentacionin si dhe nuk dërgoi asnjë njoftim për shkakun e mos dorëzimit.

Pas njoftimit paraprak të fituesit është publikuar në buletinin e APP-së nr. 2, datë 05.06.2023, u hartua Formulari përfundimtar i njoftimit të fituesit nr. 2189 Prot., është hartuar më datë 19.06.2023 duke plotësuar dhe afatin e ankimimeve.

Nuk ka patur ankesa nga OE pjesëmarrës.
Titullari i Autoritetit Kontraktor ka lidhur kontrata me nr. 2262 Prot., datë 22.06.2023 me vlerë 38,811,880 lekë pa TVSh dhe 46,574,256 lekë me TVSh me afat 120 ditë.

Nga auditimi u konstatua se, në SPE, BOE "G" ShPK & "V" ShPK i shpallur fitues, nuk plotëson kriteret:

1. Kriteri 2.3.4 ku kërkohet stafi mbështetës të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, për 2 – punonjës pllaka shtrues nuk janë paraqitur sipas shtojcës 8;
   - Germa b, Për 2 punonjës karpentier janë punësuar përkatësisht z. D. N. dhe z. E. B, por në kodin e formularit E-Sig kanë kodin e profesionit, supervizor në ndërtim dhe saldator;
   - Germa e, nuk ka dokumentacion për 2 punonjës betonues.
2. Kriteri 2.3.6 ku kërkohet fuqi punëtore prej minimumi 25 persona, OE "G" ShPK, tek formulari E-Sig, për periudhën e fundit mars 2023, ka të punësuar 16 punonjës;
3. Kriteri 2.3.7 ku kërkohet të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST për mjetet dhe pajisjet, BOE nuk ka paraqitur për mjetet ose pajisje sipas shtojcës 8 për fabrikë Betoni, si dhe nuk janë paraqitur dokumente dhe/ose mjetet dhe pajisjet si vijon;
   - 1 fadromë me goma me targë ...
   - 1 Autobitumatriçe me targë ...,

   Tek certifikata për transport ndërkombëtarë mallrash për llogari të vet, është për përdorim vetjak, në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportin rrugor" i ndryshuar, si dhe pika 3 e nenit 6 të Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimit e veprimtarisë në transportin rrugor";
   - Mungon 1 makinë për ngjitje tubash;
   - Mungon 1 nyje inerte.

Sa më sipër, nuk janë marrë masat e nevojshme nga KVO për të verifikuar përputhshmërinë e mjeteve të dorëzuara me vetë deklarimet e bëra në kundërshtim me nenin 26, pika 6 dhe 7 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për "Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".
Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t´i kërkoj operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertës i përbërë nga z. A. S. (Kryetar), z. A.Ç. (Anëtar) dhe z. E. H.(Anëtar).

3. Procedura e prokurimit me objekt "Blerje mallrash ushqimore për plotësimin e nevojave të çerdheve, kopshteve dhe konviktit të shkollës së mesme", Bashkia Gramsh viti 2023

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: "**Blerje mallrash ushqimore për plotësimin e nevojave të çerdheve, kopshteve dhe konviktit të shkollës së mesme" **viti 2023**		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 66 datë 29.03.2023	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. L. Z.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 67, datë 29.03.2023, e ndryshuar:**

4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: e hapur e thjeshtuar – marrëveshje kuadër	2. A. B. 3. L. H.	1. A. S. (Kryetar) 2. A. C. (Anëtar) 3. X. B. (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa TVSh) 9,808,512 lekë	**6. Oferta fituese** OE "N." ShPK, me vlerë 9,578,200 lekë pa TVSh	**7. Diferenca me fondin limit** 230,312 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 25.04.2023	**9. Burimi Financimit:** Nga buxheti i Shtetit (Bashkisë)	**10. Operatorët Ekonomik** a) OE "N." ShPK b) OE "4" ShPK c) OE "3" ShPK
11. Ankimime AK, Ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK, Ka**	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka**
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës nr. 4909 prot., datë 12.12.2023	**15. Vlera e kontratës (me TVSh)**	**11,493,840 lekë**

Me shkresë nr. 796 prot., datë 21.02.2023 është hartuar Urdhëri nr. 44, datë 21.02.2023 "Për ngritjen e komisionit për përcaktimin e sasive, vlerësimin e Fondit Limit dhe specifikimeve teknike për prokurimin me objekt "Blerje mallrash ushqimore për plotësimin e nevojave të çerdheve, kopshteve dhe konviktit të shkollës së mesme" për vitin 2023 dhe 2024", me përbërje z. H.P. kryetar, z. S. K., z. X. L., zj. I. B. dhe z. K. F., anëtarë.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe DT

Kjo procedurë është "E Hapur e thjeshtuar", me vlerë 9,808,512 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë Gramsh. Janë hartuar specifikimet teknike me shkresë nr. 796/ prot., datë 20.04.2023, nga Nj.P përkatësisht anëtarët H.P., E. M., X. L., I. B.dhe G. I.

Është mbajtur procesverbal pa numër dhe datë për testimin e tregut nga Nj.P, për "Miratimin e sasive fizike të çmimeve të artikujve për vlerësimin e fondit limit dhe hartimin e preventivit", si dhe është hartuar procesverbali nr. 1225/2 prot., datë 23.03.2023 "Për vlerësimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit "Blerje mallrash ushqimore për plotësimin e nevojave të çerdheve, kopshteve dhe konviktit të shkollës së mesme" për vitin 2023 dhe 2024".

Është hartuar preventivi me nr. 1225 prot., datë 23.03.2023 me vlerën 4,904,256 lekë pa TVSh dhe për të dy vitet në vlerën totale 9,808,512 lekë pa TVSh.

Urdhër Prokurimi nr. 66, datë 29.03.2023, me shkresë nr. 1289 prot., datë 29.03.2023, "Për prokurimin e fondeve buxhetore për marrëveshje kuadër, me objekt "Blerje mallrash ushqimore për plotësimin e nevojave të çerdheve, kopshteve dhe konviktit të shkollës së mesme". Caktimin e njësisë së Prokurimit; caktimin e procedurës së prokurimit", me vlerë të fondit limit 9,808,512 lekë pa TVSh, është mbajtur procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit me datë 06.04.2023. me procesverbalin nr. 1289/1 prot., datë 12.04.2023, është miratuar dhe afati për hapjen e ofertave me datë 25.04.2023. Janë miratuar DST me shkresë nr. 1497 prot., datë 20.04.2023 në përputhje me kërkesat ligjore.

Vlerësimi i ofertave

Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me Urdhrin nr. 67, datë 29.03.2023, "Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit", me përbërje z. A. S., z. A. C.dhe z. E. H.

KVO ka mbajtur proces verbalin nr. 1, datë 10.05.2023 për hapjen e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje mallrash ushqimore për plotësimin e nevojave të çerdheve, kopshteve dhe konviktit të shkollës së mesme". KVO ka marrë Vendimin nr. 1, datë 29.05.2023 "Për kualifikimin dhe

renditjen e përfundimtare të OE në tender" dhe ka renditur OE 4 ShPK me vlerë të ofertës 8,996,800 lekë pa TVSh.
U konstatua se për këtë procedurë kanë aplikuar 3 operatorë ekonomik, si më poshtë:

1. OE "3" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 5,837,258 lekë pa TVSh;
2. OE "4" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 8,996,800 lekë pa TVSh;
3. OE "N" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 9,578,200 lekë pa TVSh.

Me shkresë nr. 1355/2 prot., datë 15.06.2023 KPP-ja ka hartuar formular për publikim lidhur me pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendimet, nga subjekti "N" ShPK, me anë të ankesës me numër ankimimi elektronik A/2023/3178 dhe me nr. 1355/2023 prot., datë 14.06.2023. pretendohet nga OE "N" ShPK se OE "4" ShPK është kualifikuar pa të drejtë. KPP për ankesën e bërë kërkon: Pranimin e ankesës, pezullimin e procedurës së prokurimit dhe skualifikimn e OE "4". Për këtë është hartuar Urdhër nr. 115, datë 15.06.2023 "Për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e ankesës lidhur me vlerësimin e tenderit" dhe është marrë Vendimi nr. 2274 prot., datë 23.06.2023 "Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga OE "N" ShPK lidhur me vlerësimin e tenderit me objekt "Blerje mallrash ushqimore për plotësimin e nevojave të çerdheve, kopshteve dhe konviktit të shkollës së mesme"".
Komisioni vendosi që të pranojë pjesërisht ankesën e OE "N" ShPK, si dhe pranimin e ofertave parashikuar për tu zhvilluar më datë 10.05.2023, skualifikoi OE "4" ShPK dhe personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë ankuesin, KPP-në dhe KVO lidhur me këtë vendim. Me shkresën nr. 2148/1 prot., datë 26.06.2023 është kthyer përgjigje ankesës nga OE "N" ShPK dhe KPP-së.
Nga KPP-ja është marrë Vendimi nr. 551/2023 me shkresë nr. 1355/4 prot., datë 03.07.2023 dhe vendosi të mbylli çështjen e ankesës nga OE "N" ShPK, AK të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit dhe AK të skualifikojë OE "4" ShPK.
Nga kjo situatë KVO i ka kthyer përgjigje OE "N." ShPK me shkresë nr. 2638/1 datë 26.07.2023, dhe shprehet se për ankesën dhe pretendimin se OE "4" nuk ka paraqitur raport analizash për produktet si gjalp, djath i bardhë, vezë, qumësht, mish viçi dhe fruta, për të njëjtën arsye është skualifikuar dhe OE "N." ShPK. Sqarohet se është marrë parasysh nevoja emergjente për furnzim me mallra ushqimor si dhe KVO ka marrë të mirëqenë çmimin më të ulët të ofertave. Kështu Nj.P ka marrë Vendimin nr. 60, datë 14.08.2023 për anulimin dhe përsëritjen e procedurës së tenderit dhe OE "N." ShPK dorëzon ankesën për vendimin e anulimit në KPP.
- Me vendim të KPP-së nr. 846/2023, datë 04.09.2023 u vendos pranimi i ankesës;
- Me Urdhër nr. 236, datë 11.09.2023 u ndryshua një anëtar i KVO-së përkatësisht z. E. H. zëvendësohet me z. X. B. dhe KVO e re e krijuar bën vlerësimin për vendimin e KPP-së;
- Në datë 12.09.2023 nga KVO i dërgohet OE "N." ShPK shkresë për dorëzimin e dokumentacionit në SPE dhe ato provuese në formularin e vetëdeklarimit;
- Me procesverbalin nr. 2, datë 21.09.2023, KVO skualifikon OE "N." ShPK;
- Me datë 02.10.2023 anulohet procedura e prokurimit për shkak se nuk rezultoi asnjë ofertë e përshtatshme dhe me datë 10.10.2023 OE "N." ShPK paraqet ankesë në KPP kundër vendimit të anulimit dhe KPP me Vendim nr. 1109/2023, datë 01.11.2023 vendos pranimin e ankesës;
- Me Urdhër nr. 294, datë 06.11.2023, u ndryshua një anëtar i KVO-së përkatësisht z. A. S. zëvendësohet me z. A. Sh. dhe mbahet procesverbal datë 07.11.2023 për pranimin e vendimit të KPP-së;
- Në datë 17.11.2023 bëhet publikimi i njoftimit paraprak dhe me datë 24.11.2023 përfundon afati i ankimimit rezultoi se nuk pati ankesa.

Raporti përmbledhës me nr. 4743 Prot., është hartuar nga KVO më datë 30.11.2023. Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave nga titullari i AK u hartua Vendimi nr. 87, datë 30.11.2023 ka

vendosur kualifikimit është **"N." ShPK me ofertën e paraqitur në vlerën 9,578,200 lekë pa TVSh.**
Formulari i njoftimit të fituesit paraprak nr. 4745 Prot., është hartuar më datë 30.11.2023 dhe është publikuar në buletinin e APP-së nr. 98 datë 04.12.2023.
Titullari i Autoritetit Kontraktor ka lidhur marrëveshje kuadër me nr. 4909 Prot., datë 12.12.2023 me vlerë 9,578,200 lekë pa TVSh dhe 11,493,840 lekë me TVSh me afat 24 muaj. Titullari i AK ka hartuar Urdhërin nr. 324, datë 18.12.2023 "Caktimin e strukturës mbikëqyrëse dhe monitorimin e marrëveshje kuadër me nr. 4909 Prot., datë 12.12.2023 me objekt "Blerje mallrash ushqimore për plotësimin e nevojave të çerdheve, kopshteve dhe konviktit të shkollës së mesme"", me përbërje zj. G. I, z. X. L., zj. K. L. dhe zj. E.B.

Nga auditimi u konstatua se, në SPE, OE "N" ShPK i shpallur fitues, nuk plotëson kriterin 2.3.6, ku kërkohet raport-analiza origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i references për artikujt që prokurohen. Rezulton se OE nuk paraqet raport-analiza për produktet vaj lule dielli, gjalp, djathë i bardhë, vezë, qumësht, kos, nënprodukte të mishit të viçit, fruta dhe perime.

Sa më sipër, nuk janë marrë masat e nevojshme nga KVO për të verifikuar përputhshmërinë e mjeteve të dorëzuara me vetë deklarimet e bëra në kundërshtim me nenin 26, pika 6 dhe 7 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për "Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".
Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t´i kërkoj operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertës i përbërë nga z. A. S.(Kryetar), z. A. C. (Anëtar) dhe z. X. B (Anëtar).

4. Procedura e prokurimit me objekt "Blerje dru zjarri dhe pelet për institucionet arsimore për vitin shkollor 2023-2024 si dhe Njësitë Administrative".

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: "**Blerje dru zjarri dhe pelet për institucionet arsimore për vitin shkollor 2023-2024 si dhe Njësitë Administrative"		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 200 datë 29.08.2023	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. E. K. 2. E. M. 3. J. M.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 231, datë 01.09.2023:** 1. A. S. (Kryetar) 2. X. B. (Anëtar) 3. E.H. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur"		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 20,151,000 lekë	**6. Oferta fituese** OE "A" ShPK, me vlerë 19,608,000 lekë pa TVSh	**7. Diferenca me fondin limit** 543,000 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 04.09.2023	**9. Burimi Financimit:** Nga buxheti i Bashkisë 2023	**10. Operatorët Ekonomik** a) OE "A" ShPK
11. Ankimime AK, Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka**	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka**
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës	**15. Vlera e kontratës (me TVSh)**	**23,529,600 lekë**

04.10.2023		

Me shkresë nr. 2204 prot., datë 20.06.2023 është hartuar Urdhëri nr. 119, datë 20.06.2023 "Për ngritjen e komisionit për përcaktimin e sasive, vlerësimin dhe përllogaritjen e Fondit Limit dhe specifikimeve teknike për furnizimin me dru zjarri dhe pelet të çerdheve, kopshteve, shkollave, konviktit të shkollës së mesme për vitin shkollor 2023-2024, si dhe për zyrat e Njësive Administrative, me përbërje z. E. K. kryetar, zj. E. M., z. F.H. dhe z. X. M., anëtarë.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe DT
Kjo procedurë është "E Hapur", me vlerë 20,151,000 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë Gramsh. Janë hartuar specifikimet teknike pa numër protokolli datë 17.08.2023, nga Nj.P përkatësisht anëtarët E. M., J. M.
Është mbajtur procesverbal pa numër, datë 29.06.2023 për testimin e tregut nga Nj.P.
Urdhër Prokurimi nr. 200, datë 29.08.2023, me objekt "Për prokurimin e fondeve buxhetore për marrëveshje kuadër, me objekt "Blerje dru zjarri dhe pelet për institucionet arsimore për vitin shkollor 2023-2024 si dhe Njësitë Administrative". Caktimin e njësisë së Prokurimit; caktimin e procedurës së prokurimit", me vlerë të fondit limit 20,151,000 lekë pa TVSh, është miratuar dhe afati për hapjen e ofertave me datë 04.09.2023. Janë miratuar DST me pa numër me datë 7.08.2023, ndryshuar me shkresën nr. 3180/1, datë 22.08.2023.

Nga auditimi u konstatua se: nuk është argumentuar numri i punonjësve të përcaktuar në pikën 2.3.5 të DT, ku përcaktohet se "Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar një numër prej mesatarisht 10 (dhjetë) personave, për periudhën 3 muajt e fundit".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit i përbërë nga z. E. K., zj E. M. dhe z. J. M..

Vlerësimi i ofertave
Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me Urdhrin nr. 201, datë 09.08.2023, "Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit", me përbërje z. X. B., zj. E. I. dhe z. E. H., ndryshuar me Urdhër nr. 231, datë 01.09.2023 dhe me përbërje z. A.S., z. X. B. dhe z. E. H.
KVO ka mbajtur proces verbalin nr. 1, datë 04.09.2023 për zhvillimin e procedurave të tenderit me objekt "Blerje dru zjarri dhe pelet për institucionet arsimore për vitin shkollor 2023-2024 si dhe Njësitë Administrative". KVO ka marrë Vendimin nr. 1, datë 14.09.2023 "Për kualifikimin dhe renditjen e përfundimtare të OE në tender" dhe ka kualifikuar OE "A" ShPK të vetëm pjesëmarrës me vlerë të ofertës 19,608,000 lekë pa TVSh.

Raporti përmbledhës me nr. 3648 Prot., është hartuar nga KVO më datë 21.09.2023. Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave nga titullari i AK u hartua Vendimi nr. 67, datë 21.09.2023 ka vendosur kualifikimit është **"A" ShPK me ofertën e paraqitur në vlerën 19,608,000 lekë pa TVSh.**
Me shkresë nr. 3613 prot., datë 18.09.2023 Nj.P ka hartuar formularin për njoftimin e fituesit (paraprak) publikuar në buletinin nr. 80, datë 25.09.2023.
Titullari i Autoritetit Kontraktor ka lidhur marrëveshje kuadër me nr. 3838 Prot., datë 04.10.2023 me vlerë 19,608,000 lekë pa TVSh dhe 23,529,600 lekë me TVSh me afat 24 muaj.

Nga auditimi u konstatua se, në SPE, OE "A" ShPK i shpallur fitues, nuk plotëson kriterin 2.3.4, ku kërkohet disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet /kapacitetet teknike, për makineritë e mëposhtme:

- Për motosharrat e blera me faturë nr. 162, 169, 173 dhe 222 me datë 18, 25, 28.07.2017 dhe 31.10.2017, nuk janë paraqitur fotot;
- Kamionët dhe kamioncinët e marrë me qira me targa ... (kapacitet 3.5 ton), ... (kapacitet 3.2 ton), ... (kapacitet 3.2 ton) dhe ... (kapacitet 5.6 ton) tek certifikata për transport ndërkombëtarë mallrash për llogari të vet, është për përdorim vetjak dhe në lejen e qarkullimit, në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportin rrugor" i ndryshuar, si dhe pika 3 e nenit 6 të Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimit e veprimtarisë në transportin rrugor".

Sa më sipër, nuk janë marrë masat e nevojshme nga KVO për të verifikuar përputhshmërinë e mjeteve të dorëzuara me vetë deklarimet e bëra në kundërshtim me nenin 26, pika 6 dhe 7 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për "Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".
Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t´i kërkoj operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertës i përbërë nga z. A. S. (Kryetar), z. X. B. (Anëtar) dhe z. E. H. (Anëtar).

Zbatimi i kontratës
Titullari i AK ka hartuar Urdhërin nr. 275, datë 18.10.2023 "Caktimin e strukturës mbikëqyrëse dhe monitorimin e marrëveshje kuadër me nr. 3838 Prot., datë 04.10.2023 me objekt "Blerje dru zjarri dhe pelet për institucionet arsimore për vitin shkollor 2023-2024 si dhe Njësitë Administrative"", me përbërje z. H. P., z. F. H., z. J. M., si dhe Kontratë Publike për furnizimin e mallrave "Blerje dru zjarri dhe pelet për institucionet arsimore për vitin shkollor 2023-2024 si dhe Njësitë Administrative" nr. 3862 prot., datë 05.10.2023 shoqëruar me Urdhër 276, datë 19.10.2023 2023 për "Caktimin e strukturës mbikëqyrëse dhe monitorimin e marrëveshje kuadër me nr. 3862 Prot., datë 05.10.2023 me objekt "Blerje dru zjarri dhe pelet për institucionet arsimore për vitin shkollor 2023-2024 si dhe Njësitë Administrative"", me përbërje si mëposhtë:

- Qytet (... dhe Drejtuesit e institucioneve të shkollave, Kopshteve dhe çerdheve);
- Nj.A. Pishaj (... dhe Drejtuesit e institucioneve të shkollave, Kopshteve dhe çerdheve);
- Nj.A. Poroçan (... dhe Drejtuesit e institucioneve të shkollave, Kopshteve dhe çerdheve);
- Nj.A. Kodovjat (... dhe Drejtuesit e institucioneve të shkollave, Kopshteve dhe çerdheve);
- Nj.A. Skënderbegas (... dhe Drejtuesit e institucioneve të shkollave, Kopshteve dhe çerdheve);
- Nj.A. Kushovë (... dhe Drejtuesit e institucioneve të shkollave, Kopshteve dhe çerdheve);
- Nj. A. Sult (... dhe Drejtuesit e institucioneve të shkollave, Kopshteve dhe çerdheve);
- Nj.A. Kukur (... dhe Drejtuesit e institucioneve të shkollave, Kopshteve dhe çerdheve);
- Nj.A. Lenie (... dhe Drejtuesit e institucioneve të shkollave, Kopshteve dhe çerdheve);
- Nj.A. Tunjë (... dhe Drejtuesit e institucioneve të shkollave, Kopshteve dhe çerdheve).

Ndryshuar me Urdhër nr. 31, datë 30.01.2024, për disa ndryshime në Urdhërin nr. 276, datë 19.10.2023 dhe për në Qytet është zëvendësuar z. H.P. me z. K. H.

Shpërndarja e druve të zjarrit dhe peletës për institucionet arsimore për vitin shkollor 2023-2024 si dhe Njësitë Administrative është bërë sipas planit nr. 4390 prot., datë 07.11.2023 dhe proces verbaleve të nënshkruara nga struktura përgjegjëse dhe OE sipas specifikimeve, sasisë dhe institucioneve arsimore ose Nj. Administrative përkatëse.

Për vitin 2024:

Nga Bashkia Gramsh janë parashikuar 105 procedura prokurimi dhe janë zhvilluar 40 procedura prokurimi ose 38% nga parashikimi, me vlerë të fondit limit **430,186,638** lekë pa TVSh, vlerë të kontratës **374,971,492** lekë pa TVSh, diferenca midis tyre prej 55,215,146 lekë pa TVSh, ose në masën 87% të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

- **Blerje me vlerë të vogël,** 12 procedura, me fond limit në total prej 12,033,726 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 10,211,663 lekë, duke kursyer shumën prej 1,822,063 lekë;
- **E hapur,** 9 procedura, me fondin limit në total prej 359,925,229 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 317,091,688 lekë, duke kursyer shumën prej 42,833,541 lekë;
- **E hapur e thjeshtuar,** 10 procedura, me fondin limit në total prej 58,227,683 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 47,668,141 lekë, duke kursyer shumën prej 10,559,542 lekë.

Janë audituar 3 procedura të hapura dhe 3 procedura blerje të vogla, ose 60% e fondit limit dhe 68 % e vlerës së kontratës ku ka rezultuar si mëposhtë vijon.

1. Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i Shkollës 9-vjeçare "Rilindja", Bashkia Gramsh", viti 2024

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: "**Rikonstruksion i Shkollës "Rilindja", Bashkia Bramsh" **viti 2024**		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 249 datë 09.07.2024	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. E. S. 2. O. Ç. 3. M.A.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 250, datë 09.07.2024:** 1. A. S. (Kryetar) 2. Xh. B. (Anëtar) 3. E. H. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur"		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 92,556,705 lekë	**6. Oferta fituese** OE "I." ShPK, me vlerë 87,923,313.2 lekë pa TVSh	**7. Diferenca me fondin limit** 4,633,391.8 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 08.08.2024	**9. Burimi Financimit:** Nga buxheti i Shtetit (Bashkia Gramsh dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit)	**10. Operatorët Ekonomik** a) OE "A" ShPK b) BOE "B" ShPK & "C" ShPK c) OE "I" ShPK d) OE "R" ShPK e) OE "Z" ShPK
11. Ankimime AK, Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka**	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka**
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës nr. 4482 prot., datë 14.10.2024	**15. Vlera e kontratës (me TVSh)**	**105,507,975.84 lekë**

Me shkresë nr. 1815/5 prot., datë 27.03.2024, Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) me lëndë "Transferim fondi për shpenzime kapitale", është shpallur fitues për projektin Bashkia Gramsh.

Titullari i Bashkisë Gramsh ka hartuar Urdhrin nr. 205, datë 9.07.2024, "Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit", me përbërje z. A.S, z. X. B. dhe z. E. H.

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është "E Hapur", me vlerë 92,556,705 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit (bashkëfinancim nga buxheti i Bashkisë Gramsh dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporti), e ndarë si vijon:

- Vlera e financimit nga Bashkia Gramsh për vitin 2025 në shumën 13,883,505.8 lekë pa TVSh dhe 16,660,207 lekë me TVSh;
- Vlera e financimit nga MAS-i për vitin 2024 në shumën 19,166,666.7 lekë pa TVSh dhe 23,000,000 lekë me TVSh;
- Vlera e financimit nga MAS-i për vitin 2025 në shumën 59,506,532.5 lekë pa TVSh dhe 71,407,839 lekë me TVSh.

Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të Territorit (DPZhT) në Bashkinë Gramsh me shkresën nr. 1643/1 Prot., datë 18.04.2024, ka paraqitur shkresë përcjellëse drejtuar personit përgjegjës të Prokurimit, z. E S, për projektin me objekt *"Rikonstruksion i Shkollës "Rilindja", Bashkia Gramsh"*. Bashkëlidhur kërkesës DPZhT ka dorëzuar edhe dokumentacionin si vijon:
- Preventivi i punimeve;
- Grafiku i punimeve;
- Relacioni teknik;
- Specifikimet teknike;
- Projekti teknik.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:
Projekti arkitektonik, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga Ark. Amarildo Karaj dhe Ing. Edion Shtylla si dhe ING A. Ç. dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh, z. B.A. Bashkëlidhur relacioni teknik dhe Specifikimet teknike hartuar nga ING A. Ç.. Oponenca teknike është dërguar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkesë nr. 651/2, datë 25.06.2024, me Marrëveshje "Për kryerjen e oponencës teknike të projektit të zbatimit me objekt *"Rikonstruksion i Shkollës "Rilindja", Bashkia Gramsh"*", nr. 1993 prot., datë 13.05.2024 nga Bashkia Gramsh dhe nr. 651/1 prot., datë 07.05.2024 nga Instituti i Ndërtimit.

Hartimi i fondit limit
Projekt preventivi për investimin me objekt ***"Rikonstruksion i Shkollës "Rilindja""*** është hartuar nga Ing. A. Ç. dhe përbëhet nga 16 zëra punimesh me vlerë totale 92,556,705 lekë pa TVSh dhe 111,068,046 lekë me TVSh.

Nga auditimi i hartimit të fondit limit sipas zërave të punimeve rezultoi se çmimet e zërave të punimeve janë në përputhje me përcaktimet e manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre", por jo sipas manualit të ri në sistemin online E-Albania. Gjithashtu, pjesa më e madhe e zërave të punimeve nuk janë sipas kodeve në manualin e shfuqizuar, për zërat 2.426/11 *Prishje suvatim muri i brendshëm,* 2.426/12 *Prishje suvatimi tavani dhe trarët,* 2.426/9 *Prishje suvatim i jashtëm,* 2.281 *Heqje e pllakave bashkë me allçi,* 3.689 *Prishje trotuari,* 2.430/2 *Prishje çatie ekzistuese,* 2.1a *Gërmim dheu me krahë dhe transport me karo dore,* 2.119/1b *Arkitrarë të parapërgatitur,* 2.121 *Brez betoni M-200,* 1.30/1

Beton C-20/25 (Me çakëll) për pandus, etj.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe DT

Janë hartuar kriteret e veçanta për kualifikimin për procedurën e prokurimit me objekt *"Rikonstruksion i Shkollës "Rilindja", Bashkia Gramsh",* me Procesverbalin nr. 2896/1 datë 10.07.2024, nga Nj.P përkatësisht anëtarët O. Ç. dhe M. A. për kriteret e veçanta për kualifikimin për procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i Shkollës "Rilindja""*. Gjatë hartimit të kritereve për kapacitetin teknik është dhënë edhe argumentimi teknik lidhur me kategoritë e punimeve të përcaktuara sipas zërave të preventivit.

Për zhvillimin e procedurës Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 249, datë 09.07.2024 ku ka ngarkuar NJP me përbërje z. E. S., z, O. Ç. dhe z. M. A., për të vijuar me procedurën e prokurimit me objekt *"Rikonstruksion i Shkollës "Rilindja""* me vlerë të fondit limit 92,556,705 lekë pa TVSh. Më datë 31.07.2024 u modifikuan DST-të për shkak të rekomandimeve të APP-së dhe u hodhën në sistem, kështu duke shtyrë datë e zhvillimit të procedurës së tenderit nga data 29.07.2024, më datë 08.08.2024.

Nga auditimi u konstatua se: kriteret e vendosura për kualifikim, u konstatuan kritere të paargumentuara duke iu referuar përshkrimit të punimeve të bëra në preventiv si vijon:

1. Nuk është argumentuar numri i punonjësve të përcaktuar në pikën 2.3.3 të DT "*Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se 80 (tetëdhjete) punonjës për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:*

   •Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.

   •Listë pagesat e punonjësve, të konfirmuara nga institucionet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.
2. Nuk është argumentuar kërkesa për mjek në pikën 2.3.7 të DT, "*Operatorët ekonomik duhet të kenë të punësuar në stafin 1 (një) mjek të përgjithshëm, bazuar në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë" i ndryshuar.*
   - *Për këtë operatorët ekonomik duhet të paraqesin :*
   - *kontratën e individuale të punës;*
   - *diplomën universitare;*
   - *licencën përkatëse për ushtrimin e profesionit.*

   Nëse OE nuk kanë në stafin e tyre persona përgjegjës me aftësi dhe kualifikimet e duhura lidhur me çështjet e shëndetit në pune (nëse nuk kanë mjek të punësuar) mund ti sigurojnë këto shërbime me anë marrëdhënieve kontraktore (të paraqitet kontrata e vlefshme, diploma universitare dhe licenca përkatëse për ushtrimin e profesionit) me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

   Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

   Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK";

3. Nuk është argumentuar kërkesa për makineritë të përcaktuar në pikën 2.3.11 të DT:
   - Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton - 1 copë;
   - Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 - 15 ton – 1 copë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit i përbërë nga z. O. Ç. dhe z. M. A.

Vlerësimi i ofertave

Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me Urdhrin nr. 250, datë 09.07.2024, "Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit", me përbërje z. A.S., z. X. B. dhe z. E. H.
KVO ka mbajtur proces verbalin nr. 1, datë 08.08.2024 për hapjen e procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i Shkollës "Rilindja"".
U konstatua se për këtë procedurë kanë aplikuar 5 operatorë ekonomik, si më poshtë:

1. OE "A" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 75,856,621.15 lekë pa TVSh;
2. BOE "B" ShPK & "C" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 76,552,633 lekë pa TVSh;
3. OE "I" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 87,923,313.2 lekë pa TVSh;
4. OE "R" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 90,707,197.2 lekë pa TVSh
5. OE "Z" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 91,632,137.2 lekë pa TVSh.

KVO ka hartuar proces verbalin "Për zhvillim të procedurës së prokurimit" dhe vlerësimin nr. 1, datë 02.09.2024 kualifikimin dhe renditjen e operatorëve ekonomik me objekt "Rikonstruksioni Shkollës "Rilindja", Bashkia Gramsh". Me shkresën datë 23.08.2024 me lëndë "Kërkesë për pranimin e korrigjimeve të gabimeve aritmetike", drejtuar BOE "B" ShPK & "C" ShPK. KVO ka marrë Vendimin nr. 2, datë 12.09.2024 "Për vlerësimin e dokumentacionit të OE të renditur në vendin e parë dhe renditjen përfundimtare të OE në tenderin me objekt "Rikonstruksion i Shkollës "Rilindja", Bashkia Gramsh"", bashkëlidhur proces verbalin nr. 4, datë 12.09.2024, "Për verifikimin e dokumenteve të OE renditur në vendin e parë". Si dhe KVO ka marrë Vendimin nr. 52, datë 27.09.2024, "Për shpalljen fitues të tenderit me objekt "Rikonstruksioni Shkollës "Rilindja", Bashkia Gramsh"".

Nga auditimi në SPE dhe në dosjen e prokurimit janë skualifikuar, 3 Operatorët Ekonomik në fazën e parë:

1. OE "A" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 75,856,621.15 lekë pa TVSh;
2. OE "R" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 90,707,197.2 lekë pa TVSh;
3. OE "Z" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 91,632,137.2 lekë pa TVSh, skualifikuar me të drejtë nga KVO.

Për BOE "B" ShPK & "C" ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 76,552,633 lekë pa TVSh, është kërkuar me shkresën datë 23.08.2024 "Kërkesë për pranimin e korrigjimit të gabimit aritmetik", KVO shprehet se OE nuk e ka pranuar korrigjimin (nuk ka kthyer përgjigje), diferencë totale prej 66,744 lekë me TVSh, për zërin – Punime fasade nr. rendor 4, nr. analize 4.1 "Konstruksione metalike të përbëra për shkallë emergjence" (diferencë për vlerën e lartpërmendur më shumë se oferta por jo më lartë se OE tjetër i renditur pas tij).

Nga auditimi u konstatua se, sipas Ligjit 162/2020, "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 2 "*Autoriteti ose enti kontraktor, ... duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik,*

oferta e tij do të skualifikohet".
Pra AK bën korrigjimin dhe njofton OE, nuk bën kërkesë për pranimin, si dhe nga shqyrtimi në SPE OE nuk ka kthyer përgjigje, që do të thotë nuk ka shprehur mosdakortësi me korrigjimin.

Gjithashtu, sipas Ligjit 162/2020, "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3 dhe "*...Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.",* si dhe sipas VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për "Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", neni 82, pika 3, sqaron se shumat absolute të të gjitha korrigjimeve të ofertës së OE nuk kalon as 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar, pra në këtë rast të ofertës së OE korrigjimet as nuk e kalojnë 2% e vlerës së ofertës ekonomike as nuk ndryshon thelbësisht kushtet dhe kërkesat.

Raporti përmbledhës me nr. 4202 Prot., është hartuar nga KVO më datë 27.09.2024. Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave KVO-ja ka vendosur që OE që plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit është **"I" ShPK me ofertën e paraqitur në vlerën 87,923,313,2 lekë pa TVSh.**
Formulari i njoftimit të fituesit paraprak nr. 3957 Prot., është hartuar më datë 12.09.2024 dhe është publikuar në buletinin e APP-së nr. 63 datë 23.09.2024, si dhe Formulari i njoftimit të fituesit në përfundim të afateve të ankimit nr. 4205/1 Prot., është hartuar më datë 27.09.2024 dhe është publikuar në buletinin e APP-së nr. 67 datë 07.10.2024.
Nuk ka patur ankesa nga OE pjesëmarrës.
Titullari i Autoritetit Kontraktor ka lidhur kontrata me nr. 4533 Prot., datë 14.11.2023 me vlerë 87,923,313.2 lekë pa TVSh dhe 105,507,975.84 lekë me TVSh me afat 8 muaj nga fillimi i punimeve (dorëzimi i sheshit të punimeve). Formulari i njoftimit të kontratës është publikuar në buletin e APP-së nr. 70, datë 31.10.2024.

Nga auditimi u konstatua se, në SPE, OE "I" ShPK i shpallur fitues, nuk plotëson kriteret:

1. Kriteri 2.3.1-a, ku kërkohet: Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme; OE për punën me objekt "Dhënie trualli për ndërtim", me kontratë nr. 1384 Rep., 1308/4 Kol., datë 13.09.2017, kontratë 5 vjeçare, mungon certifikata e marrjes në dorëzim të objektit;
2. Kriteri 2.3.5 operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë minimumi punonjës të specializuar/ kualifikuar, mungon/nuk është dokumentacioni i kërkuar sipas specifikimeve si më poshtë:
   - Punonjës murator – jo më pak se 2 (dy) punonjës, sipas formularit E-Sig, punonjësit .... janë me kodet e profesionit 7115.02 dhe 9313.01 dhe jo kodit që i përket profesionit murator (7112);
   - Punonjës hidraulik – jo më pak se 2 (dy) punonjës, sipas formularit E-Sig, punonjësit ... janë me kodet e profesionit 9313.01 dhe 7112.05 dhe jo kodit që i përket hidraulik (7126);
   - Punonjës elektricist – jo më pak se 3 (tre) punonjës, sipas formularit E-Sig, për 2 punonjës ... dhe janë me kodet e profesionit 9313.01 dhe jo kodit që i përket elektricist (7411), si rasti i punonjësit ...;
   - Punonjës saldator – jo më pak se 2 (dy) punonjës, sipas formularit E-Sig, për 1 punonjës ... me kodin e profesionit 7112.05 dhe jo kodit që i përket saldator (7114);

- Punonjës bojaxhi – jo më pak se 2 (dy) punonjës, sipas formularit E-Sig, punonjësit .... janë me kodet e profesionit 9313.01 dhe 5414.02 dhe jo kodit që i përket profesionit bojaxhi (711 ose 713);
- Punonjës karpentier – jo më pak se 2 (dy) punonjës, sipas formularit E-Sig, punonjësit ... janë me kodet e profesionit 9313.01 dhe jo kodit që i përket profesionit karpentier (7115.02);
- Punonjës hidroizolues – jo më pak se 2 (dy) punonjës, sipas formularit E-Sig, punonjësit .... janë me kodet e profesionit 9313.01 dhe jo kodit që i përket profesionit hidroizoluesit (7124);
- Punonjës pllakashtrues – jo më pak se 2 (dy) punonjës, sipas formularit E-Sig, punonjësit ... janë me kodet e profesionit 7112.05 dhe 9313.01 dhe jo kodit që i përket profesionit pllakashtrues (7122);
- Punonjës specialist dyer/dritare – jo më pak se 2 (dy) punonjës, sipas formularit E-Sig, punonjësit ... janë me kodet e profesionit 7123.03 dhe 3334.07 dhe jo kodit që i përket profesionit specialist dyer/dritare (8215 ose 8219);
- Punonjës specialist kaldaje – jo më pak se 2 (dy) punonjës, sipas formularit E-Sig, punonjësit ... janë me kodet e profesionit 9313.01 dhe 5414.02 dhe jo kodit që i përket profesionit specialist kaldaje (7127);
- Punonjës gipsi – jo më pak se 2 (dy) punonjës, sipas formularit E-Sig, punonjësi...është me kodin e profesionit 9313.01 dhe jo kodit që i përket profesionit specialist gipsi (7123).

3. Kriteri 2.3.11, për mjetet dhe pajisjet mungon dokumentacioni si mëposhtë:
   - Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton – 1 copë, pasi për kamioni me targa ... tek certifikata për transport ndërkombëtarë mallrash për llogari të vet, është për përdorim vetjak, në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportin rrugor" i ndryshuar, si dhe pika 3 e nenit 6 të Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimit e veprimtarisë në transportin rrugor";
   - Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton – 2 copë, pasi për kamionët me targa ... tek certifikata për transport ndërkombëtarë mallrash për llogari të vet, është për përdorim vetjak, në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportin rrugor" i ndryshuar, si dhe pika 3 e nenit 6 të Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimit e veprimtarisë në transportin rrugor". Ndërsa kamioni me targa ... veç certifikata për transport ndërkombëtarë për përdorim vetjak. Si dhe për kamionët me targa .... veç certifikata për transport ndërkombëtarë për përdorim vetjak, janë me kapacitet 7.5 ton, pra jo 10-15 ton siç kërkohet;
   - Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 ton – 2 copë, pasi për kamionçinat me targa ... tek certifikata për transport ndërkombëtarë mallrash për llogari të vet, është për përdorim vetjak, në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportin rrugor" i ndryshuar, si dhe pika 3 e nenit 6 të Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimit e veprimtarisë në transportin rrugor";
   - Kamionçinë me kapacitet mbajtës 1 ton – 1 copë OE nuk ka dorëzuar dokumentacion;
   - Kamion me vinç – 1 copë OE nuk ka dorëzuar dokumentacion;
   - Fadromë me kova para dhe kova mbrapa – 1 copë, OE nuk ka dorëzuar dokumentacion, si dhe mjeti me targa ..., tek certifikata për transport ndërkombëtarë mallrash për llogari të vet, është për përdorim vetjak, në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportin rrugor" i ndryshuar, si dhe pika 3 e nenit 6 të Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimit e veprimtarisë në transportin rrugor;

- Autobot uji – 1 copë, mjeti me targa ..., tek certifikata për transport ndërkombëtarë mallrash për llogari të vet, është për përdorim vetjak, në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportin rrugor" i ndryshuar, si dhe pika 3 e nenit 6 të Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimit e veprimtarisë në transportin rrugor";
- Matrapik – 2 copë, OE ka dorëzuar vetëm 1 (një) foto dhe jo dy siç kërkohet;
- Makineri (helikopter) për shtresat e dyshemesë – 2 copë, OE ka dorëzuar dokumentacion vetëm për 1 (një) mjet dhe jo dy siç kërkohet;

4. Kriteri 2.3.12, Certifikata ISO 3834 - 1:2021 (Për Kërkesat e Cilësisë për Saldim me Shkrirje të Materialeve Metalike (e vlefshme), lëshuar nga institucionet zyrtare të akreditуar për këtë qëllim, është e vlefshme deri më datë 24.08.2024, ndërkohë që dorëzimi i ofertës në AK është bërë në datë 12.09.2024.

Sa sipër, kualifikimi i OE "I." ShPK është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 87, pika 4 të Ligjit 162/2020, "Për Prokurimin Publik", sipas të cilit "*Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit*".
Sa sipër, KVO ka skualifikuar BOE "B." ShPK & "C." ShPK me devijime, që mund të përkufizoheshin si devijime të vogla në zbatim të nenit 92, pika 4 të Ligjit 162/2020, "Për Prokurimin Publik" dhe ka kualifikuar OE me devijime thelbësore të DT (mungesa e eksperiencës).
Me skualifikimin e këtij BOE "B." ShPK & "C." ShPK, në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për "Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", KVO duhet të kishte bërë lidhjen e kontratës me BOE "B." ShPK & "C." ShPK. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 87,923,313,2 lekë pa TVSh me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertës i përbërë nga z. A. S. (Kryetar), z. X. B. (Anëtar) dhe z. E. H. (Anëtar).

2. Procedura e prokurimit me objekt "Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore", Bashkia Gramsh", viti 2024

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: "**Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore", **viti 2024**		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 245 datë 08.07.2024	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. E. S. 2. O. Ç. 3. M. A.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 248, datë 09.07.2024:** 1. A. S. (Kryetar) 2. X. B. (Anëtar) 3. E. H. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur"		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 82,035,740 lekë	**6. Oferta fituese** OE "M." ShPK, me vlerë 80,452,800 lekë pa TVSh	**7. Diferenca me fondin limit** 1,582,940 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 20.09.2024	**9. Burimi Financimit:** Nga buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomik** a) OE "S." ShPK b) BO "C." ShPK c) OE "M." ShPK
11. Ankimime AK, Ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK, Ka**	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka**
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës nr.	**15. Vlera e kontratës (me TVSh)**	**96,543,360 lekë**

4631 prot., datë 23.10.2024		

Referuar VKM nr. 307, datë 22.05.2024, "Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2024 nga Fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", Bashkisë Gramsh i janë akorduar 98,442,888 lekë me TVSh për projektin "Ndërtimi i pritave në bregun e Lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore". Me urdhrin e prokurimit nr. 245, datë 08.07.2024 të titullarit, është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga E. S., O. Ç. dhe M. A., për kryerjen e procedurës të llojit "e hapur", me objekt "Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore", me fond limit 82,035,740 lekë pa TVSh, e ndarë në 28,712,509 lekë pa TVSh për vitin 2024 dhe 53,323,231 lekë pa TVSh për vitin 2025. Projekti dhe preventivi i punimeve janë hartuar më herët nga Drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit O. Ç. dhe Ing. A. Ç.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe DT

Me procesverbal nr. 2897/1, datë 10.07.2024 janë hartuar specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit. Nga auditimi rezulton se procesverbali nuk është nënshkruar nga të tre anëtarët e NjP por vetëm nga O. Ç. dhe M. A., si dhe miratuar nga zyrtari i autorizuar i AK, T. B., në kundërshtim me nenin 74 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Në vijim janë hartuar edhe dokumentet standarde të tenderit, po nga këta dy anëtar.

Nga auditimi u konstatua se, në pikën 2.2.1, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, njësia e prokurimit ka kërkuar një vlerë për xhiron vjetore gjatë tre viteve 2021, 2022 dhe 2023, *jo më e vogël se vlera e fondit limit të objektit që prokurohet.* Kriteri i mësipërm kufizon pjesëmarrjen pasi është në kundërshtim me pikën 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku përcaktohet se *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomik nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.*

Po kështu, u konstatua se në pikën 2.3.1 mbi vlerën e punimeve të ngjashme, njësia e prokurimit ka kërkuar

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës të fondit limit të objektit që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
   ose
b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet

Në të dy rastet, kriteri bie në kundërshtim me pikën 5 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku përcaktohet se

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë *jo më të madhe* se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është *jo më e madhe* se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Gjithashtu u konstatua se në këtë mënyrë, kjo çështje është e përsëritur për të gjithë Procedurat e

Prokurimit të audituara nga Grupi i Auditimit.

Nga auditimi u konstatua gjithashtu se, në pikën 2.16 të DST, njësia e prokurimit është shprehur se drejtuesit teknik sipas pikës 2.3.3 të kritereve të veçanta të kualifikimit, Inxhinierët sipas përshkrimit të pikës 2.3.3/1 dhe punonjësit e specializuar sipas përshkrimit të pikës 2.3.4, duhet të zotërohen nga vetë operatori dhe nuk lejohet që ky i fundit të mbështetet në kapacitete të subjekteve të tjera, ndërkohë që në pikën 2.3.3/1, njësia e prokurimit shprehet se nëse operatori ekonomik ofertues nuk disponon një Inxhinier Mjedisi, mund të paraqesë një kontratë me persona apo subjekte të cilët kryejnë shërbime të specializuara në fushën e kërkuar, jashtë ndërmarrjes. Ky përcaktim është bërë vetëm për inxhinierin e mjedisit në kundërshtim me përcaktimin në pikën 2.16.

Nga auditimi u konstatua se, njësia e prokurimit ka kërkuar që operatori ekonomik të disponojë, 1 punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatë "*Ekspert Zjarrfikës*" në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, 1 mjek të përgjithshëm, si dhe 1 punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatë "*Koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*. Për këtë të fundit është kërkuar edhe disponimi i certifikimit përkatës ISO 45001-2018 ose ekuivalente. Të gjitha kërkesat e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pasi asnjë nga pozicionet e mësipërme nuk lidhen ngushtë me objektin e prokurimit dhe as me ndonjë prej zërave të preventivit, duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve. Këto pozicione, referuar kuadrit ligjor përkatës, janë objekt inspektimesh nga autoritetet përkatëse, nëse kërkohet, por nuk kanë asnjë ndikim në përmbushjen me cilësi të objektit të prokurimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit i përbërë nga z. O. Ç. dhe z. M. A.

Në pikën 2.3.4 është kërkuar që operatori të disponojë punonjës të specializuar si vijon:

- Teknik Ndërtimi 1
- Teknik Gjeolog 1
- Teknik Gjeodet/Topograf 1
- Teknik Hidroteknik 1
- Murator 9
- Karpentier 9
- Hekurkthyes 3
- Hidroizolues 1
- Punonjës Guri/Gurë punues 10

Si dhe mjetet:

- Manovrator/eskavatoriste 4
- Automakinist 3
- Shofer kamioni 8

Për numrin e mësipërm të punonjësve dhe mjeteve nuk është argumentuar apo analizuar nevoja sipas afatit, zërave të punimeve, etj., në kundërshtim me pikën 2/c të nenit 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Po kështu, rezulton se për teknikun e ndërtimit, teknikun hidroteknik, teknikun gjeodet dhe teknikun gjeolog duhet të paraqitet dhe dëftesë e shkollës së mesme, kërkesë kjo në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pasi aftësitë profesionale

provohen nga certifikimet përkatëse dhe dëftesa e shkollës së mesme nuk është tregues për aftësitë profesionale specifike të kërkuara.
Pas shpalljes së njoftimit të kontratës, me procesverbal nr. 3031, datë 15.07.2024, njësia e prokurimit ka rishikuar kriteret e kualifikimit, ku shprehet se me iniciativën e vet dhe pa argumentim, ka vendosur të bëjë ndryshimet si vijon:

- Nga stafi mbështetës është hequr inxhinieri gjeolog
- Nga punonjësit e specializuar janë hequr tekniku gjeolog dhe hidroizoluesi
- Nga makineritë dhe pajisjet janë hequr 2 prej kamionëve vetëshkarkues dhe 2 Rulet ngjeshës
- Afati i pranimit të ofertave datë 29.07.2024.

Për kriteret e mësipërme, në Bashkinë Gramsh ka mbërritur dhe ankesa datë 16.07.2024 nga operatori "B" ShPK, i cili paraqet argumente për kundërshtimin e kritereve si vijon:

- Disponimi i drejtuesit teknik Ing. Ndërtimi me profil gjeoteknik
- Numri i punonjësve dhe makinerive të kërkuara
- Disponimi i profilit murator
- Disponimi i teknikëve krahas Inxhinierëve

Me urdhër nr. 254, datë 17.07.2024 të titullarit, është ngritur komisioni për shqyrtimin e ankesës, i cili me procesverbal nr. 3062/2, datë 22.07.2024 ka parashtruar të gjitha argumentet për kundërshtimin e ankesës së operatorit ekonomik.
Për këtë ankesë është shprehur edhe KPP, i cili me Vendim nr. 1044/2024, datë 13.08.2024 ka pranuar pjesërisht ankesën e operatorit dhe ka urdhëruar modifikimin e disa prej kritereve nga AK Bashkia Gramsh. Në zbatim të vendimit të KPP, me shkresë nr. 3800/1, datë 04.09.2024 është hartuar edhe shtojca për modifikimin e kritereve.

Vlerësimi i ofertave
Me urdhër të titullarit nr. 248, datë 09.07.2024 është ngritur Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga A. S., X.B. dhe E.H. Me procesverbal nr. 1, datë 20.09.2024 KVO ka pasqyruar situatën në momentin e hapjes së ofertave, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 3 ofertues. Me procesverbal nr. 2, datë 01.10.2024 është bërë dhe vlerësimi i ofertuesve, nga ku rezulton se:

- Operatori ekonomik S. skualifikohet pasi ka paraqitur vetëm formularin e ofertës, listën e çmimeve të shërbimeve dhe vërtetim për taksat vendore;
- Operatori ekonomik C. skualifikohet pasi nuk ka dorëzuar dokumentacion për punët e ngjashme, nuk ka dorëzuar formularin e ofertës, nuk ka dorëzuar formularin e vetë deklarimit dhe as licencat.

Nga auditimi u konstatua se, në SPE, OE "M." ShPK i shpallur fitues, nuk plotëson kriteret:

1. Kriteri 2.3.3 operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë 1 inxhinier Topograf, mungon dokumentacioni për këtë pozicion;
2. Kriteri 2.3.4 operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar për kryerjen e punimeve:

- Murator – 9 (nëntë) punonjës, sipas formularit E-Sig, për 4 punonjës janë me kodin e profesionit 2165.12, 3119.15, 9622.01 dhe 3333.05 dhe jo kodit që i përket muratorit (9312);
- Karpentier – 9 (nëntë) punonjës, sipas formularit E-Sig, të 9 punonjësit e kanë Kodin gabim dhe jo 7115 që i përket këtij profesioni;
- Hekurthyes – 3 (tre) punonjës, sipas formularit E-Sig, për 2 punonjës janë me kodin e profesionit 9622.01 dhe 8322.01 dhe jo kodit që i përket hekurthyesit (7114);

- Punonjës guri/gurëprerës – 10 (dhjetë) punonjës, sipas formularit E-Sig, të 10 punonjësit e kanë Kodin gabim dhe jo 7111-7113 që i përket këtij profesioni.

Sa më sipër, nuk janë marrë masat e nevojshme nga KVO për të verifikuar përputhshmërinë e mjeteve të dorëzuara me vetë deklarimet e bëra në kundërshtim me nenin 26, pika 6 dhe 7 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për "Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".
Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t´i kërkoj operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertës i përbërë nga z. A.S. (Kryetar), z. X.B. (Anëtar) dhe z. E.H. (Anëtar).

3. Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion asfaltim rruga e fshatit Mashan", Bashkia Gramsh", viti 2024

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion asfaltim rruga e fshatit Mashan", viti 2024</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 208 datë 14.06.2024</td><td rowspan="2">2. Njësia e Prokurimit:
1. E. S.
2. O. Ç.
3. M.A.</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 209, datë 14.06.2024:
1. A. S. (Kryetar)
2. X.B. (Anëtar)
3. E.H. (Anëtar)</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)
81,663,419 lekë</td><td>6. Oferta fituese
BOE "T." ShPK & "S." ShPK, me vlerë 79,164,260 lekë pa TVSh</td><td>7. Diferenca me fondin limit
2,499,159 lekë</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së ofertave:
06.08.2024</td><td>9. Burimi Financimit: Nga buxheti i Shtetit (Bashkia Gramsh)</td><td>10. Operatorët Ekonomik
a) OE "M" ShPK
b) BOE "A" ShPK & "U" ShPK
c) OE "V" ShPK
d) BOE "T" ShPK & "S" ShPK</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime AK,
Nuk ka</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK,
Nuk ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,
Nuk ka</td></tr>
<tr><td colspan="3">b. Kontrata</td></tr>
<tr><td>14. Lidhja e kontratës nr. 4512 prot., datë 15.10.2024</td><td>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</td><td>94,997,112 lekë</td></tr>
</table>

Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të Territorit (DPZhT) në Bashkinë Gramsh me shkresën nr. 1711/1 Prot., datë 23.04.2024, ka paraqitur kërkesë Njësisë së Prokurimit për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksion i rrugës së fshatit Mashan Nj.A. Kodovjat, Bashkia Gramsh". Bashkëlidhur kërkesës DPZhT ka dorëzuar edhe dokumentacionin si vijon:
- Preventivi i punimeve;
- Grafiku i punimeve;
- Relacionin teknik;
- Specifikimet teknike;
- Projekti teknik.

Hartimi i fondit limit

Preventivi i punimeve për investimin me objekt "***Rikonstruksion i rrugës së fshatit Mashan Nj.A. Kodovjat, Bashkia Gramsh"*** është hartuar nga z. A. C. dhe përbëhet nga 7 zëra punimesh me vlerë totale 81,663,419 lekë pa TVSh. Oponenca teknike është dërguar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkesë nr. 650/2, datë 25.06.2024, "Për kryerjen e oponencës teknike të projektit të zbatimit me objekt *"Rikonstruksion asfaltim rruga e fshatit Mashan, Njësia Administrative Kodovjat", Bashkia Gramsh"*", me kërkesë nga Bashkia Gramsh nr. 1777 prot., datë 07.05.2024. Me shkresë nr. 3204 prot., datë 26.07.2024 Bashkia Gramsh ka kthyer përgjigje kërkesës për sqarim datë 22.07.2024 ndaj OE "H" ShPK, lidhur me vendosjen e kriterit për një Ing. Gjeoteknik, Kamionëve me tonazh (10-12, 1.5-2 dhe 3.5-5) nga 2 copë, Autobetoniere me kapacitet 2.5-3 m3 dhe 2 autobot uji, si dhe licencat NP – 12 B dhe NS – C, me shkresë nr. 3204 prot., datë 26.07.2024.

Nga auditimi i hartimit të fondit limit sipas zërave të punimeve rezulton se, çmimet e zërave të punimeve janë në përputhje me manualin e ri të sistemit online E-Albania.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe DT

Janë hartuar kriteret e veçanta për kualifikimin për procedurën e prokurimit me objekt *"*Rikonstruksion i rrugës së fshatit Mashan Nj.A. Kodovjat, Bashkia Gramsh*",* me Procesverbalin nr. 2898/1 prot., datë 10.07.2024, nga Nj.P përkatësisht anëtarët O.Ç. dhe M.A. për kriteret e veçanta për kualifikimin për procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i rrugës së fshatit Mashan Nj.A. Kodovjat, Bashkia Gramsh*"*. Gjatë hartimit të kritereve për kapacitetin teknik është dhënë edhe argumentimi teknik lidhur me kategoritë e punimeve të përcaktuara sipas zërave të preventivit.

Për zhvillimin e procedurës Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 208, datë 14.06.2024 ku ka ngarkuar NJP me përbërje zj. E.S., z. O.Ç. dhe z. M.A., për të vijuar me procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i rrugës së fshatit Mashan Nj.A. Kodovjat, Bashkia Gramsh" me vlerë të fondit limit 81,663,419 lekë pa TVSh. Me shkresë nr. 3086 prot., datë 19.07.2024 është bërë njoftim për ndryshimin e dokumenteve të tenderit.

Nga auditimi u konstatua se: kriteret e vendosura për kualifikim, u konstatuan kritere të paargumentuara duke iu referuar përshkrimit të punimeve të bëra në preventiv si vijon:

1. Nuk është argumentuar kriteri i DST-së 2.3.3/1 ku kërkohet që "*Operatori ekonomik duhet të disponojë 1(një) mjek të përgjithshëm*";
2. Nuk është argumentuar numri i punonjësve të përcaktuar në pikën të DT, 2.3.6, *"Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim jo me pak se 70 (shtatëdhjetë) punonjësish në fushën e ndërtimit, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimum, 3(tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave e vërtetuar me:*

   a.Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar;

   b.Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar";
3. Nuk është argumentuar kërkesa për makineritë të përcaktuar në pikën 2.3.8 të DT, për:
   - Kamionët vetëshkarkues me kapacitete mbajtës 10-12 t – 2 copë, Kamionët vetëshkarkues me kapacitete mbajtës jo më të vogël se 20 t – 5 copë, Kamion me kapacitet mbajtës deri në 1.5-2t – 2 copë dhe Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5-5t – 2 copë, pasi sasia e kërkuar e punimeve është më shumë se volumet në preventivin e punimeve referuar grafikut të punimeve;
   - RTV – Transportier për mjete të rënda – 2 copë;

- Agregat për prerje bimësh – 1 copë;
- Autobetoniere – 2 copë;
- Betoniere kantieri – 1 copë.

4. Nuk është argumentuar pika 2.4.2 e DST-së kërkesa që Operatori ekonomik në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës të publikuar në DST, për materialet Beton dhe Inerte duhet të paraqesë - Autorizim të prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave...

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit i përbërë nga z. O.C. dhe z. M.A.

Vlerësimi i ofertave

Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 209, datë 14.06.2024, ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. A.S. (Kryetar), z. X.B. (Anëtar) dhe z. E.H. (Anëtar).
KVO ka mbajtur proces verbalin nr. 1, datë 06.08.2024 për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksion i rrugës së fshatit Mashan Nj.A. Kodovjat, Bashkia Gramsh". U konstatua se për këtë procedurë kanë aplikuar 4 operatorë ekonomik, si më poshtë:

1. OE "M." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 80,671,565 lekë pa TVSh;
2. BOE "A" ShPK dhe "U." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 64,006,326 lekë pa TVSh;
3. OE "V." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 72,659,039 lekë pa TVSh;
4. BOE "T." ShPK dhe "S." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 79,164,260 lekë pa TVSh.

KVO me procesverbal nr. 2, datë 21.08.2024 "Për kualifikimin dhe renditjen përfundimtare të operatorëve ekonomi në tenderin" me objekt "Rikonstruksion i rrugës së fshatit Mashan Nj.A. Kodovjat, Bashkia Gramsh" dhe Vendimin nr. 51, datë 12.09.2024 për shpalljen e fituesit.

Nga auditimi në SPE dhe në dosjen e prokurimit janë skualifikuar, 3 Operatorë Ekonomik:

1. OE "M." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 80,671,565 lekë pa TVSh;
2. BOE "A" ShPK dhe "U." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 64,006,326 lekë pa TVSh;
3. OE "V." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 72,659,039 lekë pa TVSh.

Skualifikuar me të drejtë nga KVO.

Raporti përmbledhës me nr. 3953 Prot., është hartuar nga KVO më datë 12.09.2024. Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave KVO-ja ka vendosur që OE që plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit është BOE **"T." ShPK & "S." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 79,164,260 lekë pa TVSh.**
Pas njoftimit paraprak të fituesit është publikuar në buletinin e APP-së nr. 58 datë 09.09.2024, u hartua Formulari përfundimtar i njoftimit të fituesit nr. 3954/1 Prot., është hartuar më datë 12.09.2024 duke plotësuar dhe afatin e ankimimeve.
Nuk ka patur ankesa nga OE pjesëmarrës.
Titullari i Autoritetit Kontraktor ka lidhur kontrata me nr. 1158 prot., datë 15.10.2024 me vlerë 79,164,260 lekë pa TVSh dhe 94,997,122 lekë me TVSh me afat 7 muaj. Me Urdhër nr. 407, datë 25.11.2024 për ndryshimin e Urdhërit nr. 360, datë 15.10.2024 "Për caktimin e strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës nr. 4122 prot., datë 15.10.2024 me objekt "Rikonstruksion i rrugës së fshatit Mashan Nj.A. Kodovjat, Bashkia Gramsh"".

Nga auditimi u konstatua se, në SPE, BOE "T." ShPK & "S." ShPK i shpallur fitues, nuk plotëson kriteret:

1. Kriteri 2.3.4 ku kërkohet stafi mbështetës të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, për 1 – manovrator/eskavatorist nuk janë paraqitur sipas shtojcës 8, që kërkohen 4 punonjës gjithsej, (OE "S." ShPK ka paraqitur 1 punonjës dhe OE "T." ShPK ka paraqitur z F. S. dhe z. F. A. si manovratorë).
2. Kriteri 2.3.8 ku kërkohet të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST për mjetet dhe pajisjet, BOE nuk ka paraqitur për mjetet ose pajisje sipas shtojcës 8 për asfaltshtruesen.
3. Kriteri 2.3.2 kërkohet që OE fitues të paraqes licencën profesionale të shoqërisë NS-18 C, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt i lotit që prokurohet, OE "T." ShPK nuk e plotëson kriterin pasi ka NS-18 B;
4. Kriteri 2.3.3 ku kërkohet për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, BOE fitues nuk ka paraqitur dokumentacion për 1 inxhinier Gjeodet;
5. Kriteri 2.3.4 ku kërkohet stafi mbështetës, BOE fitues nuk ka paraqitur dokumentacion për:
   - Nga 5 karpentier që kërkohen nuk është paraqitur dokumentacion për 1;
   - Nuk janë paraqitur dokumente për 1 hidroizolues;
   - Elektricist – 3 punonjës, sipas formularit E-Sig, 1 punonjës e ka Kodin 3112.09 dhe jo 7411 që i përket këtij profesioni;
   - Hidraulik – 2 punonjës, sipas formularit E-Sig, 1 punonjës e ka kodin 2611.03 dhe jo 7126 që i përket këtij profesioni;
   - Automakinist – 4 punonjës, sipas formularit E-Sig, 1 punonjës e ka Kodin 7115.02 dhe jo 8332 që i përket këtij profesioni.
6. Kriteri 2.3.11, për mjetet dhe pajisjet mungon dokumentacioni si mëposhtë:
   - Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më të vogël se 20 ton për 1 copë;
   - Autovinç me kosh për 1 copë;
   - Dumper (mjet teknologjik me goma) për 1 copë mungon dokumentacioni;
   - Për mjetin autobitumatriçe me targa ... tek certifikata për transport ndërkombëtarë mallrash për llogari të vet, është për përdorim vetjak, në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportin rrugor" i ndryshuar, si dhe pika 3 e nenit 6 të Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimit e veprimtarisë në transportin rrugor";
   - Autovinç për 1 copë, mungon dokumentacioni;
   - Autobetoniere me kapacitet 2.5-m m3 për 1 copë, mungon dokumentacioni;
   - Autobot uji, për 2 copë mungon dokumentacioni.

Sa më sipër, nuk janë marrë masat e nevojshme nga KVO për të verifikuar përputhshmërinë e mjeteve të dorëzuara me vetë deklarimet e bëra në kundërshtim me nenin 26, pika 6 dhe 7 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për "Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t´i kërkoj operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertës i përbërë nga z. A. S. (Kryetar), z. X. B. (Anëtar) dhe z. E. H. (Anëtar).

Nga auditimi u konstatua gjithashtu se, për periudhën objekt auditimi veç problematikave të sqaruara specifikisht për çdo procedurë prokurimi, rezultoi se Urdhër Prokurimet nuk janë hartuar sipas kërkesave ligjore lidhur me specifikimet e shënuara për anëtarët e Njësisë së Prokurimit, duke përcaktuar persona përgjegjës për çështje të ndryshme gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, në kundërshtim me nenin 74, pika 2, 3 dhe 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, Kryetari i Bashkisë z. B. A. dhe z. E. S.

Procedurat e Prokurimeve me "Vlerë të vogël", 2023-2024
Nga auditimi për blerjet e realizuara me procedurë "*Vlerë e vogël*", për secilin urdhër prokurimi dhe urdhër shpenzim në periudhën raportuese ushtrimore (nga data 01 janar 2023 deri 31 dhjetor 2024), periudhë objekt auditimi në lidhje me dokumentacioni autorizues dhe vërtetues bashkëlidhur procedurës së prokurimit e urdhër shpenzimit në mënyrë kronologjike u konstatua sa më poshtë:

Për vitin 2023
Është ngritur Komisioni për blerjet e vogla me urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me nr. 21, datë 26.01.2023 me përbërje si vijon:

1. Z. A. S. – Kryetar;
2. Zj. E. Ç.– Anëtar;
3. Z. J. M. – Anëtar.

Ndryshuar me Komisioni për blerjet e vogla me urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me nr. 124, datë 22.06.2023 me përbërje si vijon:

1. Z. X. B. – Kryetar;
2. Z. F. B. – Anëtar;
3. Z. J. M. – Anëtar.

1. Me ***urdhër prokurimi nr. 25, datë 10.07.2023*** me objekt "Ushqimi për konviktin, kopshtin dhe çerdhe", me preventivin e llogaritjes së fondit limit nr. 2504 prot., datë 07.07.2023, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 980,425 lekë. Kontrata e Shërbimit me objekt "Blerje mallra ushqimor për plotësimin e nevojave të çerdheve, kopshteve e konviktit të shkollës së mesme" nr. 2712 prot., datë 18.07.2023, ftesa për ofertë me datë 11.07.2023, proces verbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim datë 10.07.2023 dhe proces verbali i njoftimit të fituesit datë 13.07.2023.
Me Urdhër nr. 167, datë 19.07.2023 është ngritur komisioni për mbikëqyrjen dhe monitorimin e Kontratës më lart.
Me Urdhër Shpenzimin nr. 865, datë 20.12.2023 është likuiduar subjekti "4" ShPK për vlerën 466,288 lekë, bashkëlidhur fatura nr. 388, datë 07.09.2023 dhe fletë hyrje nr. 24, datë 07.09.2023.
Me Urdhër Shpenzimin nr. 866, datë 20.12.2023 është likuiduar subjekti "4" ShPK për vlerën 12,512 lekë, bashkëlidhur fatura nr. 380, datë 11.09.2023 dhe fletë hyrje nr. 25, datë 11.09.2023.
Me Urdhër Shpenzimin nr. 867, datë 20.12.2023 është likuiduar subjekti "4" ShPK për vlerën

370,836 lekë, bashkëlidhur fatura nr. 490, datë 03.10.2023 dhe fletë hyrje nr. 26, datë 03.10.2023. Me Urdhër Shpenzimin nr. 868, datë 20.12.2023 është likuiduar subjekti "4" ShPK për vlerën 91,680 lekë, bashkëlidhur fatura nr. 724, datë 17.11.2023 dhe fletë hyrje nr. 29, datë 17.11.2023. Nga auditimi u konstatua se nuk është hartuar procesverbali i marrjes në dorëzim veprimet në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe Urdhër nr. 167, datë 19.07.2023 është ngritur komisioni për mbikëqyrjen dhe monitorimin e Kontratës pika II.4. Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.

2. Me ***urdhër prokurimi nr. 8, datë 16.03.2023*** me objekt "Policë sigurimesh për automjete", bashkëlidhur, fatura nr. 37239, datë 24.03.2023, ftesa për ofertë me datë zhvillimi 16.03.2023 dhe njoftimi i fituesit datë 23.03.2023. Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 255, datë 18.04.2023 është likuiduar subjekti "A" ShA për vlerën 998,000 lekë.
Nga auditimi u konstatua se nuk është hartuar procesverbali i marrjes në dorëzim veprimet në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.
Gjithashtu, u konstatua se nuk është hartuar procesverbali i llogaritjes së fondit limit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", neni 34 dhe 35, si dhe mos miratimi i specifikimeve teknike në kundërshtim me Ligjin nr. 162, "Për prokurimin publik", datë 23.12.2020, neni 36.

3. Me ***urdhër prokurimi nr. 28, datë 07.08.2023*** me objekt "Shërbimeve të organizimit të eventeve kulturore për festën e 18 Gushtit", me ftesën për ofertë datë 07.08.2023, si dhe është lidhur kontrata nr. 3173 prot., datë 17.08.2023, bashkëlidhur procesverbali pa numër 21.08.2023, për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës. Bashkëlidhur, fatura nr. 22, datë 01.12.2023, njoftimit të fituesit datë 10.08.2023. Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 298, datë 24.04.2024 është likuiduar subjekti "Indrit Mjeda" për vlerën 1,000,000 lekë. Nga auditimi u konstatua kalimi i afatit të pagesës, nga data e lëshimit të faturës së furnitorit, në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7.
Nga auditimi u konstatua se nuk është hartuar procesverbali i marrjes në dorëzim veprimet në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe Urdhër nr. 167, datë 19.07.2023 është ngritur komisioni për mbikëqyrjen dhe monitorimin e Kontratës pika II.4. Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.
Gjithashtu, u konstatua se nuk është hartuar procesverbali i llogaritjes së fondit limit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", neni 34 dhe 35, si dhe mos miratimi i specifikimeve teknike në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", neni 36.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, ish-Kryetari i Bashkisë z. K. T. dhe Kryetari i Bashkisë z. B. A.

Për vitin 2024
Është ngritur Komisioni për blerjet e vogla me urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me nr. 11, datë 11.01.2024 me përbërje si vijon:

1. Z. X. B. – Kryetar;
2. Z. F. B. – Anëtar;
3. Z. J. M. – Anëtar.

1. Me shkresë nr. 5037 prot., datë 28.10.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt "Blerje Peme Krishtlindjesh", me ***urdhër prokurimi nr. 39, datë 01.11.2024*** me objekt "Blerje peme dekorative për festat e fund vitit", me preventivin e llogaritjes së fondit limit pa numër dhe datë, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 900,000 lekë pa TVSh, si dhe ftesën për ofertë datë 11.11.2024. Me Urdhër nr. 402, datë 19.11.2024 "Krijimin e komisionit të marrjes në dorëzim për blerjen e materialeve "Blerje peme dekorative për festat e fund vitit"", proces verbalin e marrjes në dorëzim nr. 5505 prot., datë 04.12.2024 dhe proces verbalin për miratimin e specifikimeve teknike, datë 31.10.2024. Bashkëlidhur, fatura nr. 98, datë 03.12.2024, njoftimit të fituesit datë 13.11.2024. Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 927, datë 06.12.2024 është likuiduar subjekti "K. N." për vlerën 1,020,000 lekë dhe fletë hyrje nr. 75, datë 03.12.2024.

2. Me ***urdhër prokurimi nr. 1, datë 14.02.2024*** me objekt "Pyllëzimi në objektin "Këmbët e Roshit"", bashkëlidhur, fatura nr. 36, datë 04.04.2024, ftesa për ofertë me datë zhvillimi 19.02.204 dhe njoftimi i fituesit datë 07.03.2024, situacioni i punimeve hartuar pa numër me datë 04.04.2024. Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 306, datë 29.04.2023 është likuiduar subjekti "K." ShPK për vlerën 1,149,600 lekë. Me kontratë nr. 1206 prot., datë 13.03.2024 "Për pyllëzimin me fidanë të llojit Akacie me objekt "Pyllëzimi në objektin "Këmbët e Roshit"""".
Nga auditimi u konstatua se është hartuar procesverbali i marrjes në dorëzim me datë 03.04.2024. Është hartuar procesverbali i llogaritjes së fondit limit në Shkurt 2024.

3. Me ***urdhër prokurimi nr. 03, datë 23.02.2024*** me objekt "Polica Sigurimesh", Bashkëlidhur, fatura nr. 388, datë 08.03.2024, , ftesa për ofertë me datë zhvillimi 29.02.2024, dhe proces verbali i njoftimit të fituesit datë 01.03.2024.
Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 392, datë 28.05.2024 është likuiduar subjekti "I." për vlerën 899,076 lekë. Nga auditimi u konstatua se nuk është hartuar procesverbali i marrjes në dorëzim veprimet në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.
Është hartuar procesverbali i llogaritjes së fondit limit nr. 1, datë 16.02.2024.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, Kryetari i Bashkisë z. B.A.

Nga auditimi u konstatua gjithashtu se, për periudhën objekt auditimi veç problematikave të sqaruara specifikisht për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël për vitin 2023 dhe 2024 u konstatua se nga AK nuk janë hartuar kërkesë paraprake për fillimin e procedurës së prokurimit, veprime në kundërshtim me nenin 2 pika 2 germa "a" dhe nenin 13 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, ish-Kryetari i Bashkisë z. K. T. dhe Kryetari i Bashkisë z. B. A.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Gramsh është paraqitur observacioni me shkresën nr. 2739/2 prot., datë 01.10.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 405/11 prot., datë 03.10.2025, nga z. A. S., z. X.B. dhe z. E.H. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1.Për procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i gjimnazit "Shefqet Guzi"":

a) Për OE "I.", sipas Ekstraktit Historik rezulton se ka detyrime tatimore të papaguara ndaj Bashkisë Vlorë, sqarojmë se një dokument i lëshuar nga administrata e Qeverisjes Vendore që vërteton se subjekti i ka detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022 dhe për këstet e maturuara të vitit 2023 referuar Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vjetore", i ndryshuar si dhe VKB ku subjekti ushtron aktivitet sipas QKR. Gjithashtu rezulton se subjekti nuk ka ushtruar aktivitet përgjatë viteve 2022-2033 e në vazhdim në territorin e administratës së Bashkisë Vlorë, konstatimi juaj nuk qëndron;
b) Për konstatimin e mosparaqitja së dokumenteve për një inxhinier ndërtimi dhe elektrik, sqarojmë se janë dorëzuar për dy inxhinier ndërtimi z. F. M.dhe z. P. P., të cilët figurojnë dhe si drejtues teknik në licencën e shoqërisë dhe për një inxhinier elektrik z. A. R. i cili ka përfunduar fakultetin e inxhinierisë elektrike;
c) Për konstatimin që subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion për një punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë" dhe një të pajisur me certifikatë "Ekspert zjarrfikës", bashkëlidhur dokumentacioni;
d) Për mangësinë e makinerive sqarojmë se nuk qëndrojnë pasi për kamionin vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 20 ton- 2 copë, janë paraqitur dokumentet bashkëlidhur për mjetet me targa ... dhe ...; për dy kamionçine janë dokumentet bashkëlidhur për mjetet me targa ... dhe ...; për kamionin me vinç dy copë janë dokumentet bashkëlidhur për mjetet me targa ... dhe ....; për minifadromën një copë janë dokumentet bashkëlidhur për mjetin tip Bobcat; për pompë uji një copë është dorëzuar fatura nr. 908/2022 dhe foto; për rul vibrues dy copë janë dokumentet bashkëlidhur për mjetet tip ... dhe marka S; për pajisje niveluese për nivelim shtresash një copë është dorëzuar fatura nr. 830, datë 11.06.2018 dhe foto; për mjetin elektrosaldatriçe një copë është dorëzuar fatura nr. 1424, datë 20.06.2017, si dhe për konstatimin se certifikata e transportit është në llogari të vet dhe jo të të tretëve sqarojmë se është kërkuar që mjetet në pronësi dhe ato me qira të kenë certifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit ...dhe certifikatën e transportit pa e specifikuar nëse duhet për llogari të vet apo për të tretë;

2. Për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje mallra ushqimore për plotësimin e nevojave të çerdheve, kopshteve dhe konviktit të shkollës së mesme", në periudhën e zhvillimit të procedurës KVO është mbledhur dy herë pasi procesi është zhvilluar sipas dokumenteve përkatëse lidhur me ankesat dhe sugjerimet nga KPP-ja dhe KVO ka zbatuar më pas vendimin e KPP-së;
3. Për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje dru zjarri dhe pelet për institucionet arsimore për vitin 2023-2024 si dhe Njësitë Administrative", konstatimi që mungon foto për motosharrën nuk qëndron, bashkëlidhur foto; lidhur me kamionët dhe kamionçinat që konstatoni që në certifikatën e transportit janë për llogari të vet, në DST nuk është specifikuar ndryshe; për kamionët me kapacitet 15 ton dokumentet bashkëlidhur me targa ... dhe ...; për mungesën e dokumentacionit për kamioni me vinç kundërshtojmë konstatimin dhe bashkëlidhur dokumentacioni për mjetin me targa ...;
4. Për procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i Shkollës 9-vjeçare "Rilindja"", kundërshtojmë konstatimin lidhur me gabimin aritmetik, sqarojmë se pas kërkesës për korrigjim BOE nuk ka pranuar korrigjimin pasi nuk ka kthyer përgjigje bazuar në Ligjin nr. 92/2 i LPP dhe VKM 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 82, pika 3;

   Për OE fitues lidhur me certifikatën e marrjes në dorëzim të objektit, në legjislacionin e prokurimeve nuk parashikohet kërkesa për certifikatë/akt marrje në dorëzim, si dhe kriteri i vendosur ka qenë në tejkalim të kërkesave ligjore të përcaktuara për fushën e ndërtimit;

Lidhur me mungesën e drejtuesit teknik sqarojmë se OE fitues ka dorëzuar deklaratë për z. F. M.;

Në rastet kur për disa specialistë nuk përputhen kodet e profesionit në formularin E-Sig sqarojmë se OE ka dorëzuar të gjithë dokumentet sipas kërkesave dhe kritereve, veç të tjerave KVO nuk është organ kontrolli, investigimi apo hetimi por një strukturë e ngarkuar me detyra të posaçme të parashikuara në LPP;

Për konstatimin se disa mjete kanë certifikatë transporti për llogari të vet kjo nuk është kërkuar në DST;

Për mungesën e taksave vjetore të mjetit me targa ..., sqarojmë se nuk është kërkuar në DST dhe siguracioni është i vlefshëm në datë e hapjes së ofertave, si dhe për mjetet me kapacitet 10-15 ton janë paraqitur kamionët me targa ... dhe ...;

5. Konstatimi se nuk janë dorëzuar dokumente për kamionçinë 1 ton, sqarojmë se është paraqitur mjeti me targa ... me kapacitet 970 kg;

   Për konstatimin që mungojnë 2 kamion me vinç, nga OE janë paraqitur dokumentet për mjetet ... dhe ...,

   Konstatimi se mungon dokumentacioni për fadromë me kova para dhe mbrapa dhe autobot uji janë paraqitur mjetet me targa ... dhe ...;

   Për mjetet matrapik OE ka dorëzuar faturën nr. 1061, datë 01.11.2016 dhe foto
6. Konstatimi se certifikata ISO 3834-2:2021 nuk është e vlefshme nuk qëndron pasi dita e vlerësimit të ofertës është 08.08.2024 ndërsa dokumenti është i vlefshëm deri më datë 24.08.2024, ndërsa dorëzimi i dokumentacionit në AK është bërë në datë 12.09.2024;
7. Për procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore, Bashkia Gramsh", konstatimi se mungon dokumentacioni për një topograf, sqarojmë se është lidhur kontratë me z. D. M. dhe se të dy profesionet si inxhinier topograf dhe gjeodez janë shumë të ngjashme dhe se të dy profesionet kanë qëllim të përbashkët;

   Në rastet kur për disa specialistë nuk përputhen kodet e profesionit në formularin E-Sig sqarojmë se OE ka dorëzuar të gjithë dokumentet sipas kërkesave dhe kritereve, veç të tjerave KVO nuk është organ kontrolli, investigimi apo hetimi por një strukturë e ngarkuar me detyra të posaçme të parashikuara në LPP;
8. Për procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i rrugës Fshat Mashan, Njësia Administrative Kodovjat, Bashkia Gramsh", konstatimi se janë dorëzuar dokumentet për tre manovratorë dhe jo për katër, bashkëlidhur dokumentet për z. J.C., z. F. A., z F. S., z. P. L. dhe A. O.;

   Konstatimi se mungon asfaltshtruesja bashkëlidhur dokumentet

   Për konstatimin që OE ka licencë NS-18B dhe jo NS-18C është bashkëlidhur marrëveshja e dy operatorëve ekonomik për përqindjen e punimeve që marrin pjesë;

   Për mungesën e një inxhinieri gjeodez është paraqitur dokumentacion për zj. Ë. S.;

   Për mungesën e një karpentieri është paraqitur dokumentacion për 6 punonjës;

   Për mungesën e një hidroizoluesi është paraqitur dokumentacioni për punonjësin T. Ç.;
9. Për mungesën e një kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më të vogël se 20 ton, janë dokumentet bashkëlidhur;

   Për mungesën e dy mjeteve me kapacitet 1.5-2 ton, bashkëlidhur dokumentacioni;

   Për mungesën e autovinçit është bashkëlidhur dokumentacioni për mjetin me targa ...;

   Për taksat vjetore të mjetit ... nuk është kërkuar në DST taksa vjetore;

   Për mungesën e mjetit fadromë me goma janë paraqitur dokumentet bashkëlidhur;

   Për mungesën e një dumper mjeti me targa ... me dokumentacionin bashkëlidhur;

   Për mungesën e një autovinç mjeti me targa ..., me dokumentacionin bashkëlidhur;

Për mjetet RTV me targa ..., agregate për prerje bimësh dhe moto pompë uji, dokumentacioni bashkëlidhur.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Observacionet e paraqitura nga Bashkia Gramsh janë të njëjtat që janë dërguar për akt-konstatimet dhe janë trajtuar nga grupi i auditimit në Projekt Raportin e Auditimit duke marrë një pjesë në konsideratë dhe duke bërë ndryshimet e nevojshme në Projekt Raportin e Auditimit.

Observacioni nuk merret në konsideratë.

2.4.4 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues

Në zbatim të pikës 4.4 të Programit të Auditimit në Bashkia Gramsh, zbatimin e kontratave të punimeve në investime publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim të punëve të kryera, sipas kontratave të lidhura me Operatorët ekonomik fitues, u krye auditimi i zbatimit të punimeve në objektet:

1. Rikonstruksioni i Gjimnazit "Shefqet Guzi

A. Të dhëna mbi objektin

<table>
<tr><td colspan="5">Zbatimi i Kontratës së Punimeve: Rikonstruksioni i Gjimnazit "Shefqet Guzi".</td></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës
Nr. 4533 prot., datë 14.11.2023</td><td colspan="2">15.Vlera e kontratës (me TVSH)
80,000,078 lekë
OE fitues "I." SHPK</td><td colspan="2">16.Likuiduar
USH nr.693&717 datë 25.09.2024, vlera 5,992,896 lekë</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar
Vlera me TVSH 79,994,847 lekë
Vlera pa TVSH 66,662,373 lekë</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në ditë
Parashikuar 180 ditë, Zbatuar 180 ditë.
Fillimi punimeve: 24.11.2023
Përfundimi punimeve : 22.05.2024</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
OE "A" SHPK</td><td>Licenca Nr:</td><td>Kontrata me nr. 4534 prot., datë 14.11.2023</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
"X" SHPK</td><td>Licenca Nr:</td><td>Kontrata me nr. 5116 prot., datë 29.12.2023</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi
Datë 12.06.2024</td><td colspan="2">23.Certifikata e përfundimit të punimeve datë 19.06.2024</td><td colspan="2"></td></tr>
</table>

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 4533 prot., datë 14.11.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh, të përfaqësuar nga Kryetari z.B. A. dhe Operatorin Ekonomik "I." SHPK, me përfaqësues ligjorë z.F.M.

Vlera e kontratës është 66,666,732 lekë pa TVSH / 80,000,078 lekë me TVSH.

Afati i zbatimit të kësaj kontrate është 180 ditë, nga marrja e lejes së kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.4534 prot., datë 14.11.2023, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE "A", SHPK, vlera e kontratës është 770,137 lekë pa TVSH / 924,164 lekë me TVSH, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh ...

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.5116 prot., datë 29.12.2023, është caktuar për kryerjen e këtij OE "X" SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh respektivisht ...

Akt Kolaudimi është mbajtur më datë 12.06.2024 midis Sipërmarrësit, Mbikëqyrësit të punimeve

dhe kolaudatorit të punimeve.
Me Urdhrin nr.309, datë 17.11.2023, të kryetarit të Bashkisë Gramsh, është caktuar struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës me përbërje z.X. B., z.G. X. dhe z.K.L
Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim me datë 19.06.2024, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, si dhe nga përfaqësuesit e investitorit, Kryetari Bashkisë z.B. A., dhe në cilësinë e Komisionit për marrjes së përkohshme në dorëzim z.X. B., z.G. X. dhe z.L. H.
Projektpreventivi
Për këtë objekt Bashkia Gramsh ka lëshuar lejen infrastrukturore me nr. 4664/3, datë 22.11.2023, me objekt "Rikonstruksioni i Gjimnazit "Shefqet Guzi"", me afat 6 muaj.
- Projekt Preventivi është hartuar nga Bashkia Gramsh, projektues A.Ç., viti 2023.
Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 24.11.2023, dhe kanë përfunduar me datë 22.05.2024, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.
Në dosjen e zbatimit nuk administrohet shkresa e miratimit të projektit të rishikuar.
Tabela e rishikuar e punimeve janë shtuar 8,585,627 lekë dhe pakësuar 8,590,011 lekë, të miratuar nga Mbikëqyrësi i punimeve dhe Sipërmarrësi i punimeve.
Konstatim: Në dosjen e zbatimit mungojnë autorizimet për përdorimin e materialeve si përzierje betonesh (mix design), në kundërshtim me pikën 3, Kreu II të Udhëzimit nr.2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", ku cilësohet: *"...Materialet dhe produktet e ndërtimit me standarde të detyrueshme vendosen në vepër kur janë shoqëruar me certifikatë cilësie, me rezultatet e provave dhe të analizave, që vërtetojnë ose vlerësojnë përputhshmërinë e tyre me standardet, që referohen në përshkrimet dhe specifikimet teknike..."*.
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.
Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **2,396,609 lekë pa TVSH**.

Tabela nr. 1

Nr		Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
								Vol.	Vlera
		Punime sistemimi							
10	2.288	Trotuar me 6 cm beton + pllaka granili me bojë	m2	1,600	33.52	33.52	33.52		
		Zbriten pllakat	m³	528	33.52	33.52	33.52	33.52	17,699
		Punime suvatimi							
3	2.334	Suva e zakonshme	m²	1,000	2,378.91	2,378.91	0	2,378.91	2,378,910

		fasade mur tulle lartësi mbi 8 m							
								Total	**2,396,609**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Punime sistemimi

1. Zëri 10. Trotuar me 6 cm beton + pllaka granili me bojë. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 170 m2, në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 33.52 m2. Nga auditimi në terren rezulton se në trotuarin në anën e djathtë të shkollës, që i përket këtij zëri pune, sipas librezave të masave, nuk ishte vendosur shtresa e pllakave siç specifikohet në zërin e punës dhe në analizën e çmimit respektive, si më poshtë.

Nr.	E M E R T I M I	Njesia	PUNTORI			TRANSPORT			MATERIAL			Shuma	Shp pl	Fitim	TOTALI
Kodi			op	çmimi	Vlefta	T*km	çmimi	Vlefta	Sasia	çmimi	Vlefta		8%	10%	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	13	14	15	16	17	18	19
2.288	Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit	m2													
	Sp + p	op	2.40	185.00	444.00										
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	444.00	0.17	74.15										
	Transport	T*km				3.77	21.00	79.17							
	Zhavor	m3							0.15	450.00	67.50				
	Llaç çimento 1:2	m3							0.02	6,066.86	121.34				
	Beton C 7/10	m3							0.07	4,200.00	294.00				
	Çimento 32.5 N	kg							1.00	8.30	8.30				
	Pllaka trotuari granil+boje	m2							1.02	711.00	725.22				
	Shuma :				518.15			79.17			1,216.36	1,813.68	145.09	181.37	2,140.14

Referuar An.2.288 sipas VKM nr. 629, datë 15.7.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", i ndryshuar, pllaka trotuari për njësi ka vlerën 725 lekë për 2,140 lekë, e cila përbën 33% të zërit. Sipërmarrësi i punimeve e ka ofertuar këtë zë pune me çmimin 1,600 lekë, 33% e tij jep çmimin e pllakave prej 528 lekë për m2 e cila do zbritet këtij zëri.

Për këtë arsye, çmimi i këtij zëri pune është 528 lekë/m2 më pak se çmimi i ofertuar. Për pasojë, pagesa e shtresës së pllakës është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Zëri 3. Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8 m. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 1,530 m2, në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 2,378.91 m2. Referuar preventivit të punimeve zëri 8 ne punime suvatimi, dhe auditimit në terren fasada e jashtme është realizuar me veshje me polisterol dhe suva grafiato (sistem kapot).

Nr.	E M E R T I M I	Njesia	PUNTORI			TRANSPORT			MAKINERI			MATERIAL			Shuma	Shp pl	Fitim	TOTALI
Kodi			op	çmimi	Vlefta	T*km	çmimi	Vlefta	o.p	çmimi	Vlefta	Sasia	çmimi	Vlefta		8%	10%	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19
2.358/b	Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjete + suva.	m2																
	Sp + p	op	5.80	185.00	1,073.00													
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	1,073.00	0.17	179.19													
	Transport	T*km				0.95	21.00	19.95										
	Elektro argano	op							0.35	45.00	15.75							
	Trapano	op							0.18	95.00	17.10							
	Polisterol kompakt jeshil 5cm	m2										0.05	9,050.00	452.50				
	Kolle per ngjitje	kg										4.00	25.00	100.00				
	Upa betoni plastike	cope										9.00	22.00	198.00				
	Rrjete plastike	m2										1.10	80.00	88.00				
	Grafiato per suva	kg										5.00	25.00	125.00				
	Skele inventar	m2										1.25	130.00	162.50				
	Shuma :				1,252.19			19.95			32.85			1,126.00	2,430.99	194.48	243.10	2,868.57

Referuar An.2.358/b sipas VKM nr. 629, datë 15.7.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", i ndryshuar, suvaja realizohet me zërin grafiato e gatshme për suva, për rrjedhojë është realizuar suvatimi gjatë ndërtimit të sistemit kapot. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 2,396,609 lekë pa TVSH** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa është trajtuar më sipër nga OE "I." SHPK është bërë observacion dërguar me shkresën me nr. 400 prot., datë 24.09.2025, protokolluar në KLSH nr.405/10, datë 25.09.2025, ku janë shprehur pretendimet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Observimi lidhur me 1. Zëri i punimeve Trotuar me 6 cm beton + pllaka granili me bojë, në këtë rast OE shprehet se: Në libreza e masave pasqyrohet sasia prej 33.52 m2 e barabartë me situacionin përfundimtar, nga ana juaj është konstatuar një dëm ekonomik duke zbritur sasinë e pllakave që nuk është vendosur dhe kjo gjë qëndron por nga ana jonë është përdorur sasi betoni për ta çuar në kuote trotuari dhe kjo kërkon një kalkulim duke llogaritur dhe sasinë e betonit të përdorur pasi është shpenzuar një vlere monetare. Dhe fakti që kontraktori nuk mund të ndryshojë projektin me nismën e vet qëndron por përsëri dhe ne i qëndrojmë qe kemi shpenzuar një vlerë monetare për realizimin e trotuarit.*

2. Zëri i punimeve Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8 m, mbikëqyrësi sqaron si vijon: Në libreza e masave dhe situacionin përfundimtar pasqyrohet një volum pune prej 2378.91 m2, ku nga ana juaj është konsideruar si dëm ekonomik pasi sipas jush ky zë përfshihet në zërin e punës veshje me polisterol dhe suva grafiato (sistemi kapot).

Ri sqarim: Zëri suva e zakonshme fasade mur tulle në lartësi mbi 8m tregon që është një suvatim ne mur tulle 2.5- 3cm trashësi e cila është realizuar nga ana jone si kontraktor pasi ka qenë e parashikuar në projekt dhe në preventiv për të mbrojtur tullat e plota për mos tu dëmtuar nga lagështia pasi objekti është një ndërtese shumë vjeçare dhe i amortizuar ku copat e llacit të suvasë ekzistuese binin në ambientet dhe terrenin e shkollës. Sistemi kapot në analizë përfshin zërin suva grafiato dhe ky zë vendoset mbi polisterol dhe realizohet mbi rrjetën që ngjitet me kollë dhe ka një trashësi 1-2 mm. Suva e zakonshme është pjesa mbushëse poshtë polisterolit dhe ka një trashësi 2.5-3 cm. Hequr kapotën në disa vende për të parë realizimin e këtij zëri.

Qëndrimi i grupit të auditimit:**1**. Në lidhje me pretendimin Nr.1, grupi i auditimit të KLSH-së risqaron dhe njëherë se gjatë auditimit në terren janë kryer të gjitha verifikimet e nevojshme në prani të Mbikëqyrësit të punimeve. Sipërmarrësi nuk mund të ndryshojë me nismën e vet, të subjektit projektues a mbikëqyrës, projektin dhe përshkrimet teknike të tij, pasi është në kundërshtim me aktet nënligjorë në fuqi, ky ndryshim që pretendohet nga ana juaj nuk është i miratuar. Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri. Për pasojë, observacioni për këtë pretendim **nuk merret në konsideratë**.

2.Në lidhje me pretendimin nr.2 të subjektit, grupi i auditimit të KLSH-së sqaron se pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri. Për pasojë, observacioni për këtë pretendim **nuk merret në konsideratë**. **Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

Për sa është trajtuar më sipër nga OE "I." SHPK është bërë observacion dërguar me shkresën me nr. 400 prot., datë 24.09.2025, protokolluar në KLSH nr.405/10, datë 25.09.2025, dhe nga Mbikëqyrësi i punimeve është bërë observacion dërguar me shkresën pa nr. protokolli, dhe pa datë protokolluar në KLSH nr.405/12, datë 08.10.2025, ku janë shprehur pretendimet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Observimi lidhur me 1. Zëri i punimeve Trotuar me 6 cm beton + pllaka granili me bojë, në këtë rast OE shprehet se: Në libreza e masave pasqyrohet sasia prej 33.52 m2 e barabartë me situacionin përfundimtar, nga ana juaj është konstatuar një dëm ekonomik duke zbritur sasinë e pllakave që nuk është vendosur dhe kjo gjë qëndron por nga ana jonë është përdorur sasi betoni për ta çuar në kuote trotuari dhe kjo kërkon një kalkulim duke llogaritur dhe sasinë e betonit të përdorur pasi është shpenzuar një vlere monetare. Dhe fakti që kontraktori nuk mund të ndryshojë projektin me nismën e vet qëndron por përsëri dhe ne i qëndrojmë qe kemi shpenzuar një vlerë monetare për realizimin e trotuarit.*

2. Zëri i punimeve Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8 m, mbikëqyrësi sqaron si vijon:

Në libreza e masave dhe situacionin përfundimtar pasqyrohet një volum pune prej 2378.91 m2, ku nga ana juaj është konsideruar si dëm ekonomik pasi sipas jush ky zë përfshihet në zërin e punës veshje me polisterol dhe suva grafiato (sistemi kapot).
Ri sqarim: Zëri suva e zakonshme fasade mur tulle në lartësi mbi 8m tregon që është një suvatim ne mur tulle 2.5- 3cm trashësi e cila është realizuar nga ana jone si kontraktor pasi ka qenë e parashikuar në projekt dhe në preventiv për të mbrojtur tullat e plota për mos tu dëmtuar nga lagështia pasi objekti është një ndërtese shumë vjeçare dhe i amortizuar ku copat e llacit të suvasë ekzistuese binin në ambientet dhe terrenin e shkollës. Sistemi kapot në analizë përfshin zërin suva grafiato dhe ky zë vendoset mbi polisterol dhe realizohet mbi rrjetën që ngjitet me kollë dhe ka një trashësi 1-2 mm. Suva e zakonshme është pjesa mbushëse poshtë polisterolit dhe ka një trashësi 2.5-3 cm. Hequr kapotën në disa vende për të parë realizimin e këtij zëri.
Mbikëqyrësi sqaron si vijon: Për sa më sipër i qëndrojmë sqarimit të mëparshëm se suva e zakonshme është realizuar për të gjithë objektin dhe nuk ka të bëjë me sistemin kapot të objektit. Shtresa e astarit që ju i referoheni ne materialin tuaj, teknikisht aplikohet dhe faktikisht është aplikuar mbi suvatimin e fasadën dhe jo mbi murin e tullës.
Qëndrimi i grupit të auditimit:**1**. Në lidhje me pretendimin Nr.1, grupi i auditimit të KLSH-së risqaron dhe njëherë se gjatë auditimit në terren janë kryer të gjitha verifikimet e nevojshme në prani të Mbikëqyrësit të punimeve. Sipërmarrësi nuk mund të ndryshojë me nismën e vet, të subjektit projektues a mbikëqyrës, projektin dhe përshkrimet teknike të tij, pasi është në kundërshtim me aktet nënligjorë në fuqi, ky ndryshim që pretendohet nga ana juaj nuk është i miratuar. Pretendimet e subjektit në këtë observacion nuk janë të argumentuara me dokumentacion shtesë. Për pasojë, observacioni për këtë pretendim **nuk merret në konsideratë**.
2.Në lidhje me pretendimin nr.2 të subjektit, grupi i auditimit të KLSH-së sqaron se pretendimet e subjektit është i njëjtë me observacionin dërguar me shkresën pa nr. protokolli, datë 10.07.2025, protokolluar në KLSH nr.405/7 datë 11.07.2025, i cili është trajtuar në projekt raport nga grupi i auditimit. Pretendimet e subjektit nuk kanë argument të ri të vërtetuar me dokumentacion shtesë. Për pasojë, observacioni për këtë pretendim **nuk merret në konsideratë**.

2. ***Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme të fshatit Ceruje.***
B. Të dhëna mbi objektin

<table>
<tr><td colspan="5">Zbatimi i Kontratës së Punimeve: Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme të fshatit Ceruje</td></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës
Nr. 2262 prot., datë 22.06.2023</td><td colspan="2">15.Vlera e kontratës (me TVSH)
46,574,256 lekë
BOE fitues “G” SHPK & “V” SHPK</td><td colspan="2">16.Likuiduar
USH nr.385 datë 13.06.2024, vlera 16,510,536 lekë</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar
Vlera me TVSH 46,574,256 lekë
Vlera pa TVSH 38,811,880 lekë</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në ditë
Parashikuar 120 ditë, Zbatuar 137 ditë.
Fillimi punimeve: 30.06.2023
Përfundimi punimeve : 13.11.2023</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
OE “E” SHPK</td><td>Licenca Nr:</td><td>Kontrata me nr. 1158 prot., datë 16.03.2023</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
“P” SHPK</td><td>Licenca Nr:</td><td>Kontrata me nr. 1629 prot., datë 04.05.2023</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi
2024</td><td colspan="2">23.Certifikata e përfundimit të punimeve datë 06.06.2024</td><td colspan="2"></td></tr>
</table>

Kontratat
Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 2262 prot., datë 22.06.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh, të përfaqësuar nga Kryetari z.B. A. dhe Bashkimi i

Operatorit Ekonomik “G” SHPK & “V” SHPK, me përfaqësues z.A. Z..
Vlera e kontratës është 38,811,880 lekë pa TVSH / 46,574,256 lekë me TVSH.
Afati i zbatimit të kësaj kontrate është 120 ditë, nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit.
Mbikëqyrësi i punimeve me shkresën pa nr. prot., dhe pa datë ka kërkuar shtyrjen e afatit të punimeve me 20 ditë për arsye të zëvendësimit të tubacioneve të amortizuar ujësjellësit të hasura në rrugë.
Në dosjen e zbatimit nuk administrohet amendimi i kontratës.
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.1158 prot., datë 16.03.2023, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE “E” SHPK, vlera e kontratës është 448,030 lekë pa TVSH / 537,636 lekë me TVSH, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh ...
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.1629 prot., datë 04.05.2023, është caktuar për kryerjen e këtij OE “P” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh respektivisht ...
Akt Kolaudimi është mbajtur në vitin 2024 midis Sipërmarrësit, Mbikëqyrësit të punimeve dhe kolaudatorit i punimeve.
Me Urdhrin nr.127, datë 26.06.2023, të kryetarit të Bashkisë Gramsh, është caktuar struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës me përbërje z.A.C, znj.E. I. dhe z.O. Ç.
Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim me datë 06.06.2024, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, si dhe nga përfaqësuesit e investitorit, N/Kryetari Bashkisë z.T. B, dhe në cilësinë e Komisionit për marrjes së përkohshme në dorëzim z.O. Ç, z.G. X. dhe z.K. L.
Projektpreventivi
Në dosjen e zbatimit nuk administrohet leja infrastrukturore.
- Projekt Preventivi është hartuar nga “E” SHPK, viti 2023.
Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 30.06.2023, duhet të përfundonin në datën 29.10.2023 dhe kanë përfunduar me datë 13.11.2023, ose jashtë afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.
Me shkresën pa nr. prot., pa datë Mbikëqyrësi i punimeve ka kërkuar miratimin e ndryshimeve të volumeve dhe projektit të azhornuar. Sipas preventivit të rishikuar të punimeve janë shtuar 2,616,206 lekë dhe pakësuar 2,616,206 lekë, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, Mbikëqyrësi i punimeve dhe Sipërmarrësi i punimeve.
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.
Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **149,305 lekë pa TVSH**.

Tabela nr. 2

Nr		Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
								Vol.	Vlera

		Punime shtresash në rrugë							
2	3.193/b	Shtresë zhavorri lumi t=20cm me cilindrim	m³	425	8,466.9	8,466.9	8,367.5	99.4	42,245
		Punime mure mbajtës							
1	2.111/2	Mur mbajtës betoni M-200	m³	10,100	204.4	204.4	193.8	10.6	107,060
								Total	**149,305**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Punime mure mbajtës

1. Zëri 1. Shtresë zhavorri lumi t=20cm me cilindrim. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 8,150 m2, në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 8,466.9 m2. Nga rillogaritja e këtij zëri pune sipas vizatimeve të projektit të rishikuar rezulton se sasia është 8,367.5 m2, pasi në seksionin 0+550 dhe 1+075 sipërfaqet sipas vizatimeve janë respektivisht 108.8 m2 dhe 114.4 m2. Për këtë arsye, sipërfaqja e këtij zëri pune është 99.4 m2 më pak se sipërfaqja e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Zëri 2. Mur mbajtës betoni M-200. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 140 m3, në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 204.4 m3. Nga auditimi në terren rezulton se Muri M1 tipi 2 është realizuar mbi një tombino ekzistuese dhe ka një lartësi 1,8 m nga rillogaritja sipërfaqja është 0.86 m2 dhe jo 1.84 m2. Muri M2 tipi 14,15,16 trashësia e murit në kokë është 0.3 m dhe jo 0.4 m, nga rillogaritja sipërfaqja mesatare është 1.07 m2 dhe jo 1.23 m2. Muri M3 dhe M4 trashësia e murit në kokë është 0.3 m dhe jo 0.4 m, nga rillogaritja sipërfaqja është 1.08 m2 dhe jo 1.24 m2. Për këtë arsye, volumi e këtij zëri pune është 10.6 m3 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 149,305 lekë pa TVSH** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

3. ***Rikonstruksion i rrugës Fshati Mashan, Njësia administrative Kodovjat, Bashkia Gramsh.***

C. Të dhëna mbi objektin

Zbatimi i Kontratës së Punimeve: Rikonstruksion i rrugës Fshati Mashan, Njësia administrative Kodovjat, Bashkia Gramsh				
14.Lidhja e kontratës Nr. 4512 prot., datë 15.10.2024	**15.Vlera e kontratës (me TVSH)** 94,997,112 lekë BOE fitues "T." SHPK & "S." SHPK		**16.Likuiduar pjesor situacioni nr.5.** USH nr.248 datë 17.04.2025, vlera 13,770,000 lekë	
17- Situacioni Përfundimtar Vlera me TVSH 94,996,296 lekë Vlera pa TVSH 79,163,580 lekë	**18.Afati i kontratës në ditë** Parashikuar 215 ditë, Zbatuar 185 ditë. Fillimi punimeve: 21.10.2024 Përfundimi punimeve : 23.04.2025		**19. Zgjatja e kontratës**	
20. **Mbikëqyrësi i punimeve** OE "A" SHPK	Licenca Nr:	Kontrata me nr. 4386 prot., datë 09.10.2024		
21. **Kolaudatori i punimeve** "G" SHPK	Licenca Nr:	Kontrata me nr. 5135 prot., datë		

		05.11.2024		
22.Akt Kolaudimi 14.05.2025	**23.Certifikata e përfundimit të punimeve** datë 27.05.2025			

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 4512 prot., datë 15.10.2024, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh, të përfaqësuar nga n/Kryetari z.T.B. dhe Bashkimi i Operatorit Ekonomik "T" SHPK & "S" SHPK, me përfaqësues respektiv z.S Q dhe z. Y.B.

Vlera e kontratës është 79,164,260 lekë pa TVSH / 94,997,112 lekë me TVSH.

Afati i zbatimit të kësaj kontrate është 7 muaj, nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.4386 prot., datë 09.10.2024, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE "A" SHPK, vlera e kontratës është 716,596 lekë pa TVSH / 859,915 lekë me TVSH, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh ...

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.5135 prot., datë 05.11.2024, është caktuar për kryerjen e këtij OE "G" SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh respektivisht ...

Akt Kolaudimi është mbajtur në vitin 14.05.2025 midis Sipërmarrësit, Mbikëqyrësit të punimeve dhe kolaudatorit i punimeve.

Me Urdhrin nr.360, datë 15.10.2024, të n/kryetarit të Bashkisë Gramsh, është caktuar struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës me përbërje z.O. Ç, z.M. A. dhe z.S. V, ndryshuar me Urdhrin nr.407, datë 25.11.2024, zëvendësuar z.M. A. me z.L. H.

Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim me datë 27.05.2025, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, si dhe nga përfaqësuesit e investitorit, N/Kryetari Bashkisë z.T. B, dhe në cilësinë e Komisionit për marrjes së përkohshme në dorëzim z.O. Ç, z.S. V. dhe z.L. H.

Projektpreventivi

Për këtë objekt Bashkia Gramsh ka lëshuar lejen infrastrukturore me nr. 4566/3, datë 18.10.2024, me objekt "Rikonstruksion i rrugës Fshati Mashan, Njësia administrative Kodovjat, Bashkia Gramsh", me afat 7 muaj.

- Projekt Preventivi është hartuar nga Bashkia Gramsh, viti 2024.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 21.10.2024, duhet të përfundonin në datën 20.05.2025 dhe kanë përfunduar me datë 23.04.2025, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

Me shkresën me nr. 32/1 prot., datë 30.01.2025, Mbikëqyrësi i punimeve ka kërkuar miratimin e ndryshimeve të volumeve dhe miratimin e fondit rezervë, miratuar nga AK me shkresën nr. 4512/6 prot., datë 05.02.2025. Sipas preventivit të rishikuar të punimeve janë shtuar 7,476,260 lekë dhe pakësuar 5,924,700 lekë, diferenca 1,551, 560 do të kryhet nga fondi rezervë i kontratës, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, Mbikëqyrësi i punimeve dhe Sipërmarrësi i punimeve.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje

me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **2,990,100 lekë pa TVSH**.

Tabela nr. 3

Nr		Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
								Vol.	Vlera
		Punime sinjalistike							
1	3.942/1	Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm Bikomponente (pastë)	m	800	5,000	5,000	0	0	4,000,000
	3.942	Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm Bikomponente (spray)	m	221.98	5,000	5,000	5,000	-5,000	-1,109,900
		Punime të ndryshme							
1	An.	F.V. Fidanë Peme Rrap	copë	2,000	100	100	50	50	100,000
								Total	**2,990,100**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Punime sinjalistike

1. Zëri 1. Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm. Bikomponente (pastë). Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 5,500 m, në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 5,000 m. Nga auditimi në terren rezulton se ky zë pune është realizuar me vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm, Bikomponente (spray) dhe jo me pastë.

Referuar manualit të çmimeve, zëri 3.942 çmimi sipas historikut (data 18.12.2024 e cila i afrohet më shumë periudhës së ofertës) është rreth 221.98 lekë/m ose 578.02 lekë/m më pak se çmimi i ofertuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Zëri 2. F.V. Fidanë Peme Rrap. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 100 m, në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 100 m. Nga auditimi në terren rezulton se sasia e fidanëve e vendosur është 50 copë. Për këtë arsye, sasia i këtij zëri pune është 50 copë më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e kësaj sasie është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 2,990,100 lekë pa TVSH** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa është trajtuar më sipër nga Mbikëqyrësi i punimeve është bërë observacion dërguar me shkresën pa nr. protokolli, dhe pa datë protokolluar në KLSH nr.405/13, datë 09.10.2025, ku janë shprehur pretendimet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Observimi lidhur me 1. Zëri i punimeve Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm. Bikomponente (pastë), mbikëqyrësi sqaron si vijon: Ky proces pune me përshkrimin Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm. Bikomponente (paste)" , në*

përfundim të punimeve ishte realizuar sipas kërkesave në projekt preventiv, por meqenëse ishte dëmtuar nga kushtet atmosferike është ri bërë nga sipërmarrësi por jo me material e duhur. Objekti është brenda periudhës së garancisë së defekteve, dhe u ribë nga sipërmarrësi me materialin e kërkuar ne projekt preventivin sipas situacionit te paguar, në cilësinë dhe sasinë e duhur e për këtë u mbajtën procedurat përkatëse dhe dokumentacioni i duhur me investitorin dhe po ju dërgojmë në vijim të këtij observacioni.

2. Zëri i punimeve F.V. Fidanë Peme Rrap, mbikëqyrësi sqaron si vijon: Në objekt janë mbjellë gjithë sasia e pemëve kërkuara në preventivin e rishikuar dhe në situacionet e paguara, por një pjesë e këtyre pemëve janë tharë. Objekti është brenda periudhës së garancisë së defekteve, u rimbollën nga sipërmarrësi, u bë mbjellja e pemëve që mungojnë, në cilësinë dhe sasinë e duhur, dhe për këtë u mbajtën procedurat përkatëse dhe dokumentacionin duhur me investitorin dhe po ju dërgojmë në vijim të këtij observacioni.

Qëndrimi i grupit të auditimit:**1**. Në lidhje me pretendimin nr.1 të subjektit, grupi i auditimit të KLSH-së sqaron se pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion shtesë me investitorin të pretenduar nga subjekti në observacion. Për pasojë, observacioni për këtë pretendim **nuk merret në konsideratë**.

2.Në lidhje me pretendimin Nr.2, grupi i auditimit të KLSH-së sqaron se pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion shtesë me investitorin të pretenduar nga subjekti në observacion. Për pasojë, observacioni për këtë pretendim **nuk merret në konsideratë**.

4. ***Ndërtim i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësorë***

D. Të dhëna mbi objektin

Zbatimi i Kontratës së Punimeve: Ndërtim i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësorë				
14.Lidhja e kontratës Nr. 4631 prot., datë 23.10.2024	**15.Vlera e kontratës (me TVSH)** 96,543,360 lekë OE fitues "M." SHPK		**16.Likuiduar deri situacioni 3** USH nr.120 datë 15.04.2025, vlera 44,779,308 lekë	
17- Situacioni Përfundimtar	**18.Afati i kontratës në ditë** Parashikuar 151 ditë, Zbatuar në proces Fillimi punimeve: 28.10.2024 Përfundimi punimeve :		**19. Zgjatja e kontratës** -Amendamenti i kontratës nr.1, me shkresën nr.4631/4 prot., datë 12.03.2025. -Amendamenti i kontratës nr.2, me shkresën nr.1739/1 prot., datë 02.05.2025.	
20. **Mbikëqyrësi i punimeve** OE "A" SHPK	Licenca Nr:	Kontrata me nr. 4446 prot., datë 11.10.2024		
21. **Kolaudatori i punimeve** "G" SHPK	Licenca Nr:	Kontrata me nr. 5134 prot., datë 05.11.2024		
22.Akt Kolaudimi	**23.Certifikata e përfundimit të punimeve**			

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 4631 prot., datë 23.10.2024, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh, të përfaqësuar nga n/Kryetari z.T.B. dhe Operatori Ekonomik "M" SHPK, me përfaqësues respektiv z.E. B.

Vlera e kontratës është 80,452,800 lekë pa TVSH / 96,543,360 lekë me TVSH.

Afati i zbatimit të kësaj kontrate është 5 muaj, nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.4446 prot., datë 11.10.2024, është

caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE "A" SHPK, vlera e kontratës është 1,327,338 lekë pa TVSH / 1,592,805 lekë me TVSH, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh ...
Mbikëqyrësi i punimeve me shkresën pa nr. prot., datë 10.03.2025, ka kërkuar zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve.
Amendamenti i kontratës nr.1, me shkresën nr.4631/4 prot., datë 12.03.2025, afati i ri i përfundimit të punimeve është 30.04.2025.
Mbikëqyrësi i punimeve me shkresën pa nr. prot., datë 30.04.2025, ka kërkuar zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve.
Amendamenti i kontratës nr.2, me shkresën nr.1739/1 prot., datë 02.05.2025, afati i ri i përfundimit të punimeve është 20.06.2025.
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.5134 prot., datë 05.11.2024, është caktuar për kryerjen e këtij OE "G" SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh respektivisht ...
Me Urdhrin nr.368, datë 23.10.2024, të n/kryetarit të Bashkisë Gramsh, është caktuar struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës me përbërje z.J. M, z.L. H.dhe z.S. V.
Projektpreventivi
Për këtë objekt Bashkia Gramsh ka lëshuar lejen infrastrukturore me nr. 4678/3, datë 25.10.2024, me objekt "Ndërtim i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësorë", me afat 5 muaj.
- Projekt Preventivi është hartuar nga Bashkia Gramsh.
Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 28.10.2024, duhet të përfundonin në datën 27.03.2025 dhe nuk kanë përfunduar, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.
AK me shkresën nr. 4678/1 prot., datë 28.10.2024, ka kërkuar Kontraktorit dhe Mbikëqyrësit ndryshimin e projektit të pritave nga tërthorë në gjatësorë.
Me shkresën pa nr. prot., datë 30.10.2024, Mbikëqyrësi i punimeve ka kërkuar miratimin e zërave të rinj të punimeve të paparashikuara në preventivin fillestar. N/kryetari i Bashkisë me shkresën nr.5018/6 prot., datë 31.10.2024, ka urdhëruar ngritjen e strukturës përgjegjëse për shqyrtimin e zërave të rinj me përbërje z.O. Ç., z.L. H. dhe z.S.V., me procesverbalin e mbajtur me datë 01.11.2024, janë miratuar zërat e rinj.
Konstatim: Në dosjen e zbatimit mungojnë vizatimet justifikuese të librezave të masave përfundimtare, në kundërshtim me pikën 4, Kreu III, të Udhëzimit nr.2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", ku cilësohet: *"...4. Libri i masave mbahet për çdo objekt e nënobjekt, që ka preventiv dhe është dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve. Në të pasqyrohen vëllimet metrike të punimeve, gradualisht me zhvillimin e tyre..".*
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve.
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacionet e punimeve etj.
Nga auditimi i situacionit nr.3, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **2,773,579 lekë pa TVSH**.

Tabela nr. 4

Nr		Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni nr.3	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
								Vol.	Vlera
	I	**Ndërtim prita lumore**							
3	3.332	Gabiona rrjet xingato 1x1x1.5	m3	7,400	3,040		3,040		
		Zbritje hekuri Ø6mm	m3	205	3,040		3,040	3,040	623,200
4	3.333	Gabiona rrjet xingato 1x1x2	m3	7,400	4,049		4,049		
		Zbritje hekuri Ø6mm	m3	171	4,049		4,049	3,040	692,379
	Shuma 1								1,315,579
7	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve	m3	2,400.04	4,050		4,050		
		Zbritje transport auto mbi 10 km	m3	360	4,050		4,050	4,050	1,458,000
	Shuma 1								1,458,000
								Total	**2,773,579**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Ndërtim prita lumore

1. Zëri 3. Gabiona rrjet xingato 1x1x1.5. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 3,200 m3, në preventivin e rishikuar 3,045 m3 dhe situacionin nr.3 ky zë pune figuron në 3,040 m3. Nga auditimi në terren rezulton se për zërin 3.332 nuk ishte vendosur hekur Ø6, siç specifikohet në analizën e çmimit respektive, si më poshtë:

Nr.			PUNTORI			MATERIAL				Shp	Fitim	
	E M E R T I M I	Njesia	op	çmimi	Vlefta	Sasia	çmimi	Vlefta	Shuma	pl		TOTALI
Analize										8%	10%	
1	2	3	4	5	6	13	14	15	16	17	18	19
3.332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	m3										
	Sp + p	op	5.30	185.00	980.50							
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	980.50	0.17	163.74							
	Gur kave	m3				1.01	1,028.00	1,038.28				
	Rrjete gabian zingat	m2				6.20	350.00	2,170.00				
	Hekur Ø 6	kg				2.70	76.00	205.20				
	Tel zingato	kg				0.55	125.00	68.75				
	Shuma :				1,144.24			3,482.23	4,626.47	370.12	462.65	5,459.24

Referuar An.3.332 hekur Ø6 për njësi ka vlerën 205 lekë, vlerë e cila do ti zbritet çmimit të gabionit për njësi sipas këtij zëri. Për këtë arsye, çmimi i këtij zëri pune është 205 leke/m3 më pak se çmimi i situacionuar. Për pasojë, pagesa e hekur Ø6 për çdo gabion është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Zëri 4. Gabiona rrjet xingato 1x1x2. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 2,100 m3, në preventivin e rishikuar 4,060 m3 dhe situacionin nr.3 ky zë pune figuron në 4,049 m3. Nga auditimi në terren rezulton se për zërin 3.333 nuk ishte vendosur hekur Ø6, siç specifikohet në analizën e çmimit respektive, si më poshtë:

Nr.			PUNTORI			MATERIAL				Shp	Fitim	
	E M E R T I M I	Njesia	op	çmimi	Vlefta	Sasia	çmimi	Vlefta	Shuma	pl		TOTALI
Analize										8%	10%	
1	2	3	4	5	6	13	14	15	16	17	18	19
3.333	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x2 m	m3										
	Sp + p	op	5.10	185.00	943.50							
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	943.50	0.17	157.56							
	Gur kave	m3				1.01	1,028.00	1,038.28				
	Rrjete gabian zingat	m2				5.20	350.00	1,820.00				
	Hekur Ø 6	kg				2.25	76.00	171.00				
	Tel zingato	kg				0.45	125.00	56.25				
	Shuma :				1,101.06			3,085.53	4,186.59	334.93	418.66	4,940.18

Referuar An.3.333 hekur Ø6 për njësi ka vlerën 171 lekë, vlerë e cila do ti zbritet çmimit të gabionit për njësi sipas këtij zëri. Për këtë arsye, çmimi i këtij zëri pune është 171 leke/m3 më pak se çmimi i situacionuar. Për pasojë, pagesa e hekur Ø6 për çdo gabion është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

3. Zëri 7. Mbushje me zhavorr pas mureve. Në preventivin bazë nuk ka qenë i parashikuar ky zë pune, në preventivin e rishikuar është llogaritur 4.200 m3 dhe situacionin nr.3 ky zë pune figuron në sasinë 4,050 m3. Nga analiza teknike e këtij zëri sipas manualit rezulton se ka dhe transport auto mbi 10 km, duke marrë në konsideratë se zhavorri është marrë nga gërmimi në lumë, zëri i transportit duhet të zbritet nga analiza e çmimit. Referuar An.3.396/1, transport auto mbi 10 km për njësi ka vlerën 375 lekë për 2,446 lekë, e cila përbën 15% të zërit. Sipërmarrësi i punimeve e ka ofertuar këtë zë pune me çmimin 2,400.04 lekë, 15% e tij jep çmimin e transportit prej 360 lekë për m3 e cila do zbritet këtij zëri.

Për këtë arsye, çmimi i këtij zëri pune është 360 leke/m3 më pak se çmimi i situacionuar. Për pasojë, pagesa e transportit mbi 10 km është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 2,773,579 lekë pa TVSH** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa është trajtuar më sipër nga Mbikëqyrësi i punimeve është bërë observacion dërguar me shkresën pa nr. protokolli, dhe pa datë protokolluar në KLSH nr.405/14, datë 09.10.2025 ku janë shprehur pretendimet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Observimi lidhur me 1. Zëri i punimeve Gabiona rrjet xingato 1x1x1.5 dhe 1x1x2, mbikëqyrësi sqaron si vijon: Për sa më sipër sqarojmë se këto dy procese pune në përfundim të punimeve kanë qenë të realizuar për të gjithë objektin(gabionat) sipas kërkesave të zërit në projekt, por duke qenë se në momentin e kontrollit nuk ekzistonin mendojmë se është dëmtuar për shkak të vjedhjes. Objekti është brenda periudhës së garancisë së defekteve, nga sipërmarrësi u ribënë ky proces pune në cilësinë dhe sasinë e duhur, dhe për këtë u mbajtën procedurat përkatëse dhe dokumentacionin duhur me investitorin dhe po ju dërgojmë në vijim të këtij observacioni.*

2. Zëri i punimeve Mbushje me zhavorr pas mureve, mbikëqyrësi sqaron si vijon: Ky proces pune është realizuar për të gjithë objektin sipas kërkesave të zërit në projekt-preventiv, dhe materiali është furnizuar nga sipërmarrësi nga kantieri e tij në Cërrik i cili ka distancën nga objekti me shume se sa 10km. Po kështu punimet "Mbushje me zhavorr pas mureve të pritave" janë për mbrojtjen lumore të tokave bujqësore dhe nga Investitori nuk jemi lejuar të shfrytëzojmë zhavorrin e këtij lumi sepse sipas legjislacionit kërkon leje të veçantë, por edhe sepse volumet e mëdha që kërkoheshin nga objekti krijonin probleme në rrjedhën e lumit. Bashkëlidhur foto të këtij procesi pune dhe faturat e furnizimit të materialit nga sipërmarrësi, materiali disponuar gjendje ne "magazinën" e tij në Cërrik.

Në lidhje me këtë zë ne i qëndrojmë observacionit tonë duke theksuar se fotot e bëra në kantierin e sipërmarrësit në Cërrik janë foto nga distance e madhe, ndaj dhe materiali duket jo i njëjte me

atë të hedhur në objekt të cilit (materialit për mbushjen me zhavorr në objekt) i është bërë foto nga afër.

Qëndrimi i grupit të auditimit:**1**. Në lidhje me pretendimin nr.1 të subjektit, grupi i auditimit të KLSH-së sqaron se observacioni është i njëjtë me observacionin dërguar me shkresën pa nr. protokolli, dhe pa datë protokolluar në KLSH nr.405/4, datë 10.07.2025, i cili është trajtuar në projekt raport nga grupi i auditimit. Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion shtesë të miratuar nga Investitori. Për pasojë, observacioni për këtë pretendim **merret pjesërisht në konsideratë**.

2.Në lidhje me pretendimin Nr.2, grupi i auditimit të KLSH-së sqaron se observacioni është i njëjtë me observacionin dërguar me shkresën pa nr. protokolli, dhe pa datë protokolluar në KLSH nr.405/4, datë 10.07.2025, i cili është trajtuar në projekt raport nga grupi i auditimit. Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion shtesë të miratuar nga Investitori. Për pasojë, observacioni për këtë pretendim **merret pjesërisht në konsideratë**.

2.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës publike (Aseteve dhe Pyjeve Kullotave) të transferuara sipas VKM

2.5.1. Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

2.5.2. Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.

<u>Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës:</u>

- ✓ **Përgjegjësia në nivel vendor për menaxhimin e aseteve:**

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i cili ka përcaktuar të drejtat dhe përgjegjësitë e NjQV-ve për menaxhimin e aseteve (pronave), njësitë e qeverisjes vendore janë pronarë të aseteve dhe këshilli përkatës ushtron të drejtën e pronësisë.

Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj. Këshilli i Bashkisë Gramsh përcakton politikat dhe aprovon strategjitë për menaxhimin e aseteve vendore.

Struktura e angazhuar për dhënien me qira të aseteve të Bashkisë Gramsh për vitin 2024, është Sektori i Menaxhimit të Aseteve Vendore pjesë e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në zbatim të VKB-së nr. 85, datë 27.12.2023, "Për miratimin e numrit maksimal dhe nivelit të pagave e të shpërblimeve të punonjësve e personave të tjerë, të zgjedhur e të emëruar, të Bashkisë Gramsh, për vitin 2024", dhe Vendimit të Kryetarit të Bashkisë nr. 8, datë 30.01.2024, "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gramsh dhe njësive në varësi të saj për vitin 2024".

Për dhënien e tokave bujqësore me qira është ngarkuar Sektori i Shërbimeve Veterinare, Mbrojtjes së Tokës, Bujqësi pjesë e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor. Përsa i përket dhënies së sipërfaqeve të fondit pyjor kullosor në fushën e ndërtimit dhe operimit të HECE-ve, fotovoltaikëve, materialeve drusore, antenave, kullota veprore për bagëtitë është e ngarkuar Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

- ✓ **Pasuritë e transferuara:**

Me ndarjen e re territoriale Bashkisë Gramsh, i janë shtuar Njësitë Administraive respektivisht: Pishaj, Porocan, Sult, Kodovjat, Kukur, Lenije, Skënderbegaz, Kushovë dhe Tunjë.

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Gramsh ka në pronësi në total **<u>5,965</u> pasuri** ku vetëm 2,227

pasuri janë transferuar, dhe **51,642.04 ha** pyje dhe kullota, të cilat janë transferuar sipas VKM-ve si më poshtë:

Në vijim për Bashkinë Gramsh është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim në institucionit si më poshtë:

- **Bashkisë Gramsh:**

Me VKM-në nr. 431, datë 11.07.2007, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Gramsh të Qarkut Elbasan", është miratuar lista e pronave të paluajtshme të ndodhur në territorin dhe juridiksionin e kësaj njësie vendore në total me **499 prona**. Ku nga këto pasuri të transferuara bashkisë janë transferuar **372 prona** të cilat janë veçuar me regjistër të veçant pronat të cilat i kanë kaluar në pronësi Bashkisë dhe ato në përdorim. Gjithashtu janë edhe disa prona shtesë si: godina e Shikut, godina e Tatimeve, garazhd, objekti Y, grup deposh Çekres, Reparti Ushtarak, godina rruga Urea, Zjarrëfiksja.

- **Njësia Administrative Kushovë:**

Me VKM-në nr. 44, datë, 27.01.2010, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim", është miratuar lista e pronave të paluajtshme të ndodhura në territorin dhe juridiksionin e kësaj njësie vendore, në total me **561 prona.** Ku nga këto pasuri të transferuara njësisë janë **234 prona** të cilat janë veçuar me regjistër të veçantë pronat të cilat i kanë kaluar në pronësi Bashkisë dhe ato në përdorim. Këto pasuri nuk janë regjistruar në ASHK.

- **Njësia Administrative Pishaj:**

Me VKM-në nr. 273, datë 18.04.2012, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen, në pronësi ose në përdorim", është miratuar lista e pronave të paluajtshme të ndodhur në territorin dhe juridiksionin e kësaj njësie vendore me **1,273 prona.** Ku nga këto pasuri të transferuara njësisë janë **477 prona** të cilat janë veçuar me regjistër të veçant pronat të cilat i kanë kaluar në pronësi bashkisë dhe ato në përdorim. Këto pasuri nuk janë regjistruar në ASHK.

- **Njësia Administrative Skënderbegas:**

Me VKM-në nr. 15, datë 12.01.2011, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen, në pronësi ose në përdorim", është miratuar lista e pronave të paluajtshme të ndodhur në territorin dhe juridiksionin e kësaj njësie vendore me **903 prona.** Ku nga këto pasuri të transferuara janë njësisë **270 prona** të cilat janë veçuar me regjistër të veçantë pronat të cilat i kanë kaluar në pronësi bashkisë dhe ato në përdorim. Këto pasuri nuk janë regjistruar në ASHK.

- **Njësia Administrative Lenie:**

Me VKM-në nr. 836, datë 21.01.2012, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen, në pronësi ose në përdorim", është miratuar lista e pronave të paluajtshme të ndodhur në territorin dhe juridiksionin e kësaj njësie vendore me **702 prona.** Ku nga këto pasuri të transferuara njësisë janë **315 prona** të cilat janë veçuar me regjistër të veçant pronat të cilat i kanë kaluar në pronësi bashkisë dhe ato në përdorim. Këto pasuri nuk janë regjistruar në ASHK.

- **Njësia Administrative Sult:**

Me VKM-në nr. 507, datë 13.07.2011, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen, në pronësi ose në përdorim", është miratuar lista e pronave të paluajtshme të ndodhur në territorin dhe juridiksionin e kësaj njësie vendore me **490 prona.** Ku nga këto pasuri të transferuara njësisë janë **165 prona** të cilat janë veçuar me regjistër të veçantë pronat të cilat i kanë kaluar në pronësi bashkisë dhe ato në përdorim. Këto pasuri nuk

janë regjistruar në ASHK.

- **Njësia Administrative Kodovjat:**

Me VKM-në nr. 828, datë 21.11.2012, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen, në pronësi ose në përdorim", është miratuar lista e pronave të pa luajtshme të ndodhur në territorin dhe juridiksionin e kësaj njësie vendore me **903 prona.** Ku nga këto pasuri të transferuara njësisë janë **256 prona** të cilat janë veçuar me regjistër të veçant pronat të cilat i kanë kaluar në pronësi bashkisë dhe ato në përdorim. Këto pasuri nuk janë regjistruar në ASHK.

- **Njësia Administrative Poroçan:**

Me VKM-në nr. 661, datë 04.08.2010, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen, në pronësi ose në përdorim", është miratuar lista e pronave të pa luajtshme të ndodhur në territorin dhe juridiksionin e kësaj njësie vendore me **634 prona.** Ku nga këto pasuri të transferuara njësisë janë **138 prona** të cilat janë veçuar me regjistër të vaçantë pronat të cilat i kanë kaluar në pronësi bashkisë dhe ato në përdorim. Këto pasuri nuk janë regjistruar në ASHK.

Përmbledhësja e pronave sipas listës së inventarit si dhe VKM-ve respektive të Bashkisë Gramsh dhe Njësive Administrative paraqiten si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i Njësisë	VKM		Prona në total	Të transferuara
		Numër	Datë		
1	Bashkia Gramsh	431	11.07.2007	499	372
2	Ish-Komuna Pishaj	273	18.04.2012	1273	477
3	Ish-Komuna Lenie	836	21.11.2012	702	315
4	Ish-Komuna Sult	507	13.07.2011	490	165
5	Ish-Komuna Kushovë	44	27.01.2010	561	234
6	Ish-Komuna Kodovjat	828	21.11.2012	903	256
7	Ish-Komuna Skënderbegas	15	12.01.2011	903	270
8	Ish-Komuna Poroçan	661	04.08.2010	634	138
Totali				**5,965**	**2,227**

- ✓ **Pyjet dhe kullotat:**

Referuar VKM-së nr. 433, datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive" i ndryshuar me VKM-në nr. 684, datë 02.09.2020, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike" sipas pika 19, shtojca me nr. 17, që përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Gramsh, fillon me numrin rendor **1** deri **3,433** pronat pyll dhe kullota të Bashkisë Gramsh Fier shtrihen në **17** ekonomi pyjore dhe **6** ekonomi kullosore, që sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për auditim janë si më poshtë:

Nr.	Qarku	Bashkia	Ekonomia Pyjore Kullosore	Pyll	Kullotë	Djerrë	Bimësi pyjore	Inproduktive Shkëmbore	Rezervuar ujore	Totali
1	Elbasan	Gramsh	EK Mali i Vinës	26.63	556.84	0	0	70.34	0	653.81
2	Elbasan	Gramsh	EK Sojnik - Kukur	35.82	3,570.27	0	0	20.55	0	3,626.64
3	Elbasan	Gramsh	EP Darzezë - Sult	3,155.5	5.16	384.82	0	124.7	0	3,670.18
4	Elbasan	Gramsh	EP Dushku i Bulçarit	3,956.09	127.52	0	0	370.09	15.13	4,468.83
5	Elbasan	Gramsh	EP Galigat - Stror	1,878.06	146.23	90.84	84.08	75.1	0	2,274.31
6	Elbasan	Gramsh	EP Gramsh - Vinë	3,525.36	463.46	62.62	1.13	327.29	0	4,379.86
7	Elbasan	Gramsh	EP Holtë - Lukovë	3,056.81	73.9	46.1	0	464.66	0	3,641.47
8	Elbasan	Gramsh	EP Jançë - Kërpicë	2,851.84	28.19	0	0	180.27	0.06	3,060.36
9	Elbasan	Gramsh	EP Lubinjë - Tunjë	3,285.38	5.36	0	0	165.15	0.95	3,456.84
10	Elbasan	Gramsh	EP Mashan - Rrashtan	1,708.77	0	0	0	159.49	7.59	1,875.85
11	Elbasan	Gramsh	EP Poroçan	2,900.4	1,695.64	147.09	301.64	192.32	0	5,237.09
12	Elbasan	Gramsh	EP Prrenjas - Katërlis	2,374.09	178.09	0	0	114.27	0	2,666.45
13	Elbasan	Gramsh	EP Rove 1-2	1,814.82	245.83	0	14.31	128.36	0	2,203.32
14	Elbasan	Gramsh	EP Suhagorë-Mali i Grabovës	2,363.57	787.58	0	0	987.45	0	4,138.60
15	Elbasan	Gramsh	EP Vidhan - Skënderbegas 1-2	4,678.67	154.8	0	0	1200.4	12.7	6,046.55
16	Elbasan	Berat	EP Bregu i Balibardhës	42.58	18.3	0	0	0	0	60.83
17	Elbasan	Cërrik	EP Mollas	11.51	0.0	0	0	0	0	11.51

18	Elbasan	Pogradec	EK Guri Top - Gjemth	0	4.04	0	0	0	0	4.04
19	Elbasan	Maliq	EK Moglicë	0.27	10.93	0	0	0	0	11.20
20	Elbasan	Maliq	EK Strelcë - Lenie	0	84.32	0	0	0	0	84.32
21	Elbasan	Pogradec	EP Bishnicë (Tallë)	7.8	0	0	0	0	0	7.80
22	Elbasan	Cërrik	EK Sulovë	0	10.19	0	0	0	0	10.19
23	Elbasan	Elbasan	EP Zavalinë - Kaçivel	0	52.0	0	0	0	0	51.99
Totali				**37,673.97**	**8,218.60**	**731.47**	**401.16**	**4,580.43**	**36.41**	**51,642.04**

- Bashkia Gramsh që nga transferimi i këtyre sipërfaqeve me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, nuk është pajisur me certifikatë pronësie për sipërfaqet pyjore, kullosore dhe shkëmbore që administron.

Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, Bashkia Gramsh ka aktive 26 kontrata për dhënien me qira të pyjeve dhe Kullotave verore.

- Nga Bashkia Gramsh nuk janë bërë sondazhe gjatë kullotjes për të mos lejuar futjen e bagëtive në kullotë jashtë kapacitetit kullosor të kontraktuar, në kundërshtim me Kreun III "Kërkesat teknike të përdorimit të fondit kullosor për kullotje", pika 7, të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 2, datë 20.07.2016, "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari".
- Lidhur me pyjet e kullotat, ndonëse kanë kaluar në pronësi, nuk janë pasqyruar në kontabilitet, në llogarinë 211 "Pyjet, kullotat dhe plantacione", pasi aktivi i bilancit nuk paraqet fare gjendjen e kësaj llogarie, si dhe nuk është vijuar me regjistrimin e pronave të paregjistruara.
- Nuk janë mbajtur akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes, sipas Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për fondin kullosor", neni 29 "Organet e kontrollit", neni 30 "Dokumentimi".

Në përfundim, dhënia me qira e sipërfaqeve pyll dhe kullota vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në NJQV", VKM nr. 500, datë 14.08.2001, "Për inventarizimin e pronave në NJQV", Ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", pasi këto prona nuk janë të regjistruara në emër të NJQV, duke sjellë për pasojë të qenurit pronar me të drejta jo të plota por të kufizuara.

✓ **Në lidhje me inventarizimin e marrjen në dorëzim:**

Si çdo institucion publik edhe Bashkia Gramsh ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si, pronat, tokat dhe pasuritë natyrore. Një pjesë e konsiderueshme e pronave dhe tokave, Bashkia Gramsh i ka fituar nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, shpronësimeve si dhe një pjesë e tyre nga shkrirja e ish-komunave aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Gramsh.

Me qëllim pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Gramsh duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia etj.,.

- Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Bashkisë Gramsh dhe Njësive Administrative nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", neni 37, pika 1, ku përcaktohet që: "Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji".

- Në zbatim të Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore" si dhe në mbështetje të pikave 9-11, dhe 22 të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore", nuk janë ngritur grupet e punës, kjo e përcaktuar në misionin dhe detyrat e NJQV, administrimi i aseteve, si dhe struktura e ngarkuar për ndjekjen e tyre.
- Bashkia Gramsh nuk ka një regjistër kontabël në nivel bashkie për të gjitha asetet që ajo zotëron. Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Gramsh dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki nuk janë inventarizuar totalisht si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale.
- Nga auditimi u konstatua se nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.,), dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", nenet 27-28, parashikohet se, funksionet e bashkisë në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, funksionet e bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor.

Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, vënien në evidence të ndërtesave me sipërfaqe dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive të përcaktuara në listat e inventarëve, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira.

✓ **Regjistrimi pasurive:**

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për të gjitha njësitë administrative dhe për të gjitha kategoritë e pronave u konstatua se Bashkia Gramsh për vitet 2023-2024, nuk ka dërguar kërkesa pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh për regjistrimin e pasurive. Nga të gjithë pronat që administrohen nga vetë bashkia vetëm 59 prej tyre janë të pajisura me certifikatë pronësie, për të cilat ky titull është fituar që prej viteve 2004-2014. Të dhënat në lidhje me pronat e certifikuara ndër vite paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i pronës	Nr. i pasurisë	Data e regjistrimit	ZK	Adresa	Sip truall m^2	Sip ndërtimi m^2	Pasqyruar ose jo në bilancin e bashkisë
1	Garazhd	8/584	10.12.2014	1842	Lagjia "Sporti nr. 1	23	23	Po
2	Apartament	8/35 +1-5	15.12.2014	1842	Lagjia "Sporti"	25	25	Po
3	Dega e Mobilizimit	9/41	28.10.2004	1842	Lagjia "Sporti"	1,200	201	Po
4	Ish-Ndërmarrja e Ujrave	9/249	24.10.2008	1842	Lagjia "Sporti"	397.92	397.92	Po
5	Stadiumi	8/119	16.10.2009	1842	Lagjia "Sporti"	5,797.8	0	Po
6	Ish-Depo e Duhanit	1/63	14.09.2009	1842	Lagjia "Agjensia"	1,049.7	779	Po
7	Njësi	9/253	24.10.2008	1842	Lagjia "Sporti"	354.04	354.04	Po
8	Zyrat e Partisë Socialiste	7/131-N2	21.04.2010	1842	Lagjia "Holta"	126.5	126.5	Po
9	Shkolla Bregas	120/14	11.04.2017	1272	Fshati Bregas	300	87	Po
10	Godina e Shikut	9/66	05.11.2010	1842	Lagjia "Sporti"	1,323	273	Po
11	Ish-Ndermarrja e shqopave	7/97	20.10.2009	1842	Lagjia "Holta"	376	339.6	Po
12	Dhomë Mortale	51/52-1	10.09.2009	2167	Lagjia "Koçaj"	36.4	36.04	Po
13	Klinika Dentare	8/15	24.10.2008	1842	Lagjia "Sporti"	375	375	Po
14	Vend-Roja i Shkollës	8/40	10.11.2008	1842	Lagjia "Sporti"	15.7	15.7	Po
15	Dega e Tatimeve	9/97-N2	07.12.2010	1842	Lagjia "Sporti"	130	0	Po
16	Ish-Hotel Devolle	7/167-N18	11.08.2008	1842	Lagjia "Holta"	135	235.42	Po
17	Garazhdet e Bashkisë	7/130	31.03.2004	1842	Lagjia "Holta"	113.3	85.8	Po
18	Fidanishte	12/58	30.10.2009	1842	Lagjia "Holta"	6,588.4	0	Po
19	Shkolla e Mesme "Shefqet Guzi"	8/133	11.09.2009	1842	Lagjia "Sporti"	484.1	484.1	Po
20	Lavanderi e Konviktit	5/196	11.11.2008	1842	Lagjia "Xhile Liçi"	62.1	62.1	Po
21	Magazina e Konviktit	5/195	11.11.2008	1842	Lagjia "Xhile Liçi"	101.6	62.1	Po
22	Garazhd i Degës së Tatimeve	8/32	07.12.2010	1842	Lagjia "Sporti"	66.9	66.9	Po
23	Magazine e Shkollës "Rilindja"	8/35	15.10.2009	1842	Lagjia "Sporti"	398	398	Po
24	Fusha e grumbullimit të plehrave	1/6	16.11.2007	1842	Lagjia "Prakallinj"	12,352	0	Po
25	Godina e Bashkisë	7/131-N1	31.03.2004	1842	Lagjia "Holta"	330.5	307.5	Po
26	Zyra e Shoqatës së Gjuetareve	10/139-N3	19.03.2010	1842	Lagjia "Sporti"	18	18	Po
27	Zyrat e	10/139-N2	19.03.2010	1842	Lagjia "Sporti"	36	36	Po
28	Objekti "Y"	155/3	27.12.2010	2167	Lagjia "Koçaj"	310	310	Po
29	Stadium i ri	8/437	30.10.2009	1842	Lagjia "Sporti"	17,406.6	0	Po

30	Shkallët e stadiumit	8/204	26.01.2010	1842	Lagjia "Sporti"	110	0	Po
31	Varrezat Publike	51	14.09.2009	2167	Lagjia "Koçaj"	13,400	0	Po
32	Varrezat Publike	52	14.09.2009	2167	Lagjia "Koçaj"	2075	0	Po
33	Terren Sportiv	5/164	07.12.2010	1842	Lagjia "Sporti"	1,121.4	0	Po
34	Zyrat e Komunales Banesave	8/25-N1	24.10.2008	1842	Lagjia "Sporti"	15.24	40	Po
35	Kende Sportive	7/63	11.09.2009	1842	Lagjia "Holta"	3,568.9	0	Po
36	Zdrukthtari për Shërbime Funerale	8/88	10.11.2008	1842	Lagjia "Sporti"	25.6	110	Po
37	Tregu i Ri i Qytetit	8/265	05.01.2010	1842	Lagjia "Sporti"	2,297.2	674.2	Po
38	Dhomat e Zhveshjes	8/203	14.09.2009	1842	Lagjia "Sporti"	170.5	170.5	Po
39	Pallati i Sportit	8/202	20.10.2009	1842	Lagjia "Sporti"	1,068.8	1,068.8	Po
40	Ish-Konsultore e Gruas	8/156-N2	16.04.2010	1842	Lagjia "Sporti"	183	392.7	Po
41	Ish-Magazinë e Komunales	7/218	26.01.2010	1842	Lagjia "Holta"	30	30	Po
42	Dhome per sportistat	8/131	05.01.2010	1842	Lagjia "Sporti"	29	29	Po
43	Shkolla "35 Vjetori"	6/32	16.09.2009	1842	Lagjia "Sporti"	2,876.1	783.3	Po
44	Magazinë e Fidanishtes	12/40	14.09.2009	1842	Lagjia "Holta"	46.8	46.8	Po
45	Kopshti nr. 1	5/73	11.11.2008	1842	Lagjia "Xhile Liçi"	324	324	Po
46	Pallati i Kulturës	7/68	11.03.2009	1842	Lagjia "Holta"	1,189.8	1,189.8	Po
47	Qendra Kulturore e Fëmijëve	5/264	26.01.2010	1842	Lagjia "Holta"	466	344.2	Po
48	Kopshti nr. 3	8/156-N1	16.04.2010	1842	Lagjia "Sporti"	458	221	Po
50	Shkolla 9-Vjeçare "Rilindja"	8/36	14.09.2009	1842	Lagjia "Sporti"	1,065	1,065.4	Po
51	Konvikti i Shkollës	5/161	11.09.2009	1842	Lagjia "Holta"	438.8	304.1	Po
52	Shkolla 9-vjeçare "Asllan Shahini"	9/101	14.09.2009	1842	Lagjia "Holta"	808.5	808.5	Po
53	Kopshti nr. 2	5/59	14.09.2009	1842	Lagjia "Holta"	465	367	Po
54	Muzeu i qytetit	7/138A	14.09.2009	1842	Lagjia "Holta"	542	542	Po
55	Ish-Uzina e Pilave	10/179	14.09.2009	1842	Lagjia "Sporti"	8,887	6,867	Po
56	Kopshti nr. 4	9/43	14.09.2009	1842	Lagjia "Sporti"	321	321	Po
57	Kopshti nr. 5	10/47	14.09.2009	1842	Lagjia "Sporti"	197.1	197.1	Po
58	Magazine e çerdhes	5/96	14.09.2009	1842	Lagjia "Xhile Liçi"	95	95	Po
59	Ish-çerdhe	5/78	14.09.2009	1842	Lagjia "Xhile Liçi"	248.5	248.5	Po
Totali						**92,455.8**	**21,338.62**	**59**

- Për aktivet që i përkasin llogarive 210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje, kullota, plantacione", 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", Bashkia Gramsh të cilat janë të evidentuara në kontabilitet vetëm 59 prej tyre janë të pajisura me çertifikatë pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 35, gërma "a", "b" dhe "c" për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Bashkia Gramsh nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarive 210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje, kullota, plantacione", 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore".

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" Kreu IV neni 37 pika 1, 2, germat "a-b", Ligjin nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu (VI) "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme" dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26-30.

<u>Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura:</u>

- ✓ **Kontratat për dhënien me qira të pyjeve dhe kullotave verore për kullotje, kositje bari, krasitje gjethi dhe për ndërtime provizore nga qiramarrësit:**

Referuar pikës nr. 2, të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 2, datë 20.07.2016, "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari" citohet se, në përputhje me kohën e përdorimit, kullotat e livadhet klasifikohen në verore dhe dimërore, sipas këtyre kritereve:

2.1. Sipas ndarjes gjeografike të territorit te vendit:

a. Krahina malore veriore;

b. Krahina malore qendrore;
c. Krahina malore jugore;
2.2. Sipas shtrirjes së kullotave dhe livadheve në lartësi mbi nivelin e detit.
2.3. Sipas tipit të vegjetacionit dhe përbërjes së bimësisë së kullotave e livadheve, te përcaktuara në Manualin e Mbarështrimit të kullotave, i hartuar nga strukturat akademike të fushës së pyjeve.
Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, Bashkia Gramsh ka pasur aktive vetëm kontrata verore për dhënien me qira të ekonomive pyjore dhe kullosore.
Me VKB-në nr. 6, datë 26.01.2024, me objekt "Mbi miratimin e listës së kullotave e livadheve të gatshme për kullotje e kositje si dhe të kontratës tip". Sipërfaqet e miratuara për secilën ngastër apo nëngastër i referohen 6 (gjashtë) planeve të mbarështrimit të kryera ndër vite.
Kërkesat e paraqitura për kontratat e lidhura për dhënien me qira të kullotave verore janë administruar në Bashkinë Gramsh. Gjithashtu referuar vërtetimeve të banimit, personat fizik të cilët kanë nënshkruar kontrata me Bashkisë Gramsh janë banor të këtij qyteti, pra u është dhënë përparësi banorëve të kësaj zone sipas njësive administrative, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit nr. 2, datë 20.07.2016, "Kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotë e kositje bari", Kreu II "Procedurat e dhënies për kullotje dhe kositje bari", pika 6, germa "a" përcaktohet që: "Fillimisht plotësohen kërkesat e kërkuesve që janë nga fshatrat më afër vendndodhjes së kullotës apo livadhit".
Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, Bashkia Gramsh ka aktive 26 kontrata për dhënien me qira të kullotave me afat 6 mujor të llojit verore. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike në **Aneksin nr. 14.** Me zgjedhje janë audituar 5 kontrata ku u konstatua se:
1. Kontrata me nr. 1592 prot., datë 15.04.2024, nënshkruar ndërmjet Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. B. A. Kryetar i Bashkisë dhe z. E. B. "Fermer", me objekt kontratë "Verore" për marrjen me qira për kullotje/kositje bari/krasitje gjethi, për ndërtime provizore të qiramarrësit kullotë dimërore/verore e cila ndodhet në ekonominë kullosore "Sojnik-Kukur" në parcelën me nr. 27, me sipërfaqe 61.5 ha me kapacitet mbajtës 492 krerë. Afati i kontratës 3 vjet nga lidhja e kontratës. Vlera vjetore e qirasë është 3,750 lekë likuiduar me Mandat Arkëtimin nr. 534, datë 17.04.2024, e ndarë si më poshtë:
- Për dhentë krerë 25 x 100 lekë/krerë = 2,500 lekë;
- Qendër stani e rrethuar 20 m^2 x 50 lekë m^2/vit = 1,000 lekë;
- Ngrehinë banimi për barinj 5 m^2 x 50 lekë m^2/vit = 250 lekë;
Bashkëlidhur praktikës ndodhet kërkesa për marrjen me qira të kullotës me nr. 1358 prot., datë 28.03.2024; Deklarata Veterinare ku z. E. B. disponon 25 krerë të llojit "Të leshta"; Vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Gramsh me nr. 94 prot., datë 01.02.2024, që z. E. B. është banor i Njësisë Administrative Kukur; Skica e ngastrës e hartuar nga inxhinier znj. Ë. Q. si dhe është mbajtur procesverbali i datës 22.04.2024, për dorëzimin e ngastrës për kullotje ndërmjet palëve.
2. Kontrata me nr. 2193 prot., datë 03.06.2024, nënshkruar ndërmjet Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. B. A. Kryetar i Bashkisë dhe z. T. X. "Fermer", me objekt kontratë "Verore" për marrjen me qira për kullotje/kositje bari/krasitje gjethi, për ndërtime provizore të qiramarrësit kullotë dimërore/verore e cila ndodhet në ekonominë kullosore "Suhagorë-Guri Top" në parcelën me nr. 28, me sipërfaqe 125.35 ha me kapacitet mbajtës 1190 krerë. Afati i kontratës 3 vjet nga lidhja e kontratës. Vlera vjetore e qirasë është 13,700 lekë likuiduar me Mandat Arkëtimin nr. 899, datë 27.05.2024, e ndarë si më poshtë:
- Për dhentë krerë 100 x 100 lekë/krerë = 10,000 lekë;
- Qendër stani e rrethuar 70 m^2 x 50 lekë m^2/vit = 3,500 lekë;
- Ngrehinë banimi për barinj 4 m^2 x 50 lekë m^2/vit = 200 lekë;
Bashkëlidhur praktikës ndodhet kërkesa për marrjen me qira të kullotës me nr. 2193 prot., datë

23.05.2024; Deklarata Veterinare ku z. E. B. disponon 300 krerë të llojit "Të leshta" dhe 2 krerë "Njëthundrak"; Vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Gramsh me nr. extra prot., datë 03.05.2024, që z. T. X. është banor i Njësisë Administrative Leine; Skica e ngastrës e hartuar nga inxhinier znj. Ë. Q. si dhe është mbajtur procesverbali i datës 07.06.2024, për dorëzimin e ngastrës për kullotje ndërmjet palëve.

3. Kontrata me nr. 1871 prot., datë 03.05.2024, nënshkruar ndërmjet Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. B. A. Kryetar i Bashkisë dhe z. E. B. "Fermer", me objekt kontratë "Verore" për marrjen me qira për kullotje/kositje bari/krasitje gjethi, për ndërtime provizore të qiramarrësit kullotë dimërore/verore e cila ndodhet në ekonominë pyjore "Dushku i Bulçarit" në parcelat me nr. 9, nr. 10/a, nr. 10/b, nr. 11/a, nr. 11/b, nr. 46/2 me sipërfaqe 98.8 ha me kapacitet mbajtës 100 krerë. Afati i kontratës 3 vjet nga lidhja e kontratës. Vlera vjetore e qirasë është 21,200 lekë likuiduar me Mandat Arkëtimin nr. 640, datë 29.04.2024, e ndarë si më poshtë:

- Për dhentë krerë 240 x 50 lekë/krerë = 12,000 lekë;
- Për dhitë krerë 60 x 100 lekë/krerë = 6,000 lekë;
- Qendër stani e rrethuar 60 m^2 x 50 lekë m^2/vit = 3,000 lekë;
- Ngrehinë banimi për barinj 4 m^2 x 50 lekë m^2/vit = 200 lekë;

Bashkëlidhur praktikës ndodhet kërkesa për marrjen me qira të kullotës me nr. 1535 prot., datë 11.04.2024; Deklarata Veterinare ku z. E.B.disponon 240 krerë të llojit "Të leshta" dhe 60 "Të dhirta"; Vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Gramsh me nr. 116 prot., datë 09.04.2024, që z. E. B. është banor i Njësisë Administrative Kukur; Skica e ngastrës e hartuar nga inxhinier znj. Ë. Q. si dhe është mbajtur procesverbali i datës 05.05.2024, për dorëzimin e ngastrës për kullotje ndërmjet palëve.

4. Kontrata me nr. 1872 prot., datë 03.05.2025, nënshkruar ndërmjet Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. B. A. Kryetar i Bashkisë dhe z. Q. Sh. "Fermer", me objekt kontratë "Verore" për marrjen me qira për kullotje/kositje bari/krasitje gjethi, për ndërtime provizore të qiramarrësit kullotë dimërore/verore e cila ndodhet në ekonominë kullosore "Faqe e Malit të Bardhë" në parcelën me nr. 15/b, me sipërfaqe 23.33 ha me kapacitet mbajtës 100 krerë dhe parcelën nr. 15/b, me sipërfaqe 13.5 ha me kapacitet mbajtës 77 krerë. Afati i kontratës 3 vjet nga lidhja e kontratës. Vlera vjetore e qirasë është 23,950 lekë likuiduar me Mandat Arkëtimin nr. 743, datë 13.05.2024, e ndarë si më poshtë:

- Për dhentë krerë 200 x 100 lekë/krerë = 20,000 lekë;
- Për dhitë krerë 15 x 80 lekë/krerë = 1,200 lekë;
- Qendër stani e rrethuar 50 m^2 x 50 lekë m^2/vit = 2,500 lekë;
- Ngrehinë banimi për barinj 5 m^2 x 50 lekë m^2/vit = 250 lekë;

Bashkëlidhur praktikës ndodhet kërkesa për marrjen me qira të kullotës me nr. 813 prot., datë 20.02.2024; Deklarata Veterinare ku z. E. B. disponon 200 krerë të llojit "Të leshta", 15 "Të dhirta" dhe 1 "Njëthundrak"; Vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Gramsh me nr. 38 prot., datë 20.02.2024, që z. Q. S. është banor i Njësisë Administrative Skënderbegas; Skica e ngastrës e hartuar nga inxhinier znj. Ë. Q. si dhe është mbajtur procesverbali i datës 29.04.2024, për dorëzimin e ngastrës për kullotje ndërmjet palëve.

5. Kontrata me nr. 1591 prot., datë 15.04.2024, nënshkruar ndërmjet Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. B. A. Kryetar i Bashkisë dhe z. M. N. "Fermer", me objekt kontratë "Verore" për marrjen me qira për kullotje/kositje bari/krasitje gjethi, për ndërtime provizore të qiramarrësit kullotë dimërore/verore e cila ndodhet në ekonominë kullosore "Vidhan-Skënderbegas" në parcelën me nr. 13/b, me sipërfaqe 9.75 ha me kapacitet mbajtës 67 krerë dhe "Faqja e Kroit" parcelën nr. 19, me sipërfaqe 27.2 ha me kapacitet mbajtës 18 krerë. Afati i kontratës 3 vjet nga lidhja e kontratës. Vlera vjetore e qirasë është 34,500 lekë likuiduar me Mandat Arkëtimin nr. 468, datë 09.04.2024,

e ndarë si më poshtë:
- Për dhitë krerë 200 x 80 lekë/krerë = 16,000 lekë;
- Për të trasha krerë 15 x 800 lekë/krerë = 12,000 lekë;
- Qendër stani e rrethuar 125 m^2 x 50 lekë m^2/vit = 6,000 lekë;
- Ngrehinë banimi për barinj 10 m^2 x 50 lekë m^2/vit = 500 lekë;

Bashkëlidhur praktikës ndodhet kërkesa për marrjen me qira të kullotës me nr. 816 prot., datë 20.02.2024; Deklarata Veterinare ku z. M. N. disponon 200 krerë të llojit "Të drithta", 15 "Gjedhë" dhe 4 "Njëthundrakë"; Vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Gramsh me nr. 34 prot., datë 19.02.2024, që z. M.N. është banor i Njësisë Administrative Skënderbegas; Skica e ngastrës e hartuar nga inxhinier znj. Ë. Q. si dhe është mbajtur procesverbali i datës 29.07.2024, për dorëzimin e ngastrës për kullotje ndërmjet palëve.

Nga auditimi me zgjedhje i kontratave për dhënien me qira të ekonomive pyjore dhe kullosore të pyje dhe kullotave verore u konstatua se, në 3 raste (Kontrata me nr. 1871 prot., datë 03.05.2024, për ngastrat me nr. 9, nr. 10/a, nr. 10/b, nr. 11/a, nr. 11/b, nr. 46/2 me sipërfaqe 98.8 ha me kapacitet mbajtës 100 krerë dhe përdorim 300 krerë; Kontrata me nr. 1872 prot., datë 03.05.2025, për ngastrat me nr. 15/b, me sipërfaqe 23.33 ha me kapacitet mbajtës 100 krerë dhe nr. 15/b, me sipërfaqe 13.5 ha me kapacitet mbajtës 77 krerë dhe përdorim 215 krerë; Kontrata me nr. 1591 prot., datë 15.04.2024, për ngastrat me nr. nr. 13/b, me sipërfaqe 9.75 ha me kapacitet mbajtës 67 krerë dhe "Faqja e Kroit" nr. 19, me sipërfaqe 27.2 ha me kapacitet mbajtës 18 krerë dhe përdorim 215 krerë) dhënia në përdorim për kullotje nuk është kryer në përputhje me aftësinë mbajtëse kullosore pra ka tejkalim kapaciteti, duke j'u referuar planit të mbarështimit sipas ngastrave përkatëse. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për fondin kullosor" i ndryshuar, neni 15, pikat 1-3.

- ✓ **Kontratat për dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor për vendosjen e antenave telefonike:**

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2024, janë aktive 4 kontrata për dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor kullor për vendosjen e antenave telefonike, me afat nga 5 deri në 9 vjet, për të cilat është likuiduar detyrimi vjetor për vitin 2023 në vlerën 976,990 lekë dhe për vitin 2024 në vlerën 990,990 lekë. Nga auditimi i praktikës shoqëruese të rinovimit të kontratës konstatohet se, për kontratën me nr. 3341 prot., datë 01.09.2023, të lidhur me OE "T" Sh.a dhe nr. 5045 prot., datë 29.10.2024, të lidhur me OE "V" Sh.a. Ndërsa për kontratën me nr. 2180 prot., datë 22.05.2024, të lidhur me OE "T" Sh.a është përllogaritur servituda (rruga e kalimit) vetëm për vitin 2024 në masën 0.2 km në vlerën 14,000 lekë por ky detyrim nuk është aplikuar për vitin 2023. Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten në **Aneksin nr. 15.**

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në 391, datë 21.06.2006, "Për përcaktimin e tarifave në sektoin e pyjeve dhe kullotave" i ndryshuar, Lidhja nr. 2, "Tarifat dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik për ushtrim veprimtarie", pika 12, ku përcaktohet që:

12. Për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rijetin rrugor ekzistues		
Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës për sipërfaqen e marrë në përdorim lek/km/vit
1	Pyll trungishte	70,000
2	Pyll cungishte	50,000
3	Pyll shkurre	35,000
4	Kullota	35,000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	30,000
6	Inproduktive	25,000

- ✓ **Kontrata për dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor:**

Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, në territorin e Bashkisë Gramsh kanë

ushtruar aktivitet (referuar regjistrit të lejeve në faqen zyrtare të AKBN-së) 27 subjekte në fushën e energjitikës. Për 25 subjekte ndërmjet Bashkisë Gramsh dhe Shoqërive Koncesionare janë nënshkruar kontrata qiraje, ku për vitin 2024 vetëm 13 prej tyre kanë shlyer detyrimet në vlerën 6,238,609 lekë ndërsa vetëm Subjekti "R" ShPK nuk ka shlyer detyrimin në vlerën **622,860 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Gramsh.**

Për 12 subjekte është lidhur kontratë qiraje ndërmjet palëve por ende nuk ka filluar pagesë me pretendimin se këto subjekte nuk janë të pajisura me leje ndërtimi. Ndërkohë që referuar Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016, "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", pikat 19-21, pagesat e tarifave të qirasë fillojnë në momentin e lidhjes së kontratës. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike në **Aneksin nr. 16.**

Grupi i Auditimit bëri kërkesë për kontratat e qirave të fondit pyjor/kullosor lidhur me subjekte të cilat ushtrojnë aktivitetin në sektorin e burimeve minerare në Bashkinë Gramsh dhe Njësitë Administrative. Nga të dhënat e siguruara nga grupi i auditimit për subjekte të pajisura me kontratat e koncesionit sipas regjistrit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se përgjatë periudhës nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, në territorin e Bashkisë Gramsh, kanë ushtruar aktivitet në fushën e energjitikës 2 subjekte (nga të cilat Subjekti H... ShPK ushtron aktivitet në zonë të mbrojtur dhe menaxhimi i sak kryhet nga Agjencia e Kombëtare e Zonave të Mbrojtura) për të cilën Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit Bashkia Gramsh nuk administron dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj.,) sipas tabelës vijuese. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 17, të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për fondin kullosor", pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor" i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, "Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor". Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Nr.	Qarku	HEC-i	Shoqëria Koncesionare	Numri i Heceve	Forma e kontratës
1	Elbasan, Berat	Lenie, Çorovodë		2	BOT
71	Elbasan	Sotire 1, Sotire 2		2	BOT

Burimi i të dhënave: Faqe zyrtare e AKBN regjistri i lejeve.

- ✓ **Kontratat për dhënien me qira të tokave bujqësore:**

Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga Sektori i Shërbimeve Veterinare, Mbrojtjes së Tokës, Bujqësisë pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Bashkia Gramsh ka gjithsej 4,529 ha tokë bujqësore të pandarë në pronësi, nga të cilat 79.499 ha janë të dhëna me qira ndërsa pjesa e mbetur prej 4,449.5 ha është e lirë, por nuk disponohet informacion mbi hapësirat e zaptuara. Nga kjo drejtori, nuk janë evidentuar sipërfaqet e tokës bujqësore për dhënien me qira, nuk janë hartuar/përgatitur relacione drejtuar Këshillit Bashkiak për shqyrtimin dhe miratimin e sipërfaqeve të tokave bujqësore që mund të jepen me qira. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", pika 2. Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, janë aktive 47 kontrata për dhënien me qira të tokës bujqësore me afat 99 vjeçar, për të cilat është likuiduar detyrimi vjetor në vlerën 482,285.5 lekë. Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten në **Aneksin nr. 17.**

- ✓ **Kontrata për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike:**

Me shkresën nr. 4010 prot., datë 16.09.2024, është hartuar Raporti Teknik "Mbi studimin tekniko-

ekonomik për dhënie në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor në pronësi të Bashkisë Gramsh", nga grupi i punës i përbërë nga z. B. C., z. X. M. dhe z. E. R. i ngritur në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 319, datë 10.09.2024.
Me VKB-në nr. 63, datë 18.09.2024, është miratuar dhënia në përdorim me kontratë qiraje pyjore të sipërfaqes prej 12 ha e cila shtrihet në zonën kadastrale 1556, 1736 dhe 3262, në ngastrat/nëngastrat pyjore me nr. 1/e, 2/b, dhe 23/d, të cilat janë pjesë e ekonomisë pyjore "Galigat-Strorë", për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë. Vendimi i sipërpërmendur ka marrë konfirmimin mbi bazueshmërinë ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1016/1 prot., datë 30.09.2024. Më datë 25.11.2024, ndërmjet Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. B. A. Kryetar i Bashkisë dhe Subjektit "O" ShPK përfaqësuar nga z. A. H., është nënshkruar kontrata me nr. 4932 Rep., nr. 1571 Kol., me objekt "Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike 11.5 MW", me afat 10 vjeçar dhe vlerë kontrate 1,752,000 lekë. Për realizimin e objektit të kontratës është marrë me qira sipërfaqja prej 12 ha, e cila shtrihet në zonën kadastrale 1556, 1736 dhe 3262, në ngastrat/nëngastrat pyjore me nr. 1/e, 2/b, dhe 23/d, të cilat janë pjesë e ekonomisë pyjore "Galigat-Strorë".
Në lidhje me këtë situatë janë kryer verifikimet përkatëse mbi statusin e gjendjes së ngastrave të cilat janë dhënë sipas kontratës së sipërcituar ku u konstatua se:
- Në planin e mbarshtrimit për ngastrën nr. 1/e në ekonominë pyjore "Galigat-Storë", tipologjia e kësaj ngastre është joproduktive.
Në këtë dokument në çështjet shënime citohet se: "Sipërfaqe me bimësi pyjore. Mbulesa bimore nuk shkon as në 10% të sipërfaqes. Kryesisht cemedell, mrete, dëllinjë dhe rrallë ndonjë shkurre e shkozës së zezë. Të mbetet nën suksesionin natyrore, të ndiqet ecuria e grumbullimit". Ndërkohë që referuar VKM-së nr. 433, datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive" i ndryshuar, nr. rendor 565, EL 26 00 001 e, Ekonomia Pyjore Galiat-Storë me sipërfaqe 27.20 ha i përket kategorisë "Pyll".
- Në planin e mbarshtrimit për ngastrën nr. 2/b në ekonominë pyjore "Galigat-Storë", tipologjia e kësaj ngastre është joproduktive.
Në këtë dokument në çështjet shënime citohet se: Sipërfaqe me bimësi pyjore e kryesuar nga shqema dhe ralle ndonjë dëllinjë apo prall. Të mbetet nën suksesion natyrore, pasi ndërhyrja me pyllëzime ka rrezikuar disa herë dështimin.
Në planin e mbarshtrimit për ngastrën nr. 23/d në ekonominë pyjore "Galigat-Storë", tipologjia e kësaj ngastre është joproduktive.
Në këtë dokument në çështjet shënime citohet se: Sipërfaqe të veshura me bimësi pyjore të rralla, kryesisht Dellinja dhe cemodelli. Bimësia nuk mbulon as 10% të totalit të sipërfaqes. Të mbetet nën suksesion natyrore.
Ndërkohë që referuar VKM-së nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar, nr. rendor 610, EL 26 00 023 d, Ekonomia Pyjore Galiat-Storë me sipërfaqe 6.70 ha i përket kategorisë "Djerr".
Në kontratën e qirasë të nënshkruar në vitin 2024, u konstatua se për pasuritë e dhëna me qira nga Bashkia Gramsh nuk është bërë regjistrimi i tyre në ASHK. Pajisja e tyre me certifikatë pronësie është kusht për disponimin dhe tjetërsimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 144, neni 192 dhe neni 194.

- ✓ **Kontratat për dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor shfrytëzimin e materialit drusor:**

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2024, në total janë aktive 9 kontrata për dhënien

me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor kullor për shfrytëzimin e materialit drusor, për të cilat është likuiduar detyrimi për vitin 2023 në vlerën 2,767,762 lekë dhe për vitin 2024 në vlerën 5,726,677 lekë sipas kësteve përkatëse. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike në **Aneksin nr. 18.**

✓ **Kontratat për dhënien me qira të objekteve/ndërtesave:**

Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, Bashkia Gramsh ka dhënë në përdorim me qira 26 objekte banimi/ndërtesa (kontrata ekzistuese) me një sipërfaqe totale prej 4,737.6 m^2, nga të cilat 23 prej tyre për objekte banimi dhe 3 me kontratë enfiteozë. Për sa i përket qiramarrësve që përdorin ndërtesat për objekt banimi vetëm 15 prej tyre janë të pajisur me kontratë qiraje aktive, ndërsa 8 prej tyre nuk janë të pajisur me kontratë qiraje. Nga auditimi u konstatua se, deri më datë 31.12.2023, gjendja debitore ka qenë në vlerën 4,850,595 lekë. Përgjatë vitit 2024 është likuiduar vlera 543,500 lekë dhe janë krijuar detyrime në vlerën 947,160 lekë, ndërsa gjendja debitore më datë 31.12.2024, është në vlerën **5,254,255 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Gramsh.**

Mos lidhja e kontratës së qirasë me të gjithë poseduesit e objekteve të banimit të cilat janë pronë e Bashkisë Gramsh është në shkelje të kërkesave të VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar, Kreu I, pika 6, germa "a", nënpika "i". Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike në **Aneksin nr. 19.** Për sa i përket kontratave për dhënien me qira enfiteozë është shlyer detyrimi vjetor në vlerën totale prej 2,516,940 lekë. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Lekë

Nr.	Subjekti	Nipti	Afati	Viti i lidhjes së kontratës	Sipërfaqe në m^2	Vlera në vit	Vlera e likuiduar	Detyrimet e pa likuiduara
1	V.	...	20 vjet	15.04.2022	1,220	1,211,040	1,211,040	0
2	A .	...	20 vjet	26.07.2022	672	685,800	685,800	0
3	A. M.	...	20 vjet	25.012023	548	620,100	620,100	0
Totali						**2,516,940**	**2.516.940**	**0**

Burimi i të dhënave: Bashkia Gramsh.

✓ **Kontrata për blerjen e pasurive të paluajtshme:**

Me shkresën nr. 1712 prot., datë 23.04.2024, nga z. E. H. Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit është hartuar relacioni me objekt "Për miratimin e pjesëmarrjes së Bashkisë Gramsh në Ankandin Publik që do të zhvillohet nga Enti Kombëtar i Banesave me objekt shitjen e 12 (dymbëdhjetë) garazheve me sipërfaqe 351.03 m^2 në banesën me 8 kate dhe një kat parkim nën tokë e ndërtuar me fondet e EKB-së në qytetin e Gramshit", miratuar nga z. B. A. Kryetar i Bashkisë.

Ky dokumentacion është përcjellë pranë Këshillit Bashkiak Gramsh. Në këtë relacion citohet se: "Enti Kombëtar i Banesave ka shpallur Ankandin e hapur Publik për shitjen e 12 (dymbëdhjetë) garazhdeve me sipërfaqe totale 351.03 m² në banesën me 8 kate dhe një kat parkim nën tokë e ndërtuar nga ana e tyre në qytetin e Gramshit.

Vlera fillestare e ankandit është 22,632 lekë/m^2 ose me një vlerë të përgjithshme prej 7,944,511 lekë. Në zbatim të VKM-së nr. 898, datë 18.11.2020, "Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave dhe të objekteve të kthyera në fond banese të paprivatizuara", vlera që do të paguhet paraprakisht nga fituesi është 10% e vlerës së shitjes ose 794,451 lekë".

Me Vendimin nr. 34, datë 29.04.2024, të Këshillit Bashkiak është miratuar pjesëmarrja e Bashkisë Gramsh në Ankandin Publik që do të zhvillohet nga EKB me objekt "Shtijen e 12 garazhdeve me sipërfaqen totale 351.03 m^2 në banesën me 8 kate dhe një ka parkimi nën tokë e ndërtuar me fondet e EKB-së në Qytetin e Gramshit", e cila ka marrë konfirmimin mbi bazueshmërinë ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan me shkresën nr. 575/1 prot., datë 15.05.2024, administruar pranë Bashkisë Gramsh me praktikën nr. 1712/3 prot., datë 16.05.2024.

Me shkresën nr. 587/6 prot., datë 20.05.2024, nga z. S. Ç. në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor (EKB) ka dërguar pranë Bashkisë Gramsh Formulari i Njoftimit Fitues të Ankandit Publik. Në këto dokument evidentohet se, Bashkia Gramsh është shpallur fitues, si ofertës të paraqitur si më poshtë:

- Vendparkimi G1 me sipërfaqe 32.49 m^2 = 735,313.68 lekë;
- Vendparkimi G2 me sipërfaqe 33.28 m^2 = 753,192.96 lekë;
- Vendparkimi G3 me sipërfaqe 33.07 m^2 = 748,440.24 lekë;
- Vendparkimi G4 me sipërfaqe 32.5 m^2 = 735,540 lekë;
- Vendparkimi G5 me sipërfaqe 34.57 m^2 = 782,388.24 lekë;
- Vendparkimi G6 me sipërfaqe 27.66 m^2 = 626,001.12 lekë;
- Vendparkimi G7 me sipërfaqe 26.18 m^2 = 582,505.76 lekë;
- Vendparkimi G8 me sipërfaqe 26.18 m^2 = 592,505.76 lekë;
- Vendparkimi G9 me sipërfaqe 25.08 m^2 = 567,610.56 lekë;
- Vendparkimi G10 me sipërfaqe 26.18 m^2 = 592,505.76 lekë;
- Vendparkimi G11 me sipërfaqe 26.18 m^2 = 592,505.76 lekë;
- Vendparkimi G12 me sipërfaqe 27.66 m^2 = 626,001.12 lekë;

Në vijim të korrespodencës ndërmjet palëve janë nënshkruar kontratat e mëposhtme:

1. Më datë 23.07.2024, ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave të përfaqësuar nga znj. L. K. sipas autorizimit të datës 27.05.2024, dhe Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. A. S. sipas autorizimit me nr. 1949 prot., datë 10.05.2024, është lidhur kontrata me nr. 3331 Rep., nr. 1479 Kol., me objekt "Shitje pasurie të paluajtshme me kusht", të pasurisë me nr. 8/590-GR1, të llojit "Garazhd" me sipërfaqe 32.49 m^2.

2. Më datë 23.07.2024, ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave të përfaqësuar nga znj. L. K. sipas autorizimit të datës 27.05.2024, dhe Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. A. S. sipas autorizimit me nr. 1949 prot., datë 10.05.2024, është lidhur kontrata me nr. 3332 Rep., nr. 1480 Kol., me objekt "Shitje pasurie të paluajtshme me kusht", të pasurisë me nr. 8/590-GR2, të llojit "Garazhd" me sipërfaqe 32.28 m^2.

3. Më datë 23.07.2024, ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave të përfaqësuar nga znj. L. K. sipas autorizimit të datës 27.05.2024, dhe Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. A. S. sipas autorizimit me nr. 1949 prot., datë 10.05.2024, është lidhur kontrata me nr. 3333 Rep., nr. 1481 Kol., me objekt "Shitje pasurie të paluajtshme me kusht", të pasurisë me nr. 8/590-GR3, të llojit "Garazhd" me sipërfaqe 33.07 m^2.

4. Më datë 23.07.2024, ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave të përfaqësuar nga znj. L. K.sipas autorizimit të datës 27.05.2024, dhe Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. A. S. sipas autorizimit me nr. 1949 prot., datë 10.05.2024, është lidhur kontrata me nr. 3334 Rep., nr. 1482 Kol., me objekt "Shitje pasurie të paluajtshme me kusht", të pasurisë me nr. 8/590-GR4, të llojit "Garazhd" me sipërfaqe 32.5 m^2.

5. Më datë 23.07.2024, ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave të përfaqësuar nga znj. L. K. sipas autorizimit të datës 27.05.2024, dhe Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. A. S. sipas autorizimit me nr. 1949 prot., datë 10.05.2024, është lidhur kontrata me nr. 3335 Rep., nr. 1483 Kol., me objekt "Shitje pasurie të paluajtshme me kusht", të pasurisë me nr. 8/590-GR5, të llojit "Garazhd" me sipërfaqe 34.57 m^2.

6. Më datë 23.07.2024, ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave të përfaqësuar nga znj. L. K. sipas autorizimit të datës 27.05.2024, dhe Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. A. S. sipas autorizimit me nr. 1949 prot., datë 10.05.2024, është lidhur kontrata me nr. 3336 Rep., nr. 1484 Kol., me objekt "Shitje pasurie të paluajtshme me kusht", të pasurisë me nr. 8/590-GR6, të llojit "Garazhd" me sipërfaqe 27.66 m^2.

7. Më datë 23.07.2024, ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave të përfaqësuar nga znj. L. K. sipas autorizimit të datës 27.05.2024, dhe Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. A. S. sipas autorizimit me nr. 1949 prot., datë 10.05.2024, është lidhur kontrata me nr. 3337 Rep., nr. 1485 Kol., me objekt "Shitje pasurie të paluajtshme me kusht", të pasurisë me nr. 8/590-GR7, të llojit "Garazhd" me sipërfaqe 26.18 m^2.
8. Më datë 23.07.2024, ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave të përfaqësuar nga znj. L. K.sipas autorizimit të datës 27.05.2024, dhe Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. A. S. sipas autorizimit me nr. 1949 prot., datë 10.05.2024, është lidhur kontrata me nr. 3338 Rep., nr. 1486 Kol., me objekt "Shitje pasurie të paluajtshme me kusht", të pasurisë me nr. 8/590-GR8, të llojit "Garazhd" me sipërfaqe 26.18 m^2.
9. Më datë 23.07.2024, ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave të përfaqësuar nga znj. L.K. sipas autorizimit të datës 27.05.2024, dhe Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. A.S. sipas autorizimit me nr. 1949 prot., datë 10.05.2024, është lidhur kontrata me nr. 3339 Rep., nr. 1487 Kol., me objekt "Shitje pasurie të paluajtshme me kusht", të pasurisë me nr. 8/590-GR9, të llojit "Garazhd" me sipërfaqe 25.08 m^2.
10. Më datë 23.07.2024, ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave të përfaqësuar nga znj. L. K. sipas autorizimit të datës 27.05.2024, dhe Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. A. S. sipas autorizimit me nr. 1949 prot., datë 10.05.2024, është lidhur kontrata me nr. 3340 Rep., nr. 1488 Kol., me objekt "Shitje pasurie të paluajtshme me kusht", të pasurisë me nr. 8/590-GR10, të llojit "Garazhd" me sipërfaqe 26.18 m^2.
11. Më datë 23.07.2024, ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave të përfaqësuar nga znj. L. K.sipas autorizimit të datës 27.05.2024, dhe Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. A. S.sipas autorizimit me nr. 1949 prot., datë 10.05.2024, është lidhur kontrata me nr. 3341 Rep., nr. 1489 Kol., me objekt "Shitje pasurie të paluajtshme me kusht", të pasurisë me nr. 8/590-GR11, të llojit "Garazhd" me sipërfaqe 26.18 m^2.
12. Më datë 23.07.2024, ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave të përfaqësuar nga znj. L. K. sipas autorizimit të datës 27.05.2024, dhe Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. A. S. sipas autorizimit me nr. 1949 prot., datë 10.05.2024, është lidhur kontrata me nr. 3342 Rep., nr. 1490 Kol., me objekt "Shitje pasurie të paluajtshme me kusht", të pasurisë me nr. 8/590-GR12, të llojit "Garazhd" me sipërfaqe 27.66 m^2.
Në vijim të ecurisë së procesit të blerjes së pasurive të paluajtshme, Bashkia Gramsh ka kryer pagesën prej 10% të vlerës totale të kontratës 794,442 lekë për llogari të Entit Kombëtar të Banesave sipas Urdhër Shpenzimit nr. 526, datë 18.07.2024. Ndërsa kësti i parë është likuiduar nëpërmjet Urdhër Shpenzimit nr. 627, datë 29.08.2024, në vlerën 437,476 lekë, në zbatim të pikës 2 "Çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës" së kontratave të sipërpërmendura.
- Nga auditimi u konstatua se për të 12 (dymbëdhjetë) kontratat me objekt "Shitje pasurie e paluajtshme me kusht", në Seksionin D "Kufizimet e pronësisë", të Kartelës së Pasurisë së paluajtshme nuk është shënuar bllokimi (kushti i kontratës), i cili bllokon këtë pasuri në favor të palës blerëse deri në shlyerjen e plotë të detyrimit sipas nenit 2 "Çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës" si dhe Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 746 "Shitja me rezervë e pronëse", përcaktohet që: "Kur çmimi i shitjes paguhet me këste, blerësi e fiton pronësinë e sendit me pagimin e kështit të fundit të çmimit, duke marrë përsipër rreziqet që në çastin e dorëzimit. Kalimi me rezervë i pronësisë me kushtin e sipërm duhet të pasqyrohet në kontratë".

✓ **Kontrata për shitjen e pasurive të paluajtshme:**
Me VKB-në nr. 39, datë 31.03.2022, me objekt "Për kalimin në fond banese të objekteve "Ish-Uzina e Pilave" në pronësi të Bashkisë Gramsh për nevoja strehimi", për 19 objekte me sipërfaqen

totale prej 5,924 m^2, e cila ka marrë konfirmimin nga institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan me shkresën 495/1 prot., datë 19.04.2022, administruar në Bashkinë Gramsh me praktikën nr. 1120/3 prot., datë 26.04.2022. Lista emërore e objekteve të dhëna me qira dhe privatizimi në emër të poseduesve:

Objekti nr. 1:
Pasuria nr. 10/310-ND-1 me sipërfaqe totale S = 560 m^2
Emërtimi: Ish-Magazina dhe Kovaçan
Me posedues:
1. S. P. (në proces privatizimi)
2. T. Z.
3. A. B.
4. D. Ll. (në proces privatizimi)
5. Z. M.

Objekti nr. 2:
Pasuria nr. 10/310-ND-2 me sipërfaqe totale S = 118 m^2
Emërtimi: Ish-Ndërtesë e Elektrodave
Me posedues:
1. E. C.
2. E. I.

Objekti nr. 3:
Pasuria nr. 10/310-ND-3 me sipërfaqe totale S = 390 m^2
Emërtimi: Ish-Magazinë e Tharjes së Letrës
Me posedues:
1. G. K. (në proces privatizimi)
2. V. H.
3. A. C.
4. M. T.
5. K. Ll.
6. N. F.
7. Eni Daja

Objekti nr. 4:
Pasuria nr. 10/310-ND-4 me sipërfaqe totale S = 25 m^2
Emërtimi: Ish-Axusteri
Me posedues:
1. M. T.

Objekti nr. 5:
Pasuria nr. 10/310-ND-5 me sipërfaqe totale S = 110 m^2
Emërtimi: Ish-Gabinë Elektrike
Me posedues:
1. A. S.

Objekti nr. 6:
Pasuria nr. 10/310-ND-6 me sipërfaqe totale S = 470 m^2
Emërtimi: Ish-Laborator dhe Mencë
Me posedues:
1. A. Xh.
2. A. Xh.
3. A. Xh.

4. S. Xh.

Objekti nr. 7:
Pasuria nr. 10/310-ND-7 me sipërfaqe totale S = 936 m^2
Emërtimi: Ish-Magazinë për Përzierje Ngjitësi
Me posedues:
1. E. P.
2. A. Ç.
3. B. Ç.
4. S. Ç.
5. G. R.
6. N. Q.

Objekti nr. 8:
Pasuria nr. 10/310-ND-8 me sipërfaqe totale S = 663 m^2
Emërtimi: Ish-Depo dhe Ofiçinë
Me posedues:
1. E. B. (në proces privatizimi)
2. A. H.
3. G. P.
4. V. B.
5. T. Z.

Objekti nr. 9:
Pasuria nr. 10/310-ND-9 me sipërfaqe totale S = 145 m^2
Emërtimi: Ish-Administrat
Me posedues:
1. V. B. (në proces privatizimi)
2. F. H.
3. I. T.

Objekti nr. 10:
Pasuria nr. 10/310-ND-10 me sipërfaqe totale S = 30 m^2
Emërtimi: Ish-Vend Roje
Me posedues:
1. G. Ç.

Objekti nr. 11:
Pasuria nr. 10/310-ND-11 me sipërfaqe totale S = 432 m^2
Emërtimi: Ish-Depo
Me posedues:
1. A. Rr.
2. Iglis Xhelili (në proces privatizimi)

Objekti nr. 12:
Pasuria nr. 10/310-ND-12 me sipërfaqe totale S = 104 m^2
Emërtimi: Ish-Depo
Me posedues:
1. E. B.

Objekti nr. 13:
Pasuria nr. 10/310-ND-13 me sipërfaqe totale S = 1500 m^2
Emërtimi: Ish-Korpuesi i Shufrave të Karbonit
Me posedues:

1. Sh. E.
2. R. B.
3. P. R.

Objekti nr. 14:
Pasuria nr. 10/310-ND-14 me sipërfaqe totale S = 110 m^2
Emërtimi: Ish-Magazinë për Bluarje Qymyri
Me posedues:
1. V. H.

Objekti nr. 15:
Pasuria nr. 10/310-ND-15 me sipërfaqe totale S = 450 m^2
Emërtimi: Ish-Kaldaj
Me posedues:
1. Sh.B.
2. A. S.
3. A. H.

Objekti nr. 4:
Pasuria nr. 10/139-ND-4 me sipërfaqe totale S = 135 m^2
Emërtimi: Ish-Zyrë
Me posedues:
1. P. Sh.

Objekti nr. 16:
Pasuria nr. 10/310-ND-16 me sipërfaqe totale S = 525 m^2
Emërtimi: Ish-Depo
Me posedues:
1. K. K.
2. Enkelada Latifi (në proces privatizimi)
3. O. T.
4. V. B.
5. S. M.

Objekti nr. 17:
Pasuria nr. 10/310-ND-17 me sipërfaqe totale S = 196 m^2
Emërtimi: Ish-Zjarrfikëse
Me posedues:
1. F. K.
2. S. M.

Objekti nr. 19:
Pasuria nr. 10/310-ND-19 me sipërfaqe totale S = 25 m^2
Emërtimi: Ish-Stacion Pompimi
Me posedues:
1. Xh. Xh.

Për sa trajtuar më sipër, lidhur me realizimin e procedurës së privatizimit për 19 objektet e përcaktuara në VKB-në nr. 39, datë 31.03.2022, me objekt "Për kalimin në fond banese të objekteve "Ish-Uzina e Pilave" në pronësi të Bashkisë Gramsh për nevoja strehimi", u konstatua se në tre raste nuk rakordon sipërfaqja e objekteve sipas VKB-së me atë të është përfituar apo është në proces privatizimi konkretisht:

- Për objektin nr. 9, me emërtimin "Ish-Administrata", sipërfaqja e miratuar në VKB për tre përfitues është 145 m^2 ndërkohë që sipas aplikimeve për privatizim sipërfaqja është 111 m^2 me një

diferencë prej 34 m^2.
- Për objektin nr. 11, me emërtimin "Ish-Depo", sipërfaqja e miratuar në VKB për dy përfitues është 432 m^2 ndërkohë që sipas aplikimeve për privatizim sipërfaqja është 400 m^2 me një diferencë prej 32 m^2.
- Për objektin nr. 13, me emërtimin "Ish-Kopshti i Shufrave të Karbonit", sipërfaqja e miratuar në VKB për dy përfitues është 500 m^2 ndërkohë që sipas aplikimeve për privatizim sipërfaqja është 431.75 m^2 me një diferencë prej 68.25 m^2.
Miratimi i sipërfaqes nga Këshilli Bashkiak më tepër të sipërfaqeve nga kontratat e qirasë për ambientet të cilat janë kthyer si fond banese, ndikon drejtpërdrejte në procesin e privatizimit, për arsye se aplikanti mund ta përfitojë objektin nëpërmjet procedurës së privatizimit deri në 200 m^2 në të kundërt jo. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike në **Aneksin nr. 20.**

- ✓ **Kontratat për dhurimin e pasurive të paluajtshme:**

Nga auditimi u konstatua se, Devolli Hydropower Sh.A është Koçesionari i Projektit Hidroenegjitik të Devollit, në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit Hidroenergjetik mbi Lumin e Devollit në Republikën e Shqipërisë më datë 19.12.2008, ku është ratifikuar në Parlamentin e RSH me anë të Ligjit nr. 10083, datë 23.02.2009, dhe i plotësuar nga shtesat 1, 2, dhe 3 (Marrëveshja e Koncesionit). Bazuar në Klauzolën 3, 4, 6 të Marrëveshjes së Koncesionit, AK (Ministria e Energjitikës dhe Industrisë) ka miratuar shpronësimin e parcelave të shtëpive të fshatit Drizë me anë të VKM-së nr. 656, datë 26.09.2012, ndryshuar me VKM-në nr. 860, datë 21.10.2015.
Pasuritë e shpronësuara sipas VKM-ve të mësipërme janë vënë në dispozicion të Koncesionarit nëpërmjet VKM-së nr. 443, datë 22.05.2013. Sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin e shpronësimit të pasurive private për interes publik nr. 856, datë 22.12.21999, DHP ka hapur një llogari garancie për të gjitha kostot e shpronësimit ndaj pronarëve të shpronësuar, përfshirë fshatin Drizë dhe Cingar i Poshëm dhe Kompensimi për Shpronësimin është depozituar aktualisht edhe në llogarinë Escrow e hapur për këtë qëllim nga DHP.
DHP për personat e prekur nga projekti aplikon Kriteret e Standardeve të Performancës së IFC-së mbi të Drejtat mbi Tokën dhe Zhvendosjes së Pavullnetshme (PS5) dhe me qëllim mundësimin e Personave të Prekur nga Projekti të njëjtin nivel jetese, i ka ofruar personave të prekur të marrin pjesë në inventarin socio-ekonomik, në bazë të të cilit do të përllogaritej edhe përfitimi i shtëpisë zëvendësuese, si edhe standardet e saj. Sipas këtij program DHP merr përsipër të ndërtonte shtëpi zëvendësuese duke mbuluar diferencën e vlerës së nevojitur për ndërtimin e shtëpisë së re, para përmbytjes së shtëpisë ekzistuese.
FPP-të nuk kanë pranuan të merrnin pjesë në Inventarin Socio-Ekonomik deri në afatin përfundimtar dhe nuk pranuan të ishin pjesë e inventarit siç përcaktohet sipas programit të risistemimit. AK Ministria e Energjitikës dhe Industrisë pas fillimit të përmbytjes së rezervuarit të Banjës, i kërkoi DHP-së të përfshinte shtëpitë e FPP të përmendurat te kontratat e dhurimit, të cilët nuk pranuan ftesën e DHP-së në pjesëmarrjen në programin social/risistemimit.
Pas kërkesës së AK MEI i delegoi Bashkisë Gramsh autoritetin për t'u bërë pjesë e Marrëveshjes për Ndarjen e Përgjegjësive së bashku me DHP-në dhe Mei për financimin, projektimin, tenderimin, ndërtimin dhe dorëzimin e apartamenteve zëvendësuese tek Përfituesi i Apartamenteve Zëvendësuese, që preken nga projekti hidroenergjitik të Devollit, HEC-i i Banjës, fshatrat Drizë dhe Cingar i Poshtëm.
Për realizimin e procesit DHP, MEI dhe Bashkia Gramsh në datën 24.04.2017, kanë nënshkruar një marrëveshje për ndarjen e përgjegjësive në këtë proces, duke përfshirë të gjitha etapat e ndërtimit të apartamenteve. Referuar kësaj marrëveshje janë vendosur kushtet e mëposhtme:
- DHP do të financojë pjesërisht Projektin e Posaçëm të Risistemimit duke marrë përsipër

projektimin, tenderimin dhe ndërtimin e apartamenteve zëvendësuese;
- Bashkia Gramsh do të ketë përgjegjësinë për vënien në dispozicion të tokës mbi të cilën do të ndërtohet, lejet dhe licencat e duhura për ndërtimin, marrëdhëniet drejtpërdrejt me FPP-të;
- MEI/AK do të sigurojë përmbushjen e detyrimeve qe Bashkia ka marrë përsipër në Marrëveshjen për ndarjen e përgjegjësive;
Marrëveshja për ndarjen e përgjegjësive në lidhje me 14 apartamente zëvendësuese në qytetin e Gramshit, pika "h" e marrëveshjes përcaktohet se: "Përfituesi synon të sigurojë dhe japë akses tek trualli, të japë licencat dhe lejet, si dhe të dorëzojë apartamentet tek Familjet e Prekura nga Projekti, që janë përfituesit përfundimtarë".
Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion janë nënshkruar kontratat si më poshtë:
- Më datë 02.04.2024, ndërmjet Bashkisë Gramsh të përfaqësuar nga znj. Z. D. sipas prokurës së përgjithshme me nr. Rep 192., nr. Kol 120., më datë 16.02.2024, dhe palës përfituese z. Q.Z., znj. X. Z., znj. A.S., z. R. Z. dhe znj. F. L. është lidhur kontrata e dhurimit me nr. Rep., nr. 355, nr. 205 Kol., me objekt "Kontratë dhurimi pasurie të paluajtshme", të Pasurisë të paluajtshme e llojit Apartament, Shkalla nr. 2, Hyrja nr. 1, Apartamenti nr. 9; me nr. pasurie 8/647+1-9, vol 25, faqe 13, ZK 1842, me sipërfaqe 66 m².
- Më datë 03.04.2024, ndërmjet Bashkisë Gramsh të përfaqësuar nga znj. Z. D. sipas prokurës së përgjithshme me nr. Rep., 192, nr. Kol., 120, më datë 16.02.2024, dhe palës përfituese z. B. S. Z. është lidhur kontrata e dhurimit me nr. Rep., 358, dhe nr. Kol., 208, me objekt "Kontratë dhurimi pasurie të paluajtshme", të Pasurisë të paluajtshme e llojit Apartament, Shkalla nr. 2, Hyrja nr. 1, Apartamenti nr. 11, me nr. pasurie 8/647+1-11, vol 25, faqe 15, ZK 1842, me sipërfaqe 119.5 m².
- Më datë 29.03.2024, ndërmjet Bashkisë Gramsh të përfaqësuar nga znj. Z. D. sipas prokurës së përgjithshme me nr. Rep., 192, nr. Kol., 120, në datë 16.02.2024, dhe palës përfituese z. E. M., znj. F. K., z. D. M. dhe znj. S. M. është lidhur kontrata e dhurimit me nr. Rep., 1033, dhe nr. Kol., 588, me objekt "Kontratë dhurimi pasurie të paluajtshme", të Pasurisë të paluajtshme e llojit Apartament, Shkalla nr. 2, Apartamenti nr. 9, me nr. pasurie 8/115+1-9, vol 18, faqe 86, ZK 1842, me sipërfaqe 77 m².
- Më datë 20.03.2023, ndërmjet Bashkisë Gramsh të përfaqësuar nga znj. Dh. Ç. sipas prokurës së posaçme me nr. Rep., 402, nr. Kol., 166, në datë 28.02.2020, dhe palës përfituese z. X. Ç. dhe z. S. Ç. është lidhur kontrata e dhurimit me nr. Rep., 387, dhe nr. Kol., 187, me objekt "Kontratë dhurimi pasurie të paluajtshme", të Pasurisë të paluajtshme e llojit Apartament, Shkalla nr. 1, Hyrja nr. 1 Apartamenti nr. 6, me nr. pasurie 8/647+1-6, vol 25, faqe 10, ZK 1842, me sipërfaqe 92.3 m².
- Më datë 08.04.2024, ndërmjet Bashkisë Gramsh të përfaqësuar nga znj. Z. D. sipas prokurës së përgjithshme me nr. Rep 192, nr. Kol 120., më datë 16.02.2024, dhe palës përfituese z. L. Ç., znj. O. L. dhe z. P. Ç. është lidhur kontrata e dhurimit me nr. Rep., 372, dhe nr. Kol., 219, me objekt "Kontratë dhurimi pasurie të paluajtshme", të Pasurisë të paluajtshme e llojit Apartament, Shkalla nr. 1, Hyrja nr. 1, Apartamenti nr. 7, me nr. pasurie 8/647+1-7, vol 25, faqe 11, ZK 1842, me sipërfaqe 119.5 m².

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. B. A. Kryetar i Bashkisë Gramsh në cilësinë e titullarit të institucionit dhe Nëpunësit Autorizues; **z. E.H.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në cilësinë e Nëpunësit Zbatues; **z. F. L.** dhe **znj. A. G.** me detyrë Drejtor të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor; **z. B. C.** Përgjegjës në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor; **znj. Ë. Q., znj. M. D., z. X.M, z. E. R.** në cilësinë e personave që kanë ndjekur kontratat për dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor për ushtrim aktivitet vendosjen e Antenave Telefonike, Fotovoltaikëve, Hece-ve dhe Kullotat e Bagëtive; **znj. D. Ç., znj. L. Z.,** me detyrë Përgjegjës të Sektorit të Menaxhimit të Aseteve Vendore.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Gramsh është paraqitur observacioni me shkresën nr. 4343 prot., datë 30.09.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 405/11 prot., datë 03.10.2025, nga z. B. C., z. X. M. dhe z. E. R. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Pasi u njohëm me Projekt Raportin e Auditimit nr. 405/9 prot., datë 03.09.2025, protokolluar në Bashkinë Gramsh me nr. 2739/1 prot., datë 08.09.2025, për Akt-Konstatimin Nr. 11, të datës 20.06.2025, bëjmë obervacionet mbi auditimin për organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronave publike (aseteve dhe pyje kullotave) të transferuara sipas VKM-së, ju sqarojmë:*

Së pari: *Struktura përgjëgjëse për pyjet nuk harton plan rilevimi, harton Raport-Teknik "Mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor në pronësi publike", bazohet në harta pyjore të gjeoreferuara, në të dhënat e Planit të Mbarështimit dhe Regjistrit Kadastral mbështetur në Udhëzimin nr. 1, datë 09.06.2016, Ministria e Mjedisit "Për rregullat, proceduarat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", pika nr.3, 4, gërma "a" Sipërfaqen e fondit pyjor ose kullosor e shprehur në ha, me kufij të përcaktuar qartë në hartë të shkallës 1:10000 (kordinatat gjeografike, metrike).*

Së dyti: *Referimit nga KLSH, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive, i ndryshuar, bazuar dhe mbështetur në Ligjin nr. 57/2020, ka përcaktuar edhe detyrimin për mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit (kadastrës) së pyjeve. Ky detyrim tashmë është plotësuar nëpërmjet VKM nr. 171. datë 18.03.2022, "Për ngritjen e bazës së të dhënave për Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor dhe regjistrin e fondit kullosor, përcaktimin e strukturës, kritereve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve".*

Në pikat 3, 4 dhe 7 te Kreut II dhe pika 10 e Aneksit 1 dhe pika 3 e Aneksit II, të VKM nr. 171, përcaktohet qartazi se:

Pika 3: Regjistri u referohet të dhënave nga:

a) plani i mbarështimit, i cili është baza për krijimin e regjistrit dhe për përditësimin në vijueshmëri të treguesve të fondit pyjor e kullosor kombëtar;

Sipas këtij konteksti, është pikërisht plani i mbarështrimit që përcakton përditësimin e regjistrit (kadastrës) së pyjeve dhe jo VKM nr. 433, që mban si referencë në relacionin e saj KLSH.

Pika 4. Përdoruesi në nivel bashkie ka të drejtë të propozojë ndryshime, përditësim të informacionit dhe të prodhojë raporte nga Regjistri vetëm në konturin (kufirin) nën juridiksionin administrativo-territorial të asaj bushkie.

Sipas kontekstit të kësaj pike, është e drejtë e pa-diskutueshme e bashkisë që të propozojë dhe bëjë ndryshimet e përditësimet në përputhje me dokumentin planifikues që është plani i mbarështimit i miratuar dhe në fuqi ekzekutive ligjore.

Pika 7. Ndryshimi, përditësimi i të dhënave dhe pranimi i tyre nga administratori bëhet mbi bazën e dokumentacionit ligjor e teknik, të cilat i vihen në dispozicion nga "përdoruesi".

Sipas këtij konteksti, dokumenti ligjor e teknik nuk është askush tjetër por vetëm plani i mbarështimit i hartuar, miratuar dhe në fuqi ekzekutive ligjore.

Sipas pikës 10 të aneksit 1:

10. Planet e mbarështimit të pyjeve dhe të kullotave të hartuara për çdo ekonomi pyjore, në

përputhje me kërkesat e udhëzimit përkatës, "Për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve", të miratuar për këtë qëllim, përbëjnë bazën e mbajtjes së treguesve kadastralë për gjendjen e fondit pyjor dhe kullosor. Sipas këtij konteksti plani i mbarështimit i miratuar dhe vetëm plani i mbarështimit është baza e treguesit kadastralë, e cila ligjërisht dhe qartësisht prevalon mbi referencën që përdor KLSH.
Sipas pikës 3 të Aneksit 2:
3. Regjistri, në periudhat ndërmjet dy planeve të mbarështimit dhe ndërmjet dy inventarizimeve kombëtare, pasqyron ndryshimet që ndodhin në fondin pyjor për shkak të ndryshimeve në:
a) pronësi, administrim, përdorim;
b) gjendjen e grumbullit dhe treguesit silvoteknikë të tij.
***Së treti:** Në vijim nga ana e Bashkisë Gramsh, nëpërmjet ASHK, referuar legjislacionit përkatës është bërë pajisja e pasurive që janë objekt i kontratës nr. 4932 Rep., nr. 1571 Kol., datë 25.11.2024, me dokumentacionin e rregullt të pronësisë si: Çertifikatë e Regjistrimit të pronësisë, Kartelë e pasurisë së Paluetjshme dhe Fragment të Hartës Kadastrale, është bërë Amendim Kontrate me nr. Repertori: 2532. nr. Koleksioni: 899, datë 30.06.2025, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.*
***Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** **Së pari:** Referuar dokumentacionit shoqërues së praktikës për dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor për vendosje stacionesh, bazamentesh për panele fotovoltaike me qëllim promovimin e energjisë, është evidentuar që plani i rilevimit nuk përfshin të gjithë elementët përkatës me qëllim krahasimin e të dhënave të tij me ato të ASIG (ortofoto) pra gjendja fatike në terren.*
***Së dyti:** Grupi i auditimit ka kryer rakordiminin e të dhënave ndërmjet ngastrave të transferuara nëpërmjet VKM-së nr. 433, datë 08.06.2016, dhe të dhënave të planit të mbarshtrimit ku evidentohet se nuk përputhet tipologjia e tokës.*
***Së treti:** Ju i referoheni pajisjes së objektit të kontratës me çertifikatë pronësie, por ky dokumentacion nuk ndodhet bashkëlidhur këtij observacioni.*
Së katërti:** Të gjithë problematikat e sipërpërmendura vijnë si rezultat i mos pajisjes me çertifikatë pronësie të ngastrave të dhëna me qira për vendosje stacionesh, bazamentesh për panele fotovoltaike me qëllim promovimin e energjisë. Dhënia me qira e pasurisë pa u pajisur me çertifikatë pronësie është edhe shkelje e kërkesave të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 144, neni 192 dhe neni 194. Për sa trajtuar më sipër **observacione nuk merret në konsideratë.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Gramsh është paraqitur observacioni me shkresën nr. 4344 prot., datë 30.09.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 405/11 prot., datë 03.10.2025, nga znj. Ë. Q. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
***Pretendimi i subjektit:** Kontratat për dhënien me qira të pyjeve dhe kullotave verore për kullotje e kositje bari, krasitje gjethi dhe për ndërtime provizore nga qiramarrësit:*
***1.** Kontrata nr. 1591 prot., datë 15.04.2024, lidhur me fermerin z. M. N. ju sqarojmë se: Fondi kullosor i ekonomisë Vidhan- Skënderbegas, i është referuar inventarit të listës së kullotave miratuar dhe me VKB. Kapaciteti mbajtës është bazuar në bazë të kërkesë të bërë nga vet fermeri i cili ka rënë dakort për sipërfaqen e dhënë duke firmosur kontratën dhe procesverbalin e dorëzimit të sipërfaqes sepse kjo sipërfaqe e dhënë me qira është në interesin e vet fermerit sepse ndodhet në afërsi të stallës dhe burimeve të ujit. Si specialiste e kullotave i jam referuar kërkesës së fermerit, sqarojmë që pagesa e kullotës bëhet në lekë/krere dhe jo lekë/sipërfaqe.*

2. *Kontara nr. 1872 prot., datë 03.05.2024, lidhur me fermerin z. Q. S. ju sqarojmë se: Fondi kullosor i ekonomisë Vidhan- Skënderbegas, i është referuar inventarit të listës së kullotave miratuar dhe me VKB. Kapaciteti mbajtës është bazuar në bazë të kërkesë të bërë nga vet fermeri i cili ka rënë dakor për sipërfaqen e dhënë duke firmosur kontratën dhe procesverbalin e dorëzimit të sipërfaqes sepse kjo sipërfaqe e dhënë me qira është në interesin e vet fermerit sepse ndodhet në afërsi të stallës dhe burimeve të ujit. Si specialiste e kullotave i jam referuar kërkesës e së fermerit, sqarojmë që pagesa e kullotës bëhet në lekë/krere dhe jo lekë/sipërfaqe.*

3. *Kontrata nr. 1871 prot., datë 03.05. 2024, lidhur me fermerin z. E. B., është lidhur në ekonomi pyjote (pyje që kullotën) ku kapaciteti krerë për sipërfaqe nuk është i njëjtë me kapacitctin mbajtës krerë për sipërfaqe në ekonomi kullosore. Gjithashtu sipërfaqet në pyje që kulloten nuk janë të referuara në listën e kullotave të miratuara në VKB. Vegjetacioni në kullota është më i madh se vegjetacioni në pyje që kullotën prandaj dhe sipërfaqja e dhënë është më e madhe.*

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: *Ne i referohemi përcaktimeve të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për fondin kullosor", neni 15, pika 3, ku citohet se: "Dhënia në përdorim për kullotje bëhet në përputhje me aftësinë mbajtëse kullosore, të përcaktuara në planin e mbarështimit për çdo ngastër ose nëngastër" si dhe VKB-së nr. 6, datë 26.01.2024, me objekt "Mbi miratimin e listës së kullotave e livadheve të gatshme për kositje si dhe kontratës tip", pra në këtë dokument janë miratuar ngastrat sipas ekonomive pyjore dhe kullosore së bashku me sipërfaqen e tyre që do të jepen me qira. Krahasimi i kësaj sipërfaqe është kryer me numrin e krerëve sipas kontratave përkatëse të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, ku është evidentuar tjekalim i numrit të krerëve mbi kapacitetin mbajtës të ngastrës. Dokumentacion vërtetues i kësaj situate janë edhe çertifikatat lëshuar nga veterineri përkatësi për numrin e krerëve. Për sa trajtuar më sipër* ***observacioni nuk merret në konsideratë.***

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Gramsh është paraqitur observacioni me shkresën nr. 4345 prot., datë 30.09.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 405/11 prot., datë 03.10.2025, nga znj. M. D. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Kontratat për dhënie me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor për vendosjen e Antenave Telefonike:*

1. *Rinovimi i kontratës së qirasë me nr. 2180 prot., datë 22.05.2024, të lidhur midis shoqërisë "O" Sh.A dhe Bashkisë Gramsh për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik në pronësi të Bashkisë Gramsh, marrjen me qira të një sipërfaqe prej 200 m² (0.02) ha dhe 0.2 km rrugë, për instalim dhe operim të antenës telefonike, ju sqarojmë se: kontrata fillestare është lidhur nga Komuna Kodovjat sot Njësia Administrative Kodovjat në vitin 2015 me afat 9 - vjeçar me të drejtë rinovimi, me rinovimin e kontratës nga Bashkia Gramsh, nga verifikimi në terren shoqëria "O" Sh.A përdorte 0.2 km rrugë kalimi për tek antena telefonike ku u pasqyrua dhe u përllogarit në rinovimin e kontratës të vitit 2024. Pra nuk mund të bëhej përllogaritja e servitudës për vitin 2023 kur kontrata ishte aktive dhe e lidhur nga Njësia Administrative Kodovjat.*

2. *Rinovimi i kontratës së qiras me nr. 3341 prot., datë 01.09.2023, lidhur midis shoqërisë "O" Sh.A dhe Bashkisë Gramsh, për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik në pronësi të Bashkisë Gramsh, marrjen me qira të një sipërfaqe prej 300 m² (0.03) ha, për instalim dhe operim të antenës telefonike, ju sqarojmë se: Nuk është përllogaritur pagesa për servitudën sepse shoqëria "O" Sh.A, përdor rrugën egzistuese që lidh fshatrat e Njësisë Administrative Lenie, bashkëngjitur foto të objektit dhe rrugës.*

3. *Rinovimi i kontratës së qirasë me nr. 5045prot, datë 29.10.2024, lidhur midis shoqërisë "V"*

Sh.A dhe Bashkisë Gramsh për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik në pronësi të Bashkisë Gramsh, marrjen me qira të një sipërfaqe prej 300 m² (0.03) ha, për instalim dhe operim të antenës telefonike, ju sqarojmë se: Nuk është përllogaritur pagesa për servitudën sepse shoqëria "V" Sh.A, përdor rrugën egzistuese që lidh fshatrat e Njësisë Administrative Poroçan, bashkëngjitur foto të objektit dhe rrugës.
Për subjektin që ushtronë aktivitet në fondin pyjor dhe kullosor dhe që është pajisur me Leje Koncesionare nga ministria përkatëse ju sqarojmë si më poshtë:
***1.** Nuk disponojmë dokumentacion tekniko-ligjor dhe kontratë qiraje të lidhur midis Bashkisë Gramsh dhe shoqërisë koncesionare "E" ShPK, për Hec "Lenie", pasi veprimtaria e këtij Hec-i nuk është në pjesën e fondit pyjor/kullosor dhe si rrjedhoj nuk mund të përllogarisim detyrimet që i lindin subjektit.*
***Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** **Së pari:** Referuar dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Gramsh/Grupi i Punës i cili ka kryer verifikimet në terren për përllogaritjen e servitudës për kontratat për dhënien me qira të sipërfaqeve për vendosjen e antenave telefonike, së bashku me fotografitë përkatëse (bashkëlidhur këtij observacioni), **observacioni merret** në konsideratë dhe do të kryhen reflektimet përkatëse në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit, në kushtet kur nuk janë hapur rrugë të reja kalimi, por rrugët janë ekzistuese të fshatrave dhe kalojnë pranë antenave telefonike.*
Së dyti:** Ne i referohemi regjistrit të lejeve, pra ky subjekt ushtron aktivitet në fondin pyjor dhe kullosor, për të cilin duhet të hartohet dokumentacion përkatës tekniko-ligjor, kontratë qiraje etj., me Shoqërinë Koncesionare "E" ShPK, për Hec "Lenie". Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Gramsh është paraqitur observacioni me shkresën nr. 4340 prot., datë 30.09.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 405/11 prot., datë 03.10.2025, nga z. E.S. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
***Pretendimi i subjektit:** Në faqen 168 të Projekt Raportit, në paragrafin e titulluar Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Referuar Urdhërit nr. 333, datë 29.12.2023, Kryetari i Bashkisë, emëron z. E. S. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Aseteve Vendore dhe Urdhërit Nr. 7, datë 10.01.2024, Kryetari i Bashkisë, emëron z. E. S. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, pra vetëm 6 ditë pune, observacioni merret në konsideratë dhe do të kryhen reflektimet përkatëse në hartimin e Projekt Raportit të Auditimit duke mos e ngarkuar me përgjegjësi. Por në faqen 174 të Projekt Raportit, në paragrafin e fundit: Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. E. S. me detyrën e Përgjegjësit të Sektorit të Menaxhimit të Aseteve Vendore. Sa më sipër, jam i bindur se kemi të bëjmë me një lapsus gjatë hartimit të Projekt Raportit prandaj. Ju lutem që ta reflektoni në momentin e hartimit të Raportit Përfundimtar.*
***Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Për sa i përket ngarkimit me përgjegjësi të z. E. S. në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Menaxhimit të Aseteve Vendore i cili ka ushtruar këtë detyrë për një periudhë kohore vetëm prej 6 ditësh, ju bëjmë me dije se ka ndodhur një lapsus nga grupi i auditimit gjatë hartimit të Projekt Raportit të Auditimit në kushtet kur observacioni është marrë në konsideratë lidhur me çështjen e përgjegjësi, ku në Raportin Përfundimtar të Auditimit do të kryhen reflektimet përkatëse.*

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Gramsh është paraqitur observacioni me shkresën nr. 4347 prot., datë 30.09.2025, administruar në KLSH me

praktikën nr. 405/11 prot., datë 03.10.2025, nga znj. Q. K. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. *Mbi me rekomandimin për nxjerrjen në Këshillin Bashkiak të tokave bujqësore për dhënien me qira.*

Aktualisht, tokat bujqësore në fjalë nuk janë të regjistruara në mënyrë përfundimtare në përdorim apo administrim të bashkisë, për shkak të mungesës së dokumentacionit të plotë dhe akteve specifike të transferimit.

Megjithëse ekzistojnë VKM të përgjithshme për kalimin e tokave nga shteti te njësitë e vetëqeverisjes vendore zbatimi i tyre në praktikë kërkon akte të veçanta pët secilën njësi administrative apo sipërfaqe të identifikuar, të cilat mundësojnë regjistrimin përfundimtar në favor të Bashkisë në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.

Pa këto akte, bashkia nuk ka bazë ligjore për të marrë vendim mbi përdorimin apo dhënien me qira të këtyre tokave, pasi do të binte në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për administrimin e pronës publike.

Gjithashtu, sqarojmë se përgatitja e dokumentacionit për nxjerrjen e VKM-ve të veçanta është kompetencë e bashkië, dhe në këtë drejtim është ndërmarrë puna për evidentimin dhe përgatitjen e materialeve për një pjesë të sipërfaqeve bujqësore. Procesi është në vijim dhe do të shtrihet edhe për zonat e tjera administrative.

2. *Mbi mungesën e informacionit të saktë për zaptuesit e tokave bujqësore, pronë shtetërore:*

Bashkia aktualisht nuk disponon një informacion të plotë dhe të verifikuar për subjektet apo individët që përdorin ose kanë zaptuar toka bujqësore, pronë shtetërore, pa titull ligjor. Kjo situatë vjen si pasojë e disa faktorëve objektivë:

- Zaptimet janë kryer ndër vite, në mënyrë informale dhe pa ndonjë dokumentacion të centralizuar; - Vështirësi në evidentimin dhe verifikimin në terren për shkak të burimeve të kufizuara njerëzore dhe teknike;

Pavarësisht këtyre vështirësive, bashkia ka nisur një proces të brendshëm të evidentimit të përdoruesve informalë, duke mbledhur informacion nga njësitë administrative dhe strukturat lokale, me qëllim ndërtimin e një bazë të dhënash reale dhe të përditësueshme, për të mundësuar më pas veprimet administrative dhe ligjore të nevojshme.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: *Ne i referohemi përcaktimeve të Udhëzimit nr. 1, datë 18.07.2012, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", pika 2, ku përcaktohet se: "Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT), në komunë ose bashki, evidenton sipërfaqet e tokës bujqësore për dhënie me qira, objekt të pikës 1 të këtij kreu, duke pasqyruar numrin kadastral të ngastrave, madhësinë në hektarë, si dhe vendndodhjen e tyre. Pasqyra me të dhënat e evidentuara, pasi konfirmohet nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), në qark, i paraqitet këshillit të komunës ose bashkisë, i cili shqyrton dhe miraton sipërfaqet e tokave bujqësore, që mund të jepen me qira", pra dhënia e tyre duhet të kryhet pasi të merret miratimi përkatës nga Këshilli Bashkiak, për më tepër dhënia e një pasurie me qira kryhet në rastin kur pasuria është e pajisur me çertifikatë pronësie, problematikë e cila është e mbartur ndër vite. Siç konfirmohet edhe nga ana Juaj në observacion, Bashkia Gramsh ka ngritur një grup pune i cili po kryhen verifikimet përkatëse mbi përdoruesit informalë të tokave bujqësore, por ky proces ende nuk ka përfunduar. Për sa trajtuar më sipër* ***observacioni nuk merret në konsideratë.***

2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit

6.1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit.
6.2. Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj.;

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit me nr. 405/1 prot; datë 08.04.2025 i ndryshuar, me objekt: "**Auditim mbi zbatimin e kërkesave të Ligjit 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar**, *prej datës 01.01.2023 deri më 31.12.2024,* u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- *Dokumentacioni në sistemin "E leje";*
- *Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;*
- *Dokumentacion i disponueshëm në drejtorinë e financës;*
- *Dokumentacion i disponueshëm në drejtorinë juridike;*
- *Dokumente të tjera nga arkiva, etj.*

Bashkia Gramsh ka miratuar **Planin e Përgjithshëm Vendor** dhe **Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr. 01, datë 10.06.2020, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësimi Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, infrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik, ndarja e territorit në zona dhe njësi.

Auditimi konsiston në këto fusha:
1. Dhënia e Lejes së Zhvillimit,krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.
2. Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik.
3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.
4. Dhënia e Certifikatës së Përdorimit.

LEJET E NDËRTIMIT, ZHVILLIMIT DHE PËRDORIMIT PËR PERIUDHËN 01.01.2023 - 31.12.2024

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Gramsh, rezulton se për afatin e auditimit **01.01.2023 deri në 31.12.2024** ka pasur **133 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh** si: leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m2, leje zhvillimi, deklarata për kryerje punimesh, certifikata përdorimi, etj., të evidentuara në tabelën përmbledhëse në **Tabelën nr. II.6.1 dhe Tabelën nr. II.6.2**

Tabela nr. II.6.1: aplikimet në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2023-31.12.2023

Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023 nga sistemi e-lejet					
Nr.	**Lloji i lejes**	**Total**	**Miratuar**	**Refuzuar**	**Në proces**
1	Certifikatë përdorimi	10	6	4	-
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	5	2	3	-
3	Leje infrastrukture	6	6	-	-
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m^2	13	7	6	-
5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa	4	1	3	-

	ndryshim funksioni				
6	Leje për ndryshim funksioni	19	15	4	-
7	Leje rindërtimi, rikonstr. dhe riparimi të nd. së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni	3	1	2	-
8	Leje zhvillimi	8	5	3	-
9	Njoftim për fillim punimesh	3	3	-	-
10	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	1	0	1	-
11	Leje ndërtimi për prishje ndërtimi ekzistues	1	1	0	-

Burimi: DPKTMP Bashkia Gramsh. Përpunoi: Grupi i auditimit

Tabela nr. II.6.2: aplikimet në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2024-31.12.2024

Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024 nga sistemi e-lejet					
Nr.	**Lloji i lejes**	**Total**	**Miratuar**	**Refuzuar**	**Në proces**
1	Certifikatë përdorimi	13	7	6	-
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	8	3	5	-
3	Leje infrastrukture	15	13	2	-
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m^2	6	4	2	-
5	Leje për ndryshim funksioni	3	3	0	-
6	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	2	2	0	-
7	Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	1	1	0	-
8	Leje zhvillimi	3	2	1	-
9	Njoftim për fillim punimesh	6	6	0	-
10	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m^2	1	1	0	-
11	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	2	2	0	-

Burimi: DPKTMP Bashkia Gramsh. Përpunoi: Grupi i auditimit

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës (këtu e në vazhdim DPKTMP) e Bashkisë Gramsh, si dhe në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit, janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e evidentuara në **Tabelën nr. II.6.3**, bashkëlidhur këtij akt-konstatimi.

Tabela nr. II.6.3 – Rastet e audituara

Nr.	**Titulli i objektit**	**Zhvilluesi**	**Miratuar**	**Preventivi**
	Leje ndërtimi			
1	Rikonstuksion, shtesë anësore dhe në lartësi, e objektit 2 kate me podrum		07.05.2024	24,029,666.53
2	Objekt 1 dhe 2 kate, me podrum		29.05.2024	14,175,213
3	Objekt shërbimi 2 kate		19.01.2024	5,483,033
4	Magazinë 1 kat me mur rrethues		01.12.2023	4,589,329
5	Rikonstruksion (me ndryshim volumi) dhe shtesë kati i objektit 1 kat		30.11.2024	5,160,594.9
	Certifikata përdorimi			
6	Godinë shërbimi e banimi 1-3-4-5 kate mbi tokë e 2 kate nën tokë		10.01.2024	-
7	Ndërtim objekti 3-kat		03.09.2024	-
8	Magazinë për ruajtjen e prodhimeve bujqësore,		07/10/2024	-

	1-kat me sipërfaqe më të vogël se 250 m2			

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në lidhje me auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, vërehen parregullsitë si më poshtë:

- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **3 raste**, taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur e saktë, pasi vlera e përllogaritur nga Bashkia Gramsh rezulton më e lartë se ajo që parashikon kuadri ligjor. Në **4 raste** janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu në **1 rast** u konstatua se dokumentet e pasurisë nuk janë ngarkuar e rifreskuar gjatë tre muajve të fundit nga data e aplikimit për leje ndërtimi. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 1396/5, datë 07.05.2024, për objektin: "Rikonstuksion, shtesë anësore dhe në lartësi, e objektit 2 kate me podrum", me adresë Gramsh, me zhvillues N.R, me problematika si më poshtë vijon:

- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është përllogaritur saktë, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, pika 3, si dhe Paketës Fiskale miratuar nga Bashkia Gramsh.
  Bazuar të Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006**,** *"Për sistemin e taksave vendore"*, i ndryshuar, neni 27, *"Taksa e ndikimit në infrastrukturë",* pika 1, përcaktohet se: *"Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri."*. Në pikën 2, përcaktohet se: *"Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri në 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave".* Në pikën 3, përcaktohet se: "*Në rastin e ndërtimeve, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit.*" Referuar pikës 1, neni 46 *"Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja"* të Ligjit 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, përllogaritja e TNI-së bëhet duke krahasuar dy mënyrat, mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet.
  - Llogaritja në bazë të çmimit për metër katror, duke ju referuar çmimit për koston mesatare të ndërtimit të entit të banesave, si dhe paketës fiskale të bashkisë Gramsh është si më poshtë:

  $$765.3\ m^2 * 32{,}331\ lekë/m^2 * 1\% = \mathbf{247{,}429.143\ lekë}$$

  - Llogaritja me vlerën e preventivit sipas paketës fiskale të bashkisë Gramsh:

  $$24{,}029{,}666.52\ lekë * 1\% = \mathbf{236{,}699.6\ lekë}$$

  - Llogaritja e vlerës sipas Bashkisë Gramsh është **331,211.3 lekë**, duke e përllogaritur vlerën e TNI-së si objekt i cili kryhet nga shoqëri ndërtimi me qëllim rishitje.

  Nga përllogaritjet e kryera, rezulton se vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë duhet të jetë **247,429.143 lekë.** Përllogaritja e kësaj takse duhet të ishte realizuar duke u mbështetur në vlerën më të lartë të dalë nga analizat e kryera sipas përcaktimeve të nenit 27, pika 3 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në përputhje me nenin 46, pika 1 të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, si dhe në zbatim të Paketës Fiskale të miratuar nga Bashkia Gramsh, pika 4.2.

2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 1470/5, datë 29/05/2024, për objektin: "Objekt 1 dhe 2 kate, me podrum", me adresë Gramsh, me zhvillues M. K., me problematika si më poshtë vijon:

- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është përllogaritur saktë, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, pika 3, si dhe Paketës Fiskale miratuar nga Bashkia Gramsh.
  Bazuar tnë Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006**,** *"Për sistemin e taksave vendore"*, i ndryshuar, neni 27, *"Taksa e ndikimit në infrastrukturë",* pika 1, përcaktohet se: *"Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri.".* Në pikën 2, përcaktohet se: *"Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri në 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave".* Në pikën 3, përcaktohet se: "*Në rastin e ndërtimeve, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit.*"
  Referuar pikës 1, neni 46 *"Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja"* të Ligjit 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, përllogaritja e TNI-së bëhet duke krahasuar dy mënyrat, mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet.
  - Llogaritja në bazë të çmimit për metër katror, duke ju referuar çmimit për koston mesatare të ndërtimit të entit të banesave, si dhe paketës fiskale të bashkisë Gramsh është si më poshtë:

  $406.7\ m^2 * 32{,}331$ lekë/$m^2 * 3\% =$ **394,470.3 lekë**

  - Llogaritja me vlerën e preventivit sipas paketës fiskale të bashkisë Gramsh:

  14,175,213 lekë * 3% = **425,256.4 lekë**

  - Llogaritja e vlerës sipas bashkisë Gramsh është **882.467.5 lekë**, duke e përllogaritur vlerën e TNI-së si objekt i cili kryhet nga shoqëri ndërtimi me qëllim rishitje.

  Nga përllogaritjet e kryera, rezulton se vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë duhet të jetë **425,256.4 lekë**. Përllogaritja e kësaj takse duhet të ishte realizuar duke u mbështetur në vlerën më të lartë të dalë nga analizat e kryera sipas përcaktimeve të nenit 27, pika 3 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në përputhje me nenin 46, pika 1 të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, si dhe në zbatim të Paketës Fiskale të miratuar nga Bashkia Gramsh, pika 4.2.
- Kjo proçedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 23 ditësh pune, veprime jo në përputhshmëri me nenin 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit".

3. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 4375/5, datë 19/01/2024, për objektin: "Objekt shërbimi 2 kate", me adresë Gramsh, me zhvillues A. A. dhe R. A., me problematika si më poshtë vijon:

- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është përllogaritur saktë, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, pika 3, si dhe Paketës Fiskale miratuar nga Bashkia Gramsh.
  Bazuar në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006**,** *"Për sistemin e taksave vendore"*, i ndryshuar, neni 27, *"Taksa e ndikimit në infrastrukturë",* pika 1, përcaktohet se: *"Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri.".* Në pikën 2, përcaktohet se: *"Në rastin e*

ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri në 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave". Në pikën 3, përcaktohet se: "*Në rastin e ndërtimeve, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit.*" Referuar pikës 1, neni 46 *"Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja"* të Ligjit 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, përllogaritja e TNI-së bëhet duke krahasuar dy mënyrat, mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet.

- Llogaritja në bazë të çmimit për metër katror, duke ju referuar çmimit për koston mesatare të ndërtimit të entit të banesave, si dhe paketës fiskale të bashkisë Gramsh është si më poshtë:

$$\underline{210\ m^2 * 32{,}331\ \text{lekë}/m^2 * 3\% = \mathbf{203{,}685.3\ lekë}}$$

- Llogaritja me vlerën e preventivit sipas paketës fiskale të bashkisë Gramsh:

$$\underline{5{,}483{,}033\ \text{lekë} * 3\% = \mathbf{164{,}491\ lekë}}$$

- Llogaritja e vlerës sipas bashkisë Gramsh është **<u>305,527.8 lekë</u>**, duke e përllogaritur vlerën e TNI-së si objekt i cili kryhet nga shoqëri ndërtimi me qëllim rishitje.

Nga përllogaritjet e kryera, rezulton se vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë duhet të jetë **<u>203,685.3 lekë.</u>** Përllogaritja e kësaj takse duhet të ishte realizuar duke u mbështetur në vlerën më të lartë të dalë nga analizat e kryera sipas përcaktimeve të nenit 27, pika 3 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në përputhje me nenin 46, pika 1 të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, si dhe në zbatim të Paketës Fiskale të miratuar nga Bashkia Gramsh, pika 4.2.

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 11 ditësh pune, veprime jo në përputhshmëri me nenin 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit".

4. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 4100/5, datë 01/12/2023, për objektin: "Magazinë 1 kat me mur rrethues", me adresë Gramsh, me adresë Gramsh, me zhvillues A.B., me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 11 ditësh pune, veprime jo në përputhshmëri me nenin 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit".
- Kartela dhe Harta e pasurisë së paluajtshme nuk është ngarkuar e rifreskuara gjatë tre (3) muajve të fundit. Nga auditimi i kësaj procedure, vihet re se harta e ngarkuar është rifreskuar në datën 07.04.2023, kartela e pasurisë është rifreskuar në datë 10.01,2024, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 20.08.2024.

5. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 3543/5, datë 30/11/2024, për objektin: "Rikonstruksion (me ndryshim volumi) dhe shtesë kati i objektit 1 kat", me adresë, Pishaj, Gramsh, me zhvillues L. D. dhe F. D., me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 58 ditësh pune, veprime jo në përputhshmëri me nenin 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit".

Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me:
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 27, pika 3;
- Ligji nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, neni 46, pika 1;
- Paketa Fiskale, miratuar nga Bashkia Gramsh, pika 4.2.;

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. B. A., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Gramsh, (për rastet 1 - 5);
- Z. O. Ç., në cilësinë e drejtorit të DPZHKT, (për rastet 1 - 5);
- Zj. E. M., në cilësinë e specialistes së financës, (për rastet 1, 2);
- Zj. E. Ç., në cilësinë e specialistes së financës (për rastin 3).

➢ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në **1 rast** Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) nuk është përllogaritur e saktë. Bashkia Gramsh nuk ka marrë të gjitha masat për të përftuar të ardhurat që legjislacioni parashikon për objektet që pajisen me leje ndërtimi. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastin e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 4100/5, datë 01/12/2023, për objektin: "Magazinë 1 kat me mur rrethues", me adresë Gramsh, me adresë Gramsh, me zhvillues A. B., me problematika si më poshtë vijon:

- **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është përllogaritur saktë,** veprime jo në përputhshmëri me nenin 27, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, pika 3, si dhe Paketës Fiskale miratuar nga Bashkia Gramsh.
  Bazuar në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006**,** *"Për sistemin e taksave vendore"*, i ndryshuar, neni 27, *"Taksa e ndikimit në infrastrukturë",* pika 1, përcaktohet se: *"Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri."*. Në pikën 2, përcaktohet se: *"Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri në 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave".* Në pikën 3, përcaktohet se: "*Në rastin e ndërtimeve, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit.*"
  Referuar pikës 1, neni 46 *"Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja"* të Ligjit 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, përllogaritja e TNI-së bëhet duke krahasuar dy mënyrat, mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Referuar këtyre të dhënave, më poshtë po bëjmë llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për këtë objekt:
  - Llogaritja në bazë të çmimit për metër katror, duke ju referuar çmimit për koston mesatare të ndërtimit të entit të banesave, si dhe paketës fiskale të bashkisë Gramsh është si më poshtë:

  $$\underline{151.75\ m^2 * 32{,}331\ \text{lekë}/m^2 * 3\% = \mathbf{147{,}186.9\ lekë}}$$

  - Llogaritja me vlerën e preventivit sipas paketës fiskale të bashkisë Gramsh:

  $$\underline{4{,}589{,}329\ \text{lekë} * 3\% = \mathbf{137{,}679.9\ lekë}}$$

  - Llogaritja e vlerës sipas bashkisë Gramsh është **73,593 lekë**, duke e përllogaritur vlerën e TNI-së si objekt i cili kryhet nga shoqëri ndërtimi me qëllim rishitje.

  Nga përllogaritjet e kryera, rezulton se vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë duhet të jetë **147,186.9 lekë.** Përllogaritja e kësaj takse duhet të ishte realizuar duke u mbështetur në vlerën më të lartë të dalë nga analizat e kryera sipas përcaktimeve të nenit 27, pika 3 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në përputhje me nenin 46, pika 1 të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, si dhe në zbatim të Paketës Fiskale të miratuar nga Bashkia Gramsh, pika 4.2.

Vlera e llogaritur nga **Bashkia Gramsh** me mungesë prej 73,593.9 lekë përbën të ardhura të munguara për institucionin e **Bashkisë Gramsh**.

Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me:
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 27, pika 3;
- Ligji nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, neni 46, pika 1;
- Paketa Fiskale, miratuar nga Bashkia Gramsh, pika 4.2.;

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. B. A., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Gramsh, (për rastin 1);
- Z. O. Ç., në cilësinë e drejtorit të DPZHKT, (për rastin 1);
- Zj. E. Ç., në cilësinë e specialistes së financës (për rastin 1);

Shënim:

Në lidhje me rastin nr. 6, referuar Tabelës nr.3, certifikatë përdorimi për objektin "Godinë shërbimi e banimi 1-3-4-5 kate mbi tokë e 2 kate nën tokë", me zhvillues S. I., grupi i auditimit shprehet se kjo procedurë është audituar dhe nuk janë konstatuar problematika madhore.

Në lidhje me rastin nr. 7, referuar Tabelës nr.3, certifikatë përdorimi për objektin "Ndërtim objekti 3-kat", me zhvillues S. L., grupi i auditimit shprehet se kjo procedurë është audituar dhe nuk janë konstatuar problematika madhore.

Në lidhje me rastin nr. 8, referuar Tabelës nr.3, certifikatë përdorimi për objektin "Magazinë për ruajtjen e prodhimeve bujqësore, 1-kat me sipërfaqe më të vogël se 250 m2", me zhvillues M. S., grupi i auditimit shprehet se kjo procedurë është audituar dhe nuk janë konstatuar problematika madhore.

Konkluzion i përgjithshëm mbi miratimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit:

1. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në **të gjitha raste**, taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur saktë. Në disa raste, kjo taksë është përllogaritur më e lartë sesa parashikohet nga dispozitat ligjore, ndërsa në raste të tjera është arkëtuar më pak se sa duhet, duke rezultuar në mungesa në të ardhura. Në **4 raste** janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu në **1 rast** u konstatua se dokumentet e pasurisë nuk janë ngarkuar të rifreskuar gjatë tre muajve të fundit nga data e aplikimit për leje ndërtimi

2.7 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtës së Territorit të Njësive Vendore (IMTV)

7.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV-së për prishjen e objekteve pa leje zhvillim.

7.2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV-së për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

7.3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërin e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Në zbatim të pikës 7 (shtatë), të programit të auditimit nr. 405/1 prot; datë 08.04.2025, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Procesverbalet e konstatimit të kundërvajtjes;

2. Vendimet e masave administrative (gjobave);
3. Vendimet e pezullimeve të punimeve;
4. Vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme;
5. Planet mujore, tremujore dhe/ose vjeçare të punës;
6. Dokumentacioni i IMTV-së në lidhje me gjobat e vendosura, arkëtimet, urdhrat ekzekutivë, vendimet e gjykatës etj.;
7. Dokumentacioni financiar në lidhje me kontabilizimin dhe arkëtimet e gjobave;
8. Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga IMTV dhe Drejtoria e Financës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar dhe përputhshmërisë me dispozitat ligjore, u konstatua se:

7.1 Mbi strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor:

7.1.1 Auditim i periudhës 01.01.2023-31.12.2024

Referuar strukturës organizative të Bashkisë Gramsh për vitin 2023 dhe 2024, si dhe informacionit të kërkuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore**,** në lidhje me organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor, rezulton se: është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* i ndryshuar.

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, struktura organizative e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor është miratuar me Vendim nr. 144, datë 29.12.2022 dhe ndryshuar me Vendimin nr.53 datë 07.08.2023 të kryetarit të Bashkisë Gramsh. Kjo strukturë ka në përbërjen e saj 3 pozicione pune, nga të cilët 1 Kryeinspektor dhe 2 Inspektorë.

Për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, struktura organizative e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor është miratuar Vendim nr. 08 datë 30.01.2024 të kryetarit të Bashkisë Gramsh. Kjo strukturë ka në përbërjen e saj 2 pozicione pune, nga të cilët 1 Kryeinspektor dhe 1 Inspektorë.

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2024, IMTV ka pasur në strukturën e tij, punonjësit sipas tabelës në vijim:

Tabela nr. II.7.1: Struktura e IMTV, Bashkia Gramsh për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2024

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Lloji i Diplomimit	Data e fillimit	Data e largimit	Shënime
1	E.H.	Inspektor	Drejtësi	11.06.2020	12.07.2023	Prej datës 11.06.2020 – 31.02.2021 në cilësinë e inspektorit, 31.02.2021-12.07.2023 në cilësinë e Kryeinspektorit
2	E. H.	Kryeinspektor	Drejtësi	31.02.2021	12.07.2023	
3	A. B.	Inspektor	Inxhinieri	01.09.2021	12.07.2023	-
4	A. Ç.	Kryeinspektor	Inxhinieri	08.08.2023	31.05.2024	-
5	G. Xh.	Inspektor	Inxhinieri	01.09.2023	30.08.2024	-
6	S.V.	Inspektor	Inxhinieri	02.09.2024	-	-

Burimi: Bashkia Gramsh. Përpunoi Grupi i Auditimit

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 1, rezulton se gjatë periudhës 31.02.2021 – 12.07.2023, struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) në Bashkinë Gramsh është drejtuar nga Kryeinspektori z. E.H., i diplomuar në Drejtësi.

Për periudhën 08.08.2023 – 31.05.2024, drejtimin e strukturës e ka mbajtur Kryeinspektori z. A. Ç., i diplomuar në Inxhinieri.

Gjithashtu, gjatë periudhës 01.09.2021 – 12.07.2023, pjesë e strukturës ka qenë inspektori A. B., me arsim të lartë në Inxhinieri.
Për periudhën 01.09.2023 – 30.08.2024, në përbërje të strukturës ka qenë inspektori G.Xh., gjithashtu i diplomuar në Inxhinieri.
Nga data 02.09.2024 e në vijim, pjesë e strukturës si inspektor është Samuel Veliu, i diplomuar në Inxhinieri.

Nga të dhënat e pasqyruara edhe në tabelën nr. 1, u konstatua se:

- Nga auditimi i dokumentacionit që lidhet me kualifikimet profesionale të stafit, rezulton se gjatë periudhës së auditimit, në strukturën e IMTV në Bashkinë Gramsh është punësuar personel që **plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 11** të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar, i cili përcakton se:

  Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.

- Struktura e IMTV-së në Bashkinë Gramsh nuk përmban numrin e nevojshëm të personelit (inspektorëve), në kundërshtim me përcaktimet e nenit 14 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar. i cili përcakton se:

  *Autoritetet e qeverisjes vendore sigurojnë që për kryerjen e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj, të kenë profesionistë të kualifikuar dhe me eksperiencë pune në fushat përkatëse. Numri minimal i profesionistëve që duhet të sigurojë çdo njësi e qeverisjes vendore përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, në bazë të numrit të popullsisë së njësisë së qeverisjes vendore, dhe është në çdo rast jo më i vogël se **6 profesionistë***

  Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se gjatë periudhës së auditimit, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) në Bashkinë Gramsh nuk ka funksionuar me strukturën e plotësuar sipas organikës së miratuar. Mungesa e plotësimit të strukturës me numrin e duhur të inspektorëve përbën një mospërputhje me kërkesat ligjore dhe organizative, si dhe një element të konsiderueshëm risku për funksionimin efektiv të këtij institucioni.

IMTV, Bashkia Gramsh nuk ka një regjistër elektronik për regjistrimin në kohë të akteve të përpiluara nga IMTV, për një bashkëpunim dhe administrimin me efektivitet të informacionit, ku të pasqyrohen të gjitha inspektimet e kryera dhe masat e marra.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. K. T., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, nga 01.01.2023 deri në 14.05.2023;
- Z. B. A., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, nga 24.05.2023 – 31.12.2024;

7.2 Mbi planifikimin e inspektimeve dhe raportimin periodik:
7.2.1 Mbi planifikimin e inspektimeve:
Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet t'i ushtrojë detyrat e tij funksionale në bazë të planeve mujore, tri-mujore dhe/ose vjeçare të punës, sipas planifikimit, i cili hartohet nga kryeinspektori i IMTV-së, në zbatim të VKM-së nr. 894, datë 01.11.2015, *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i*

njësisë vendore", nënpika b.ii.
Nga grupi i auditimit është kërkuar dokumentacion dhe informacion mbi hartimin e tyre, në mënyrë periodike dhe përcjelljen tek strukturat e varësisë. Nga IMTV **nuk është vendosur në dispozicion asnjë plan pune**, i miratuar nga kryeinspektori.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. E. H.**, në cilësinë e Kryeinspektori të IMTV për periudhën 01.01.2023 - 12.07.2023, për mos-hartimin e planeve të punës;
- **Z. A. Ç.**, në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 08.08.2023 - 31.05.2024, për mos-hartimin e planeve të punës.

7.2.2 Mbi raportimin periodik:
Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet të përgatisë dhe t'i japë të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, si p.sh. vendimet e marra ndaj kundërvajtjeve të konstatuara (pezullim, gjobë, prishje të objektit të kundërligjshëm), kallëzimet penale, si dhe kërkesat për heqje të licensave profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, sipas përcaktimeve të nenit 5 të Ligjit nr.9780, datë 16/07/2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* pika f).
Nga ana e IMTV **nuk është vendosur në dispozicion asnjë raportim për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2024**.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. E. H.**, në cilësinë e Kryeinspektori të IMTV për periudhën 01.01.2023 - 12.07.2023, për mos-hartimin e planeve të punës;
- **Z. A.Ç.**, në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 08.08.2023 - 31.05.2024, për mos-hartimin e planeve të punës.

7.3 Mbi dokumentimin e kundërvajtjeve dhe proceseve të prishjeve me evidenca fotografike:
7.3.1 Mbi dokumentimin e kundërvajtjeve:
Në zbatim të nenit 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pika a), inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të kundërvajtjes së konstatuar me foto ose video, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë.
Referuar këtyre përcaktimeve, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se **në të gjitha rastet, kundërvajtja e konstatuar nuk është dokumentuar me fotografi ose video** dhe nuk është bërë pjesë e dosjes individuale të praktikës.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. E.H.**, në cilësinë e kryeinspektorit pranë IMTV
- **Z. A. B.**, në cilësinë e inspektorit pranë IMTV,

7.3.2 Mbi dokumentimin e procesit të prishjes së objekteve të kundërligjshëm:
Në zbatim të nenit 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pika a), inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të proceseve të punës, në këtë rast të procesit të prishjes së objektit të kundërligjshëm, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë.
Gjatë periudhës së auditimit u konstatua **se asnjë nga vendimet e marra për prishjen e objekteve të ndërtuara në kundërshtim me ligjin nuk është ekzekutuar**. Këto raste janë paraqitur në

tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. II.7.2: Rastet, për të cilat nuk është ekzekutuar vendimi i prishjes

Nr.	Proces-verbali i konstatimit		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar
	Nr. serie	Datë		
1	0000012	29.06.2023	Z. Ç.	Ndërtim objekti shtëpi banimi xoklaturë me lartësi 50 cm beton arme me distance 13m x 8.2 metra, objekt i pa përfunduar

Burimi: Bashkia Gramsh. Përpunoi Grupi i Auditimit

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. E.H.**, në cilësinë e kryeinspektorit pranë IMTV
- **Z. A. B.**, në cilësinë e inspektorit pranë IMTV,

7.4 Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të pezullimit të punimeve:

Vendimi për pezullimin e punimeve në ndërtim nxirret në rastin kur është i nevojshëm një afat kohor paraprak, për marrjen e vendimit, për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe të urbanistikës, ose për marrjen e vendimit për prishjen e objektit. Pezullimi i punimeve në ndërtim ka afat deri në 60 ditë. Një vendim i tillë merret në rastet kur:

- subjekti i kontrolluar mungon në objekt ose nuk i paraqet grupit të inspektimit dokumentacionin teknik e/ose ligjor të punimit/ndërtimit;
- mungojnë masat e sigurimit teknik në objekt dhe mjetet mbrojtëse të jetës së punëtorëve;
- plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor kërkon proces miratimi nga autoriteti përgjegjës i planifikimit;
- vendimi i pezullimit të punimeve të ndërtimit për plotësimin e dokumentacionit teknik e/ose ligjor ka rezultuar i pamjaftueshëm dhe subjekti ndërtues kërkon zgjatjen e afatit, duke e argumentuar në mënyrë zyrtare.

Referuar këtyre përcaktimeve, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se **në <u>1 rast</u> nuk është nxjerrë vendimi për pezullimin e punimeve**, kur do të duhej t'i ishte dhënë kohë subjektit të konstatuar për plotësimin e dokumentacionit ose përmirësimin e masave të sigurimit teknik në objekt dhe shtimin e mjeteve mbrojtëse të jetës së punëtorëve, paraqitur në tabelën e mëposhtme. Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me nenin 13 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar.

Tabela nr. II.7.3

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar
	Nr. serie	Data		
1	0000012	29.06.2023	K.	Shkelje e afateve të lejes së ndërtimit

Burimi: Bashkia Gramsh. Përpunoi Grupi i Auditimit

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. S. V.**, në cilësinë e inspektorit pranë IMTV,

Protokolluar në KLSH me nr. 405/11, datë 03.10.2025, është observuar nga funksionarët e Bashkisë Gramsh dhe IMTV, me anë të shkresës nr. 4346 prot., datë 30.09.2025, si më poshtë vijon:

Pretendimi i subjektit:
Në lidhje me konstatimin për ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të pezullimit të punimeve, Bashkia Gramshshprehet se: "Vendimi për pezullim të punimeve është akt administrativ që përgatitet nga inspektori, por miratimi dhe nxjerrja përfundimtare e tij është kompetencë e kryeinspektorit dhe organit drejtues të IMTV-së ....."
Qëndrimi i grupit të auditimit:
Së pari, sqarojmë se argumentat e subjektit nuk janë të bazuara dhe të argumentuara ligjërisht, si dhe nuk është vënë në dispozicion dokumentacion i ri për të ndryshuar qëndrimin e grupit të auditimit. Konstatimet e kryera nga grupi i auditimit i referohen akteve ligjore dhe nënligjore.
Së dyti, duke u bazuar në pretendimet e paraqitura nga subjekti, në mungesë të Kryeinspektorit, nuk duhej të ishte hartuar procesverbali i konstatimit dhe as të ishte marrë vendimi për vendosjen e masës administrative.
Për sa më sipër, **argumenti juaj nuk merret në konsideratë.**

7.5 Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të dënimit me masë administrative gjobë:
Vendimi për dënimin e kundërvajtësit me masë administrative gjobë merret për të gjitha rastet kur konstatohen shkelje në veprimtarinë ndërtimore. Ky vendim bashkë-shoqëron gjithmonë vendimin për pezullimin e punimeve dhe vendimin për prishjen e objektit të kundërligjshëm. Vlera e masës administrative përcaktohet sipas dispozitave ligjore, ndërsa për objektet e ndërtuar pa marrë paraprakisht miratimin e autoriteteve vendore ose qendrore, gjoba përcaktohet në raport të drejtë me vlerën e investimit.
Nga ana e kryeinspektorëve të IMTV, Bashkia Gramsh, për periudhën e auditimi 2023-2024, janë nxjerrë në total 2 vendime për dënimin e kundërvajtësit me masë administrative gjobë, me vlerë totale 600,000 lekë.

Tabela nr. II.7.4

Nr.	Vendim gjobe		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar	Vlera e gjobës
	Nr. serie	Data			
1	0000003	10.07.2023	Z. Ç.	Ndërtim objekti shtëpi banimi xoklaturë me lartësi 50 cm beton arme me distance 13m x 8.2 metra, objekt i pa përfunduar	500,000 lekë
2	0000001	09.09.2024	K.	Shkelje e afateve të lejes së ndërtimit	100,000 lekë

Burimi: Bashkia Gramsh. Përpunoi Grupi i Auditimit

Referuar auditimit të këtyre vlerave, pasqyruar në tabelën nr. 4, është konstatuar se për kundërvajtësin Zylyf Çoku, vlera e masës administrative dënim me gjobë është vendosur e pabazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Kjo vlerë fikse prej 500,000 lekë nuk është e parashikuar në asnjë nga pikat dhe nënpikat e nenit 52 të Ligjit nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar me Ligjin Nr. 119/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit". Kundërvajtja e cituar më sipër, ka të bëjë me punime të kryera pa leje ndërtimi, për të cilat, vlera e gjobës llogaritet sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika e), ku citohet: "kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për

metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi...".

Për llogaritjen e gabuar të vlerës së masës administrative dënim me gjobë, ngarkohet me përgjegjësi:
- Z. E. H., në cilësinë e kryeinspektorit pranë IMTV

7.6 Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të prishjes së objektit të kundërligjshëm dhe ekzekutimin e tyre:
Vendimi për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm merret në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit, si dhe në të gjitha rastet kur nuk respektohet vendimi i pezullimit të punimeve në ndërtim, nuk plotësohet dokumentacioni, teknik e ligjor dhe kur ka parregullsi në zbatimin e punimeve në objekt, brenda afatit kohor të parashikuar në vendimin përkatës. Vendimi për prishje shoqërohet me vendimet e dënimit me gjobë dhe për kundërvajtësin përgatitet kallëzimi penal, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2024, nga inspektorët e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Gramsh, është konstatuar gjithsej **1 subjekt** për ndërtim informal të ndërtuar pa leje ndërtimi.
Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se IMTV Bashkia Gramsh, për kundërvajtësin Z. Ç. ka proceduar me vendim për prishjen e objektit të kundërligjshëm, për ndërtime informale të ndërtuar pa leje ndërtimi ,por **nuk është ekzekutuar vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm.**
Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me neni 52 të Ligjit nr.107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",* i ndryshuar, pika 6.

Për mos-nxjerrjen e Urdhërit për ekzekutimin e vendimit të prishjes së ndërtimit të kundërligjshëm, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. E. H., në cilësinë e kryeinspektorit pranë IMTV

7.7 Mbi nisjen e procedurave për të kallëzuar penalisht kundërvajtësit:
Në respektim të nenit 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, pika dh), si dhe nenit 52 i Lgjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 7, kryeinspektori i IMTV ka detyrimin e përgatitjes së kallëzimit penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe të paraqitjes së tij pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi. Grupi i auditimit i kërkoi informacion IMTV Bashkia Gramsh mbi nisjen e indicies së veprës penale pranë organeve ligjzbatuese, për të gjithë rastet, që në zbatim të përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal, përbëjnë vepër penale.
Për sa më sipër u konstatua se nga ana e IMTV Bashkia Gramsh nuk është vendosur në dispozicion dokumentacion zyrtar, justifikues dhe vërtetues, për procedurën e nisjen e indicies së veprës penale pranë organeve ligjzbatuese, për rastet që përbëjnë vepër penale.

Për mos-nisjen e indicies së veprës penale pranë organeve ligjzbatuese, për rastet që përbëjnë vepër penale, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. E.H., në cilësinë e kryeinspektorit pranë IMTV

7.8 Mbi arkëtimin e masave administrative:
Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Gramsh për periudhën

01.01.2023 deri më 31.12.2023, rezulton se është vendosur ***1 gjobë*** në vlerën ***500,000 lekë***, e cila nuk është arkëtuar.
Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Gramsh për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, rezulton se është vendosur ***1 gjobë*** në vlerën ***100,000 lekë***, e cila është arkëtuar në masën 100%.
Këto raste janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. II.7.5

Nr.	Vendim gjobe		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar	Vlera e gjobës	Arkëtuar
	Nr. serie	Data				
1	0000003	10.07.2023	Z.Ç	Ndërtim objekti shtëpi banimi xoklaturë me lartësi 50 cm beton arme me distance 13m x 8.2 metra, objekt i pa përfunduar	500,000 lekë	JO
2	0000001	09.09.2024	K.	Shkelje e afateve të lejes së ndërtimit	100,000 lekë	PO

Burimi: Bashkia Gramsh. Përpunoi Grupi i Auditimit

Nga auditimi i dokumentacionit konstatojmë se:
- Aktualisht jemi në kushtet kur ka dalë Ligji nr. 127, datë 19.12.2024 *"Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 01 Janar 2015 deri më 30 Nëntor 2024 nga Inspektoratet vendore të mbrojtjes së territorit, Inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit, Autoriteti kombëtar i ushqimit, Inspektorati shtetëror shëndetësor, si dhe Policia e shtetit dhe ajo bashkiake"*.
- Për periudhën objekt auditimi nga ana e IMTV, DTTV, dhe Drejtorisë Juridike nuk janë ndjekur në kohë dhe me përpikmëri të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën prej **500,000 lekë** (për vitin 2023), në mospërputhje me kërkesat e neni 16/a të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve"*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *"Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, **deri në një muaj**. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit"*.

Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se përgjatë periudhës objekt auditimi nuk është bërë asnjë kërkesë për të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit të gjobave, veprim ky në mospërputhje me kërkesat e parashikuara në dispozitat ligjore të nenit 30 të Ligjit nr. 10 279, datë 20.05.2010 *"Për Kundërvajtjet Administrative"*, pika 4, i cili përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë, përkatësisht nga:
a) kryetari i bashkisë;
b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative.

Për mos-marrjen e masave për arkëtimin e masave administrative dënim me gjobë, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. B. A., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë
- Z. E. H., në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV

- Z. A. Ç., në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV

7.9 Mbi inspektimin e objekteve në zhvillim, me leje të miratuar nga Bashkia Gramsh

Në zbatim të përcaktimeve të nenit 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, pika a), Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Për periudhën objekt auditimi, bashkia rezulton të ketë **133** aplikime në sistem për leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe certifikata përdorimi, ndër të cilat rezultojnë të miratuara **91** leje, pasqyruar si më poshtë:

Tabela nr. II.7.6: Aplikimet në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2023-31.12.2023

Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023 nga sistemi e-lejet					
Nr.	**Lloji i lejes**	**Total**	**Miratuar**	**Refuzuar**	**Në proces**
1	Certifikatë përdorimi	10	6	4	-
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	5	2	3	-
3	Leje infrastrukture	6	6	-	-
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m^2	13	7	6	-
5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	4	1	3	-
6	Leje për ndryshim funksioni	19	15	4	-
7	Leje rindërtimi, rikonstr. dhe riparimi të nd. së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni	3	1	2	-
8	Leje zhvillimi	8	5	3	-
9	Njoftim për fillim punimesh	3	3	-	-
10	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	1	0	1	-
11	Leje ndërtimi për prishje ndërtimi ekzistues	1	1	0	-

Burimi: DPKTMP Bashkia Gramsh. Përpunoi: Grupi i auditimit

Tabela nr. II.7.7: Aplikimet në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2024-31.12.2024

Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024 nga sistemi e-lejet					
Nr.	**Lloji i lejes**	**Total**	**Miratuar**	**Refuzuar**	**Në proces**
1	Certifikatë përdorimi	13	7	6	-
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	8	3	5	-
3	Leje infrastrukture	15	13	2	-
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m^2	6	4	2	-
5	Leje për ndryshim funksioni	3	3	0	-
6	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	2	2	0	-
7	Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	1	1	0	-
8	Leje zhvillimi	3	2	1	-
9	Njoftim për fillim punimesh	6	6	0	-
10	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m^2	1	1	0	-
11	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	2	2	0	-

Burimi: DPKTMP Bashkia Gramsh. Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi i dokumentacionit dhe të dhënave u konstatua se nga IMTV, Bashkia Gramsh **nuk janë miratuar akte kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi.**
Duke marrë parasysh numrin e lejeve të miratuara rezulton se veprimet janë në mospërputhje me:
- nenin 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, shkronja a), i cili përcakton se:

Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:
a) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

- nenin 51 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, i cili përcakton se:

Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.

- pikën 2 të VKM-së nr. 894, datë 04.11.2015 *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore"*, e cila përcakton se:

Kryeinspektori / inspektori i njësisë vendore, gjatë kontrollit të ushtruar për zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi, i vlerëson shkelje të punimeve në ndërtim rastet e mospërputhjes së objektit në ndërtim me kërkesat e lejes së zhvillimit/të ndërtimit e të projektit teknik të zbatimit apo me deklarimin paraprak të miratuar e të konfirmuar nga organi i autorizuar.

Nga auditimi u konstatua mungesa e një bashkëpunimi eficient midis IMTV-së dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit në Bashkinë Gramsh, në kundërshtim me nenin 51 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 3, i cili përcakton se:

Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. E. H.**, në cilësinë e Kryeinspektori për periudhën 01.01.2023 - 12.07.2023;
- **Z. A.Ç.**, në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 08.08.2023 - 31.05.2024;
- **Z. A. B**, në cilësinë e inspektorit për periudhën 01.01.2023 - 12.07.2023;
- **Z. G. X.**, në cilësinë e inspektorit për periudhën 01.09.2023 - 30.08.2024

Konkluzion i përgjithshëm mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV Bashkia Gramsh:
1. Nga auditimi rezulton se IMTV në Bashkinë Gramsh nuk ka funksionuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe organizativ, pasi konstatohen mangësi në organizim, planifikim, raportim, dokumentim, ndjekje procedurash dhe ekzekutim detyrimesh ligjore, çka tregon mungesë efektiviteti në ushtrimin e përgjegjësive të saj për mbrojtjen e territorit

2.8 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Bashkia Gramsh nuk ka respektuar këtë afat, duke mos kthyer pergjigje mbi planin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar *nuk janë marrë masa* për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: *"Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*

III. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak Gramsh, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Bashkia Gramsh nuk ka hartuar planin e veprimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, nuk ka raportuar rregullisht pranë Këshillit Bashkiak, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 50, pika 5, ku përcaktohet që: "Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo audituesit të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë".

IV. **Rekomandimet e KLSH-së:**

Në Bashkinë Gramsh janë lënë për zbatim gjithësej **27** masa nga të cilat :

- **20** Masa organizative,

-1 Masa për shpërblim dëmi ne vlerën **264,970 lekë pa TVSH.**

-4 Masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) në vlerën **66,975,686 lekë.**

-2 Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficience dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën **3,172,806 lekë**.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve rezultojnë se **12** rekomandime janë te zbatuara, **3** të zbatuara pjesërisht, **3** në proces zbatimi dhe **9** rekomandime të pa zbatuara.

V. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Gramsh të Kryetarit të Bashkisë z. B. A. me nr. 361/7 prot., datë 13.06.2024, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
27	**12**	**3**	**3**	**9**

B. MASA ORGANIZATIVE

1. **Gjetje nga auditimi:** Bashkia Gramsh nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe nuk ka hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, pasi nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të. Takimet e GMS nuk dokumentohen me procesverbale, nuk ka hartuar strategjinë dhe regjistrin e riskut dhe nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime, nuk ka plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore, nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, VKM nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike" dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.*(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.1.1 faqe 20-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	**20**	**20**	**0**
Masa për shpërblim dëmi	**1** **264,970 lekë pa TVSH.**	**1** 264,970 lekë	**0**
Masa për administrimin e fondeve publike te ardhura te munguara	**4** në vlerën **66,975,686 lekë.**	**4**	**0**
Masa për eliminimin efektive negative EEE	**2**	**2**	**0**
Totali	**27**	**27**	**0**

<u>1.1. Rekomandimi</u>: Kryetari i Bashkisë Gramsh, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për: njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij; të përditësojë dhe të forcojë aktivitetin e GMS, të koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut; të hartojë dhe të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se janë marrë masat për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij gjithashtu me urdhër të kryetarit bashkisë Nr.142 datë 25.04.2024 "Për menaxhimin dhe koordinimin e riskut" është përcaktuar Koordinatori i riskut, njëkohësisht dhe urdher nr.143 datë 25.04.2024 "Për krijimin e grupit për menaxhimin strategjik (gms), dhe ekipeve te menaxhimit te programeve(emp)" u krijua grupi i

menaxhimit financiar dhe grupi i menaxhimit strategjik. Nuk është hartuar gjurma e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut,
Rekomandimi është Zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e NjAB u konstatua se: Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, nuk janë kryer auditime në fushat të cilat vlerësohen me risk të lart, nuk ka filluar procesin e certifikimit për 1 (një) auditues, nuk ka hartuar "Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm". Dosjet e auditimit nuk janë të plotësuara me dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesave ligjore. Nuk është kryer auditim tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH-ja. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016, të MF "Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik" i ndryshuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020, kapitulli VI "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikat 2.1.2-2.1.3 faqe 30-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandim: Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin risk të lart, Të marrë masa për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH duke planifikuar auditim tematik për këtë qëllim.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se procesi i çertifikimit nuk ka filluar sepse nuk është çeluar nga drejtoria Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Dosjet janë plotesuar me dokumentacionin përkatës.Bazuar në Planin Strategjik vjetor me nr.3682/3 dt 12.10.2023 janë planifikuar për auditim subjektet me risk të lartë si, Drejtoria e Planifikim territorit, Drejtoria e Tatim –Taksave Sek. Menaxhimit të aseteve. Është ngritur urdhëri nr.169.dt.13.05.2024 me nr.1970.prot dt.13.05.2024 Per miratimin e programit për sigurimin e brendshëm të cilësise
Rekomandimi është Zbatuar pjesërisht

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Gramsh së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2023 kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2023 buxheti përfundimtar i rishikuar ka vlerën 1,156,202,174 lekë ndërsa realizimi është në vlerën 1,052,977,960 lekë në masën 91% ose me një mosrealizim në vlerën 103,224,214 lekë.
Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2023 janë planifikuar në vlerën 231,565,284 mijë lekë dhe realizuar 185,919,755 mijë lekë ose në masën 80.2%. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Gramsh në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9, pika 1.3, germa "c" dhe "ç", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të

vetëqeverisjes vendore", UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" dhe VKB përkatëse. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.1-2.2.5, faqe 36-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera të Bashkisë Gramsh, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se gjatë hartimit te Projekt Buxhetit te vitit 2024 eshte kryer një planifikim real te te ardhurave te veta ne perputhje me demografine e qytetit konkretisht në buxhetin fillestar ishin parashikuar të ardhura ne vlerën 110,470 mije leke, ndersa në buxhetin me ndryshime planifikimi i të ardhurave të veta është 121,615 mijë lekë ndërsa realizimi për vitin 2024 është 126,319 prej të cilave 16,222 mijë lekë janë detyrime të prapambetura mbi taksat lokale të Uzinës Mekanike Gramsh, të xhiruara në periudhën janar 2025 por nga instucioni kreditues jane klasifikuar si transaksione te vitit buxhetor 2024, vlerë e cila ishte e palanifikuar ne parashikimin e të ardhurave të buxhetit 2025, pra të ardhurat e relizuar dhe të planifikuara nga viti 2024 janë në vlerën 110,097 mijë lekë ose 90.64% e planifikimit
Rekomandimi është Zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Gramsh më datën 01.01.2023, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive në total në **vlerën 13,119,103 lekë** e përbërë nga detyrime të prapambetura me burim financimi nga të ardhurat e veta në vlerën 10,002,173 lekë + detyrime të prapambetura nga FZHR në vlerën 2,641,476 lekë + detyrime të prapambetura nga Ministria e Linjës në vlerën 475,454 lekë.Gjatë vitit 2023 janë likuiduar detyrime të prapambetura në **vlerën 3,910,399 lekë** me burim financimi nga të ardhurat e veta që i përkasin detyrimeve progresive të datës 31.12.2022. Vlera e detyrimeve të trashëguara të papaguara më datë 31.12.2023, pa përfshirë detyrimet e krijuara gjatë vitit 2022, është në **vlerën 9,208,704 lekë** e përbërë nga detyrime të trashëguara me burim financimi nga të ardhurat e veta në vlerën 6,091,774 lekë + detyrime të trashëguara nga FZHR në vlerën 2,641,476 lekë + detyrime të trashëguara nga Ministria e Linjës në vlerën 475,454 lekë.Detyrimet e prapambetura të krijuara vetëm përgjatë vitit 2023 janë **vlerën 6,424,478 lekë** me burim financimi nga të ardhurat e veta. Vlera totale e detyrimeve të prapambetura progresive më datë 31.12.2023, është në **vlerën 15,633,182 lekë** e përbërë nga detyrime të prapambetura me burim financimi nga të ardhurat e veta në vlerën 12,516,252lekë + detyrime të prapambetura nga FZHR në vlerën 2,641,476lekë + detyrime të prapambetura nga Ministria e Linjës në vlerën 475,454lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, pikat-162, Rubrika "Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve", nenin 52, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 5, datë 27.12.2014, "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91.*(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.1-2.2.5, faqe 36-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Gramsh dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ë marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve

paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se detyrimet e prapambetura në fillim të vitit 2024 janë në vlerën 15,633,182 lekë prej të cilave:3,116,930 lekë janë detyrimeve të mbartura nga FZHR dhe Ministritë e linjës 2,936,028 lekë detyrime të mbartura prej vitesh me mangësi në dokumentacionin e dorëzuar 3,989,392 lekë detyrime të mbartura nga vendimet gjyqësore 5,590,832 Detyrime të mbartura në proces likuidimi. Gjatë vitit 2024 jane likuiduar 5,590,182 lekë detyrime të prapambetura dhe janë shtuar 5,811,559 lekë detyrime të reja,gjëndja e detyrimeve të prapambetura në 31.12.2024 është 15,853,909 lekë ose 2.59% e nivelit të përgjithshëm të shpenzimeve, pra bashkia Gramsh nuk është në fashën e 15% probleme financiare. Me VKB nr 7 datë 30.01.2025 "për miratimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2024 " në zbatim të aktit normativ nr 5 date 19.12.2024 " Për shpërndarjen e fondit të pakushtëzuar shtesë " është miratuar një fond për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe janë në fazën e likuidimit të tyre
Rekomandimi është Zbatuar pjesërisht

5. Gjetje nga auditmi: Për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 145,121,000 lekë dhe realizimi në vlerën 109,191,007 lekë ose në masën 75.2% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 35,929,993 lekë.
Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, u konstatua se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura të debitorëve. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave" Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu II, pika 2, germa "a" dhe "b", Kreu III, pika 32. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 46-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.
5.2. Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifat vendore të vitit buxhetor aktual.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se planifikimi i të ardhurave është bërë analitik për çdo zë të taksave dhe tarifave vendore.
Rekomandimi është Zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore,të ardhurat nga agjentët tatimorë (Ujësjellës Kanalizime Gramsh Sh.A sot pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan detyrimet e abonentëve familjarë, ASHK Gramsh në lidhje taksën mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, Drejtoria Rajonale e Tatime Elbasan në lidhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat personale dhe DSHTRR Elbasan në lidhje me taksat vendore të qarkullimit për mjetet e përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Gramsh dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Gramsh. Bashkia Gramsh ka të dhëna vetëm për vlerën e arkëtuar nga këta agjentë, sipas vlerës së depozituar në thesar, por nuk ka bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimor dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre.Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga Agjentët Tatimorë, Bashkia Gramsh, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore", neni 117.*(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 46-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Gramsh të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.
6.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Gramsh, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se Bashkia Gramsh ka bërë rakordimet me ujësjellës kanalizime Elbasan.Bashkëlidhur edhe akt-rakordimet
Rekomandimi është Zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Gramsh kryhet në programin Excel. DTTV nuk kryhen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Gramsh i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e

DTTV. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV. Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: "Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar".*(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 46-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marren masa për hartimin e regjistrit të taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se DTTV nuk ka një sistem të mirfilltë për taksat e tarifat vendore por ne Excel dhe në regjistra.
Rekomandimi është Pa Zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Gramsh për vitin 2023 u konstatua se, subjekti "B" me Nipt ... ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Gramsh në fushën materialeve elektrike, por sipas të dhënave të QKB-së ky subjekt rezulton i pezulluar. Po kështu dhe subjektet "A ." me Nipt ..., Subjekti "E. T." me Nipt ... dhe Subjekti "B" me Nipt ... nuk ushtrojnë aktivitet, por sipas QKB këto subjekte janë aktiv.

Për sa trajtuar më sipër nga DTTV nuk janë mbajtur akt-konstatime mbi statusin e subjekteve verifikimin në qoftë se këto subjekte ushtrojnë aktivitet, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, neni 22, nenet 48-49.*(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 46-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore (sektori I kontrollit në terren), të planifikojë inspektime në terren në lidhje me statusin e subjekteve, në qoftë se konstatohen subjekte që ushtrojnë aktivitet pa u regjistruar në QKB t'u përllogariten taksat dhe tarifat vendore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se janë mbajtur të gjithë proçesverbalet dhe është përllogaritur taksa për çdo subjekt që ushtron aktivitet tregtar. Bashkëlidhur proçesverbalet.
Rekomandimi është Zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2023 kanë ushtruar aktivitet në territorin e Bashkisë Gramsh 2 subjekte në fushën e ndërtimit të cilat nuk kanë hapur nipt sekondar në zbatim të detyrimeve ligjore duke shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore ndaj institucionit sipas kontratave konkretisht:
-Kontrata me nr. 4499 prot., datë 13.11.2023, me objekt "Për kryerjen e punimeve në objektin "Rikonstruksion i Zyrave të Këshillit Bashkiak dhe Zyrave të katit të parë të Bashkisë Gramsh", në vlerën 5,389,429 lekë me Tvsh lidhur ndërmjet Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. B.

A.Kryetar i Bashkisë dhe OE "S." ShPK përfaqësuar nga Administratori z. Y. B.
-Kontrata me nr. 4381 prot., datë 06.11.2023, me objekt "Për kryerjen e punimeve në objektin "Ndërtim i Urës Bailey, Përroi Çumës (Dushit), në rrugën automobilistike Kuratë-Grabovë, Njësia Administrative Lenie", në vlerën 12,676,022.35 lekë me Tvsh lidhur ndërmjet Bashkisë Gramsh përfaqësuar nga z. B. A. Kryetar i Bashkisë dhe BOE "V" Shpk & "P" Shpk përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor z. T. E.
Në lidhje me këtë situatë Bashkia Gramsh është drejtuar OE "S." ShPK me kërkesë për pajisje me adresën dytësore me shkresën nr. 4665 prot., datë 22.11.2023, për të cilën ka lëshuar edhe faturën për arkëtimin e detyrime për taksat dhe tarifat vendore në vlerën 18,325 lekë si dhe OE "V." ShPK pajisje me adresën dytësore me shkresën nr. 4666 prot., datë 22.11.2023, për të cilën ka lëshuar edhe faturën për arkëtimin e detyrime për taksat dhe tarifat vendore në vlerën 28,608 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, neni 22, nenet 48-49. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 46-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa në vijimësi, për të gjithë subjektet që kanë lidhur kontratë investimesh me bashkinë, pajisjen e tyre me nipt sekondar dhe përllogaritjen e taksave dhe tarifave vendore deri në momentin e përfundimit të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se Subjektet të cilat kryejnë punime në territorin e bashkisë Gramsh kanë likuiduar detyrimet sipas shkresave të dërguara nga përgjegjësi i prokurimeve. Bashkëlidhur shkresa nr. 4540 prot, datë 16.10.2024, shkresa nr. 5162 prot, datë 07.11.2024.
Rekomandimi është Zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, në territorin e Bashkisë Gramsh kanë ushtruar aktivitet (referuar regjistrit të lejeve në faqen zyrtare të AKBN-së) 29 subjekte në fushën e energjetikës. Për 12 subjekte ndërmjet Bashkisë dhe Shoqërive Koncesionare janë nënshkruar kontrata qiraje ku për vitin 2023 janë likuiduar detyrimet në vlerën totale 5,249,649 lekë. Gjithashtu për 13 subjekte është lidhur kontratë qiraje ndërmjet palëve por ende nuk ka filluar pagës me pretendimin se këto subjekte nuk janë të pajisura me leje ndërtimi. Ndërkohë që referuar Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016, "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", pikat 19-21, pagesat e tarifave të qirasë fillojnë në momentin e lidhjes së kontratës. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 46-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Gramsh në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të marrë masa që, të aplikojë pagesën e tarifave të kontratave të qirasë për dhënien e sipërfaqeje të fondit pyjor kullosor nga momenti i lidhjes së kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se nga Bashkia Gramsh nuk është marrë asnjë mase për ketë rekomandim.
Rekomandimi është Pa Zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Grupi i Auditimit bëri kërkesë për kontratat e qirave të fondit

pyjor/kullosor lidhur me subjekte të cilat ushtrojnë aktivitetin në sektorin e burimeve minerare në Bashkinë Gramsh dhe Njësitë Administrative.Nga të dhënat e siguruara nga grupi i auditimit për subjekte të pajisura me kontratat e koncesionit sipas regjistrit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, në territorin e Bashkisë Gramsh, kanë ushtruar aktivitet në fushën e energjetikës 4 subjekte, për të cilat Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit Bashkia Gramsh nuk administron dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj.,). Veprime këto në kundërshtim me Neni 17, i Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për fondin kullosor", pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor" i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, "Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor".*(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 46-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandim: Drejtorisë së shërbimit Pyjor t'i kërkojë informacion Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me qëllim evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar. **Koment i grupit të auditimit**: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se nga Bashkia Gramsh nuk është marrë asnjë mase për ketë rekomandim. **Rekomandimi është Pa Zbatuar**

12. Gjetje nga auditimi: Për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit për vitin 2023, ka dalë Urdhri nr. 359, datë 07.12.2022, i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e komisioneve të inventarizimit të aktiveve të institucionit dhe njësive administrative. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t'i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 85, germa "c". Me Urdhrin nr. 297, datë 13.11.2023, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur komisioni për vlerësimin e mallrave dhe materialeve të propozuara për t'u nxjerrë jashtë përdorimit. Nga komisioni i sipërpërmendur është mbajtur procesverbali me shkresën nr. 4987 prot., datë 18.12.2023, ku janë vlerësuar aktive për nxjerrje jashtë përdorimit në vlerën totale 9,400,066 lekë si më poshtë:

-Për llogarinë 327 "Inventar i imët" në vlerën 1,494,041 lekë;
-Për llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" në vlerën 1,023,922 lekë;
-Për llogarinë 312 "Materiale konsumi" në vlerën 31,923 lekë;
-Për llogarinë 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 6,850,180 lekë.

Me shkresën nr. 5042 prot., datë 21.12.2023, z. B. A. Kryetar i Bashkisë Gramsh është drejtuar

me një relacion Këshillit Bashkiak Gramsh mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të Zyrave të Bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj.
Me Vendimin nr. 86, datë 27.12.2023, të Këshillit Bashkiak është miratuar nxjerrja e aktiveve jashtë përdorimit në vlerën 9,400,066 lekë.
Nga auditimi u konstatua se, më datë 31.12.2023, janë përfshirë në gjendjen e llogarisë 327 "Inventar i imët" vlera 1,494,041 lekë, llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" vlera 1,023,922 lekë, llogarisë 312 "Materiale konsumi" vlera 31,923 lekë dhe llogarisë218 "Inventar ekonomik" vlera 6,850,180 lekë, të cilat nuk janë në gjendje pune dhe kanë marrë miratimin sipas VKB nr. 86, datë 27.12.2023, për nxjerrje jashtë përdorimit dhe në kushte të tilla këto aktive duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara". Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Aneksi nr. 1, "Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)", 2.1, "Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2", vlera totale e sipërpërmendur 9,400,066 lekë e cila i përket kostos historike mjete të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 58-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
12.1. Rekomandim: Nga komisionet e inventarizimit të aktiveve pas përfundimit të procesit të inventarizimit të të paraqiten para nëpunësit autorizues raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se nga komisionet e inventarizimit të ngritur me urdhër nr 432 datë 12.12.2024 dhe urdhër nr 355 datë 11.10.2024 janë kryer invetarizimet fizike por në raportin janë shprehur për kushtet e ruajtjes së tyre, gjëndjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, rekomandim i cili do të plotësohet ne inventarizimin e vitit 2025.
Rekomandimi është Në Proces Zbatimi

12.2. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në pasqyrat e vitit 2024 të bëjë sistemimin e vlerës totale prej 9,400,066 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të aktiveve të dëmtuara që i përkasin llogarive 327 "Inventar i imët" në vlerë 1,494,041 lekë, 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" në vlerën 1,023,922 lekë, 312 "Materiale konsumi" në vlerën 31,923 lekë dhe 218 "Inventar i imët" në vlerën 6,850,180 lekë, sistemi të kryhet referuar trajtimit kontabël në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara".

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se materialet e propozuara për tu nxjerrë jashtë përdorimi në vlerën 9,400,066 lekë janë miratuar për tu nxjerrë jashtë përdorimi me VKB nr 86 datë 27.12.2023 dhe janë asgjesuar në zbatim të urdhërit të brendshëm nr 127 datë 26.04.2024 dhe rrjedhimisht nuk janë të kontabilizuara në pasqyrat financiare të vitit 2024.
Rekomandimi është Zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" më datë 01.01.2023,

paraqitet në vlerën 49,561,257 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 48,980,497 lekë me një pakësim në vlerën 580,760 lekë. Në gjendjen e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" nuk është përfshirë vlera 66,975,686 lekë e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore dhe për pasojë kjo llogari nuk paraqet situatën reale debitore. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespodencë ndërmjet Drejtorisë së Tarifave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme",pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 58-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" me kunërparti llogarinë 470 "Të ardhura për t'u marrë".

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se DTTV për vitin 2024 ka dërguar listen e debitorëve për subjektet pranë drejtorisë së finances me shkresën nr 1072 prot, date 11.03.2025. Shkresa nr. 3823-3823/96 prot, date 04.09.2024 "Njoftim dhe kërkesë për pagesë të detyrimeve tatimore". Shkresa nr. 5329 prot, date 19.11.2024 "Bllokim llogarie bankare për subjektet debitore"**.** Në pasqyrat financiare të vitit 2024 në logarinë 468 "Debitore të ndryshëm' janë reflektuar edhe debitorët fizik/Juridik të cilët kanë detyrime mbi taksat dhe tarifat vendore sipas shkresës së drejtorisë të të ardhurave vendore nr 1072 datë 11.03.2025 në vlerën 3,863,999 lekë.
Rekomandimi është Zbatuar

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i analitikëve u konstatua se në gjendjen e llogarisë 211 "Pyje, kullota, plantacione" në vlerën 11,217,186 lekë kosto historike është përfshirë vlera 11,217,186 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Gramsh (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre.
-Në gjendjen e llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" në vlerën 916,488,386 lekë kosto historike është përfshirë vlera 376,538,010 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Gramsh (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.
-Në gjendjen e llogarisë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" në vlerën 2,509,282,471 lekë kosto historike është përfshirë vlera 343,864,618 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Gramsh (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i

ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 58-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se Gjëndja e e llogarisë 211 "Pyje, kullota, plantacione" e pasqyruar ne pasqyrat financiare është në vlerën 13,203,906 lekë prej të cilave vlera 2,396,720 lekë është e analizuar sipas librave të investimeve ndërsa vlera prej 1,807,186 lekë është e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike, kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Gramsh pa analizë dhe pa dokumentacion shoqërues.
-Gjëndja e e llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" e pasqyruar ne pasqyrat financiare është në vlerën 1,027,311,230 lekë prej të cilave vlera 110,822,844 lekë jnë investime të vitit 2024 dhe vlera 916,488,386 lekë janë të trashëguara nga viti 2023 në të cilën është përfshirë vlera 376,538,010 lekë e analizuar në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Gramsh (në formë tabelore në programin Excel) por e pa shoqëruar me librin e investimeve, nuk gjendet dokumenti i origjinës.
-Gjëndja e llogarisë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" e pasqyruar ne pasqyrat financiare është në vlerën 2,632,843,507 lekë prej të cilave vlera 123,561,036 lekë jnë investime të vitit 2024 dhe vlera 2,509,282,471 lekë janë të trashëguara nga viti 2023 në të cilën është përfshirë vlera 343,864,618 lekë e analizuar në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Gramsh (në formë tabelore në programin Excel) por e pa shoqëruar me librin e investimeve, nuk gjendet dokumenti i origjinës.
Rekomandimi është Pa Zbatuar

15. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 231 "Për aktive afatgjata materiale" në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve u konstatua se, për vitin 2023 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punimet si dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesat, për vlerën 56,918,948 lekë që i përkasin llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" objekti "Rikonstruskioi i Shkollës së Mesme "Shefqet Guzi" likuiduar vlera 15,940,032 lekë nga kontrata në vlerën 80,000,078 lekë me Tvsh, objekti "Rikonstruksioni i banesave të familjeve në nevojë" likuiduar vlera 7,250,000 lekë nga kontrata në vlerën 15,127,102 lekë dhe llogarisë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" objekti "Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme të fshatit Çërujë" likuiduar në vlerën 20,400,000 lekë nga kontrata në vlerën 46,574,256 lekë, objekti "Sistemim asfaltim Lagja Holta Ish-Konservimi" në vlerën 13,328,916 lekë nga kontrata në vlerën 20,328,916 lekë. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhej të paraqitej në bilanc 0 lekë, kur ka kontrata investimesh në proces, pra kjo llogari duhej të pasqyrohej në vlerën 56,918,948 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 58-81*

të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të merren masa për kontabilizimin e vlerës 56,918,948 lekë në llogarinë 231 "Për aktive afatgjata materiale" që i përket likuidimeve të situacioneve pjesore të kontratave të investimeve të cilat janë në proces zbatimi punimesh.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se për objektet e mesipërme ka përfunduar afati i punimeve dhe njëkohësisht është kryer likuidimi i tyre dhe në pasqyrat financiare 2024 janë pasqyruar në llogaritë respektive 212 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë rrjete vepra ujore".
Rekomandimi është Zbatuar

16. Gjetje nga auditimi: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 "Investime për aktive afatgjata jo materiale" paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" në vlerën 0 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 0 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 "Nga fondet e veta të investimeve" e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 "Teprica e grandeve kapitale të brendshme" në vlerën 693,000 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Aneksi 1, gërma "c".*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 58-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230 - 231 "Investime në proçes" me kundërparti llogaritë 105 "Teprica e grandeve kapitale të brendshme", 115 "Nga fondet e veta të investimeve" dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 "Fondi Bazë".

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se nuk janë reflektuar rekomandimet e kontrollit mbi këtë konstatim edhe ne pasqyrat financiare te vitit 2024 vlera e kasioneve qe ka bashkia mbi inceneratorin E... dhe Ujësjellës Kanalizime Elbasan janë pasqyruar në llogarinë 26 "Pjesmarrje ne kapitalin e vet" në kundër parti të llogarisë 105 "Teprica e Granteve kapitale të Brendshmne.
Rekomandimi është Pa Zbatuar

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi administrimin e pronave të Bashkisë Gramsh për periudhën objekt auditimi, rezultoi se sipas VKM-ve nga **5,965 prona** vetëm **2,227 janë të transferuara**sipas listës përfundimtare të pronave. Nga pronat në pronësi, nga Bashkia Gramsh janë pajisur me çertifikatë pronësie gjithsej 59 prona dhe nuk janë pajisur me certifikatë pronësie 2168 prona.

-Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Bashkisë Gramsh dhe Njësive Administrative Pishaj, Porocan, Sult, Kodovjat, Kukur, Lenije, Skënderbegas, Kushovë dhe Tunjë nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në

Republikën e Shqipërisë", neni 37, pika 1, ku përcaktohet që, "Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji".
-Nga auditimi i llogarisë 210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje, plantacione", 212 "Ndërtesa e konstruksione", 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", 214 "Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune", 215 "Mjete transporti" dhe 218 "Inventar ekonomik" u konstatua se nga Bashkia Gramsh mbajtja e informacionit mbi ekzistencën e aktiveve mbahen në formatin Excel, por nuk disponohet një regjistër kontabël në formë të shkruar në zbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve një njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26-30.
-Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 "Toka, troje, terrene", llogarisë 211 "Pyje, kullota, plantacione", llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", Bashkia Gramsh nga **2,227** pasuri të pasqyruara në kontabilitet vetëm **59** prej tyre posedojnë titull pronësie. Nga Bashkia Gramsh nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarisë 210 "Toka, troje, terrene", llogarisë 211 "Pyje, kullota, plantacione" (nuk disponohet asnjë certifikatë pronësie), llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore". Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 35, germa "a", "b" dhe "c" për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 58-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 "Toka, troje, Terrene", 211 "Pyje, Kullota Plantacione", 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara), sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

17.2. Rekomandim: Bashkia Gramsh, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për hartimin e regjistrit të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se është ende në fazën e dokumentimit të plotë të aseteve të transferuara nga Njësitë Administrative për hartimin e regjistrit të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre
Rekomandimi është Në proces zbatimi

18. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Gramsh në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerë 23,453,620 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Gramsh. Për 3 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Gramsh janë ngurtësuar fonde në vlerën 6,485,097 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Gramsh, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e

dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 6,485,097 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 58-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Gramsh, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontrator për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se**:** Gjendja e llogarisë Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Gramsh në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerë 23,453,620 lekë gjatë vitit 2024 janë kaluar finde te kontraktorët në vlerën 10,838,719 lekë ose 46 % njëkohësisht janë akumuluar garanci nga investimit e viti buxhetor 11,511,482 lekë dhe gjendja e pasqyruar në pasqyrën e pozicion financiar të Bashkisë Gramsh në fund të vitit 2024 është 23,453,614 lekë
Rekomandimi është Zbatuar

19. Gjetje nga auditimi: Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 205/9 prot., datë 31.07.2023, ku janë lënë për zbatim 20 masa organizative, 4 masa për shpërblim dëmi në vlerën 1,871,390 lekë, 5 masa për administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet dhe arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore të ardhura të munguara dhe 16masa disiplinore.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 20 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuara 3 masa janë zbatuar plotësisht, 2 masa janë zbatuar pjesërisht, 5 masa janë në proces zbatimi dhe 10 masa janë të pa zbatuara.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 4 masa në vlerën 1,871,390 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuara 3 masa janë zbatuar plotësisht (arkëtuar në vlerën 1,606,420 lekë) dhe 4 masa janë të pa zbatuara.

c. Për administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet dhe arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore të ardhura të munguara janë rekomanduar 5 masa në vlerën 49,055,661 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuara 2 masa janë zbatuar pjesërsiht dhe 3 masa janë të pa zbatuara.

d. Masa disiplinore janë rekomanduar 16 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuara 16 masa janë të pa zbatuara.

-Gjithashtu nga Bashkia Gramsh nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në KLSH duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.5, faqe 81-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. <u>Masa organizative</u>

<u>1.1. Rekomandimi:</u> *Bashkia Gramsh me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon:*

-Të hartojë planin e trajnimeve për stafin;

-Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik";

-Të miratojë "Strategjinë e Menaxhimit të Riskut".

<u>3.1. Rekomandimi:</u> *Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuara dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korrigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.*

<u>4.1. Rekomandimi:</u> *Kryetari i Bashkisë Gramsh dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, ku mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet rriskë për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.*

<u>6.1. Rekomandimi:</u> *Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga Agjentët Tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizmin e Agjentëve Tatimore me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura. Të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat të cilat mblidhen nga Agjentët Tatimore, të kryqëzojë informacionet me institucioni e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.*

<u>7.1. Rekomandimi:</u> *Bashkia Gramsh të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit, ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifat vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.*

<u>8.1. Rekomandimi:</u> *Drejtorisë së Shërbimit Pyjor të kërkojë informacion Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me qëllim evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.*

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

<u>9.1. Rekomandimi:</u> *Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve në llog.468 "debitorë të ndryshëm", në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë port të ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që Pasqyrat Financiare të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve*

ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.
11.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje", duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.*
12.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e 6 pronave të certifikuara në ASHK Elbasan, por pa vlerë respektive, si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Gramsh.*

17.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë të gjitha masat e nevojshme për lidhjen e një Akt-marrëveshjeve me subjektet zhvillues "Z. E.Ll, Znj J.Ll" dhe me subjektin zhvillues "K" SHPK me NIPT J.....S, për kalimin e sipërfaqes prej 166.8 m^2 banim në favor të Bashkisë Gramsh sipas pjesëve takuese së sipërcituar.*
19.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Gramsh të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme duke reflektuar kërkesat e pikës 5.1 të VKM Nr. 267 datë 27.04.2023.*
20.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Gramsh të marrë të gjitha masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, dhe përshpejtimin e zbatimit të rekomandimeve në proces zbatimi të lëna nga KLSH në raportin e auditimit të fundit, sipas shkresës nr. 376/7 prot., datë. 22.07.2022, të përshkruara në mënyrë të detajuar në këtë raport auditimi, pika "Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në auditimin e fundit" si vijon:*

B. Masa për shpërblim dëmi
3.1. Rekomandimi: *Bashkia Gramsh të arkëtojë vlerën prej* ***264,970 lekë pa TVSH*** *nga sipërmarrësi i punimeve BOE "F" SHPK & "Sh." SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës me nr. 1931 prot., datë 28.05.2021 me objekt "Sistemim asfaltim lagjja "Ish reparti Ushtarak" Bashkia Gramsh.*

C. Masa për administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet dhe arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore të ardhura të munguara.
1.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Tatim Taksave Vendore Bashkia Gramsh, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën* ***66,577 mijë lekë****, si më poshtë vijon:*
a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare. b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme). c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Tatim Taksave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar. d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë Tatim Taksave dhe Drejtorisë Juridike, të marren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Gramsh për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

2.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën* ***71,441 lekë*** *ndaj* ***4*** *personave.*

3.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Gramsh, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për pajisen me liçensa të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe arkëtimin e tarifës së pataksuar prej* ***4,800,000 lekë*** *ndajë* ***6*** *subjekteve, sipas pasqyrës së sipërcituar.*

4.1. Rekomandimi: *Drejtoria Juridike të njoftojë periodikisht Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me operatorët ekonomik që shpallen fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bëjë ngarkesën e të gjitha subjekteve për detyrimet vendore që lindin me lidhjen e kontratës, si dhe të marrë të gjitha masat për pagesën e rregullt të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me përcaktimet e paketës fiskale, nga secili operator ekonomik që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Gramsh.*

5.1. Rekomandimi: *Inspektorati i Mbrojtës Territorit (IMT) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Gramsh, të kërkojë në Gjykatë, shndërrimin e vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 "Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv" dhe neni 30 "Arkëtimi i shumave të detyrimeve" të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe arkëtimi i vlerës* ***5,806,667 lekë*** *e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Gramsh.*

Menjëherë

A. ***Masa organizative të lëna në auditimin e mëparshëm.***
5.1. Rekomandim: *Bashkia Gramsh të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit, ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifat vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.* ***7.1 Rekomandimi:*** *Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve në llog.468 "debitorë të ndryshëm", në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë port ë ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që Pasqyrat Financiare të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.* ***9.1 Rekomandim:*** *Bashkia Gramsh duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZRPP dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimit dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.*
B. ***Masa për administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet dhe arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore të ardhura të munguara.***
5.1. Rekomandim: *Drejtoria Juridike të njoftojë periodikisht Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me operatorët ekonomik që shpallen fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bëjë ngarkesën e të gjitha subjekteve për*

detyrimet vendore që lindin me lidhjen e kontratës, si dhe të marrë të gjitha masat për pagesën e rregullt të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me përcaktimet e paketës fiskale, nga secili operator ekonomik që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Gramsh.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se në lidhje me rekomandimin për marrjen e 16 masave disiplinore për punonjësit e bashkisë Gramsh nga Kryetari Bashkisë është ngritur urdhëri nr.217 datë 18.08.2023 "Për krijimin e komisionit disiplinor për punonjësit për shkeljet e konstatuara sipas raportit të KLSH-së. Komisionit disiplinor nuk është mbledhur për të zbatuar rekomandimet e lëna nga KLSH
Rekomandimi është Pa Zbatuar

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Detyrimet e prapambetura mbi vendimet gjyqësore më datë 31.12.2023, janë në vlerën 6,177,048 lekë e përbërë nga shpenzime me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna në vlerën 2,187,656 lekë dhe çështje të tjera të ndryshme ndryshme gjyqësore në vlerën 3,989,392 lekë. Bashkia Gramsh për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2023 ka shpenzuar vlerën 2,187,656 lekë, nga e cila i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 4 raste.**Vlera totale 2,187,656 lekë e shpenzuar për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, nga Bashkia Gramsh për zbatimin e vendimeve gjyqësore konsiderohet efekt negativ financiar.** Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 60.*(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.1-2.2.5, faqe 36-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Gramsh të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se në lidhje me 4 rastet e largimit nga puna ka te bej me periudhen e reformes territoriale dhe rastet jane te mbartura nga shkrirja e ish-Komunave, Sektori i BNJ është këshilluar që të zbatojë në mënyrë rigoroze gamën ligjore si për rekrutiminb ashtu edhe për ndërprerjen e marrëdhenies se punës
Rekomandimi është Pa Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë u konstatua se, në 3 raste janë zhvilluar projekte artistike për të cilat nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe Kulturën", neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8. Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e projekteve artistike (honorare për artistët) është kryer sipas Vendimit nr. 103, datë 27.12.2022, të Këshillit Bashkiak. Nga Bashkia Gramsh për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, për 3 subjekte është likuiduar shuma **985,150 lekë e cila përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi të prokurimit publik,** duke i përjashtuar këto procedura. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.3, faqe 58-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të evidentojë të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar. **Koment i grupit të auditimit**: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se për rekomandimin e mësiperm nga bashkia Gramsh nuk është marrë asnjë masë **Rekomandimi është Pa Zbatuar**

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se deri më datën 31.12.2022, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë abonentët familjarë dhe biznesi i madhe i vogël në vlerën **18,123,392 lekë.**Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, janë krijuar debitorë në vlerën **23,157,628 lekë.** Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2023, për abonentët familjarë janë në vlerën **41,281,020 lekë e cila përbën të ardhura të munguar për Buxhetin e Bashkisë Gramsh,** si më poshtë:

1. Vlera 5,219,245 lekë për 3,764familje, nga mos arkëtimi i taksës së tokës bujqësore;
2. Vlera 3,092,567 lekë për 5,653 familje, nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës;
3. Vlera 3,273,040 lekë për 2,339 familje, nga mos arkëtimi i tarifës së pastrimit;
4. Vlera 182,480 lekë për 5,653 familje, nga mos arkëtimi i taksës së truallit.
5. Vlera 139,900 lekë, mos arkëtimi i tarifës së vaditjes dhe kullimit.
6. Vlera 932,400 lekë për 1,889 familje, nga mos arkëtimi i tarifës së gjelbërimit.
7. Vlera 1,473,934 lekë për 2,059 familje, nga mos arkëtimi i tarifës së ndriçimit.
8. Vlera 276,200 lekë për 1,889 familje, nga mos arkëtimi i tarifës së ujërave të përdorur.
9. Vlera 4,223,720 lekë për 1,470 familje, nga mos arkëtimi i tarifës dru zjarri.
10. Vlera 1,370,996 lekë, nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga biznesi i vogël.
11. Vlera 20,935,084 lekë, nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga biznesi i madh.
11. Vlera 161,454 lekë, nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga biznesi i vogël.

Njësia Administrative Pishaj. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara", nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore".*(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 46-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore deri më datën 31.12.2023, në **vlerën totale 41,281,020lekë.** a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.
b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.
d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
e. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Gramsh, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se DTTV për vitin 2024 ka dërguar listën e debitorëve për subjektet pranë drejtorisë së financës me shkresën nr. 1072 prot, date 11.03.2025. Shkresa nr. 3823-3823/96 prot, date 04.09.2024 "Njoftim dhe kërkesë për pagesë të detyrimeve tatimore". Shkresa nr. 5329 prot, date 19.11.2024 "Bllokim llogarie bankare për subjektet debitore".
Rekomandimi është Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, u konstatua se nga ASHK Gramsh janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi. Nga auditimi u konstatua se deri më datë 31.12.2022, për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë detyrimi për këtë taksë është 71,441 lekë për 4 persona. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 2,175,849 lekë nga të cilat është arkëtuar vlera 2,175,849 lekë, pra nuk janë krijuar detyrime. Në total detyrimi për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë më datë 31.12.2023, është në **vlerën 71,441 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Gramsh.** Nga dokumentacioni i paraqitur u konstatua se Bashkia Gramsh për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar ASHK-së Dega Gramsh ose ASHK Rajonal Elbasan, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore. Veprime këto në

kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", neni 27, pika "d", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 46-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **71,441 lekë** ndaj **4** personave.

2.2. Rekomandim: Bashkia Gramsh, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Politikave Urbane për personat të cilat nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leja, t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Elbasan vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se qytetarët janë njoftuar verbalisht, dhe asnjëri prej tyre nuk është paraqitur për të bërë pagesat në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje. Në vijim do të vazhdojë proçedura për t'i kërkuar Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Elbasan për vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë për secilin debitor
Rekomandimi është Pa Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, kanë qenë aktive 23 kontrata për dhënien me qira të objekteve ndërtesave nga të cilat 3 prej tyre janë dhënë me kontratë qiraje enfiteozë. Nga auditimi u konstatua se deri më datën 31.12.2022, për mos pagimin e detyrimeve të përcaktuara në kontratën e qirasë janë krijuar debitorë në **vlerën 20,772,630 lekë.** Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, janë krijuar debitorë në **vlerën 4,850,595 lekë.** Në total detyrimet progresive më datë 31.12.2023, për mos likuidimin e detyrimeve të përcaktuara në kontratën e qirasë janë në vlerën **25,623,225 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Gramsh.** *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 46-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e ndërtesave/objekteve në total në vlerën**25,623,225 lekë** duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se janë marrë këto masa: Bazuar në legjislacionin në fuqi është ngritur grupi i punës për inventarizim dhe verifikimin në vënd të gjendjes së pronave jopublike të paluajtshme të Bashkisë Gramsh, ose që janë transferuar me V.K.M në pronësi/përdorim të bashkisë, me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 86 datë 28.02.2025 ku detyrat e grupit të punës janë: Është krijuar regjistri i inventarizimit të pronave jopublike të paluajtshme dhe ka nisur verifikimi në terren i gjendjes së tyre. Janë marrë masa duke njoftuar të gjithë debitorët për pagesën e detyrimit të mbajtur. Bashkëlidhur keni njoftimet për pagesën e detyrimit të mbartur bashkë me lajmërim-marrjet. Është arkëtuar shuma prej 391,120 lekë duke e ulur shumën e detyrimit të prapambetur në 25,232,105 lekë, gjithashtu po vazhdon

mbledhja e detyrimit të dy prej debitorëve në bazë të akt marrëveshjes së lidhur me ta.
Rekomandimi është në Proces Zbatimi

Si konkluzion: Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 361/7 prot., datë 13.06.2024, ku ja len per zbatim **38** masa organizative, nga të cilat 23 rekomandime nga auditimi i fundit dhe 15 rekomandime të rikërkuara.

- **1** masa për shpërblim dëmi në vlerën **264,970 lekë pa TVSH e rikërkuar**
- **9** masa për administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet dhe arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore të ardhura të munguara në vlerën **76,720,371 lekë, nga të cilat 3 rekomandime nga auditimi I fundit dhe 6 të rikërkuara**
- **2** masa per eleminimin efektive negative te konstatuara ne administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicietet, eficense dhe efektivitet te fondeve publike.
- **1** Masa disiplinore

-Gjithashtu nga Bashkia Gramsh nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në KLSH duke mos respektuar kështu edhe afatin 20 ditor dhe atë 6 mujor.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, gërma "c", neni 30, pika 2.

Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të rikërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi sekretari i Përgjithshëm dhe titullari i Bashkisë Gramsh.

III. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Bashkia Gramsh nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe nuk ka hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, pasi nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të. Takimet e GMS nuk dokumentohen me procesverbale, nuk ka hartuar strategjinë dhe regjistrin e riskut dhe nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime, nuk ka plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore, nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, VKM nr. 833, datë 28.10.2020, "*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*", Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*" dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.1 faqe 12-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gramsh, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për: njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij; të përditësojë dhe të forcojë aktivitetin e GMS, të koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut;

të hartojë dhe të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e NjAB u konstatua se:
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, nuk janë kryer auditime në fushat të cilat vlerësohen me risk të lart, nuk ka hartuar "*Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm*". Dosjet e auditimit nuk janë të plotësuara me dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesave ligjore. Nuk është kryer auditim tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH-ja. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016, të MF "*Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik*" i ndryshuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020, kapitulli VI, pika 4.1.1. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.1 faqe 12-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin risk të lart si dhe të marrë masa për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH duke planifikuar auditim tematik për këtë qëllim.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Gramsh ka hartuar tavanet përgatitore të programit Buxhetor Afatmesëm Vendore për vitet 2024-2026 me relacionin nr. 1315 prot., datë 31.03.2023, relacion i cili është miratuar nga Këshilli Bashkiak me Vendim nr. 30, datë 28.04.2023, me nr.1315/2.prot., datë 09.05.2023 i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresë nr. 548/1.prot., datë 11.05.2022, jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimi nr. 6, datë 28.02.2023 *"Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026" kreu I pika 1.*
Projekt dokumenti i PBA-së për vitet 2024-2026 të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar është dërguar elektronikisht më datë 01.06.2022, me nr.2014.prot., datë 05.06.2023 dhe zyrtarisht me shkresë nr. 2014/1.prot., datë 05.06.2023 në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 6., datë 28.02.2023
Nga drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve nuk janë paraqitur kërkesat buxhetore shtesat sipas programit të Koordinatorit të GMS, brenda muajit Prill 2023. Pjesë e kërkesave buxhetore duhet të jenë edhe objektiva për arritjen e barazisë gjinore, si dhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë në komunitetin e tyre pakica rome dhe egjiptiane objektiva për integrimin e tyre në komunitet të cilat nuk janë parashikuar në PBA 2024-2026, në kundërshtim me Udhëzimin nr.6., datë 28.02.2023 "*Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026",* pika 7.
- Nga auditimi u konstatua që buxheti vjetor 2024 është miratuar me VKB nr. 88, datë 27.12.2023, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan me shkresën nr. 84/1.prot., datë 16.01.2023. Dokumentacion për buxhetin 2024 është dërguar pranë Këshillit Bashkiak jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"*, neni 41, pika 1, dhe pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.2 faqe 32-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Gramsh të marrë masa që në planifikimin e PBA në vazhdim (2026-2028) ta dërgojë atë brenda afateve të përcaktuara në Këshillin Bashkiak dhe në Ministrinë e Financave.

Me hartimin e PBA 2026-2028

3.2. Rekomandimi: Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve në bashkëpunim me Koordinatorin e GMS të marrin masa që në planifikimin e PBA në vazhdim (2026- 2028) kërkesat buxhetore sipas programit të përfshijnë edhe objektiva për arritjen e barazisë gjinore, si dhe kërkesa buxhetore për komunitetin rome dhe egjiptiane si dhe ti dërgojnë ato brenda afateve të përcaktuara ligjore te koordinatori i GMS.

Me hartimin e PBA 2026-2028

3.3. Rekomandimi: Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore i bashkisë Gramsh dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa që të dërgoje brenda afateve të përcaktuara për miratim në Këshillin Bashkiak buxhetin e vitit në vazhdim

Me hartimin e PBA 2026-2028

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit te buxhetit te vitit 2024 u konstatua qe, buxheti fillestar është në vlerën prej 595,257 mijë lekë, miratuar me VKB nr. 88, datë 27.12.2023.Vlera fillestare e planifikuar e buxhetit ka pësuar ndryshime duke u shtuar për vlerën prej 95,130 mijë lekë e cila përbëhet nga të ardhurat e veta të cilat janë trashëguar nga viti 2023 për vitin 2024 me VKB-në nr.17, datë 29.02.2024, "*Për miratimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2023"* duke arritur ne vlerën 690,387 lekë. Gjithashtu u konstatua që ka pasur ndryshime buxhetore për vitin 2024 në vlerën prej 31,629 mijë lekë duke arritur planifikimin buxhetor në vlerën prej 722,016 mijë lekësh që nuk përfshin fondet e deleguara të Bashkisë Gramsh. Ndryshimet buxhetore kanë ndodhur brenda muajit Mars 2024. Planifikimi fillestar i buxhetit nuk është kryer sakte ,rrjedhimisht ka pasur ndryshime te te tjera buxhetore. Nga auditimi u konstatua që në programin buxhetor 1110 *"Planifikim menaxhim administrim"* janë përshirë produkte buxhetore investimesh për rruge rurale dhe investime te tjera të cilat nuk duhej të kategorizoheshin në programin buxhetor 1110 por në programin buxhetor 04520 *"Rrjeti rrugor rural".* Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar neni 19, 20, 22, 32, 33, 47, 67, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* neni 9, pika 1.3, germa "c" dhe "ç", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore"* nenet 40, 41, 45, 46. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"*; pikat 12-17', pikat 21-27, pikat 28-33. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.2 faqe 32-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës e Bashkisë Gramsh të marrë masa të përmirësojë procesin e planifikimit dhe kategorizimit të buxhetit duke siguruar ndarjen e saktë të programeve buxhetore dhe reflektimin korrekt të të ardhurave të trashëguara dhe ndryshimeve buxhetore brenda afateve dhe procedurave ligjore.

Me hartimin e PBA 2026-2028

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua që me vendim të Këshillit Bashkiak nr.18, datë 29.02.2024 *"Për miratimin e ndryshimit të planit të buxhetit të Bashkisë Gramsh për vitin 2024"* është pakësuar programi 01110 *"Planifikim menaxhim dhe administrim"* me vlerë 2,000,000 lekë dhe është shtuar programi *"Fondi rezerve"* në programin 04980 me vlerë 2,000,000 lekë.
Ky vendim është konfirmuar nga prefekti i qarkut me shkresën 366/1.prot., datë 18.03.2024.
Për sa më sipër rezulton që ka pasur planifikim të pasaktë të programeve buxhetore duke përfshirë fondin rezerve brenda programit 1110, që është planifikim menaxhim dhe administrim. Ndryshimi ka ndodhur brenda muajit Mars 2024. Programi buxhetor 04980 fondi rezerve sipas raportit të

monitorimit është 65,000 lekë në planifikim dhe zero lekë në realizim ndërkohe që fondi rezerve në vetvete është planifikim 2,000,000 lekë dhe realizim 1,950,000 lekë.
Nga auditimi u konstatua që programi buxhetor 04980 i cili është ka qenë i planifikuar me ndryshime në vlerën 2,000,000 lekë dhe në raportin e monitorimit të buxhetit rezulton planifikim 65,000 lekë, do të thotë që vlera prej 1,935,000 lekë rezulton e ndryshuar si program buxhetor nga prekja e fondit rezerve. Nga auditimi u konstatua që ka vendime të këshillit bashkiak të vitit 2024 për prekjen e fondit rezerve për shpenzime për kurim në të cilën nuk përcaktohet pakësimi i programit 04980 (fondi rezerve) dhe praktika e ndjekur për ndryshimin e programit nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit është pas vendimit të Këshillit Bashkiak për prekjen e fondit rezerve pasi nga te dhënat e thesarit rezulton që programi 04980 për vitin 2024 është realizuar në vlerën zero leke. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit i është drejtuar Degës se thesarit Gramsh për pakësimin e programit buxhetor 04980 (fondi rezerve) dhe shtimin e programit 01110 (planifikim administrim) në mënyrë që të kryente veprimet e pagesës për kurim të vendosur nga Këshilli Bashkiak .
Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar neni 19.20,47, 67, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 9, pika 1.3, germa "c" dhe "ç", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" nenet 40,45,46, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" i ndryshuar, Kreu II.3. "*Buxheti i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore Rregulla dhe kritere për përdorimin e buxhetit vendor"* pikat 92 deri 108 UMFE nr. 22, date 30.07.2018, "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore*", kreu II "Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e monitorimit të buxhetit".
Udhëzimin plotësues nr.1., datë 24.01.2024 Për zbatimin e buxhetit për vitin 2024 Kreu II. "Kritere dhe procedura specifike shtesë për zbatimin e buxhetit vendor", pika 100 deri 130. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.2 faqe 32-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Gramsh të marrë masa të përcaktojë saktë programin buxhetor 04980 *"Fondi rezerve"* në praktikat e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Gramsh nuk ka dërguar raporte 4 mujore të monitorimit dhe të zbatimit të buxhetit për vitin 2024 në Ministrinë e Financave. Raporti i monitorimit të buxhetit për vitin 2024 nuk është hartuar në përputhje të plotë të përcaktimeve të nenit 54 të Ligjit 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar germa a, ç, h, i, f. Raporti i monitorimit të buxhetit nuk është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Gramsh sipas përcaktimeve të nenit 48 pika 3 të Ligjit 68/2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, si dhe nuk disponohet një korrespodencë shkresore me Këshillin Bashkiak dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me raportimin mujor mbi monitorimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* neni 3. Pika 44, Udhëzimin nr. 22, datë 30.7.2018 *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore"*, pika 22 dhe pikat 27,28,29. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.2 faqe 32-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Gramsh të marrë masa të dërgojë në Ministrinë e Financave raportet katër mujore të monitorimit të buxhetit të vitit në vazhdim, si dhe ti publikojë ato në faqen zyrtare të bashkisë Gramsh.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura u konstatua që vlera e detyrimeve për faturat e prapambetura në fillim të vitit 2024 rezultojnë për mallrat dhe shërbimet, përkatësisht në vlerën 2,534,228 lekë për investimet ne vlerën 5,992,632 lekë dhe për investimet nga ministritë e linjës 3,989,392 lekë.
U konstatua që ne vitin 2024 janë kryer likuidime te faturave te vitit 2023 dhe nuk janë likuiduar faturat e përpara vitit 2023 duke mos respektuar radhën e kryerjes se pagesave te faturave sipas moshës se krijimit te tyre.
Veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar neni 52, me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, pikat 153-12, Rubrika *"Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve",* Udhëzimin e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 5, datë 27.12.2014, "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura",* pikat 27-30. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.2 faqe 32-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës së Bashkisë Gramsh të marrë masa të kryeje likuidimet e detyrimeve të prapambetura që kanë rezultuar në fillim të vitit 2024 duke respektuar radhën e kryerjes së pagesave.

Brenda vitit 2025

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave për pagesat e vendimeve gjyqësore u konstatua që bashkia Gramsh ka shpenzuar 961,430 lekë për vitin 2024 për zbatimin e vendimeve gjyqësore: Vlera prej 961,430 lekë e shpenzuar nga Bashkia Gramsh për zbatimin e vendimeve gjyqësore konsiderohet efekt negativ financiar.
Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Nuk është kryer analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to.
Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" i ndryshuar, pika 60. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.2 faqe 32-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gramsh të marrë masa për analizimin e arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe të nxjerrë përgjegjësitë administrative në lidhje me humbjen e vendimeve gjyqësore.

Brenda vitit 2025

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të inventarizimit u konstatua se, nuk u paraqitën dokumente për kryerjen e inventarëve fizikë për aktivet e institucionit, për rrjedhojë llogaritë e aktiveve në bilancin e vitit 2024, janë mbyllur për gjendjen kontabël. Në këto kushte, llogaritë e pasqyrave financiare, nuk janë të rakorduar me gjendjen fizike, gjë e cila nuk krijon besueshmëri mbi vërtetësinë e tyre. Në këtë rast, nxjerrja e pasqyrave financiare pa kryer inventarizimin fizik e të gjithë aseteve, është shkelje e kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu III, pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.3 faqe 65-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gramsh në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për mbylljen e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit për llogaritë 210 *"Toka, troje, terrene"*, 211 *"Pyje, plantacione, kullota"*, 212 *"Ndërtesa e*

konstruksione", 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*, 214 *"Instalime teknike, makineri e pajisje"*, 215 *"Mjete transporti"* dhe 218 *"Inventar ekonomik"*, duke bërë dhe verifikimin në terren të këtyre aseteve.

Deri më datë 31.12.2025

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2024, rezultoi se Llogaria 202 *"Studime dhe kërkime"* më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 14,561,739 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është përllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 13,254,199 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 12,377,478 lekë. Nga auditimi u konstatua se në gjendjen e llogarisë 202 *"Studime dhe kërkime"* janë përfshirë projektet *"Rikonstruksion i Lagjes "Holta"* dhe *"Rikonstruksion i Lagjes Sporti nr. 2"*, në vlerën totale 2,810,976 lekë *(kosto historike)* të cilat nuk duhej të kontabilizoheshin në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II, Aneksi 1, pika 2, klasa 2. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.3 faqe 65-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 *"Studime e kërkime"*, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 2,810,976 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara në llogaritë 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* dhe 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"*.

Deri më datë 31.03.2026

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i analitikëve u konstatua se, llogaria 210 *"Toka, troje, terrene"* e pasqyruar në bilanc për vlerën 50,742,734 lekë dhe llogaria 211 *"Pyje, kullota, plantacione"* në vlerën 13,203,906 lekë, janë të pa analizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari. Si dhe në gjendjen e llogarisë 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* në vlerën 916,488,386 lekë kosto historike është përfshirë vlera 376,538,010 lekë dhe 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"* në vlerën 2,509,282,471 lekë kosto historike është përfshirë vlera 343,864,618 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Gramsh *(në formë tabelore në programin Excel)* e pa analizuar e cila ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.3 faqe 65-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Deri më datë 31.12.2025

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b *"Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)"* për llogarinë 218 *"Inventar ekonomik"* është përllogaritur normë amortizimi i akumuluar deri më datë 31.12.2024, në vlerën 125,927,730 lekë *(kosto historike)* ose në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 *"Pajisje kompjuterike"* nga aktivet e llogarisë bazë 218 *"Inventar ekonomik"* e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 36. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.3 faqe 65-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në gjendjen e llogarisë 218 *"Inventar ekonomik"* të klasifikojë veçmas llogarinë 218/6 "*Pajisjet kompjuterike*" në regjistrin e aseteve të njësive dhe pasqyrat financiare, konform kërkesave të nomenklaturës së llogarive, duke aplikuar amortizimin sipas normës përkatëse për çdo aktiv.

Deri më datë 31.03.2026

13. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 231 *"Për aktive afatgjata materiale"* në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve u konstatua se, për vitin 2024 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punimet si dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, konkretisht objektet: *"Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore"* me vlerë kontrate 80,452,800 lekë pa TVSh me OE *"M."* ShPK me afat përfundimi punimesh më datë 24.03.2025, për të cilën janë likuiduar situacionet pjesore në vlerën 34,455,010; *"Rikonstruksion asfaltim rruga e fshatit Mashan"* me vlerë kontrate 79,164,260 lekë pa TVSh me OE *"T."* ShPK me afat përfundimi punimesh më datë 15.05.2025, për të cilën janë likuiduar situacionet pjesore në vlerën 35,638,680, dhe *"Rikonstruksioni Shkollës 9-vjeçare "Rilindja" Bashkia Gramsh"* me vlerë kontrate 87,923,313 lekë pa TVSh me OE *"I."* ShPK me afat përfundimi punimesh më datë 13.06.2025, për të cilën janë likuiduar situacionet pjesore në vlerën 23,000,000 lekë. Në këto kushte gjendja e kësaj llogari nuk duhej të paraqitej në pasqyrat financiare në vlerën 0 lekë, kur ka kontrata investimesh në proces, pra në këtë llogari duhej të pasqyrohej vlera e situacioneve pjesore të likuiduara. Sipas informacionit kontabël llogaria 231 *"Për aktive afatgjata materiale"* është nënvlerësuar në vlerën 93,093,690 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Aneksi 1. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.3 faqe 65-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të merren masa për kontabilizimin e vlerës 93,093,690 lekë në llogarinë 231 *"Për aktive afatgjata materiale"* që i përket likuidimeve të situacioneve pjesore të kontratave të investimeve të cilat janë në proces zbatimi punimesh.

Deri më datë 31.03.2026

14. Gjetje nga auditimi: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 *"Investime për aktive afatgjata jo materiale"* paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 *"Investime për aktive afatgjata materiale"* në vlerën 0 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 0 lekë e cila nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 *"Nga fondet e veta të investimeve"* e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 *"Teprica e grandeve kapitale të brendshme"* në vlerën 693,000 lekë. Këto veprime

janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Aneksi 1, gërma "c. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.3 faqe 65-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të evidentojë pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, në llogaritë 230 - 231 *"Investime në proces"* me kundërparti llogaritë 105 *"Teprica e grandeve kapitale të brendshme"*, 115 *"Nga fondet e veta të investimeve"* dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 *"Fondi Bazë"*.

Deri më datë 31.03.2026

15. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Gramsh në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 24,126,383 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Për 22 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Gramsh janë ngurtësuar fonde në vlerën 3,264,686 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Gramsh, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 3,264,686 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2011, *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.3 faqe 65-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gramsh, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.Gjetje nga auditimi: Në 7 raste (4 raste për vitin 2023 dhe 3 raste për vitin 2024) dhe konkretisht për procedurën e prokurimit me objekt *"Rikonstruksion i Gjimnazit "Shefqet Guzi" viti 2023", "Sistemim-asfaltim i rrugëve të fshatit Cerujë, viti 2023", "Blerje mallrash ushqimore për plotësimin e nevojave të çerdheve, kopshteve dhe konviktit të shkollës së mesme" viti 2023, "Blerje dru zjarri dhe pelet për institucionet arsimore për vitin shkollor 2023-2024 si dhe Njësitë Administrative", "Rikonstruksion i Shkollës 9-vjeçare "Rilindja", Bashkia Gramsh", viti 2024, "Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore", viti 2024 dhe "Rikonstruksion asfaltim rruga e fshatit Mashan", Bashkia Gramsh", viti 2024,* janë konstatuar mangësi që lidhen me hartimin e kritereve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 2/c i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për "*Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.4 faqe 85-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Njësia e prokurimit të marrë masa që kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, duke garantuar që përcaktimi i kritereve të jetë sa më i argumentuar dhe i mbështetur në përllogaritje sipas nevojave.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në 7 raste u konstatua se gjatë procedurës së vlerësimit të përmbushjes së kritereve të kualifikimit, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt *"Rikonstruksion i Gjimnazit "Shefqet Guzi" viti 2023", "Sistemim-asfaltim i rrugëve të fshatit Cerujë, viti 2023", "Blerje mallrash ushqimore për plotësimin e nevojave të çerdheve, kopshteve dhe konviktit të shkollës së mesme" viti 2023, "Blerje dru zjarri dhe pelet për institucionet arsimore për vitin shkollor 2023-2024 si dhe Njësitë Administrative", "Rikonstruksion i Shkollës 9-vjeçare "Rilindja", Bashkia Gramsh", viti 2024, "Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore", viti 2024 dhe "Rikonstruksion asfaltim rruga e fshatit Mashan", Bashkia Gramsh", viti 2024,* KVO mjaftohet me vetëdeklaratën e operatorëve mbi përmbushjen e kritereve e cila ngarkohet në sistem dhe nuk merren masa për verifikimin e përmbushjes së kritereve nga operatori fitues në momentin e dorëzimit të dokumentacionit fizik origjinal. Nga KVO nuk janë marrë masat e nevojshme për të verifikuar përputhshmërinë e mjeteve të dorëzuara me vetëdeklarimet e bëra, kështu kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Dokumentet Standarde të Tenderit. Neni 26, pika 6 dhe 7 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për "Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.4 faqe 85-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Në funksion të garantimit të përmbushjes së kapaciteteve teknike, KVO të marrin masa të mos mjaftohen vetëm me vetëdeklaratat e ofertuesit të kualifikuar, por përpara lidhjes së kontratës të sigurohen për vërtetësinë e deklaratës, nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit fizik të dorëzuar.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit rezultoi se Urdhër Prokurimet nuk janë hartuar sipas kërkesave ligjore lidhur me specifikimet e shënuara për anëtarët e Njësisë së Prokurimit, duke përcaktuar persona përgjegjës për çështje të ndryshme gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, në kundërshtim me nenin 74, pika 2, 3 dhe 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.4 faqe 85-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gramsh të marri masa që në hartimin e Urdhrave të Prokurimit të mos përcaktojë detyra të veçanta për secilin anëtarë duke respektuar parashikimet ligjore ku të gjithë anëtarët të veprojnë të barabartë gjatë të gjithë procesit të prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit me "*vlerë e vogël*":

-Në katër raste për procesin e marrjes në dorëzim të mallrave u konstatua se nuk është hartuar procesverbali i marrjes në dorëzim veprimet në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

-Në 6 raste nga AK nuk janë hartuar kërkesë paraprake për fillimin e procedurës së prokurimit, veprime në kundërshtim me nenin 2, pika 2, germa "a". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.4 faqe 85-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandimi: Titullari i njësisë vendore apo personi i autorizuar prej tij të miratojë për çdo rast të hartojë kërkesat paraprake për fillimin e procedurës së prokurimit, si dhe urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Komisioni të përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision duhen të bëjnë pjesë jo

më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi material.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit u konstatua mungesa e dokumenteve kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit që vërteton kontrollin e cilësisë së punimeve, në kundërshtim me Udhëzimin nr.2, datë 13.5.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*", për objektet si më poshtë:

1- Për objektin Rikonstruksioni i Gjimnazit "Shefqet Guzi", mungojnë autorizimet për përdorimin e materialeve si përzierje betonesh (mix design).

2- Për objektin Ndërtim i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësorë, mungojnë vizatimet justifikuese të librezave të masave. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.4 faqe 85-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1. Rekomandimi: Mbikëqyrësi i punimeve dhe grupet e ndjekjes dhe të zbatimit të kontratave të marrin masat për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm teknik, me qëllim verifikimin e sasive dhe cilësinë e materialeve e të produkteve të përdorura.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Gramsh dhe Njësive Administrative Pishaj, Porocan, Sult, Kodovjat, Kukur, Lenije, Skënderbegaz, Kushovë, Tunjë u konstatua se:

- Me VKM-të përkatëse, kjo njësi vendore ka në pronësi në total 5,965 pasuri nga të cilat janë transferuar vetëm 2,227 prej tyre, por nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, *"Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"*, neni 37, pika 1, ku përcaktohet që, *"Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji"*;
- Në zbatim të Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, *"Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore"* si dhe në mbështetje të pikave 9-11, dhe 22 të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, *"Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore"*, nuk janë ngritur grupet e punës, kjo e përcaktuar në misionin dhe detyrat e NJQV, administrimi i aseteve, si dhe struktura e ngarkuar për ndjekjen e tyre;
- Nuk ka një regjistër kontabël në nivel bashkie për të gjitha asetet që ajo zotëron. Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Gramsh dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki nuk janë inventarizuar totalisht si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale;
- Nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.,), dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"*, nenet 27-28, parashikohet se, funksionet e bashkisë në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, funksionet e bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, vënien në evidence të ndërtesave me sipërfaqe dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive të përcaktuara në listat e inventarëve, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira;

- Për vitet 2023-2024, nuk ka dërguar kërkesa pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh për regjistrimin e pasurive. Nga të gjithë pronat që administrohen nga vetë bashkia vetëm 59 prej tyre janë të pajisura me certifikatë pronësie, për të cilat ky titull është fituar që prej viteve 2004-2014;
- Për aktivet që i përkasin llogarive 210 *"Toka, troje, terrene"*, 211 *"Pyje, kullota, plantacione"*, 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* dhe 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*, Bashkia Gramsh të cilat janë të evidentuara në kontabilitet vetëm 59 prej tyre janë të pajisura me certifikatë pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pika 35, gërma "a", "b" dhe "c" për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Bashkia Gramsh nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarive 210, 211, 212 dhe 213. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.5 faqe 131-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gramsh të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin e pronave të Bashkisë Gramsh të kaluar me VKM, mbi gjendjen fizike për hartimin e regjistrit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

21.2. Rekomandimi: Drejtoria Financës të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 *"Toka, troje, terrene"*, 211 *"Pyje, kullota plantacione"*, 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* dhe 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara), sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i kontratave për dhënien me qira të ekonomive pyjore dhe kullosore të pyje dhe kullotave verore u konstatua se, në 3 raste (Kontrata me nr. 1871 prot., datë 03.05.2024, për ngastrat me nr. 9, nr. 10/a, nr. 10/b, nr. 11/a, nr. 11/b, nr. 46/2 me sipërfaqe 98.8 ha me kapacitet mbajtës 100 krerë dhe përdorim 300 krerë; Kontrata me nr. 1872 prot., datë 03.05.2025, për ngastrat me nr. 15/b, me sipërfaqe 23.33 ha me kapacitet mbajtës 100 krerë dhe nr. 15/b, me sipërfaqe 13.5 ha me kapacitet mbajtës 77 krerë dhe përdorim 215 krerë; Kontrata me nr. 1591 prot., datë 15.04.2024, për ngastrat me nr. nr. 13/b, me sipërfaqe 9.75 ha me kapacitet mbajtës 67 krerë dhe *"Faqja e Kroit"* nr. 19, me sipërfaqe 27.2 ha me kapacitet mbajtës 18 krerë dhe përdorim 215 krerë) dhënia në përdorim për kullotje nuk është kryer në përputhje me aftësinë mbajtëse kullosore pra ka tejkalim kapaciteti, duke ju referuar planit të mbarështimit sipas ngastrave përkatëse. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007, *"Për fondin kullosor"* i ndryshuar, neni 15, pikat 1-3. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.5 faqe 131-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1. Rekomandimi: Bashkia Gramsh, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit të marrë masa që, dhënia me qira e ngastrave që shtrihen në ekonomitë pyjore dhe kullosore pronë e bashkisë, të kryhet në përputhje me kapacitetin mbajtës të numrit të krerëve të bagëtive në zbatim të planit të mbarështimit.

Në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e siguruara për subjekte të pajisura me kontratat e koncesionit sipas regjistrit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se përgjatë periudhës nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, në territorin e Bashkisë Gramsh, kanë ushtruar aktivitet në fushën e energjetikes 2 subjekte (nga të cilat Subjekti H. ShPK ushtron aktivitet në zonë të mbrojtur dhe menaxhimi i sak kryhet nga Agjencia e Kombëtare e Zonave të Mbrojtura) për të cilën Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit Bashkia Gramsh nuk administron dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj.,). Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 17, të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, *"Për pyjet dhe shërbimin pyjor"* i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, *"Për fondin kullosor"*, pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, *"Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor"* i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10.2008, *"Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor"*. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.5 faqe 131-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga Sektori i Shërbimeve Veterinare, Mbrojtjes së Tokës, Bujqësisë pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Bashkia Gramsh ka gjithsej 4,529 ha tokë bujqësore të pandarë në pronësi, nga të cilat 79.499 ha janë të dhëna me qira ndërsa pjesa e mbetur prej 4,449.5 ha është e lirë, por nuk disponohet informacion mbi hapësirat e zaptuara. Nga kjo drejtori, nuk janë evidentuar sipërfaqet e tokës bujqësore për dhënien me qira, nuk janë hartuar/përgatitur relacione drejtuar Këshillit Bashkiak për shqyrtimin dhe miratimin e sipërfaqeve të tokave bujqësore që mund të jepen me qira. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, *"Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara"*, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.5 faqe 131-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Gramsh të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi pune me specialist të fushës, me qëllimin evidentimin dhe saktësimin e gjendjes/statusit faktit të tokave bujqësore, pas përfundimit të këtij procesi të paraqitet informacion pranë Këshillit Bashkiak duke përmbush edhe njëkohësisht dispozitat ligjore përkatëse.

Menjëherë

25. Gjetje nga auditimi: Me VKB-në nr. 63, datë 18.09.2024, është miratuar dhënia në përdorim me kontratë qiraje pyjore të sipërfaqes prej 12 ha e cila shtrihet në zonën kadastrale 1556, 1736 dhe 3262, në ngastrat/nëngastrat pyjore me nr. 1/e, 2/b, dhe 23/d, të cilat janë pjesë e ekonomisë pyjore "Galigat-Strorë", për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë. Më datë 25.11.2024, ndërmjet Bashkisë Gramsh dhe Subjektit "O" ShPK, është nënshkruar kontrata me nr. 4932 Rep., nr. 1571 Kol., me objekt *"Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike 11.5 MW"*, me afat 10 vjeçar dhe vlerë kontrate

1,752,000 lekë. Për realizimin e objektit të kontratës është marrë me qira sipërfaqja prej 12 ha, e cila shtrihet në zonën kadastrale 1556, 1736 dhe 3262, në ngastrat/nëngastrat pyjore me nr. 1/e, 2/b, dhe 23/d, të cilat janë pjesë e ekonomisë pyjore *"Galigat-Strorë"*.
Në lidhje me këtë situatë janë kryer verifikimet përkatëse mbi statusin e gjendjes së ngastrave të cilat janë dhënë sipas kontratës së sipërcituar ku u konstatua se:
- Në planin e mbarështimit për ngastrën nr. 1/e në ekonominë pyjore *"Galigat-Storë"*, tipologjia e kësaj ngastre është joproduktive.
Në këtë dokument në çështjet shënime citohet se: *"Sipërfaqe me bimësi pyjore. Mbulesa bimore nuk shkon as në 10% të sipërfaqes. Kryesisht cemedell, mrete, dëllinjë dhe rrallë ndonjë shkurre e shkozës së zezë. Të mbetet nën susessionin natyrore, të ndiqet ecuria e grumbullimit"*. Ndërkohë që referuar VKM-së nr. 433, datë 08.06.2016, *"Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive"* i ndryshuar, nr. rendor 565, EL 26 00 001 e, Ekonomia Pyjore Galiat-Storë me sipërfaqe 27.20 ha i përket kategorisë *"Pyll"*.
- Në planin e mbarështimit për ngastrën nr. 2/b në ekonominë pyjore *"Galigat-Storë"*, tipologjia e kësaj ngastre është joproduktive.
Në këtë dokument në çështjet shënime citohet se: Sipërfaqe me bimësi pyjore e kryesuar nga shqema dhe rrallë ndonjë dëllinjë apo prall. Të mbetet nën suksesion natyrore, pasi ndërhyrja me pyllëzime ka rrezikuar disa herë dështimin.
Në planin e mbarështimit për ngastrën nr. 23/d në ekonominë pyjore *"Galigat-Storë"*, tipologjia e kësaj ngastre është joproduktive.
Në këtë dokument në çështjet shënime citohet se: Sipërfaqe të veshura me bimësi pyjore të rralla, kryesisht Dellinja dhe cemodelli. Bimësia nuk mbulon as 10% të totalit të sipërfaqes. Të mbetet nën suksesion natyrore.
Ndërkohë që referuar VKM-së nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar, nr. rendor 610, EL 26 00 023 d, Ekonomia Pyjore Galiat-Storë me sipërfaqe 6.70 ha i përket kategorisë *"Djerr"*.
Në kontratën e qirasë të nënshkruar në vitin 2024, u konstatua se për pasuritë e dhëna me qira nga Bashkia Gramsh nuk është bërë regjistrimi i tyre në ASHK. Pajisja e tyre me certifikatë pronësie është kusht për disponimin dhe tjetërsimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, *"Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 144, neni 192 dhe neni 194. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.5 faqe 131-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
25.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Gramsh të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialist të fushës, me qëllim verifikimin dhe rakordimin e tipologjisë së ngastrave që janë dhënë me kontratë qiraje për vendosje stacionesh, bazamentesh për panele fotovoltaike me qëllim promovimin e energjisë, ndërmjet të dhënave të VKM-së nr. 433, datë 08.06.2016, planit të mbarështimit dhe gjendjes faktike në terren. Në rast se evidentohen mos rakordime/diferenca mbi tipologjinë e ngastrave të kryhen amendimet përkatëse në kontratën e qirasë. Gjithashtu për rastet në vijim të mbahet në konsideratë që, lidhja e kontratës së qirasë të kryhet duke u mbështetur në certifikatën e pronësisë.

Menjëherë

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për të 12 *(dymbëdhjetë)* kontratat me objekt *"Shitje pasurie e paluajtshme me kusht"*, në Seksionin D *"Kufizimet e pronësisë"*, të Kartelës së Pasurisë së paluajtshme nuk është shënuar bllokimi *(kushti i kontratës)*, i cili bllokon këtë pasuri në favor të palës blerëse deri në shlyerjen e plotë të detyrimit sipas nenit 2 *"Çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës"* si dhe Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, *"Kodi Civil i Republikës së*

Shqipërisë" i ndryshuar, neni 746 *"Shitja me rezervë e pronës"*, përcaktohet që: *"Kur çmimi i shitjes paguhet me këste, blerësi e fiton pronësinë e sendit me pagimin e kështit të fundit të çmimit, duke marrë përsipër rreziqet që në çastin e dorëzimit. Kalimi me rezervë i pronësisë me kushtin e sipërm duhet të pasqyrohet në kontratë". (Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.5 faqe 131-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26.1. Rekomandimi: Bashkia Gramsh të marrë masa duke i'u drejtuar AShK-së vendore Gramsh për kryerjen e kufizimit të pasurisë në seksionin përkatës në kartelën e pasurisë për 12 (garazhedet) që kanë qenë objekt shitje me kusht, deri në momentin e shlyerjes përfundimtare të kësteve të pagesës për çmim kontraktor nga përfituesit, me qëllim ruajtjen e sigurisë juridike si dhe eliminimin e riskut nga tjetërsimi për pasuritë objekt kontrate.

Menjëherë

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, lidhur me realizimin e procedurës së privatizimit për 19 objektet e përcaktuara në VKB-në nr. 39, datë 31.03.2022, me objekt *"Për kalimin në fond banese të objekteve "Ish-Uzina e Pilave"* në pronësi të Bashkisë Gramsh për nevoja strehimi", u konstatua se në tre raste nuk rakordon sipërfaqja e objekteve sipas VKB-së me atë të është përfituar apo është në proces privatizimi konkretisht:

- Për objektin nr. 9, me emërtimin *"Ish-Administrata"*, sipërfaqja e miratuar në VKB për tre përfitues është 145 m^2 ndërkohë që sipas aplikimeve për privatizim sipërfaqja është 111 m^2 me një diferencë prej 34 m^2.
- Për objektin nr. 11, me emërtimin *"Ish-Depo"*, sipërfaqja e miratuar në VKB për dy përftues është 432 m^2 ndërkohë që sipas aplikimeve për privatizim sipërfaqja është 400 m^2 me një diferencë prej 32 m^2.
- Për objektin nr. 13, me emërtimin *"Ish-Kopshti i Shufrave të Karbonit"*, sipërfaqja e miratuar në VKB për dy përftues është 500 m^2 ndërkohë që sipas aplikimeve për privatizim sipërfaqja është 431.75 m^2 me një diferencë prej 68.25 m^2.

Miratimi i sipërfaqes nga Këshilli Bashkiak më tepër të sipërfaqeve nga kontratat e qirasë për ambientet të cilat janë kthyer si fond banese, ndikon drejtpërdrejtë në procesin e privatizimit, për arsye se aplikanti mund ta përfitojë objektin nëpërmjet procedurës së privatizimit deri në 200 m^2 në të kundërt jo. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.5 faqe 131-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

27.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Gramsh, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për rastet e privatizimit të pronave, në relacionet shoqëruese të dërguara pranë Këshillit Bashkiak të paraqitet sipërfaqja e objektit që do të privatizohet në përputhje me koeficientet që i takon përfituesit bazuar në kontratat e qirasë duke përmbushur edhe njëkohësisht detyrimet ligjore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **3 raste**, taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur saktë, pasi vlera e përllogaritur nga Bashkia Gramsh rezulton më e lartë se ajo që parashikon kuadri ligjor. Në **4 raste** janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu në **1 rast** u konstatua se dokumentet e pasurisë nuk janë ngarkuar të rifreskuara gjatë tre muajve të fundit nga data e aplikimit për leje ndërtimi. Mangësitë dhe shkeljet e konstatuara janë evidentuar për objektet: -Leje ndërtimi "Rikonstuksion, shtesë anësore dhe në lartësi, e objektit 2 kate me podrum", miratuar me Vendim nr. 1396/5, datë 07.05.2024, me zhvillues N. R.; -Leje ndërtimi "Objekt 1 dhe 2 kate, me podrum", miratuar me Vendim nr. 1470/5, datë 29/05/2024, me zhvillues M. K.; -Leje ndërtimi "Objekt shërbimi 2 kate", miratuar me

Vendim nr. 4375/5, datë 19/01/2024, me zhvillues A. A. dhe R. A.; -Leje ndërtimi "Magazinë 1 kat me mur rrethues", miratuar me Vendim nr. 4100/5, datë 01/12/2023, me zhvillues A. B.; -Leje ndërtimi "Rikonstruksion (me ndryshim volumi) dhe shtesë kati i objektit 1 kat", miratuar me Vendim nr. 3543/5, datë 30/11/2024, me zhvillues L. D. dhe F. D.; Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me -Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 27, pika 3; Ligji nr. 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, neni 46, pika 1; Paketa Fiskale, miratuar nga Bashkia Gramsh, pika 4.2. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.6 faqe 155-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

28.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, Bashkia Gramsh, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi:

- të kryej përllogaritjen e saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak, Gramsh.
- të shqyrtojë aplikimet dhe të japin vendimet e miratimit ose refuzimit, brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore;
- të sigurohet që gjatë shqyrtimit të aplikimit për leje ndërtimi, dokumentacioni i pronësisë të jetë i rifreskuar brenda një periudhe jo më të gjatë se tre muaj nga data e aplikimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

29.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV në Bashkinë Gramsh, u konstatuan mangësi dhe praktika joefektive, si më poshtë:

- Struktura organizative nuk ka pasur numrin minimal prej 6 profesionistësh, siç kërkohet nga neni 14 i Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, i cili përcakton se autoritetet e qeverisjes vendore duhet të kenë jo më pak se 6 profesionistë, bazuar në popullsi.
- Nuk janë hartuar plane pune mujore, tremujore dhe vjetore, në kundërshtim me VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore*", pika b.ii.
- Nuk janë dërguar raportime periodike tre-mujore pranë IKMT, në kundërshtim me nenin 5 pika f) të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "*Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme*", i ndryshuar.
- Nuk është dokumentuar me foto ose video asnjë kundërvajtje apo proces prishjeje, në kundërshtim me nenin 41 pika a) të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë*".
- Gjoba e vendosur prej 500,000 është e pabazuar, pasi sipas nenit 52 pika 1, nënpika e) të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, gjoba duhet të jetë e barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por jo më pak se 35,000 lekë/m².
- Vendimi i marrë për prishjen e objektit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar, veprime në kundërshtim me nenin 52 pika 6 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar.
- Nuk janë nisur procedura kallëzimi penal për kundërvajtësit, siç kërkohet nga neni 5 pika dh) i Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "*Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme*", i ndryshuar dhe neni 199/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
- Nuk janë ndjekur procedurat për arkëtimin e gjobave, duke mos kërkuar nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit, në kundërshtim me nenin 16/a të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar si dhe nenin 30 pika 4 të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative".

- Nuk janë kryer inspektime mbi objektet me leje ndërtimi dhe nuk janë miratuar akte kontrolli, në kundërshtim me nenin 51 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.7 faqe 162-171 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

29.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Gramsh, në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, të marrë masat për:

- Ristrukturimin e plotë të IMTV-së, duke garantuar organizimin e brendshëm, përmes rishikimit të strukturës organizative dhe rekrutimin të stafit me kapacitete të përshtatshme profesionale.
- Hartimin dhe miratimin e planeve të punës mujore, tremujore dhe vjetore, duke përcaktuar objektivat, afatet dhe përgjegjësit për realizimin e tyre.
- Dokumentimin me foto dhe/ose video të çdo kundërvajtjeje, procesi inspektimi apo prishjeje, me qëllim sigurimin e transparencës, gjurmueshmërisë dhe provueshmërisë ligjore të veprimeve të ndërmarra.

Menjëherë dhe në vijimësi

29.2.Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Gramsh, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të marrë masat për kryerjen periodike të inspektimeve mbi objektet me leje ndërtimi, me qëllim sigurimin e mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe parandalimin e shkeljeve në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Gramsh janë lënë për zbatim gjithsej **27** masa nga të cilat:
- **20** Masa organizative;
-**1** Masë për shpërblim dëmi ne vlerën **264,970 lekë pa TVSH**;
-4 Masa për uljen e borxhit tatimor për te rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (te ardhura të munguara) në vlerën **66,975,686 lekë**;
-2 Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficience dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën **3,172,806 lekë**.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve rezultojnë se **12** rekomandime janë te zbatuara, **3** të zbatuara pjesërisht, **3** në proces zbatimi dhe **9** rekomandime të pa zbatuara.

Gjithashtu nga Bashkia Gramsh nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në KLSH duke mos respektuar kështu edhe afatin 20 ditor dhe atë 6 mujor. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, germa "c", neni 30, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.8 faqe 172-194 të Projekt Raportit të Auditimit).

30.1 Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. Masa organizative

11.1. Rekomandim: Drejtorisë së shërbimit Pyjor t'i kërkojë informacion Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me qëllim evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për

zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.1. Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. Masa organizative

12.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e 6 pronave të certifikuara në ASHK Elbasan, por pa vlerë respektive, si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Gramsh.*

Menjëherë dhe në vijimësi

17.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë të gjitha masat e nevojshme për lidhjen e një Akt-marrëveshjeve me subjektet zhvillues "Z. E. L., Znj J. L." dhe me subjektin zhvillues "K." SHPK me NIPT ..., për kalimin e sipërfaqes prej 166.8 m^2 banim në favor të Bashkisë Gramsh sipas pjesëve takuese së sipërcituar.*

Masa për shpërblim dëmi

3.1. Rekomandimi: *Bashkia Gramsh të arkëtojë vlerën prej* ***264,970 lekë pa TVSH*** *nga sipërmarrësi i punimeve BOE "F" SHPK & "Sh." SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës me nr. 1931 prot., datë 28.05.2021 me objekt "Sistemim asfaltim lagjja "Ish reparti Ushtarak" Bashkia Gramsh.*

Masa për administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficience dhe efektivitet dhe 5.1. Rekomandimi: *Inspektorati i Mbrojtës Territorit (IMT) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Gramsh, të kërkojë në Gjykatë, shndërrimin e vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 "Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv" dhe neni 30 "Arkëtimi i shumave të detyrimeve" të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe arkëtimi i vlerës* ***5,806,667 lekë*** *e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Gramsh.*

Menjëherë

C. Masa për uljen e borxhit tatimor për rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

3.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e ndërtesave/objekteve në total në vlerën **25,623,225 lekë** duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30/4/2015, "*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*", nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Gramsh), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **8,815,693 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të kryera me bankë për vitet 2023-2024, me zgjedhje u audituan dy kontratat për realizimin e shërbimit të pranimit, depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve të Bashkisë Gramsh, të nënshkruara ndërmjet bashkisë dhe OE *"E"* Sh.A me nr. 719 prot., datë 16.02.2023, dhe nr. 649 prot., datë 09.02.2024 ku u konstatua:

- Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, në total është situacionuar në total 2,222.106 ton mbetje urbane të depozituara pranë impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan *(Shoqërisë "E" Sh.A)* e ndarë në situacione mujore konkretisht 1,788.886 ton mbetje urbane për zonat urbane dhe 433.22 ton mbetje urbane për zonat rurale. Për sasinë 2.222.106 ton mbetje urbane është faturuar vlera totale 5,555,265 lekë pa TVSh sipas faturave ditore që i përket dokumentimit të peshimit të mjetit në gjendjen fillestare me ngarkesë dhe pa ngarkesë. Ky dokumentacion në zbatim të kushteve të kontratës së shërbimit të sipërcituar shoqërohet Raportin mujor me objekt *"Raporti i Sektorit të Sipërmarrjes të shërbimeve publike, Pastrim Gjelbërmit, Varrezave Publike (të reja dhe të vjetra) si dhe Dekori i qytetit"*. Nga auditimi u konstatua se për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, janë situacionuar më tepër **117 ton mbetje urbane të depozituara në impiantin e trajtimit të mbetjeve në vlerën 292,500 lekë pa TVSh** (117 ton * 2,500 lekë/ton = 292,500 lekë), duke marrë në konsideratë faktin që mjeti me targë ... ka kapacitet mbajtës 3.83 ton ndërkohë që përgjatë kësaj periudhe është situacionuar depozitim ditor i mbetjeve më tepër nga kapaciteti mbajtës i mjetit.
- Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, në total është situacionuar në total 2,269.16 ton mbetje urbane të depozituara pranë impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan *(Shoqërisë "E." Sh.A)* e ndarë në situacione mujore konkretisht 1,911.08 ton mbetje urbane për zonat urbane dhe 358.08 ton mbetje urbane për zonat rurale. Për sasinë 2,269.16 ton mbetje urbane është faturuar vlera totale 5,672,900 lekë pa TVSh sipas faturave ditore që i përket dokumentimit të peshimit të mjetit në gjendjen fillestare me ngarkesë dhe pa ngarkesë. Ky dokumentacion në zbatim të kushteve të kontratës së shërbimit të sipërcituar shoqërohet Raportin mujor me objekt *"Raporti i Sektorit të Sipërmarrjes të shërbimeve publike, Pastrim Gjelbërimit, Varrezave Publike (të reja dhe të vjetra) si dhe Dekori i qytetit"*. Nga auditimi u konstatua se për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, janë situacionuar më tepër **85.44 ton mbetje urbane të depozituara në impiantin e trajtimit të mbetjeve në vlerën 213,600 lekë pa TVSh** (85.44 ton * 2,500 lekë/ton = 213,600 lekë), duke marrë në konsideratë faktin që mjeti me targë ... ka kapacitet mbajtës 3.83 ton ndërkohë që përgjatë kësaj periudhe është situacionuar depozitim ditor i mbetjeve më tepër nga kapaciteti mbajtës i mjetit. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.3 faqe 65-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gramsh, të marrë të gjitha masa administrative për

arkëtimin e vlerës prej **506,100 lekë** nga OE *"E."* Sh.A, si pasojë e mbi faturimit të kapacitetit mbajtës të mjetit për mbetjet urbane.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në objektin *Rikonstruksioni i Gjimnazit "Shefqet Guzi"* nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionin përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt me vlerë **2,396,609 lekë pa TVSH / 2,875,930 lekë me TVSH**, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes me nr. 4533 prot., datë 14.11.2023, të lidhur midis Bashkisë Gramsh dhe OE "I." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.4 faqe 85-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1.Rekomandimi: Bashkia Gramsh të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 2,396,609 lekë pa TVSH, si pagesë e punimeve të pakryera nga subjekti "I." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 4533 prot., datë 14.11.2023, me objekt *Rikonstruksioni i Gjimnazit "Shefqet Guzi"*.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në objektin *Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme të fshatit Ceruje* nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt me vlerë **149,305 lekë pa TVSH / 179,166 lekë me TVSH**, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes me nr.2262 prot., datë 22.06.2023, të lidhur midis Bashkisë Gramsh dhe BOE "G." SHPK & "." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.4 faqe 85-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1.Rekomandimi: Bashkia Gramsh të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 149,305 lekë pa TVSH, si pagesë e punimeve të pakryera nga subjekti "G." SHPK & "V." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr.2262 prot., datë 22.06.2023, me objekt *Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme të fshatit Ceruje*.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në objektin *Rikonstruksion i rrugës Fshati Mashan, Njësia administrative Kodovjat, Bashkia Gramsh* nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt me vlerë **2,990,100 lekë pa TVSH / 3,588,120 lekë me TVSH**, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes me nr. 4512 prot., datë 15.10.2024, të lidhur midis Bashkisë Gramsh dhe BOE "T." SHPK & "S." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.4 faqe 85-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1.Rekomandimi: Bashkia Gramsh të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 2,990,100 lekë pa TVSH, si pagesë e punimeve të pakryera nga subjekti "T." SHPK & "S." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 4512 prot., datë 15.10.2024, me objekt *Rikonstruksion i rrugës Fshati Mashan, Njësia administrative Kodovjat, Bashkia Gramsh*.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në objektin *Ndërtim i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësorë* nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionin nr.3 dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt,

rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt me vlerë **2,773,579 lekë pa TVSH / 3,328,295 lekë me TVSH**, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes me nr.4631 prot., datë 23.10.2024, të lidhur midis Bashkisë Gramsh dhe OE "M." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.4 faqe 85-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Bashkia Gramsh të ngrejë një grup pune për verifikimin e objektit *Ndërtim i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësorë,* mbi kontrollin e vendosjes së hekurit Ø6 në të gjitha brinjët për secilin gabion me përmasa 1x1x1, 1x1x1.5, 1x1x2 dhe 1x1x2.5 përgjatë gjithë mbrojtjes lumore, në të 4 rreshtat e tij përgjatë gjatësisë së mbrojtjes lumore dhe të mbajë dokumentacionin verifikues.
Në rast se gjatë verifikimit në terren nga grupi i ngritur nga Bashkia, verifikohet që kjo sasi hekuri nuk është vendosur nga sipërmarrësi i punimeve, Bashkia Gramsh të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 1,315,579 pa TVSH, si pagesë e punimeve të pakryera nga subjekti "M." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 4631 prot., datë 23.10.2024, me objekt *Ndërtim i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësorë*.

Menjëherë

5.2.Rekomandimi: Bashkia Gramsh të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 1,458,000 lekë pa TVSH, si pagesë e punimeve të pakryera nga subjekti "M." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 4631 prot., datë 23.10.2024, me objekt *Ndërtim i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësorë*.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1. Gjetje nga auditimi: Për procedurën e prokurimit me objekt: *"Rikonstruksion i Shkollës "Rilindja", Bashkia Gramsh" viti 2024, me fond limit 92,556,705 lekë pa TVSh*. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues OE, "I." ShPK me ofertën e paraqitur në vlerën 87,923,313 lekë pa TVSh, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur, ndërkohë që KVO ka skualifikuar BOE "B." ShPK & "C." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 76,552,633 lekë pa TVSh me devijime, që mund të përkufizoheshin si devijime të vogla, duke sjellë një diferencë prej **11,370,680 lekë pa TVSh**. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.4 faqe 85-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Gramsh, të marrin masa për garantimin e përdorimit me efektivitet të fondeve në dispozicion duke vlerësuar me kujdes dhe paanshmëri mangësitë që çojnë në skualifikimin e operatorëve ekonomik sidomos në rastet kur kjo vendimmarrje shoqërohet me pasoja financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH
1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimit i taksave dhe tarifave vendore rezultoi se, gjendja e debitorëve progresive në fund të vitit 2024 është në vlerën **38,443,251 lekë** që përbën të ardhura të munguara, nga të dhënat e Drejtorisë së Financës dhe DTTV kjo vlerë nuk është kontabilizuar.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", neni 15, pika dhe pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.2 faqe 32-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* me kundërparti llogarinë 470 *"Të ardhura për t'u marrë"*, si dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve nga taksat e tarifat vendore të cilat deri në fund të vitit 2024 në vlerë progresive arrijnë **38,443,251 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore.

Deri më datë 31.03.2026

2. Gjetje nga auditimi: Nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, rezultojnë 27 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, të 4 subjektet kanë detyrime me një efekt financiar me vlerë **totale 2,000,000 lekë** e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Gramsh. Këto veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me Ligjin nr. 71.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, neni 4. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.2 faqe 32-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të Bashkisë Gramsh, të marrë masat për ndjekjen e pagesave të subjekteve që ushtrojnë e aktivitetin e tregtimit të lëndëve djegëse sipas autorizimeve si dhe arkëtimin e diferencës së detyrimeve të papaguara në vlerë **totale prej 2,000,000 lekë**, nga subjektet:

1. K. ShPK me nipt ... për vlerën 800,000 lekë (për të dy pikat që tregton lëndë djegëse);
2. S. ShPK me nipt ... për vlerën 400,000 lekë;
3. G. ShPK me nipt ... për vlerën 800,000 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: U konstatua se Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan është debitorë ndaj Bashkisë Gramsh për vlerën **1,812,500 lekë** të ardhura të munguara vlerë kjo e pakontabilizuar, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.2 faqe 32-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Bashkia Gramsh, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që të arkëtojë detyrimin prej 1,812,500 lekë ndaj Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan si dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të kontabilizojë detyrimin.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, në territorin e Bashkisë Gramsh kanë ushtruar aktivitet *(referuar regjistrit të lejeve në faqen zyrtare të AKBN-së)* 27 subjekte në fushën e energjetikes. Për 25 subjekte ndërmjet Bashkisë Gramsh dhe Shoqërive Koncesionare janë nënshkruar kontrata qiraje, ku për vitin 2024 vetëm 13 prej tyre kanë shlyer detyrimet në vlerën 6,238,609 lekë ndërsa vetëm Subjekti *"R. E."* ShPK nuk ka shlyer detyrimin

në vlerën **622,860 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Gramsh.** Për 12 subjekte është lidhur kontratë qiraje ndërmjet palëve por ende nuk ka filluar pagesë me pretendimin se këto subjekte nuk janë të pajisura me leje ndërtimi. Ndërkohë që referuar Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016, *"Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"*, pikat 19-21, pagesat e tarifave të qirasë fillojnë në momentin e lidhjes së kontratës. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.5 faqe 131-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Gramsh në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të marrë masa të aplikojë pagesën e tarifave të kontratave të qirasë për dhënien e sipërfaqeje të fondit pyjor kullosor nga momenti i lidhjes së kontratës për 12 subjekt sipas listës të paraqitur në Aneksin nr. 16.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të marrë masa, për arkëtimin e vlerës prej **622,860 lekë** nga subjekti *"R. E."* ShPK, për detyrimeve të pashlyera të kontratës së qirasë, për ushtrimin e aktivitetit në fushën e energjetikes, lidhur me Bashkinë Gramsh.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, Bashkia Gramsh ka dhënë në përdorim me qira 26 objekte banimi/ndërtesa (kontrata ekzistuese) me një sipërfaqe totale prej 4,737.6 m^2, nga të cilat 23 prej tyre për objekte banimi dhe 3 me kontratë enfiteozë. Për sa i përket qiramarrësve që përdorin ndërtesat për objekt banimi vetëm 15 prej tyre janë të pajisur me kontratë qiraje aktive, ndërsa 8 prej tyre nuk janë të pajisur me kontratë qiraje. Nga auditimi u konstatua se, deri më datë 31.12.2023, gjendja debitore ka qenë në vlerën 4,850,595 lekë. Përgjatë vitit 2024 është likuiduar vlera 543,500 lekë dhe janë krijuar detyrime në vlerën 947,160 lekë, ndërsa gjendja debitore më datë 31.12.2024, është në vlerën **5,254,255 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Gramsh.** Mos lidhja e kontratës së qirasë me të gjithë poseduesit e objekteve të banimit të cilat janë pronë e Bashkisë Gramsh është në shkelje të kërkesave të VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014, *"Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"* i ndryshuar, Kreu I, pika 6, germa "a", nënpika "i". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.5 faqe 131-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Bashkia Gramsh, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e ndërtesave/objekteve në total në vlerën **5,254,255 lekë** duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat. Për familjet që banojnë në objektet/apartamentet në pronësi të Bashkisë Gramsh pa kontratë qiraje, të merren masa për pajisjen e tyre me kontratë duke përmbushur njëkohësisht edhe detyrimet ligjore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në **1 rast,** taksa e ndikimit në infrastrukturë (TNI) nuk është përllogaritur e saktë. Bashkia Gramsh nuk ka marrë të gjitha masat për të përftuar të ardhurat që legjislacioni parashikon për objektet që pajisen me leje ndërtimi. Më konkretisht, kjo anomali është konstatuar për objektin: - Leje ndërtimi "Magazinë 1 kat me mur rrethues", miratuar me Vendim nr. 4100/5, datë

01/12/2023, me zhvillues A.B.; Nga përllogaritjet e kryera, rezulton se vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë duhet të jetë **147,186.9 lekë**. Përllogaritja e kësaj takse duhet të ishte realizuar duke u mbështetur në vlerën më të lartë të dalë nga analizat e kryera sipas përcaktimeve të nenit 27, pika 3 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në përputhje me nenin 46, pika 1 të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, si dhe në zbatim të Paketës Fiskale të miratuar nga Bashkia Gramsh, pika 4.2. Vlera e llogaritur nga Bashkia Gramsh me mungesë prej **73,593.9 lekë** përbën të ardhura të munguara për Bashkisë Gramsh. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.6 faqe 155-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, të marrë masat për arkëtimin e vlerës prej 73,593.9 lekë, si diferencë e rrjedhur nga përllogaritja e gabuar e taksës së ndikimit në infrastrukturë, për lejen e ndërtimit të miratuar me Vendim nr. 4100/5, datë 01/12/2023 për objektin: *"Magazinë 1 kat me mur rrethues"*.

Menjëherë

E. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimit i taksave dhe tarifave vendore rezultoi se, gjendja e debitorëve progresive në fund të vitit 2024 është në vlerën **2,946,793 lekë që përbëjnë** detyrim për arkëtim. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", neni 15, pika, dhe pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2.2 faqe 32-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gramsh në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të analizojnë, nxjerrin përgjegjësitë dhe marrin të gjitha masat ligjore për arkëtimin e detyrimeve debitorë për taksat dhe tarifat vendore, të cilat në fund të vitit 2024, arrijnë në vlerën prej **2,946,793 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

F. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15 "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", nenin 58 "*Llojet e masave disiplinore*", të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*", **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Gramsh, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore në Shërbimin Civil", i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale **për 10 punonjës**, si më poshtë:

I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Nenin 15 *"Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, Nenin 58 *"Llojet e masave disiplinore"*, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Gramsh**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për

dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a. "Vërejtje", sipas shkeljeve të konstatuara për punonjësit si më poshtë:
1. Z. E. H., *me funksion Drejtor i Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e KVO-së dhe* në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare*:*
Për mangësi në procesin e hartimit të Programit Buxhetor afat mesëm 2024-2026 dhe buxhetin e vitit 2024 si dhe mangësi në procedurat e zbatimit te buxhetit të vitit 2024.
Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar neni 19, 20, 22, 32, 33, 47, 67, në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* neni 9, pika 1.3, germa "c" dhe "ç", ne kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore"* nenet 40,41,45,46.

- Për moszbatim të Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"*; *"Përgjegjësitë e Grupit të Menaxhimit Strategjik"* pikat 28-33.
- Për moszbatim të Udhëzim nr. 22, datë 30.7.2018 *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore"* kreu II, pika 27, *"Përgjegjësitë e nëpunësit zbatues"* dhe pikat 28-30;
- Për moszbatim të Ligjit nr. 162/202, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe akte të tjera nënligjore për prokurimin publik;
- Nuk u paraqitën dokumente për kryerjen e inventarëve fizikë për aktivet e institucionit, për rrjedhojë llogaritë e aktiveve në bilancin e vitit 2024, janë mbyllur për gjendjen kontabël. Në këto kushte, llogaritë e pasqyrave financiare, nuk janë të rakorduar me gjendjen fizike gjë e cila nuk krijon besueshmëri mbi vërtetësinë e tyre. Në këtë rast, nxjerrja e pasqyrave financiare pa kryer inventarizimin fizik e të gjithë aseteve;
- Në gjendjen e llogarisë 202 *"Studime dhe kërkime"* janë përfshirë projektet *"Rikonstruksion i Lagjes "Holta"* dhe *"Rikonstruksion i Lagjes Sporti nr. 2"*, në vlerën totale 2,810,976 lekë *(kosto historike)* të cilat nuk duhej të kontabilizoheshin në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë;
- Nga auditimi i analitikëve u konstatua se, llogaria 210 *"Toka, troje, terrene"* e pasqyruar në bilanc për vlerën 50,742,734 lekë dhe llogaria 211 *"Pyje, kullota, plantacione"* në vlerën 13,203,906 lekë, janë të pa analizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari.
- Gjendja e llogarisë 231 *"Për aktive afatgjata materiale"* në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve konstatohet se, për vitin 2024 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punimet si dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, që i përkasin llogarisë 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* dhe 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"* konkretisht objektet: *"Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore"* me vlerë kontrate 80,452,800 lekë pa TVSh me OE *"M."* ShPK me afat përfundimi punimesh më datë 24.03.2025, për të cilën janë likuduar situacionet pjesore në vlerën 34,455,010; *"Rikonstruksion asfaltim rruga e fshatit Mashan"* me vlerë kontrate 79,164,260 lekë pa TVSh me OE *"T"* ShPK me afat përfundimi punimesh më datë 15.05.2025, për të cilën

janë likuiduar situacionet pjesore në vlerën 35,638,680, dhe *"Rikonstruksioni Shkollës 9-vjeçare "Rilindja" Bashkia Gramsh"* me vlerë kontrate 87,923,313 lekë pa TVSh me OE *"I."* ShPK me afat përfundimi punimesh më datë 13.06.2025, për të cilën janë likuduar situacionet pjesore në vlerën 23,000,000. Në këto kushte gjendja e kësaj llogari nuk duhej të paraqitej në pasqyrat financiare në vlerën 0 lekë, kur ka kontrata investimesh në proces, pra në këtë llogari duhej të pasqyrohej vlera e situcioneve pjesore të likuiduara.;

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 *"Investime për aktive afatgjata jo materiale"* paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 *"Investime për aktive afatgjata materiale"* në vlerën 0 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 0 lekë e cila nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 *"Nga fondet e veta të investimeve"* e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 *"Teprica e grandeve kapitale të brendshme"* në vlerën 693,000 lekë.

2. Z. O. Ç., në cilësinë e Njësisë së Prokurimit;
3. Zj. L. Z., në cilësinë e Njësisë së Prokurimit;
4. Zj. E. M., në cilësinë e Njësisë së Prokurimit;
5. Z. E. S., në cilësinë e Njësisë së Prokurimit.
Për moszbatim të Ligjit nr. 162/202, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe akte të tjera nënligjore për prokurimin publik.

6. Z. A. J., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore;
Për moszbatim të Ligjin nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", neni 15, pika 2, Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, neni 4, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 5.

II. Për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kodin e Punës:
Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", neni 15 "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*", shkronja c, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 "*Masat Disiplinore*" dhe në kontratën individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Gramsh, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore "**Vërejtje me shkrim**", për punonjësin:
1. Z. E. S., në cilësinë e Njësisë së Prokurimit;
2. Z. L. H., në cilësinë e Njësisë së Prokurimit;
3. Z. J. M., në cilësinë e Njësisë së Prokurimit;
4. Z. X. B., në cilësinë e KVO-së.
Për moszbatim të Ligjit nr. 162/202, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe akte të tjera nënligjore për prokurimin publik.

Në vijimësi

F.1. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.
Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës

administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre.
Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte "Vërejtje", përkatësisht:

1. Z. E. K.- në cilësinë e Njësisë së Prokurimit.
2. Z. K. T.- në cilësinë e Njësisë së Prokurimit.
3. Z. A. B.- në cilësinë e Njësisë së Prokurimit.
4. Z. M. A. në cilësinë e Njësisë së Prokurimit.
5. Z. A. S.- në cilësinë e KVO-së.
6. Z. A. S.- në cilësinë e KVO-së.
7. Z. A. Ç.- në cilësinë e KVO-së.
8. Z. E. H.- në cilësinë e KVO-së.

G. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTARTËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë**:

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

Në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT